MUZEU PEABODY
UNIVERSITETI HARVARD

MALET E GJIGANTËVE

STUDIM RACOR DHE KULTUROR
KUSHTUAR GEGËVE TË SHQIPËRISË SË VERIUT

CARLETON S. COON

Përkthyer nga

Mal BERISHA

BOTIME
EDUALBA



Gegë tipik nga Malësia e Madhe

MALET E GJIGANTËVE

STUDIM RACOR DHE KULTUROR
KUSHTUAR GEGËVE TË SHQIPËRISË SË VERIUT

Titulli i origjinalit: THE MOUNTAINS OF GIANTS
- A Racial and Cultural Study of the North Albanian
Mountain Ghegs by Carleton S. Coon

Papers of the Peabody Museum of American Archeology
and Ethnology, Harvard University vol. xxiii -no. 3
Cambridge, Massachusetts, USA.

Published by the Museum 1950

Botues: Botime EduALBA
Redaktorë: Ndrek Gjini, Mehmet Elezi, Edlira Birko
Ballina: Ina Musai
Fotografia e Alpeve në kopertinë: Kristaq Janushi

© Mal Berisha, 2024
www.Malberisha.com

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Coon, Carleton S.
Malet e gjigantëve : studim kulturor kushtuar
gegëve të Shqipërisë së veriut / shkruar nga Carleton
S. Coon ; përkthyer nga Mal Berisha ; redaktoi
Ndrek Gjini. - Tiranë: Edualba, 2024.
316 f. : me fotogr. ; 17 x 24 cm.

Tit. origj.: The mountains of giants : A racial and cultural
study of the north Albanian mountain Ghegs .

ISBN 9789928121790

1. Antropologjia 2. Antropometria 3. Shqiptarë

572.9(=18)

Shtypur në shtypshkronjën "Flesh", Tiranë

DR. CARLETON S. COON



Dr. Carleton S. Coon lindi më 23 qershor 1904. Ai konsiderohet si një nga antropologët më të rëndësishëm amerikanë të shekullit të 20-të. Në vitin 1925 kur ishte vetëm 24 - vjeç ai u diplomua për antropologji me Medalje të Artë në Universitetin e Harward - it. Në vitin 1928, ai u emërua profesor i antropologjisë pranë këtij Universiteti. Coon ka shërbyer si dekan i Fakultetit të Antropologjisë në Harvard dhe për një kohë të gjatë ka qenë President i Shoqatës së Antropologëve të Shteteve të Bashkuara. Në vitin 1948, ai u bë kurator i etnologjisë në Muzeun e Universitetit të Pensilvanisë dhe njëherazi profesor po në atë universitet.

Dr. Coon është shumë i rëndësishëm për ne shqiptarët, pasi përveç veprave të tij të çmuara, ai shkroi edhe librin "Malet e Gjigantëve", një studim racor dhe kulturor kushtuar Gegëve të Shqipërisë së Veriut. Ai është i pari dhe pothuajse i vetmi antropolog deri më sot që ka ndërmarrë një ekspeditë kaq të gjatë në kohë, në vitet 1929 - 1930, dhe kaq të shtrirë në hapësirën e Maleve të Gegnisë. Ai ka jetuar në terren, i ka matur trupat e shqiptarëve me dorën e tij, i ka analizuar të dhënat dhe e ka argumentuar mbijetesën Iliro - Dardane - Dinarike të shqiptarëve Gegë në veri të Shqipërisë. Si antropolog i pavarur, ai dha mendimin e tij pa asnjë ndikim ideologjik. Studime të ngjashme të kryera nga antropologët shqiptarë gjatë viteve të diktaturës nuk kanë mundur të përmendin emrin dhe veprën e Prof. Coon në punimet e tyre.

Studimi i matjeve antropologjike të 1.067 shqiptarëve, i realizuar nga Prof. Coon, as nuk është sfiduar dhe as nuk është përsëritur më që nga viti 1930, në formë, në masë apo dhe shtrirje të tillë.

Karriera e tij shkencore filloi në vitet 1920 dhe zgjati deri në vdekjen e tij në vitin 1981. Ai dha kontribute të rëndësishme në antropologjinë moderne, duke përfshirë antropologjinë sociale dhe biologjike, si dhe studime arkeologjike. Përveç studimeve shkencore, Coon shkroi romane dhe libra për publikun e gjerë mbi historinë dhe zhvillimin e njerëzimit. Librat e tij më të njohur përfshijnë "The Story of Man"[1] (1954) dhe "The Seven Caves[2]" (1957), ku përshkruan kërkimet arkeologjike në Lindjen e Mesme. Autobiografia e tij, "Adventures and Discoveries"[3], ofron një pasqyrë të thellë të jetës dhe karrierës së tij.

Ai fliste 10 gjuhë të ndryshme, duke përfshirë ato të disa prej fiseve të izoluara që ai studioi. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Coon shërbeu në Afrikë dhe Lindjen e Mesme me Zyrën e Shërbimeve Strategjike dhe, pas luftës, u bë panelist i rregullt në programin shkencor të CBS-së, "What in the World?"[4]. Përkundër kritikëve të tij rreth teorisë së prejardhjes së pesë racave të njerëzimit, vitet e fundit, me përdorimin e analizave të ADN-së, teoria e tij rezulton të jetë e mbështetur shkencërisht.

Në përfundim, Coon është një nga personalitetet akademike që i ka dhënë formë antropologjisë fizike amerikane dhe ka një vend të çmuar për studimin e tij mbi Gegët e Maleve të Veriut të Shqipërisë. Për këtë, i jemi mirënjohës.

Prof. Carleton S. Coon është autor i këtyre librave:

Shkencë:

1. Fiset e Rifit (Studime Afrikane të Harvardit, 1931)
2. Racat e Europës (1939)
3. Historia e Njeriut (1954)
4. Karavani: Historia e Lindjes së Mesme (1958)
5. Origjina e Racave (1962)
6. Racat: Një Studim mbi Problemet e Formimit të Racës tek Njeriu
7. Popujt Gjuetarë
8. Antropologjia nga A në Zh (1963)

1 The Story of Man - Historia e Njeriut
2 "The Seven Caves", Shtatë Shpellat
3 "Adventures and Discoveries", "Aventurat dhe zbulimet"
4 "What in the World?", Çfarë në këtë botë?

9. Racat e Gjalla të Njeriut (1965)
10. Shtatë Shpellat: Eksplorimi Arkeologjik në Lindjen e Mesme
11. Formimi i Racës së njeriut
12. Popujt Gjuetarë
13. Malet e Gjigantëve: Një Studim Racor dhe Kulturor i Gegëve të Veriut të Shqipërisë (1950)
14. Antropologjia nga A në Zh (1963)
15. Racat e Gjalla të Njeriut (1965)
16. Shtatë Shpella: Eksplorimi Arkeologjik në Lindjen e Mesme
17. Raporti i Shpellës Yengema (puna e tij në Sierra Leone)
18. Përshtatjet Racore (1982)

Letërsi dhe libra me kujtime:

1. Mishi i Demit të Egër (1932)
2. Rifjani (1933)
3. Matjet në Etiopi dhe Fluturimi në Arabi (1935)
4. Një Histori nga Afrika e Veriut: Historia e një Antropologu si Agjent i OSS (1980)
5. Aventura dhe Zbulime: Autobiografia e Carleton S. Coon (1981)



Bashkëshortja e Prof. Carleton S. Coon, Mary Coon - Goodale, e veshur me rrobe të grave Gegë në trup dhe me një plis të bardhë në kokë, dëshmi e përkushtimit të autorit për ta bërë këtë studim sa më bindës e sa më shkencor.

PARATHËNIE E AUTORIT CARLETON S. COON

Të dhënat mbi të cilat bazohet ky studim janë mbledhur në Shqipërinë e Veriut gjatë vjeshtës, dimrit dhe pranverës së viteve 1929-1930. Fondet për këtë u siguruan nga Këshilli Kombëtar për Kërkime në Washington, D.C., dhe z. Francis Drexel Smith nga Colorado Springs, Colorado. Pas përfundimit të punës në terren, Këshilli Kombëtar për Kërkime, ku isha bashkëpunëtor, më pagoi pagën për një vit, si dhe shpenzimet për analizën statistikore dhe shtypjen e materialit. Më 7 prill 1932, ky studim iu paraqit Këshillit Kombëtar për Kërkime, i cili e miratoi atë.

Ai iu dorëzua dhe u miratua gjithashtu nga qeveria e atëhershme shqiptare. Për një sërë arësyesh publikimi u shty. Kështu unë, me ndihmën bujare financiare të dhënë nga Fondi Milton dhe J. H. Clark Bequest i Universitetit të Harvardit, dhe një tjetër mbështetje nga Fondi Viking, munda të punësoja një asistent në vitet 1946 - 48 për të më ndihmuar me një rishikim të plotë. Ky rishikim tani ka përfunduar. Personeli i ekspeditës së atyre viteve, 1929 - 30 përfshinte, përveç meje, zonjën Stanley Salmen (atëherë zonja Coon)[1]; z. Frederick E. Farnsworth, tani Oficer i Shërbimit të Jashtëm të SHBA; z. Anthony Stevens, anëtar i stafit të Konsullatës Amerikane në Tiranë dhe z. Stavri Frashëri[2] Në punën tonë u ndihmuam nga Gjeneral Brigade Julius C. Holmes, i Ngarkuar me Punë në Legatën Amerikane në Tiranë, doktori i ndjerë J. Dineley Prince, Ministër i SHBA - së në Jugosllavi, z. Paul deMille, Konsull i SHBA-së në Tiranë si dhe z. Joseph Shutack, anëtar i stafit të tij. Na ndihmuan gjithashtu zotërinjtë Kota, Rauf Fico dhe Xhelal Frashëri, nënpunës të qeverisë shqiptare ashtu si edhe oficerët britanikë që drejtonin xhandarmërinë shqiptare, duke përfshirë Gjeneral Percy

1 Mary Coon - me mbiemrin e lindjes Goodale, qe e martuar me Carleton Coon nga viti 1926 deri në divorcin e tyre në vitin 1944. Pas divorcit, ajo e ndryshoi emrin në Stanley Salmen.

2 Stavri Thoma Frashëri lindi më 5 gusht 1912 në qytetin e Korçës dhe rrjedh nga familja e njohur Frashëri. Ai punoi si mësues në Institutin Shqiptaro-Amerikan të Bujqësisë në Golem, Kavajë, i themeluar në vitin 1925 nga Dr. Charles Telford Erickson, një amerikan që i kushtoi jetën e tij Shqipërisë. Stavri Frashëri, si pjesë e ekspeditës së Prof. Carleton S. Coon, ka shkruar libra dhe kontribuar në studimet e tij antropologjike. (Shënim i përkthyesit)

dhe kolonelët Stirling, Martin, dhe Glegg. Po të mos kishte qenë për xhandarët e tyre, ne nuk do t'ja kishim dalë mbanë.

Gjatë këtyre viteve që kanë kaluar, që nga koha kur e bëra atë rrugëtim, kam marrë mbështetje nga shumë anë dhe shumë miq të shquar. Studiuesia e nderuar M. E. Durham më ka dhënë këshilla dhe informacione të vlefshme. Zonja Margaret Hasluck, e njohur për dijenitë e saj rreth shqiptarëve, gjithashtu nuk u kursye asnjëherë të më ndihmonte. Me të pata rastin dhe kënaqësinë të njihesha dhe të bisedoja drejt për së drejti në Kajro gjatë Luftës së Dytë Botërore, madje edhe të shfrytëzoja fondin e saj me njohuri që dukej të ishte i pafund. Faza përfundimtare e rishikimit dhe korrigjimit të këtij studimi u pasua nga ndihma bujare e një numri të madh miqësh shqiptarë, këtu në Amerikë. Peshkopi Fan Noli e lexoi pjesën e parë dhe të tetë dhe bëri mjaft korrigjime në to. Ai gjithashtu ndihmoi edhe me informacione të reja. Ndihmësi i tij besnik dhe i aftë, z. Qerim Panariti, ishte përherë i gatshëm të më ndihmonte. Kur u morëm me matjen e dy brezave Toskë - shqipëtar në lagjet e Bostonit, zotëri Panaritit iu bashkua edhe miku im i vjetër z. Peter Peterson dhe babai i tij, z. Dmitri Peterson, të dy nga Somerville, Massachusetts, si dhe nga shumë të tjerë. Ishte edhe z. Stavro Skendi nga New Yorku që më dha njohuri dhe këshilla mbi gjuhësinë shqiptare.

David de Harport dhe Dr. William Laughlin kaluan shumë mbrëmje në realizimin e programit të matjeve të sapo - përmendura. Zonja Martha Dick bëri llogaritjet dhe shtypjen në makinë shkrimi gjatë periudhës së mëvonshme të përpunimit të materialit, ndërsa Zonja Constance Woodbury e kishte bërë këtë gjë pothuajse dy dekada më parë. Bashkëshortja ime, Lisa D. Coon[3], i vizatoi hartat dhe figurat. Dr. Stanley Garn më ndihmoi të kuptoj teknikën e përtypjes, ndërkohë që Dr. William J. Crozier, si gjithmonë, më dha këshilla statistikore.

Carleton S. Coon
Cambridge, Mass. Qershor, 1948

3 Lisa D. Coon ishte bashkëshortja e dytë e prof. Coon, për të cilën thotë se e ndihmoi për hartat.

DY FJALË NGA PËRKTHYESI

Fakti që jam lindur në zemër të maleve të Gegnisë, pikërisht në Malësinë time të dashur të Gjakovës, ishte një nga arsyet kryesore që më shtyu të merrem me përkthimin e këtij libri me kaq vlerë.

Kur miku im, antropologu, gazetari dhe poeti Ndrek Gjini, ma prezantoi këtë vepër, mësova se ishte studimi i parë, i vetëm dhe më i detajuari antropologjik për Shqiptarët e Gegnisë i këtij lloji, i botuar ndonjëherë. Natyrisht, kur zbulova që Carleton S. Coon ishte një nga emrat më të mëdhenj midis profesorëve të antropologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në të gjitha kohërat, Dekan i fakultetit të tij në Universitetin e Harvardit dhe për një kohë të gjatë, Presidenti i Shoqatës së Antropologëve Amerikanë, kjo më intrigoi edhe më shumë.

Më pas mësova se ai ishte i pari dhe i vetmi antropolog i huaj, me titull profesor, që kishte ardhur në Shqipëri thjesht, me qëllimin e mirë për të studiuar racën Dinarike Iliro - Shqiptare, duke kaluar vjeshtën, dimrin dhe pranverën e viteve 1929-1930 midis Gegëve të Veriut të Shqipërisë. Kjo më frymëzoi edhe më shumë.

Ai nuk u bë antropolog pasi u njoh me këtë fenomen të lashtë Iliro - Shqiptar. Ai erdhi ta studionte dhe ta bënte atë të njohur në botën akademike të Harvardit, një nga universitetet më të njohura në botë, në kohën kur ai tashmë kishte marrë titullin Profesor i Antropologjisë.

E gjithë kjo përfaqëson vijimësinë e dëshirës sime të madhe për të bërë të njohura vlerësimet e autorëve anglo-amerikanë rreth autoktonisë, traditës, historisë, kulturës dhe racës shqiptare. Për mua, studimet, shkrimet dhe botimet e tyre përbëjnë kulmin e shkencave albanologjike, në çfarëdo forme qofshin ato. Në mos me libra të veçantë, të paktën me botime dhe studime, syrit tim nuk i kanë shpëtuar emra anglo – amerikanësh të cilët do t'i rendit më poshtë.

Prandaj, me këtë libër i shtova punës sime për vlerësimin e veprave të anglo-amerikanëve, duke filluar që nga revista amerikane, "National Geographic Magazine", shkrimet e Richard Knolles, Edward Brown, Lady Mary Wortley Montagu, William Martin Leake, Lord Byron, John Hobhouse, Charles Cockerell, Edward

Lear, David Urquhart, Robert Curzon, Edmond Spencer, William Winckfield, George Finlay, Henry Fanshawe Tozer, Clement C. Moore, Arthur Evans, Arthur MacMorrough Kavanagh, Edward Frederick Knight, Fanny Janet Blunt, Henry N. Brailsford, Duncan Heaton Armstrong, Norman Douglas, George Philippson, Henry Hodgkinson, Aubrey Herbert, Edith Durham, Margaret Hasluck, Kontesha Elizabeth Herbert, Ruth Padinnginton, Owen Pearson, Charles Telford Erickson, Edith Pierpont Stickney, Benjamin Disraeli, Herman Bernstein, Henry Holland, Robert Elsie, Sir Noel Malcolm, prof. David Abulafia, dr. David Shankland, Michael Gunn, Bejtullah Destani dhe të tjerë, për të ardhur te ky libër në gjuhën shqipe.

Falënderoj mikun tim, Presidentin e Kompanisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, z. Avni Ponari, për ndihmën e jashtëzakonshme i cili mundësoi financimin për përkthimin, botimin dhe promovimin e këtij libri. Jam thellësisht mirënjohës për kontributin e tij në mbështetje të artit dhe kulturës, përmes platformës së parë dhe të vetme digjitale për lexim librash në Gjuhën Shqipe: www.Audiobooks.AL, si dhe për mbështetjen e "Orkestrës së Harqeve SIGAL".

Po ashtu, falënderoj mikun tim, prof. dr. Bardhyl Musai, për ndihmën e dhënë në konceptimin sa më estetik të librit, si dhe z. Flamur Hudhri për ndihmën në printimin e këtij libri. Falënderoj z. Elinor Bajraktari për ndihmesën e dhënë në fushën digjitale. Në fund, por jo nga rëndësia, dua të falënderoj familjen time për mbështetjen e pakursyer.

Dëshiroj të theksoj se tabelat dhe figurat ilustruese të librit janë vënë në tekstin e librit në shqip, ashtu sikursejanë në origjinal në botimin anglisht, për të ruajtur autenticitetin, si dhe për të mundësuar që, nëse ky studim iu vlen antropologëve shqiptarë, ta përdorin atë në formën e tij origjinale. Presupozojmë se antropologët shqiptarë ose ata që janë të interesuar për këtë studim e kanë gjuhën angleze si gjuhë të përdorur në profesionin e tyre. Për më tepër, pas kaq shumë kohe që kur ky studim është kryer dhe ky libër është botuar, vlerat numerike nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe. Ajo që ka rëndësi për antropologët shqiptarë është metodologjia shkencore dhe përkushtimi profesional i prof. Carleton S. Coon.

Shpresoj që ky libër të ndriçojë shumë mendje, të huaja dhe shqiptare, mbi rëndësinë dhe vlerat e Gegëve të Malësisë së Veriut, në ruajtjen e trashëgimisë dhe pranisë së pastër të racës Iliro-Shqiptare në trojet tona.

Mal Berisha
Tiranë, 5 tetor 2024

ANËTARËT E "KLUBIT TË GJURMUESVE"

Një organizatë private e studentëve të antropologjisë në Universitetin e Harvardit dhe Kolegjit Radcliffe, për të treguar vlerësimin dhe dashurinë e tyre për profesor Coon, ndërmorën mbledhjen e një fondi për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve të botimit të kësaj monografie.

Ata janë:

James M. Andrews
J. Lawrence Angel
Conrad M. Arensberg
John K. Bodel John Otis Brew
L. Cabot Briggs
Kirk Bryan
Ripley P. Bullen
Chester S. Chard
Harold J. Coolidge
Charlene Craft
Robert W. Ehrich
Paul H. Gebhard
Mary Ellen Goodman
Emil W. Haury
Hugh Hencken
John D. Hoag
Henry Hornblower, II
Bruce Howe
Frederick Johnson
Alfred Kidder, II
Alfred V. Kidder
Solon T. Kimball
Clyde Kluckhohn
Ralph Linton
Derwood W. Lockard
Samuel K. Lothrop
Hallam L. Movius, Jr.
Henry I. Myers
Douglas L. Oliver
John Pelzel
Philip Phillips
H. E. D. Pollock
F. L. W. Richardson
John H. Rowe
H. Medill Sarkisian
J. F. Paul Schumacher
Charles I. Shade
Charles E. Snow
Marshall Stone
Walter W. Taylor, Jr.
Mischa Titiev
Alfred M. Tozzer
Robert Wauchope
Harold P. Winchester
Frederick R. Wulsin

PASQYRA E LËNDËS

PROBLEMI DINARIK 23
TOKA E GEGËVE TË MALËSISË 33
TEKNIKAT DHE ZËNIA ME PUNËT E DORËS
EKONOMIA NË NJË SHOQËRI TË IZOLUAR 45
Veglat e punës - rishqyrtim 49
SISTEMI FAMILJAR: KUSH MARTOHET ME KË DHE PËRSE 75
POLITIKA DHE GJAKMARRJA 95
JETA RITUALE 107
HISTORIA E MALËSISË SË GEGNISË 117
PËRBËRJA ETNIKE E SERIVE TONA METRIKE 141
Tabelat 3: Matjet dhe indekset 145
Tabela 4: Vëzhgimet 147
ANTROPOLOGJIA FIZIKE E STUDIUAR SIPAS MOSHËS,
DETYRËS, FUNKSIONIT DHE TRASHËGIMISË 157
FENOTIPI OSE KARAKTERISTIKAT TRUPORE
TË GEGËVE TË MALËSISË 165
Matjet në përgjithësi 165
Ndryshueshmëria e serisë në tërësi dhe e fiseve në veçanti 176
Dallimet mes karakteristikave trupore midis fiseve.
Vlerësimi statistikor i tyre 178
Ndryshueshmëritë rajonale në madhësinë dhe formën e trupit 182
Ndryshueshmëritë e kupolës kranale sipas krahinave 185
Ndryshueshmëritë e formës së fytyrës sipas krahinave 186
Ndryshueshmëritë krahinore të pilozitetit 190

Ndryshueshmëritë rajonale në pigmentim. 191
Përmbledhja e dallimeve krahinore midis fiseve 178

MOSHA. 199
Saktësia e të dhënave të tashme 199
Mosha në kampion si e tërë 200
Ndryshueshmëritë fisnore në moshë. 201
Mosha dhe forca 202
Mosha dhe karakteristikat metrike të zgjedhura. 203
Mosha dhe pjesët e caktuara të buta të fytyrës 207
Mosha dhe flokët. 209
Mosha dhe zbardhja e flokëve. 211
Mosha dhe ndryshimet e ngjyrës së flokëve 214
Mosha dhe dallimet ndërfisnore 215

KAFSHIMI 219
Mekanizmi i okluzionit dental 219
Kafshimi dhe mosha 221
Kafshimi dhe gjeografia 223
Kafshimi dhe gjatësia e fytyrës 225
Kafshimi dhe gjerësia e fytyrës karakteristikat dhe efektet ndërvepruese . .228

TOKA 233
Toka dhe bimësia. 233
Toka dhe tiparet fizike në malësinë e gegnisë. 235
Statusi shoqëror dhe ushqyerja 240
Përfundimi 241

LIDHJA E FOSHNJAVE NË DJEP 245
Provat e mbledhura 245
Teknikat e lidhjes së fëmijës në djep 247
Marrëdhënia midis llojeve të deformimeve 250
Provat rreth vëllezërve 252
I majti ose i djathti, asimetria dhe sheshtësia 253
Provat e Bostonit. 255
Antropometria e sheshtësisë 258
Forma e kokës sipas shpërndarjes fisnore 261

POZICIONI RACOR I MALËSORËVE GEGË 265
REFERENCAT 269
FIGURAT KOLLOTIP 277
INDEKSI 311

ÇFARËDO QË TË KISHTE BËRË KOMISIONI NDËRKOMBËTAR I KUFIJVE, (I NGRITUR PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË*), KURRË NUK DO TË KISHTE MUNDUR TË NXISTE MË SHUMË URREJTJE TEK SHQIPTARËT NDAJ NDËRKOMBËTARËVE SESA AJO QË KISHTE BËRË, AQ SA DUKEJ SIKUR KY TË KISHTE QENË VETË QËLLIMI I TYRE KRYESOR.

CARLETON S. COON
BOSTON, 1950

*Shënim i përkthyesit

PROBLEMI DINARIK

DENIKER[1] (1852-1918) ishte i pari taksonomist[2] që e shquajti dallimin midis dy llojeve të brahicefalëve[3] evropianë: Alpinët curvoccipital[4] me fytyrën e rrumbullakët, hundën e shkurtër dhe të butë dhe trupin e mbushur dhe Adriatikët ose Dinarikët, më të gjatë dhe më të hollë, me kafkën planoccipitale,[5] fytyrën e gjatë dhe trekëndore, dhe hundën e gjatë, të ngushtë dhe të harkuar. Ai vendosi saktësisht përqendrimin e Dinarikëve në malet që kundrojnë nga bregu lindor i Detit Adriatik drejt perëndimit. Një formë të ngjashme, me atë të armenoidit, ai e gjeti në malet e Armenisë dhe të Kaukazit. Seritë e matjeve që nga koha e Denikerit kanë konfirmuar ekzistencën e njerëzve të tillë në këto zona. Dëshmi të tjera kanë treguar se tiparet dinarike nuk kufizohen vetëm në racën e bardhë, por mund të shihen në pjesë të Azisë dhe Oqeanisë madje edhe midis disa indianëve nga Meksika dhe Peruja. Këto vëzhgime kanë çuar në tezën se dinarikizimi është një proces biologjik që mund t'u ndodhë njerëzve kudo që të jenë dhe në rrethana që ende nuk janë përcaktuar qartë.

Në të gjithë materialin e hershëm kafkor,[6] të zbuluar deri tani në botë, ekzemplarët dinarikë mungojnë. Asgjë nuk mund të jetë më e largët nga format e rrashtës dhe të fytyrës të Neandertalit, Cro-Magnon - it, Kodrave Galley, apo

1 Deniker, 1890 and 1900 (Shënim i autorit)

2 Taksonomisti është një shkencëtar që merret me klasifikimin dhe sistematizimin e organizmave të gjallë, duke përfshirë njerëzit, në kategori të ndryshme bazuar në karakteristikat e tyre të përbashkëta. Këto kategori përfshijnë llojet, gjinitë, familjet, rendet dhe klasat.

3 Termi "brahicefalë" vjen nga dy fjalë greke: "brachys," që do të thotë "i shkurtër," dhe "kephale," që do të thotë "kokë." Kështu, brahicefalët janë njerëz me forma të kokës që janë relativisht të shkurtra dhe të gjera. Kjo është në kundërshtim me dolicefalët, të cilët kanë kokë të ngushtë dhe të gjatë..(Shëinm i përkthyesit)

4 Termi "curvoccipital" i referohet një pjese të kafkës ku pjesa oksipitale është e lakuar ose e harkuar. Pjesa oksipitale është pjesa e pasme dhe baza e kafkës që mbron pjesën e pasme të trurit. (Shënim i përkthyesit)

5 Termi "planoccipital" i referohet një morfologjie të veçantë të kafkës, ku pjesa oksipitale (pjesa e pasme e kafkës) është e sheshtë ose më e rrafshët sesa zakonisht. Ky term vjen nga latinishtja, ku "planus" do të thotë "i sheshtë" dhe "occipital" i referohet pjesës oksipitale të kafkës. (Shënim i përkthyesit)

6 "Materiali kranial" përfshin mbetjet skeletore ose shembujt që lidhen konkretisht me kokën (kranium) të një individi apo një grupi. Në antropologji dhe arkeologji, materiali kranial shpesh studiohet për të kuptuar aspekte si anatomia, morfologjia dhe në disa raste gjeneza e popullsisë së të kaluarës apo individëve. (Shënim i përkthyesit)

ndonjë fosilje tjetër të njohur. Një kokë e shkurtër, e lartë, një fytyrë e gjatë me një nofull të ngushtë, një zverk i sheshtë - të gjitha këto karakteristika qëndrojnë në polin e kundërt evolucionar ndaj ekzemplarëve të hershëm. Asnjë nga kafkat e hershme të gjetura në Amerikë nuk është dinarike dhe nuk gjendet as në Lindjen e Largët. Burrat neolitikë në Evropë, në Lindjen e Afërt dhe në Afrikë janë pothuajse në mënyrë të njëtrajtshme mesdhetare, dhe ajo tendencë drejt brakicefalisë është curvoccipital, me sa duket një formë mbijetese e ardhur nga popullatat e mëparshme.

Dinarikët më të hershëm të njohur deri më sot dëshmohen nga disa kafka nga vendet e Epokës së Bronzit në Mesopotami dhe në varret e fundit të Epokës së Bakrit[7] në Qipro, të datuara rreth vitit 3000 p.e.s. Edhe atëherë, dinarikët ishin pakicë. Fragmente të tre kafkave, me sa duket dinarike, janë zbuluar në varret spanjolle Bell Beaker, ndërsa njëqind ose më shumë të tilla të gjetura në Britani, Austri, Gjermani dhe Alpet e Adriatikut, mund t'i atribuohen Epokës së Bronzit.[8] Format e varreve dhe gjetjet brenda tyre tregojnë pa diskutim se këta njerëz ishin të xhvendosur që lëviznin nëpër Mesdheun Lindor. Gjatë gjithë historisë racore të Evropës ka vetëm një periudhë kur këto migrime mund të kenë ndodhur - fillimi i Epokës së Bronzit. Edhe atëherë imigrantët nuk duhet të kenë ardhur në numër të madh, madje as si një popullsi homogjene nga përkatsia racore.

Straboni e cilëson një popull me emrin dardan në verilindje të vendit të gegëve, në Fushën e Kosovës, përtej rrjedhës së sipërme të lumit Drin.

Sot përqendrimi Dinarik shtrihet në Alpet e Adriatikut me një bërthamë më të vogël e cila gjëndet në Karpate. Autorët që kanë botuar studime para vitit 1929 mendonin se qendra e vërtetë do të gjendej në veri të Shqipërisë, pasi vendi ishte i egër dhe i thyer, e folmja vendase ishte më arkaikja në Evropë si dhe për shkak të numërit të malësorëve që i ishin nënshtruar matjeve të bëra tashmë në Shkodër.

7 Epoka e Bakrit (Kalkolitiku) qëndron midis epokës së gurit dhe epokës së bronzit. Ajo është periudhë kalimtare, kur njerëzit filluan të përdorin bakrin për të krijuar vegla dhe armë, para se të zbulonin se përzierja e bakrit me kallajin krijonte bronzin, që ishte shumë më i fortë (shën. i përkthyesit).

8 Kjo teori u avancua nga Hughes, 1938 (ende e papublikuar), dhe Coon, 1939. (Shënim i autorit)

Gegnia Shqiptare dukej vendi strategjik ku mund të studiohej problemi dinarik. Kjo në të vërtetë përbëhet nga dy probleme:[9]

(a) Përshkrimi në detaje i llojit Dinarik dhe,

(b) Shpjegimi i atij problemi.

Le t'i shpjegojmë që të dya: Biologjia moderne ofron të paktën dy teori të cilat do të shpjegonin *dinarikizimin*.[10]

1 - Teoria e Hibridizimit. Një kombinim i dominantëve në një kryqëzim midis dy popullatave gjenetikisht të ndryshme, njëra me kokë të gjatë dhe me fytyrë të ngushtë, tjetra me kokë të rrumbullakët dhe fytyrë të gjerë. Nëse koka e shkurtër, koka e gjerë, koka e lartë, balli i gjerë, nofulla e ngushtë, fytyra e gjatë, hunda e gjatë, hunda e ngushtë - të gjitha këto do të ishin dominuese mbi numrat e tyre të kundërt dhe të bashkuara, këto mund të rezultonin në një formë dinarike.[11]

2 - Teoria e Evolucionit. Siç thekson Dobzhansky,[12],[13] shumica e gjenetistëve tani mendojnë se mutacionet ndodhin gjen pas gjeni. Nëse *dinarikizimi* është një proces evolucionar, atëherë vetëm një gjen është i përshirë në atë process. Për ta përcaktuar këtë duhet të studiojmë trajtën e formës së kokës dhe të fytyrës dinarike. Për më tepër, nëse kjo është e vërtetë, evropianët dinarikë nuk duhet të ndryshojnë nga evropianët e tjerë, ose indianët dinarikë amerikanë nga indianët e tjerë të Amerikës, etj., në tipare të ruajtura, si ngjyra e lëkurës, e flokëve, e syve, forma e flokëve, dendësia e flokëve, etj.

Në librin tim "Racat e Evropës", kam theksuar se në të gjithë Evropën Qendrore popullsi të ndryshme kishin patur një rritje të vazhdueshme të indeksit cefalik që nga shekulli i 6-të pas Krishtit e këndej. Këtë ia atribuova rishfaqjes së elementeve gjenetike që rrjedhin nga popullatat paraneolitike. Ndërsa bujqit dhe barinjtë depërtuan në Evropë, gjuetarët dhe familjarët e tyre u tërhoqën në pyje dhe në male. Përfundimisht këta të dytët u asimiluan si një element i shkrirë në shoqëri, në popullatën e përgjithshme. Rritja historike e brakicefalisë

9 Biologjia moderne ofron të paktën dy teori që do të shpjegonin dinarikizimin. (Shënim i autorit)

10 Kjo teori u avancua nga Hughes, 1938, (e pabotuar) dhe Caleton S. Coon, 1939. (Shënim i autorit)

11 Coon, 1939.

12 Theodosius Dobzhansky ishte një biolog dhe antropolog i njohur, i lindur në Ukrainë më 1900 dhe i shpërngulur në Shtetet e Bashkuara. Ai është një nga figurat më të rëndësishme në fushën e gjenetikës dhe evolucioni modern. Dobzhansky është i njohur për punën e tij të thellë mbi teorinë e evolucionit, veçanërisht për rolin e gjenetikës në proceset evolutive. (Shënim i përkthyesit)

13 Dobzhansky, 1944, p. 258. (Shënim i autorit)

ndodhi kështu për shkak të vlerës selektive të asaj forme të veçantë të kokës, pasi pushtuesit e tyre u vranë në luftë ose u zvogëluan numerikisht në mënyrë selektive nga imigracioni.

Weidenreich,[14],[15] kohët e fundit ka mbështetur tezën se brakicefalizimi është një hap progresiv evolucionar. Ai pretendon se brakicefalizimi prodhon një mbajtëse më efikase për trurin sesa një kafkë e gjatë dhe e ngushtë, dhe se një kokë e rrumbullakët është më e përshtatshme për të plotësuar nevojën e të qëndruarit në këmbë. Pavarësisht nëse kjo tezë është mekanikisht e saktë apo jo, Weidenreich ka bërë një shërbim të vyer duke dhënë mbështetjen e tij për të ardhur në përfundimin e saktë se brakicefalia evropiane është endemike dhe jo e prejardhjes së kohëve të fundit nga kontinente të tjera. Fakti që një popullatë e izoluar mund të jetë dominuese është një nga subjektet tona të tanishme të studimit.

Materiali i tanishëm është i përshtatshëm për një studim të tillë. Territori ku jetojnë Gegët e veriut të Shqipërisë është një vend i vogël, pak më shumë se 3500 milje katrorë. Popullsia e tij ndoshta shkon rreth 250,000 banore, prej të cilëve 90,000 mund të jenë katolikë dhe 160,000 janë myslimanë.[16] Në vitin 1930 na u tha se popullsia e Mirditës kishte rreth 11,000 banorë – të gjithë katolikë; ajo e Pukës 14,000, prej të cilëve 8.000 ishin myslimanë dhe 6.000 katolikë. Këto shifra ndoshta janë shumë të ulëta. Në rregjistrimin e vitit 1927 raportohej për 814,485 persona që jetonin në Shqipëri. Rregjistrimi i vitit 1930 e ngriti shifrën në 1,003,124, prej të cilëve 104,184 ishin katolikë. Regjistrimi i vitit 1930 jep dendësinë e popullsisë për Shqipërinë të jetë 36.5 banorë për kilometër katror, ose 102 të tillë për milje katror. Vendi malor i Gegëve, i ndarë rishtazi në 3 krahina pa marrë parasysh kufijtë fisnorë, thuhej se kishte 100 banorë për milje katrore në krahinën e Dibrës, 75 në atë të Shkodrës dhe 64 në krahinën e Kosovës.

Në vitin 1930 sipërfaqja tokësore e Shqipërisë ishte 10.600 milje katrorë. Me një popullsi prej 1,003,124 banorësh, dendësia e popullsisë ishte 94 vetë për milje

14 Franz Weidenreich ishte një anatomist dhe antropolog fizik i shquar gjerman, i cili dha kontribute të rëndësishme në studimin e evolucionit njerëzor. (shënim i përkthyesit)

15 Weidenreich, 1945. (Shënim i autorit)

16 Që kur u shkrua kjo monografi, është bërë modë në Amerikë të përdoret forma më korrekte, Muslimi. Do të ishte e këndshme nëse ky ndryshim do të ishte bërë këtu dhe në të gjithë tekstin. Megjithatë, është harxhuar kaq shumë kohë dhe janë bërë kaq shumë korrigjime, saqë unë kërkoj kënaqësinë e lexuesve për të mbajtur "o"-në në vend të "u"-së dhe "i"-së. Në fakt, zanoret arabe janë të pakta, rudimentare dhe të pandikuara në shkrimin e zakonshëm. Semantikisht, ato kanë më pak rëndësi se në turqisht, prej nga vjen forma muslimane, dhe ishin turqit ata që i shndërruan shtatëdhjetë për qind të shqiptarëve në myslimanë. Pak prej tyre, dyshoj, do të kundërshtonin mbi këto baza. (Shënim i autorit)

katrore, jo 102. Nëse secilit prej shifrave të tjera i zbresim 8 vetë, atëherë dalim tek shifrat e mëposhtme: Dibra – 92 vetë, Shkodra – 67 vetë, Kosova – 56 vetë. Këto shifra mund të gjënden nëpërmjet pranisë numerike të katolikëve. Nga 104,000 katolikë, të paktën 14,000 jetojnë në qytete, duke lënë jo më shumë se 90,000 në tokat fisnore. Tokat fisnore banohen specifikisht prej katolikësh që zënë rreth 1.225 milje katrore. Ato të banuara nga katolikët dhe myslimanët së bashku zënë rreth 440 milje katrore.

Kështu, 1.450 milje katrorë mund të konsiderohen si vend katolik, dhe me një popullsi prej 90,000 banorësh, kjo jep 62 persona për milje katrore, që përputhet me shifrën e korrigjuar të regjistrimit. Duke marrë si referencë të shifrave një zonë midis të Dibrës dhe Kosovës, ne gjejmë se rreth 70 vetë për milje katrore i takojnë zonave me popullsi të besimit mysliman. Këto zona mbulojnë një hapsirë prej rreth 2.300 milje katrorë. Aty jeton një popullsi prej rreth 160,000 vetësh. 160 plus 90 është e barabartë me 250. Që këtu, popullsia e Gegëve del të jetë 250.000 vetë.[17]

Seria jonë e të kontaktuarve prej gati 1.100 burrash mund të themi se përfaqësonte një për qind të totalit të meshkujve të rritur. Pra, ky ishte një kampion mjaft i mirë, krahasuar me sondazhe të tjera kombëtare për të njëjtën çështje. Të dhënat u nxorën nga të gjitha fiset dhe nga çdo pjesë e secilit fis. Kjo përfshinte kryepleqtë, xhandarët, bujqit, ata artizanë që gjëndeshin atypari, hoxhallarë dhe me pak fjalë atë pjesë të madhe të popullsisë, si nga ana rajonale në shumicën e fiseve, ashtu edhe në lidhje me dallimet që viheshin re bazuar në pozitën shoqërore dhe profesionale. Ne nuk i matëm thjeshtë ata malësorë që kishin zbritur në qytete, por zgjodhëm të shkonim shtëpi në shtëpi nëpër male dhe aty ua morëm masat që dëshironim.

Përveç të dhënave antropometrike ne kemi bërë përpjekje të mëdha që të përshkruanim dhe të diskutonim mjediset natyrore dhe sociale në të cilat jetonin objektet e studimit tonë. Ky material është po aq i rëndësishëm për studimin tonë sa matjet dhe vëzhgimet mbi vetë burrat. Ai jo vetëm përshkruan ndikimet fiziko - kimike që ndikojnë mbi organizmat në rritje, por gjithashtu tregon sistemet e tyre të çiftëzimit, të cilat janë me rëndësi të madhe për këdo që interesohet për problemet gjenetike. Për më tepër, siç do ta vërejmë në këtë studim, kjo ka

17 Almagia, 1932; Arbenia, 1 Qershor 1930, për të dhënat e regjistrimit, National Catholic Almanac, 1946, fq. 93. (Shënim i autorit)

rëndësi të veçantë pasi zbulon ndikimet mekanike të kontrolluara nga kultura, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë "formësojnë arritjet tona". Një shembull është lidhja e foshnjeve në djep ndërsa kokat e tyre janë ende të buta, një praktikë që e ushtrojnë malësorët shqiptarë, ashtu si edhe popujt e tjerë në Evropën juglindore dhe Azinë perëndimore, e përdorin.

Në kapitujt që vijojnë nuk do të përpiqemi të merremi me çdo detaj të qytetërimit të Gegëve. Ky nuk është një punim etnografik, por një punim somatologjik.[18] Ne jemi të interesuar pë konturin kryesor të kulturës në tërësi dhe vetëm në ato detaje që lidhen specifikisht me problemin tonë: Kush janë Gegët dhe si i fituan ata karakteristikat e tyre anatomike të tanishme?

Në fakt është i nevojshëm një veprim i mëtejshëm përkufizues që të vendosim kampionin tonë në përshtatje me kohën. Në përshkrimin e çdo kulture, etnografi duhet të vendosë qendrën e tij të sudimit në një kornizë specifike kohore. Të gjitha kulturat ndryshojnë, si në detaje ashtu edhe në tërësi, ndërkohë që ato që lëvizin më ngadalë, ndryshojnë mjaftueshëm ndër vite për ta bërë këtë hap ndryshues të nevojshëm. Një vendndodhje e tillë specifike kohore quhet "*E tashmja etnografike*".[19]

Për qëllimet tona studimore, "*E tashmja etnografike*"[20] duhet të jetë koha ndërmjet datës kur shumica e subjekteve tona antropometrike kanë lindur dhe asaj kur ata kanë arritur formën e tyre fizike të pjekur. Kështu, do t'i jepet vëmendja e duhur si trashëgimisë ashtu edhe mjedisit. Të gjithë 1.063 burrat që morën pjesë në studimin tonë, varionin nga mosha 18 vjeç deri në moshën e thyer, shumica prej të cilëve në moshën midis 25 deri në 49 vjeç. Kështu mesatarja ishte 39.4 vjeç. Matjet tona u bënë në vitet 1929 - 30, andaj viti mesatar i lindjes na dilte të fillonte më 1890, me një vit tjetër që fillonte që nga ai 1860-s ose më herët, e deri në vitin 1911. Nëse shtojmë 20 vjet për procesin e pjekurisë, ky numër rritet nga viti 1880 përafërsisht, deri në datën e matjes, me mesataren e saj në vitin 1910.

"*E tashmja jonë etnografike*" është, pra, një brez kohe i shtrirë në dy dekada, të përqendruara në periudhën midis viteve 1890 - 1910. Në këtë kohë, zonat

18 Teoria e somatologjisë, e njohur gjithashtu si tipologjia trupore, është një fushë studimi që merret me klasifikimin e trupave të njeriut në tipe të ndryshme bazuar në karakteristikat e tyre fizike. (Shënim i përkthyesit)

19 E tashmja etnografike në studimet antropologjike i referohet një qasjeje metodologjike dhe teorike që fokusohet në dokumentimin dhe analizimin e jetës së përditshme të një grupi njerëzish apo komuniteti në momentin aktual. Në thelb, kjo do të thotë që antropologët studiojnë realitetet bashkëkohore dhe situatat shoqërore që ndodhin në kohë reale, në vend që të fokusohet vetëm në të kaluarën historike apo në traditat e kaluara. (Shënim i përkthyesit))

20 Chapple dhe Coon, 1942, faqja e brendshme e përparme. (Shënim i autorit)

fisnore malore të Gegnisë ishin, si edhe në pjesën tjetër të Shqipërisë, pjesë të Perandorisë Turke dhe epoka-epike e gjakmarrjes kishte arritur kulmin e vet. Në përshkrimet kulturore të dhëna në kapitullin 3 "Teknologjia dhe Puna" deri te 6 - ta, "Jeta Rituale," lexuesi duhet të mbajë mend se, përveç nëse specifikohet ndryshe, referencat tona kanë të bëjnë vetëm me këtë epokë-epike.



Zona fisnore e Shqipërisë së Veriut. Zona me pika simbolizon male dhe pyje të pashfrytëzuara jo vetëm si kullota sezonale por edhe si burime druri. Shkalla, 1:250.000.

GEGËT E MALËSISË QË PËRBËJNË OBJEKTIN E VËZHGIMIT TONË U PËRKISNIN 10 FISEVE. ATO JANË MALËSIA E MADHE, DUKAGJINI, MALËSIA E GJAKOVËS, HASI, LUMA, PUKA, MIRDITA, ZADRIMA, MATI DHE DIBRA.

TOKA E GEGËVE TË MALËSISË

Njerëzit, të cilët janë objekt i këtij studimi janë malësorët që banojnë në vargun malor Dinarik në të dyja anët e lumit Drin, i cili çan nëpër male dhe rend drejt Detit Adriatik. Pjesa më e madhe e vendit të tyre shtrihet brenda kufijve politikë të Shqipërisë, por ka edhe pjesë të saj të cilat dikur ishin toka të banuara prej shqiptarësh por që, qysh prej tre dekadave të fundit të shekullit të kaluar kanë mbetur nën Jugosllavinë. Ata flasin dialektin verior të Gjuhës Shqipe, të njohur si Gegnishte. Megjithatë, ata nuk janë të vetmit folës të Gegnishtes. Aty gjënden edhe Gegë të Malësisë edhe Gegë të Fushës. Studimi i tanishëm ka të bëjë vetëm me të parët. Arësyeja pse ata u zgjodhën posaçërisht është se ata ruanin ende, në vitin 1929, një sistem të plotë fisnor të organizimit shoqëror, diçka që gjendet shumë rrallë sot në Evropë. Ky ka një avantazh të jashtëzakonshëm. Për shembull: Normat e martesave preferenciale janë të përcaktuara qartë dhe ato ende respektohen me rigorozitet. Ne e mësuam jo vetëm se kush martohet me kë, por gjithashtu u siguruam se i njëjti sistem ishte zbatuar për breza të tërë. Për një studim të gjenetikës njerëzore, ky material ka përparësi të dukshme.

Gegët e Malësisë që përbëjnë objektin e vëzhgimit tonë u përkisnin 10 fiseve, të paraqitura në figurën 1. Ato janë Malësia e Madhe, Dukagjini, Malësia e Gjakovës, Hasi, Luma, Puka, Mirdita, Zadrima, Mati dhe Dibra. Para vitit 1913, të gjitha fiset, përveç Dukagjinit, të cilët tani kufizohen me Jugosllavinë, shtriheshin brenda territorit të sotëm të atij vendi. Në disa pjesë të kufirit verior mbivendosja është e herëshme. Shumë prej fiseve malazeze e pranojnë prejardhjen nga familjet shqiptare dhe të gjitha fazat e asimilimit gjuhësor dhe kulturor gjenden midis dy njësive etnike. Në veri të Shkodrës, megjithatë, disa fshatra tërësisht shqiptare iu dorëzuan Serbisë pas Luftës Ballkanike, dhe kjo shkaktoi trazira sa ekonomike aq edhe politike. Më në lindje, që nga Peja në Dibër, Komisioni Ndërkombëtar, i cili e vendosi kufirin midis dy vendeve, në atë kohë ua dha jugosllavëve të gjitha

pikat strategjike, praktikisht të gjitha qytetet e pasura tregtare përgjatë kufirit serbo-shqiptar të cilat shërbenin si frymëmarrje ekonomike për të dy popujt.




Dr. Coon, me Stavri Frashërin dhe shoferin e tyre, gjatë rrugës nga Shkodra në Tiranë, pas përfundimit të ekspeditës.

Ky kufi etnik nuk është aspak i qartë. Në Rafshin e Kosovës jetojnë disa fise të tëra Gegë, së bashku me fshatrat e serbëve. Paraardhësit e këtyre Gegëve të ultësirës migruan atje në kohën e turqve, pas disfatës së Car Dushanit. Këta Gegë të shpërngulur ndoshta e kanë prejardhjen nga fiset e malësisë, por do të duhej shumë punë për të përcaktuar marrëdhëniet e tyre të vërteta. Ne nuk patëm mundësi që t'i masnim ata në masë dhe për këtë arësye nuk do t'i përfshijmë në këtë studim.[1]

1 Semple, 1931, chap. 5. (Shënim i autorit)

Gegët e Ultësirës së Shqipërisë, të cilët nuk ishin objekt i matjeve tona, e popullojnë vendin që nga rajonet fisnore në lindje të Adriatikut dhe zbresin drejt jugut deri në lumin Shkumbin. Është ky lum që shënon kufirin imagjinar midis Gegnisë dhe Toskërisë. Shumë prej Toskëve janë të krishterë ortodoksë. Gegët e krishterë janë katolikë romakë. Ata që nuk përfshihen në asnjërën nga këto grupe fetare janë myslimanët. Pjesa më solide myslimane e Shqipërisë gjëndet në rajonin qendror, si në Gegni ashtu edhe në Toskëri, ku peizazhi është më pak i thyer. Të dyja këto grupe të krishtera që i mbijetuan regjimit turk më me sukses, ishin të vendosur nëpër male. Në jug, përveç Toskëve, gjënden edhe mijëra barinjë vllehë që e flasin rumanishten si gjuhën e tyre amtare. Aty gjënden edhe bullgarë. Kufiri epirot kalon përmes një zone ku fshatrat greke dhe shqiptare ndërthuren, duke shkaktuar përherë trazira të natyrës së vet kufitare.



Tre rajonet kryesore gjeologjike në Gegni:
1 - Gëlqerorët e Mezozoikut;
2 - Serpentinat e rajoneve të larta;
3 - Shkëmbinjtë e Metamorfozuar të Triasit dhe Paleozoikut të Sipërm;
4 - Palosje intensive (Mezozoik-Eocen);
5 - Pellgu (Baseni) terciar;
6 - Flishi i Eocenit. (Almagia, 1932, fq. 464-73, harta në fq. 467, "sipas Nowack").

Në të gjithë Shqipërinë gjen vendbanime jevgjish (romesh) endacakë, të cilët jetojnë me zanatet e tyre tradicionale si punimi i metaleve, kovaçhanja, hedhje falli, tregtim i kuajve etj. Në qytetet më të mëdha ka gjithmonë një lagje me banorë të tillë të cilët shërbejnë edhe si muzikantë edhe... me gra joshëse. Ajo që vihet re është se në vendin e Gegëve nuk ka vend për vendbanime apo lagje ciganësh. Të vetmit ciganë për të cilët pashë dhe dëgjova ishte një i tillë në Bicaj dhe një tjetër në Kukës, të dy në fisin e Lumës.

Vendi i Gegëve të Malësisë është tërësisht malor. Edhe pse në hartë gjatësia e vendit të tyre është 75 milje i gjatë dhe 55 milje i gjërë, këto përmasa nuk arrijnë të përcjellin distancën vertikale. Shtigjet shkojnë nga poshtë lart, gjarpërojnë nëpër male, ngjiten e rrotullohen dhe kthehen thuajse atje ku u nisen. Në vitin 1929 neve na u desh po aq kohë për të përshkuar tërë gjatësinë e Malësive Gegë, me mjetet e disponueshme të udhëtimit sa do të na duhej për të udhëtuar nëpër tërë Shtetet e Bashkuara me hekurudhë. Për një shqiptar, Shala është aq larg nga Dibra, sa ç'është për një amerikan San Francisko nga Bostoni.

Malet e Gegnisë nuk janë një grumbull i përqendruar majash të mbuluara me dëborë, që ngrihen në lartësi prej 7000 deri në 8000 këmbë dhe as nuk ndjekin një sistem të thjeshtë vargmalesh dhe luginash paralele. Në vend të kësaj ato ndahen nga shtigje që kalojnë përmes lumit Drin të cilat ky lum i ka gërryer në kalimin e vet në rrjedhën e tij të trazuar që nga Fusha e Kosovës deri në Detin Adriatik. Në prerjet e gurta të grykës së Drinit, udhëtari mund të shohë një trashëgimi mbresëlënëse të ndryshimit gjeologjik - shtresë pas shtrese, të "gdhendur" mbi shkëmbinjët sedimentarë, me forma të habitshme, të përdredhura dhe të formuara në rrjedhë të shekujve dhe mijëvjeçarëve.

Megjithëse e gjithë gjeologjia sistematike e këtij rajoni mbetet për t'u studiuar, ne gjetëm fakte të mjaftueshme për të arritur qëllimin që i kishim vënë vetes. Figura 2 tregon tre rajone gjeologjike kryesore në Gegni. Të parat janë malet gëlqerore të Mesozoikut/Mezocoic[2] të Malësisë së Madhe dhe pjesë të Dukagjinit në Malësinë e Gjakovës. Ky është një vazhdim i peizazhit të zhveshur shkëmbor, aq karakteristik për Malin e Zi, i cili, në veri të Liqenit të Shkodrës, arrin në det në një varg luginash të përmbytura, më e madhja prej të cilave gjendet në Gjirin e Kotorrit. Këtu dheu është i cekët, ndërsa aluvioni pothuajse mungon në shtretërit e përrenjve. Asnjë pemë nuk i gjelbëron shpatet e bardha, as në verë dhe as në dimër. Në to shihet pamja ndriçuese ose e gurëve gëlqerorë ose e borës. Në kthesën e Drinit, zona më e ngushtë e palosjes intensive është gjithashtu kryesisht gëlqerore, që mbulon një pjesë të Dukagjinit, pjesët e Nikajt dhe Mërturit të Malësisë së Gjakovës, dhe bajraqet Bugjon dhe Berishë të Pukës. Në vendin e

2 Era Mezozoike, shpesh e quajtur "Epoka e Zvarranikëve" ose "Epoka e Dinosarëve," është një erë gjeologjike që zgjati rreth 186 milionë vjet, nga afërsisht 252 deri në 66 milionë vjet më parë. Ajo është e ndarë në tre periudha kryesore: (Shënim i përkthyesit)

përcaktuar deri tani, pjesa më e madhe e të cilit është në veri të Drinit, kushtet gjeologjike ngjajnë me ato që gjenden në veri të kufirit.

Zona e dytë është një zonë me shkëmbinj magmatikë, e përbërë kryesisht nga vargmale dhe gabbro.[3] Kjo zonë përmban gjithë Mirditën, pjesën më të madhe të Zadrimës, Matit, Pukës dhe Hasit, si dhe pjesë të Dibrës dhe Malësisë së Gjakovës. Në këtë rajon gëlqerja është aq e rrallë saqë pak njerëz mund të përballojnë ndërtimin e shtëpive prej guri, për shkak të mungesës së harasanit.[4]

Nga pikëpamja dietike, duhet patur parasysh rëndësia e këtij kontrasti midis zonës veriore gjeologjike, ku uji ka përmbajtje gëlqerore dhe zonës qendrore, ku uji nuk përmban gëlqere. Kjo merr rëndësi të posaçme pasi të gjitha ushqimet që konsumohen janë të rritura brenda zonave të banimit përfshirë foragjeret, drithërat, qumështin dhe mishin.

Rajoni i tretë është zona lindore, e cila përfshin gjysmën e Hasit, të gjithë Lumën dhe pjesën më të madhe të Pukës. Ai rajon është i përbërë nga depozitime metamorfike të Triasikut[5] dhe Paleozoikut[6] të Sipërm, të gërryera thellë, me shpate të pjerrëta dhe bregore të pasura aluviale. Nga pikëpamja dietike, ajo ka karakteristika të të dy krahinave, asaj veriore dhe asaj qendrore.

Përmes këtyre masiveve malore, të përbëra nga lloje të ndryshme shkëmbinjsh të shtrirë dhe të ngritur në periudha të ndryshme, rrjedhin dy lumenj me degët e tyre. Këta janë Drini dhe Mati. Duke i studiuar ata mund të arrihet më lehtë tek njohuritë më të sakta për gjeografinë fisnore të Gegnisë.

Në lindje të Kukësit bashkohen dy "Drinat", Drini i Bardhë dhe Drini i Zi. Burimi fillestar i Drinit të Bardhë e merr ujin te një shpellë në rajonin e Pejës e më pas rrjedh drejt jugut në kufirin shqiptar, ku merr një kthesë drejt perëndimit. Një bashkim i menjëhershëm dhe i shpejtë i të dy ujërave merr të njëjtin drejtim.

Drini i Zi e ka burimin e ujit në dalje të Liqenit të Ohrit, krejt në jug të territorit të Gegëve. Ai rrjedh në drejtim të veriut në një vijë pothuajse të drejtë përmes Luginës së Dibrës, duke kaluar qytetet e Dibrës së Madhe dhe Dibrës së

3 "Gabbro" në shqip quhet "gabbro." Emri shkencor i këtij lloji guri përdoret njësoj si në anglisht. (Shënim i përkthyesit)

4 Harasan - llaç (përzierje me rërë e me gëlqere etj.), që përdoret në ndërtim. Vjen nga emri krahinës Khorasan, në Iran. Herë-herë shkruhet horasan, horosan. Fjalë e huazuar prej turqishtes. (Shënim i redaktorit)

5 Periudha Triasike është periudha e parë e Erës Mezozoike, që shtrihet nga afërsisht 252 deri në 201 milionë vjet më parë. (Shënim i përkthyesit)

6 Paleozoiku i Sipërm, i njohur gjithashtu si Paleozoiku i Vonë, është një ndarje e Erës Paleozoike, e cila shtrihet nga afërsisht 541 deri në 252 milionë vjet më parë. Paleozoiku i Sipërm përfshin tre periudhat e fundit të Erës Paleozoike. (Shënim i përkthyesit)

Vogël (Peshkopia). Ndërsa rrjedh drejt veriut, lugina herë pas here ngushtohet deri sa shtrati i tij hapet përsëri përpara se lumi të arrijë në Kukës.

Në Kukës dy degët e lumit takohen. Që aty, shtrati i lumit zgjerohet, uji rrjedh edhe më vrullshëm, duke shkumëzuar dhe dallgëzuar, përmes rrjedhës së tij nëpër kanionet e veta deri sa arrin tek një ultësirë, pikë ku ai ndahet në dy shtretër lumenjsh. Njëri lum tani derdhet në Liqenin e Shkodrës dhe më pas shkarkohet në det. Ndërsa "tjetri" vërshon drejpërsëdrejti në Detin Adriatik. Përveç disa kilometrave të fundit në rrjedhjen e tij, Drini është aq i rrëmbyeshëm sa nuk mund të lundrohet. Kapacitetet e tij për ta shfrytëzuar për energji hidroelektrike janë të mëdha.[7]

Lumi tjetër, Mati, rrjedh në det pak më larg, në jug të Lezhës. Ai lum i kullon ujrat e të gjitha tokave të fiseve të Matit dhe pjesën më të madhe të Mirditës. Edhe ky lum është i vrullshëm dhe i pa lundrueshëm ndërkohe që në dimër dhe pranverë ai shpesh bëhet i pamundur për t'u kaluar.

Këta lumenj dhe pllajat e tyre formojnë kufijtë e zakonshëm midis fiseve. Dibra dhe Mati i përcjellin lumenjtë Drini i Zi dhe Mat, përkatësisht, ndërsa pllaja midis tyre është kufiri ndarës midis dy krahinave. Drini i Bardhë, në Jugosllavi,[8] është vija ndarëse kufitare midis fiseve të Hasit dhe fisit tjetër që jeton në Ultësirën e Podrimës. Në dy vende ai e ndan Hasin nga Luma ndërsa në Shqipëri, "Drinat" e Bashkuar e ndajnë Hasin nga Puka, Malësinë e Gjakovës nga Puka, Dukagjinin nga Puka dhe Malësinë e Madhe nga Puka dhe Zadrima.

Rrjedha veriore e lumit Mat, Fani, i cili edhe ai ndahet në dy degë, në Fanin e Vogël dhe Fanin e Madh, lag Mirditën, përveç bajrakut të Spaçit. Aty një si pykë që shtrihet në veriperëndim, formon pjesë të sistemit të lumit Drin. Me këtë ujëndarje midis Drinit dhe dy Fanëve ai përbën kufirin midis Pukës dhe Mirditës. Vazhdueshmëria e ujëndarjes midis Matit dhe Dibrës veçon më në veri Mirditën nga Luma, Matin nga Mirdita dhe Dibrën nga Luma më në lindje të Drinit të Zi.

Këta lumenj shërbejnë shpesh më shumë si kufij fisnorë sesa si rrugë udhëtimi. Brigjet e tyre janë aq të pjerrta sa që rrugët zakonisht e gjejnë më të lehtë të ndjekin kreshtat dhe supet e maleve. Ato zgjaten nëpër lugina vetëm aty ku mundësohet kalimi nëpër to. Ujërat e tyre janë aq të vrullshëm sa që vetëm në pika të rralla mund të lundrohen. Në tërësi ato janë pengesa për udhëtim dhe komunikim.

7 Sa largpamës ishte autori që në atë kohë. Sot ekziston kaskada e Drinit me një numër hidrocentralesh. (Shënim i përkthyesit)

8 Kur është shkruar libri, Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë. (Shënim i përkthyesit)

Është një rregull i njohur prej kohësh për gjeografët që në pellgun Mesdhetar në tokat që shtrihen në shpatet perëndimore të masave tokësore periferike, bie më shumë shi sesa në ato në lindje. Sa më të larta të jenë malet që ndjekin bregun, aq më shumë shi bie në to. Në Gegni dhe në Mal të Zi bie më shumë shi se në çdo vend mesdhetar. Në bregdetin Adriatik, që nga Lezha deri në Dubrovnik, bie më shumë se 152 cm shi në vit, ndërsa në të gjithë Gegninë bie diku midis 152 cm dhe 100 cm me një tërësi reshjes që vjen duke u zvogëluar drejt lindjes.

Ky nuk është vetëm shiu dimëror pasi aty bie shi në çdo muaj të vitit dhe reshjet verore arrijnë nga 10 deri në 20 cm, mjaftueshëm për të lejuar kultivimin e misrit në një vend me bujqësi të thatë. Ky mot përfshin vetëm zonën e lartë të Gegnisë, jashtë zonës klimatike mesdhetare. Reshjet dimërore fillojnë si shi në shtator pastaj kthehen në borë, në lartësitë e mëdha. Dimri zgjat më shumë në luginat e lartësive të mëdha dhe në majat e maleve për rreth. Në zona të tjera, seria e reshjeve të borës dhe pastaj shkrirja e shpejtë e tyre e bëjnë këtë rajon po aq të pakëndshëm sa ç'është New England – i në fillim të pranverës.

Temperaturat e ulta gjithashtu e pengojnë rritjen e shumë kulturave mesdhetare, si fiku dhe ulliri, të cilat nuk duken më sapo largohemi nga bregu. Të gjitha zonat e larta karakterizohen prej ngricave të ashpra dimërore. Brenda kufirit të Fushës së Kosovës klima bëhet kontinentale.

Vegjetacioni natyror i zonave të larta të Gegnisë është ruajtur pothuajse më mirë se në çdo vend tjetër kufitar, mesdhetar. Kjo ka ndodhur për shkak të vështirësive të udhëtimit dhe mungesës së transportit. Në veri të Drinit, në zonën gëlqerore, peizazhi është kryesisht i zhveshur pasi toka është shumë e cekët për të ushqyer rrënjët e drurëve. Megjithatë, zona magmatike,[9] është e mbuluar me pyje të dendura, me lisa që pasohen nga masive me bredha gjigantë, diametri i trungjeve të të cilëve shkon deri në 3 metra. Diku, në një pikë në rrugën midis Pukës dhe Kukësit, rruga kalon përmes një pylli të tillë, ku udhëtari sheh trungje të cilat janë prerë për t'i shitur në Shkodër. Në një lartësi edhe më të madhe, përtej nivelit të bredhave fillon zona e pishës. Ato drurë mund të krahasohen me pyjet, në toka të ngjashme, në mes të Korsikës.


Ndërsa majat e Shalës janë përgjithmonë të bardha, ato të jugut të Malit të Zi

9 Zona magmatike është një rajon në koren e Tokës ku ndodhin procese magmatike, që përfshijnë formimin, ngritjen dhe kristalizimin e magmës (material i shkrirë nga brendësia e Tokës). Magma është burimi i lavës që shpërthen gjatë aktivitetit vullkanik dhe gjithashtu krijon shkëmbinj magmatikë kur ngurtësohet. (Shënim i përkthyesit)

janë përgjithmonë të errëta prej mbulesës halore. Vetëm në disa vende në jug të Drinit majat e pishave dalin mbi kokën e disa lisave. Në zonën e metamorfizuar në lindje gjenden më shumë drurë ahu dhe pishe si edhe specie të tjera gjethe-rënëse si vidhi dhe rrapi, ndërsa selvitë janë mbjellë në varrezat e myslimanëve dhe në trojet rreth xhamive.

Siç pritej, malet dhe pyjet e këtij vendi pak të zhvilluar ende strehojnë një numër kafshësh të egra, të rrezikshme. Luanët e kohës së Homerit janë larguar, por ariu, ujku dhe derri i eger kanë qëndruar aty. Drerët kullosin në shpatet e maleve të larta dhe në pyje, por Gegët nuk i vrasin ato. Të vetmet kafshë të egra që kanë njëfarë rëndësie ekonomike janë pjestarët e ndryshëm të familjes së nuselalëve, veçanërisht martenat, të cilët disa malësorë i zënë në kurth dhe ua përdorin leshin. Përndryshe, fauna është një shqetësim, pasi arinjtë dhe ujqërit ju sulmojnë bagëtinë, vëçanërisht delet. Kopetë kanë nevojë për mbrojtje të vazhdueshme nga një ose më shumë burra me pushkë dhe me një numër qenësh të fortë.

Është pikërisht ky mjedis, i cili duhet të ketë ndryshuar fare pak që nga koha Romake, e ndoshta edhe më herët se aq, ku Gegët fisnikë kanë mbijetuar deri në ditët e sotme. Ata i kanë ruajtur gjuhën dhe zakonet e tyre që i kthejnë në Epokën e Hekurit. Formimi i tokës, klima, pozicioni gjeografik larg rrugëve kryesore të udhëtimit dhe migracionit, të gjitha bashkohen për t'i bërë malet dhe pyjet e Gegnisë një nga rajonet më të veçuara dhe të izoluara të Europës. Është një zonë e vërtetë strehimi, e krahasueshme me Kaukazin dhe largësitë perëndimore të Himalajeve, Appalachians, dhe Ozarks.



Antropologu i Harvardit, dr. Carleton S. Coon, duke marrë matjet e një malësori në Mirditë" (Foto: Carleton S.Coon 1929).

NË SERINË TONË PREJ 1.102 BURRAVE, U LISTUAN 36 ZANATE. KËTO MUND TË GRUPOHEN NË 7 KATEGORI: BUJQËSI, ZEJTARI, SHËRBIME, TRANSPORT, TREGTI, ADMINISTRATË DHE SHËRBIME FETARE.

TEKNIKAT DHE ZËNIA ME PUNËT E DORËS EKONOMIA NË NJË SHOQËRI TË IZOLUAR

Haberlandt,[1], Baroni Nopça[2] dhe të tjerë, kanë shkruar dhe përhapur dijeni të hollësishme për kulturën materiale të malësorëve Gegë. Nuk është qëllimi im të zevendësoj punën e tyre. Ajo që dua të them për teknikat e punës në këtë vend është shkruar me të vetmin qëllim: Të sqaroj problemin e gjenezës njerëzore në Veri të Shqipërisë. Para së gjithash, do të shqyrtojmë vetë serinë antropometrike, pasi aty është burimi i informacionit tonë për fenotipin[3] Gegë (fig. 12). Boshllëqet e matjes përmbajnë, përveç konstanteve antropometrike dhe vëzhguese, informacionin e mëposhtëm për çdo subjekt: Numrin serial, gjininë, datën, vendin ku është matur, moshën, fisin, bajrakun, grupin e babait, grupin e nënës, numrin e grave që i përkasin babait, numrin e fëmijëve të çdo gjinie për çdo grua, profesionin, zanatin, zyrën ose gradën, fenë, lidhjet farefisnore me anëtarët e tjerë të serialit, si dhe numrin e mbështjellësve të fotografive dhe të vetë kornizës.

Ne matëm 1.102 persona. Prej tyre, 1.058 ishin anëtarë të të njëjtave fise ku të dy prindërit vinin nga i njëjti fis si dhe subjekti. Prej tyre njëmbëdhjetë rezultuan të ishin nga martesat ndërfisnore. Tridhjetë e tre të tjerë mbeten për t'u llogaritur. Nëntë ishin bij të baballarëve nga Hasi dhe nënave nga Podrimja, katër ishin burra nga Podrimja. Këta trembëdhjetë jetonin në territorin fisnor të Hasit, në anën jugosllave të kufirit. Podrimja është një nga fiset shqiptare të vendosura në rrafshin e Kosovës, e mbetur tërësisht në territorin jugosllav. Nuk u regjistruan martesa të përziera midis njerëzve të Podrimës dhe fiseve të Hasit nga ana shqiptare e kufirit.

1 Gottlieb Haberlandt ishte një botanist i njohur austriak, i cili ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e biologjisë bimore dhe veçanërisht në studimin e fiziologjisë qelizore dhe kulturës së indeve bimore. (Shënim i përkthyesit)

2 Baroni Franz Nopcsa, ishte një paleontolog, gjeolog hungarez i njohur për kontributet e tij në studimin e gjuhëve dhe për eksplorimet e tij në Ballkan. (Shënim i përkthyesit)

3 Fenotipi është grupi i karakteristikave ose tipareve të dukshme të një organizmi që rezultojnë nga ndërveprimi i përbërjes së tij gjenetike (gjenotipi) dhe ndikimeve ambientale. Fenotipat përfshijnë një gamë të gjerë atributesh, të tilla si pamja fizike, sjellja, vetitë biokimike dhe karakteristikat fiziologjike. (Shënim i përkthyesit)

Njëzet të tjerët ishin të huaj në territorin fisnor të Gegëve brenda territorit të banuar nga shqiptarët. Gjashtëmbëdhjetë prej tyre vinin nga qyteti i Dibrës së Madhe, që kishte mbetur në anën e Jugosllavisë me një përzierje popullsie me shqiptarë, serb dhe pak turq. Njëri, nga bajraku i huaj i Gores, ishte mysliman që fliste serbisht. Ai bën pjesë në fisin e Lumës. Prona e shtëpisë së tij shtrihej në të dy anët e kufirit. Një tjetër ishte shqiptar nga qyteti i Gjakovës. Dy të tjerë vinin nga brenda Gegnisë por jashtë territorit fisnor – përkatësisht nga Kruja dhe Elbasani.

Këta njëzet burra ishin të gjithë imigrantë të gjeneratës së parë. Nuk kishte brez të vjetër si ata. Unë nuk mata asnjë prej djemve të tyre prandaj këta të ardhur të veçantë nuk patën asnjë ndikim në serialin tonë. Të gjithë ata ishin specialistë në një lloj zanati Nëpërmjet studimit të të dhënave për profesionet e shënuara në tabelat tona mund të zbulojmë statusin e saktë të këtyre njerëzve.

Në serinë tonë prej 1.102 burrave, u listuan 36 zanate. Këto mund të grupohen në 7 kategori: Bujqësi, zejtari, shërbime, transport, tregti, administratë dhe shërbime fetare. Ato gjenden ndër dhjetë fiset dhe dyzet e katër "të tjerët" si më poshtë:

	Total	Extr.	Proc.	Serv.	Trans.	Trade	Pol.	Rel.
MeM	105	101		1		2	1	
Duk	106	103					3	
MeJ	104	87		2	1	7	7	
Has	114	102	11					1
Lum	109	79		1		2	25	2
Puk	102	87		3		1	11	
Mir	101	89	4	1		1	6	
Zad	105	104					1	
Mat	104	80	2	2			20	
Dib	108	75	7		3	11	9	3
Others	44	23	7	2		7	4	1
	1102	930	31	12	4	31	87	7

Kjo tabelë tregon shpërndarjen rajonale të 7 kategorive të punës në kohën kur Prof. Coon e ndërmori këtë studim. Kategoritë janë: Bujqësia, zejtaria, shërbimet, transporti, tregtia, administrata dhe shërbimet fetare. Ato janë shpërndarë në zonat: Malësi e Madhe, Dukagjin, Malësia e Gjakovës, Hasi, Luma, Puka, Mirdita, Zadrima, Mati dhe Dibra.

Bujqësi: Nga 930 burrat e listuar, 926 ishin bujq, 3 barinj e një druvar. Druvari dhe njëri nga barinjtë vinin nga Luma, tjetri nga Mirdita. Tetëdhjetë e pesë për qind e të gjithë banorëve të Gegnisë të matur janë bujq, 88 për qind e të gjithë fiseve

Zejtari: Dymbëdhjetë zanate janë renditur në përpunim si qymyrtar, farkëtar,

teneqepunues, marangoz, lëkurëpunues, qeleshepunues, rrobaqepës, këpucar, mishtar, bukëpjekës, kuzhinier dhe ëmbëltor.

Dy qymyrtarët, farkëtari dhe marangozi ishin mirditorë. Zanatet janë reciprokisht të ndërvarura. Si rregull, veglat prej hekuri importohen dhe shpërndahen nga tregtarët nëpër qytete. Kokat e sëpatës, drapërat, grepat dhe veglat e tjera të formave të njohura të Epokës së Hekurit, prodhohen nga mjeshtrit në qendrat më të mëdha, si në Shkodër dhe shiten në zonat malore. Punët e vogla të farkëtarisë zakonisht bëhen nga ciganët.

Zanatçinjtë vinin nga një kategori tjetër. Asnjëri prej tyre nuk ishte malësor, përveç një kuzhinieri dhe një bukëpjekësi, të dy me origjinë nga Mati. Ata punonin në selinë e re të prefekturës së ngritur nga mbreti Zog, në Burrel, brenda territorit të Matit. Ata ishin atje për shkak të ndikimit të qeverisë së re qendrore në fiset malore. Asnjëri nga këta burra nuk kishte ndonjë përvojë të mëparshme.

Teneqepunuesi, samartari dhe qeleshepunuesi ishin nga Peshkopia, qyteti kryesor i Dibrës. Nga tre rrobaqepësit në këtë qytet, njëri ishte vendas, tjetri nga Dibra e Madhe dhe i treti nga Gjakova. Mishtari, njëri nga dy bukepjekësit, dhe kuzhinieri i mësuar në Peshkopi, ishin nga Dibra e Madhe. Ëmbëltori punonte në Kukës dhe në Lumë. Nga këta mbeten njëmbëdhjetë bukëpjekës. Këta burra vinin të gjithë nga Gjonaj dhe fshatrat fqinje të Hasit, brenda një largësie që bëhej me këmbë që nga Prizreni.[4]

Bukëpjekja është profesioni i tyre i trashëguar, tradicionalisht. Ata e marrin miellin nga mullinjtë e Prizrenit dhe pastaj, pasi e gatuajnë, e shesin bukë të gatshme, po në atë qytet. Shumë nga këta bukëpjekës hasjanë emigrojnë në qytete të largëta për të punuar. Z. Anthony Stevens, udhërrëfyesi ynë, punonjës i Departamentit të Shtetit të SHBA-së, e kishte filluar jetën si një nga këta bukëpjekës. Ishte djalosh kur shkoi në Cincinnati për të punuar në një furrë buke.

Pra mund të vihet re lehtë se brenda territorit fisnor të Gegëve teknikat e përpunimit praktikohen pothuajse ekskluzivisht në viset kufitare lindore. Peshkopia është shtuar me banorë me shpejtësi pasi Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve i vitit 1913, ua ndërpreu malësorëve dibranë hyrjen në qytetin e tyre të tregëtisë së natyrshme - Dibrën e Madhe. Prandaj, shumë nga dibranët e asaj ane u shpërngulën drejt Peshkopisë, e cila tani është brenda territorit të shtetit

4 Haberlandt, 1917; Nopça, 1925; Start, 1939; Traeger, 1904. (Shënim i autorit)

shqiptar. Në të njëjtën mënyrë Prizreni u shkëput nga Luma dhe si rrjedhojë u ndërtua Kukësi. Gjakova u nda nga burrat vet epik të Malësisë së Gakovës të cilët tani e kanë Kukësin si qendrën e tyre të re. Në anën perëndimore nuk ka pasur ndonjë shqetësim të tillë. Tani, Shkodra, Lezha dhe Kruja, si edhe në shekujt e kaluar, shërbejnë si qytete tregu për malësorët rreth tyre.

Shërbimet: Janë vetëm 12 burra të listuar në fjalën "shërbime". Dy prej tyre janë hanxhinj. Njëri është një burrë nga Puka, nikoqir në Rrape, që është edhe vendlindja e tij. Tjetri është një burrë që vjen nga larg, një krutan, i cili e ka hanin tek Guri i Bardhë, në Mat. Krutanët janë të specializuar në mbajtjen e bujtinave, madje edhe në kulmin e pushtetit osman, ata mund të gjendeshin anë e mbanë Perandorisë Turke, deri në Azinë e Vogël. Këta hanxhinj martohen në Krujë dhe nuk përzihen me popullsinë e rajoneve ku e ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Tre burra ishin pronarë restorantesh. Njëri prej tyre ishte prej Koplikut, i cili duket se kishte një dyqan në Shkodër, tjetri ishte nga Luma dhe një tjetër ishte nga Malësia e Gjakovës, me dyqane në Kukës. Edhe berberi i Kukësit ishte nga Malësia e Gjakovës. Njëri nga të dy kamarjerët ishte vendas që i shërbente xhandarmarisë në postën e Pukës, ndërsa tjetri ishte prej Dibrës së Madhe që punonte në hotel në Peshkopi, një institucion i ri ky për atë vend. Nga tre të punësuar si shërbëtorë, të tre ishin vendas. Njëri i shërbente prefektit dhe një tjetër mësuesit në qendrën e re administrative në Burrel. I treti punonte për një prift në Mirditë.

Prej 12 punësimeve në "shërbime", punësimi i nëntë prej tyre mund të shpjegohet me ndryshimet e ngjarjeve politike të kohëve së fundit.

Transporti: Transporti në Gegni, në vitin 1929, nënkuptonte vetëm një gjë - shërbimet e qiraxhinjëve.[5] Ata ishin karrocierë, shumë të zotët, të mësuar me natyrën e egër, që i dërgonin mallrat kudo që iu kërkohej. Vesi i tyre i keq ishte se përpiqeshin të rrisnin çmimin gjatë rrugës, për shkak të vështirësive që haseshin në udhëtim. Tre në katër prej tyre ishin nga Dibra dhe një nga Malësia e Gjakovës. Me sa di unë, të gjithë qiraxhinjtë ashtu si dhe hanxhinjtë, janë myslimanë.

Tregtia: Të gjithë tregtarët në malësi janë vetë pronarë dyqanesh. Aty nuk ka institucione tregtare komplekse apo të mëdha. Nga 31 tregtarët që i matëm, 18

5 Fjala "qiraxhi" i referohet një personi që transporton mallra me kafshë pune, si kuaj apo mushka, nga një zonë në një tjetër. Në të kaluarën, qiraxhinjtë ishin transportuesit që përdornin mjete të thjeshta, shpesh karroca të tërhequra nga kuaj, për të kryer shërbime transporti mes fshatrave ose qyteteve, veçanërisht në terrene të vështira ose në zona ku rrugët moderne ishin të papërshtatshme. Kjo fjalë në këtë libër dhe në këtë kontekst nuk duhet ngatërruar me fjalën "qeraxhi" pra qeramarrësin e një banese ose objekti për përdorim tregtar. (Shënim i përkthyesit)

ishin në Peshkopi. Prej tyre, 11 ishin vendas dhe *jabanxhi* nga Dibra e Madhe. Ata 6 tregtarë që i matën në Kukës, të gjithë ishin nga Malësia e Gjakovës. Dy të tillë që i matëm në një fshat të Lumës, në Bicaj, ishin vendas. Një burrë i Malësisë së Gjakovës që u mat e kishte dyqanin e tij në qytezën e tij në Kolgecaj. Kështu që 25 nga 31 tregtarët që i matëm erdhën nga kufijtë lindorë, nga qytetet e mëdha ose fqinjët e tyre. Situata është e njëjta edhe me artizanët të cilët i shisnin prodhimet e tyre.

Tani kanë mbetur edhe katër dyqanxhinj: Dy janë nga Malësia e Madhe, njëri me dyqan në Shkodër, tjetri me dyqan në shtëpi. Nga dy të tjerët, njëri është vendas në Pukë, tjetri vendas në Mirditë. Mirditori, i cili e ka të vetmin dyqan në atë fis, na tha se babai i tij ishte një oficer austriak që e ngjizi atë gjatë Luftës së Parë Botërore. Kjo do t'i jepte një moshë maksimale të mundshme prej 14 vjeç në kohën e matjes. Në fakt ai ishte të paktën 30!?

VEGLAT E PUNËS - RISHQYRTIM

Malësori gegë është krenar për familjen dhe vendin e tij të lindjes, por është edhe sfidues. Dëshira e tij për t'u identifikuar është më e madhe se vetë frika e vdekjes.

Carleton S. Coon.

Nga studimi i të dhënave jo somatologjike[6] të mbledhura në serinë tonë, dhe nga ajo që dihet përgjithësisht për kulturën materiale të Gegëve, mund të bëjmë një përmbledhje të shkurtër, duke mbajtur gjithmonë parasyshë se qëllimi ynë kryesor është të përcaktojmë elementët ekonomikë në situatën kulturore brenda të cilës jetojnë Gegët.

Mjetet prerëse janë të bëra prej hekuri. Ato prodhohen nga farkëtarët nëpër qytetet ku Gegët e zhvillojnë tregtinë e tyre. Në Shkodër, për shembull, ka një lagje të tërë me farkëtarë, shumica e të cilëve, nëse jo të gjithë, janë romë. Me çekiç dhe dana, një kudhër të vogël dhe një farkë me një pedale që lëvizet me këmbë,

6 .Të dhënat somatologjike i referohen informacionit lidhur me studimin e matjeve të trupit të njeriut dhe karakteristikave fizike. Këto të dhëna shpesh mblidhen në fusha të tilla si antropologjia, biologjia, mjekësia dhe ergonomia për të kuptuar variacionin fizik të njeriut dhe pasojat e tij. (Shënim i përkthyesit)

ata farkëtojnë pothuajse të gjitha objektet metalike të nevojshme për malësorët të cilat i përdorin për bujqësinë, blegtorinë, transportin dhe zdrukthëtarinë e tyre shtëpiake. Ata bëjnë kudhra të vogla, çekiçë, gozhdë, sëpata, sqeparë, thika, parmenda, lopata, shata, drapëra me dhëmbë, kosa, lidhëse trarësh, mentesha dyersh, patkonj, yzengji kuajsh, zinxhirë, frena, mashë dhe hekura zjarri, mjete ndriçimi dhe ndoshta artikuj të tjerë që i kanë shpëtuar vëmendjes tonë.[7]

Në afërsi të Gegnisë nuk ka ndonjë shkritore. I gjithë hekuri që përdorin farkëtarët importohet. Megjithëse farkëtarët e qytetit mund t'i bëjnë të gjitha këto mjete pune dhe vegla përdorimi nga hekuri i tregtuar, është e pamundur që farkëtarët e zonave të largëta, si në Mirditë, të bëjnë diçka më tepër sesa patkonjtë e kuajve. Askush në Shqipëri nuk mund të bëjë mjete prej çeliku. Jo vetëm materiali, por edhe mjetet e gatshme, duhet të importohen, dhe për këtë arësye janë të shtrenjta. Kjo është arësyeja pse sharrat dhe burgjitë janë të rralla në male, ku pothuajse veglat e vetme prej çeliku që shihen janë limat, të dobishme për mprehjen e mjeteve të hekurit dhe përpunimin e drurit.

Kjo shpjegon natyrën primitive të përpunimit të drurit nga Gegët. Shumica e objekteve prej druri që kërkojnë mjete ose aftësi të veçanta blihen në qytetet tregtare. Këtu ka tre lloje specialistësh të përpunimit të drurit që i ushtrojnë zejet e tyre: Vozëtarët, mjeshtrat e tezgjahut dhe marangozët. Zdrukthëtarët bëjnë vedra dhe kova druri për përdorim në kuzhinë. Aty përfshihen vozat, koritat e qumshtit dhe fuçitë në të cilat ruhet gruri. Materiali nga i cili janë bërë këto është druri i pishës. Mjeshtri i tezgjahut pret pjesë të ndryshme druri, i laton dhe bën direkë, të cilët i monton horizontalisht dhe veritikalisht duke krijuar një si kafaz. Zdrukthëtarët prodhojnë edhe arka të forta druri, të stolisura me zbukurime anash, si dhe djepat ku i rritin fëmijët e tyre.

Gega, atje në malet e larta, është njeriu që i bën vetë të gjitha punët e shtëpisë. Ai mund të mos jetë në gjendje të prodhojë të gjitha sendet e veçanta të përmendura më lart, por ai mundet t'i gdhendë trarët për shtëpinë e tij, të montojë një parmendë të re gjatë muajve të dimrit kur ka pak punë jashtë, ose të bëjë një nga ato ndenjëset e tij masive ose shkambinjtë prej druri pishe. Marangozët profesionistë atje gjënden rrallë, por ka edhe atje burra që tregojnë më shumë aftësi se të tjerët, në këtë drejtim.

7 Haberlandt-i, Nopcsa dhe i imi. Për informacionin më të mirë lidhur me këtë, mund të referoheni në Haberlandt, 1917, fq. 90. (Shënim i autorit)

Në Gegni, si në shumicën e vendeve të botës primitive të njohur për antropologët, është zakon që zjarret të mos i lenë të shuhen, sepse është e vështirë t'i rindezin përsëri. Nëse ndodh kjo, atëherë një banor i shtëpisë do të duhet të ecë goxha larg për të marrë ca prush të ndezuar hua nga ndonjë fqinj. Në vitet 1929 dhe 1930, shumica e Gegëve e ndiznin zjarrin me strall dhe unur ose me ndezës të vjetër me fitil të thatë, ose eshkë. Ata e bënin këtë fshehtazi prej meje për të mos më kërkuar shkrepsen, pasi iu vinte turp. Mbreti Zog ia kishte dhënë të drejtën ekskluzive për prodhimin dhe shitjen e shkrepëseve një kompanie suedeze (Trusti Suedez i Shkrepëseve). Kjo kompani, e kishte rritur menjëherë çmimin e një kutie shkrepëseje nga një qindarkë në pesë qindarka. Mbreti, në të njëjtën kohë kishte ndaluar përdorimin e çakmakut dhe çelikut për ndezësa. Kjo i la malësorët në një pozitë të palakmueshme - tani ata nuk mund të përballonin koston e shkrepseve, por nuk mund të ndiznin as zjarr me mjete të tjera. Megjithatë, jashtë qyteteve të njohura, veprimet e paligjshme të malësorëve, kalonin pa u vënë re.

Disa studiues me emër, veçanërisht Nopça, janë marrë me llojet e shtëpive të Shqipërisë së Veriut. Këto zakonisht ndahen në bazë të planimetrisë dhe rregullimit të brendshëm të dhomave dhe arkitekturës, në një numër kategorishë: Disa prej tyre janë stane të thjeshta, që kanë vetëm një dhomë për ta përdorur vetëm në verë nga barinjtë, në kullotat e larta malore. Pastaj vijnë shtëpitë me dy dhoma njëkatëshe, një dhomë për kafshët dhe tjetra për familjen. Pastaj të ashtuquajturat shtëpi me verandë, me një portik të përparmë të bërë prej druri dhe me kolona që të kujtojnë kohën homerike. Dhe më pas vjen kulla ose fortesa e mbrojtshme nga sulmet nga jashtë. (fig. 8, a).

Shtëpia me dy dhoma duket të jetë më e përhapura në malësi, edhe pse strukturat më të komplikuara i kanë bërë këto ndërtesa të rralla historikisht. Shtëpia me verandë, edhe pse e vjetër në Mesdhe, duket se ka arritur vonë në këtë zonë banimi, duke u shpërndarë bashke me përhapjen e Islamit. Kulla, ose fortesa, thuhet se erdhi në të njëjtën kohë me atë të shtëpisë me verandë. Të dyja arritën në Kastrat dhe në Shalë aty rreth vitit 1850, duke u prezantuar nga një njeri që kishte jetuar në Stamboll, i njohur si Liho Çuni.

Sa i takon materialeve të ndërtimit, Gegët janë jashtë mase të kufizuar në furnizime me materiale vendase për shkak se transporti është shumë i vështirë. Në rajonin e përcaktuar në figurën 2 si "Vargmalet e Thepisura" guri është i vështirë për t'u prerë dhe i papërshtatshëm për muraturë të mirë, përveçse kur bie në duart

e mjeshtrave të zotët të përpunimit të tij. Për më tepër, gëlqerja gjendet vetëm në pak vende dhe zakonisht është e pamundur të bëhet harasan pa shumë udhëtime të lodhëshme me kuaj ngarkese ose gomerë. Në këtë rajon shumë nga shtëpitë janë të bëra prej druri, me trungje të kthyer në trarë të vendosur mbi njëri-tjetrin dhe të mbajtur në vend nga pjesë të kryqëzuara vertikale ose diagonale. Shtëpitë tjera janë të bëra me thupra, me shtylla pingule që i mbajnë ato, me shkopinj të përkulshëm të thurur brenda dhe jashtë, midis tyre. Ndonjëherë ky gardh me thupra është i zhveshur, por zakonisht vishet me një lloj suvatimi prej balte.

Aty ku gjenden mjaft gurë gëlqerorë të përshtatshëm, aty përdoren këto materiale. Shtëpitë më të thjeshta dhe më të varfra bëhen me murature të thatë. Megjithatë, shumica janë të ndërtuara me llaç. Materiali i përdorur për të mbuluar çatinë kalon nga përdorimi i kashtës tek shikulla[8], nga rrasa e gurit tek tjegullat. Vite më parë kashta përdorej shumë më shpesh sesa tani. Kalimi nga gruri në misër, si drithëra bazë, i privoi fermerët në shumë pjesë të Shqipërisë nga materiali i përdorur për çati.

Pjesa e brendshme e shumicës së shtëpive janë mjaft të zhveshura, pa qilima në dyshemetë me dërrasa të latuara dhe me pak dekorime në mure. Në shtëpitë e vjetra, një oxhak mbulon rreth 10 metra katrorë të dyshemesë dhe tymi e gjen rrugën e daljes jashtë përmes kashtës ose tjegullave të çatisë. Kjo dalje e tymit bën që të thahet mishi i varur sipër kokës së njerëzve të shtëpisë dhe e kthen atë në pastërma. Kjo është edhe më e theksuar tek katolikët, të cilët e varin mishin e derrit në tavan, për nevojat e tyre ushqimore në dimër.

Ardhja e kullës si modeli i ndërtimit në malësi, solli me vete disa risi të veçanta arkitekturore. Kulla është një ndërtesë trekatëshe me formë drejtkëndëshe, e ndërtuar edhe për banim edhe për mbrojtje. Nopça gjen një lidhje të ndërsjelltë midis pranisë së kullave nëpër fshatra dhe bajrakë të ndryshëm dhe vdekjes nga vrasjet. Kati i poshtëm i kullës përdoret për strehimin e kafshëve, ndërsa katet e dyta dhe të treta përdoren për banim. Dera e katit të parë është e veçantë, ndërsa dera e katit të dytë hapet pasi ngjitesh në një kat më sipër me shkallë prej guri nga jashtë. Prej aty ngjitja vazhdon për në katet e banimit me shkallë druri të brendshme.

Në këtë kullë me strukturë shumëkatëshe duhej bërë diçka për nxjerrjen e tymit përjashta. Prandaj u ndërtuan votra zjarri, njëra mbi tjetrën në çdo kat

8 Shikull: dërrasë e hollë dhe e ngushtë, e çarë me sëpatë (jo me sharrë), që përdoret për mbulojët e shtëpive; fjalë e brumit të shqipes. Sinonime: flugë, fregull, furde, skubël, shindë. (Shënim i redaktorit)

dhe një oxhak i lartë i cili siguronte nxjerrjen e tymit jashtë. Një nga problemet kryesore me shtëpinë e modës së vjetër ishte mungesa e një tualeti. Gega i rënë në gjak, për të përmbushur nevojat e natyrës në një fushë misri, në një mëngjes të ftohtë, përbënte një objektiv të dukshëm për armiqtë e tij që i zinin pritë, ndërkohë që Kanuni nuk përmbante rregulla të qarta për të ndaluar këtë veprim. Kështu, mjeshtrat e kullave ndërtuan një ballkon të mbyllur, të varur, prej murature, për të shërbyer si "banjo". Midis higjenës dhe sigurisë, fitoi siguria. Vrima e kullimit bëhet e kthyer brryl, për të parandaluar të shtënat që mund të vinin nga poshtë. Zakonisht një rrymë e fortë ngjitet lart vrimës së kullimit. Poshtë, paralel me murin derdhen mbeturinat dhe po të mos ishte për klimën e shëndetshme malore dhe imunitetin e lartë trupor të malësorëve, epidemitë do të ishin më të zakonshme sesa janë. Kulla ka pak frengji dhe këto janë të ndërtuara më shumë për të qëlluar nga brenda sesa për dritë apo ajrosje.

Shtëpitë e Gegëve kanë vlerë edhe sociale edhe ekonomike. Ato zakonisht janë të mëdha dhe të përshtatshme për një familje të zgjeruar bashkë me kafshët e saj. Duke shërbyer edhe për mbrojtje, ato reflektojnë pavarësinë lokale të familjeve brenda tyre. Në ato kulla, gratë vendosen në katin e dytë ndërsa burrat në katin e sipërm. Thënë ndryshe, gratë jetojnë në një pjesë të shtëpisë, jo aq të fortifikuar në afërsi, ndërsa burrat rrinë në një zonë më të fortifikuar. Kjo reflekton pacenueshmërinë e grave në kodin vendor të hakmarrjes.

Ndërtimi i kullave kërkon aftësi mjeshtrash ndërtimi. Të gjithë gurët duhet të jenë katrorë dhe të vendosen me kujdes njëri mbi tjetrin duke shtruar harasan me *mistri* në mes të tyre. Oxhaqet duhet të bëhen të *lart*ë, siç duket, në mënyrë që të tërheqin tymin siç duhet. Ndërtimi i mureve të larta kërkon skela. Nopça thotë se ato janë ndërtuar nga muratorë shëtitës dhe se në vitin 1908 kushtonin nga 440 deri në 660 korona (110 - 165 dollarë). Kur pyeta për muratorët më thanë se ata janë dibranë, të cilët kanë ndërtuar kulla edhe në Mal të Zi e Bosnje, edhe gjetkë në Jugosllavi. Nuk e di saktësisht se nga vijnë këta muratorë nga Dibra. Nuk kam parë një të tillë në punë dhe as nuk është shfaqur në udhëtimet tona.

Këto shtëpi, të çfarëdo lloji qofshin, ngrohen me dru, i cili në të njëjtën kohë përdoret edhe për zjarr edhe për të gatuar. Në pjesën më të madhe të rajonit ka shumë dru zjarri, por në rajonin verior, gëlqeror, drurët janë më të rrallë dhe duhen prerë dhe mbartur që nga larg. Malësorët fitojnë ndonjë para duke zbritur ngarkesa me dru zjarri në qytetet e tregut që pastaj t'i shesin ato.

Në vitin 1929 në shumë shtëpi përdorej një formë primitive për ndriçim. Kur errësohej, e zonja e shtëpisë vendoste disa spirra[9] pishe mbi disa mbajtëse hekuri të varura në tavan. Pisha siguronte dritë të mjaftueshme për të parë, por vështirë se mjaftonte për të lexuar. Megjithatë, në disa shtëpi të tjera përdornin qirinj ndërsa në disa të tjera, llamba vajguri. Vajguri në këtë vend futej në bidona prej metali që mbanin deri në pesë gallona. Ishte një kohë kur më vështirë gjendeshin bidonat që mbanin vajgurin, sesa vetë vajguri.



Burrë me plis, rroba gjysmë-perëndimore dhe një armë në brez. Në të majtë, një grua nga malësia me kostum tipik popullor (Foto: Carleton S. Coon 1929).

Në të vërtetë, veshjet e Gegëve kanë marrë edhe më shumë vëmendje sesa shtëpitë e tyre. Kostumet janë piktoreske dhe përbëjnë koleksione të mrekullueshme. Ato ndryshojnë nga fisi në fis, nga bajraku në bajrak dhe në disa raste nga fshati në fshat. Pas gjashtë muaj udhëtimi nëpër male, edhe unë vetë arrita

9 Spirrë - në këtë rast: copëz druri e hollë me majë, për t'u ndezur më lehtë; spicë. (Shënim i redaktorit)

të dalloja se nga vinte njëri dhe nga vinte tjetri. Këto i dalloja sipas prerjes së xhaketas, ngjyrës së veshjes së poshtme të tij, formës së qeleshes/plisit[10] të tij dhe sidomos nga zbukurimet e çorapeve. Nëse pas gjashtë muajve një i huaj kishte arritur këtë prag të njohjes së tillë të veshjeve, një malësor vendas me shikim të qartë mund të identifikonte një udhëtar nga një fis, bajrak apo fshat tjetër, po aq lehtë sa një djalë modern mund të shquante markën e një makine ose aeroplani, me një të parë. Kjo dukuri e shenjave të dallueshme në veshje, ka një kuptim shumë të përcaktuar.[11]

Malësori Gegë është krenar për familjen dhe vendin e tij të lindjes, por është edhe sfidues. Dëshira e tij për t'u identifikuar është më e madhe se vetë frika e vdekjes. Ai nuk largohet nga shtëpia, përveçse atëherë kur udhëtimi i tij vlerësohet si shumë i rëndësishëm.

Kostumi i burrit fillon me një plis prej leshi pa cepa, në formë konike ose i rrafshtë në anën e sipërme. Shpesh, rreth qafës ai mban një shami ose një shall të gjatë. Pjesa e sipërme e trupit të tij mbulohet nga një xhaketë prej leshi, me mëngë të gjata dhe një lloj qafëze, shpesh herë si të thuash në trajtën e veshjes së një marinari. Në përgjithësi, ai nuk vesh këmishë. Nga beli deri tek kyçi i këmbës ai mban një palë pantallona të leshta zhguni, zakonisht të ngushta tek këmbët dhe me një gjerësi të lehtë në pjesën e prapme, që në disa raste të kujton pakëz ndikimin e pantallonave të gjera turke. Nëse është i pasur, ai mund të veshë gjithashtu një jelek të zbukuruar, pa mëngë. Ai zakonisht mban një lloj brezi të gjerë, që quhet *shokë,* ose një si rryp. Ai vishet me opinga, ose me këpucë prej lëkure të papërpunuar, lloj i zakonshëm i këpucëve primitive evropiane, e cila gjendet jo vetëm në Ballkan por edhe në Rusi, Irlandë dhe vende të tjera, ku tradita është mjaft e fortë dhe këpucët janë mjaft të shtrenjta. Kjo bën të ruhet ky lloj i lashtë i këpucëve të bëra në shtëpi. Në vitin 1929, Gegët më të varfër përdornin copa të gomave të makinave në vend të opingave. Ishte diçka e habitshme të shihje një copëz të freskët gome nga pista e garave të *Goodyear* ose *Michelin* në një shteg malor 50 cm të gjerë. Në të njëjtën kohë, të pasurit mbanin këpucë të prodhuara në perëndim.

Si burrat ashtu edhe gratë mbathin çorape të thurura me duart e grave. Ato i bëjne me qëndisje të veçanta të dallueshme familjare, siç bëhen edhe qëndisjet

10 Në disa treva si Malësia e Gjakovës etj. përdoret fjala *kapuç,* me prejardhje nga italishtja; *qeleshe* vjen nga turqishtja ndërsa *plis* është e burimit indoeuropian të shqipes. (Shënim i redaktorit)

11 Kjo është konfirmuar edhe nga Peshkopi Fan Noli (Shënim i autorit)

tartane skoceze.[12] Megjithatë kam parë edhe burra që nuk kishin mbathur çorape fare.Veshja e grave ndryshon nga vendi në vend, por është në thelb një kombinim i një veshje të plotë e mbushur me qëndisma që të kujton veshjen e një perëndeshe nga Kreta,[13] e mbuluar nga një bluzë ose korse e plotë. Shto këtu edhe një shall ose një shami koke dhe shumë bizhuteri, që blihen tek argjendarët në qytet, dhe gruaja duket e veshur për bukuri.

Këto kostume janë padyshim të lashta. Disa nga elementët e tyre mund të gjurmohen në Mesdheun e hershëm, të tjera në Epokën e Hekurit të Evropës Qendrore. Megjithatë, vetë Gegët nuk i bëjnë të gjitha pjesët e tyre, por e vazhdojnë traditën sipas kërkesës, si Indianët Crow për të cilët Stetson,[14] për dekada të tëra, ka prodhuar një lloj të veçantë kapelje.

Materiali bazë i veshjes endet në shtëpi. Bujku Gegë i siguron gruas së tij leshin e nevojshëm nga tufa e deleve, qofshin të bardha apo edhe të zeza. Ajo e kreh atë me gërhanë[15], një lloj krehëri me tela, i blerë ose i bërë në shtëpi; herë-herë gërhanët bëhen thjesht prej një dërrase me gozhda të gjata ngulur në të, të cilat shërbejnë si dhëmbë krehëri. Malësorja fillimisht e shprish leshin me dorë, pastaj e lënur me gërhanë, dhe kështu leshi bëhet i gatshëm për tjerrje. Pajisja e saj e tjerrjes përbëhet nga një furkë, një bosht dhe një shportë që e mban perin e tjerrur. Malësorja e vendos furkën në mes të këmbëve, e përcjell fijen e leshit për tek boshti me dorën e majtë, që e mban atë me dorën e djathtë, me të cilin e tjerr atë. Ajo e tjerr leshin, e mbështjell atë rreth boshtit tashmë në formë peri dhe e lëshon në shportë. Sa herë që nuk ka ndonjë gjë tjetër për të bërë, ose edhe kur ecën përgjatë shtegut, amvisa shqiptare tjerr me përkushtim. Tjerrja e shpejtë për të është bërë refleks njësoj si numërimi i rruazave të tespive tek disa burra.

---

12 Tartani skocez është një lloj stofi tradicional nga Skocia, i cili përdoret zakonisht për të bërë kilte dhe veshje të tjera tradicionale skoceze. Ky stof është i njohur për dizajnin e tij karakteristik me katrorë dhe vija në ngjyra të ndryshme, që krijojnë një model të përsëritur, i quajtur "plaidi". Çdo familje ose klan skocez shpesh ka tartanin e vet specifik, me ngjyra dhe dizajn unik, që përfaqëson identitetin e tyre. (Shënim i përkthyesit)

13 Veshja e perëndeshës nga Kreta, e njohur si veshja minoike apo veshja e perëndeshave të minoikëve, daton nga periudha e qytetërimit Minoik (rreth 2000-1450 p.e.s.) dhe përfaqëson një stil të dallueshëm të artit dhe kulturës së asaj kohe në ishullin e Kretës. Kjo veshje tregon për rolin e rëndësishëm që gratë dhe perëndeshat kishin në qytetërimin minoik, ku ato luanin një rol qendror në jetën fetare dhe shoqërore. (Shënim i përkthyesit)

14 Emri Stetson zakonisht lidhet me kapelën Stetson, një kapelë kauboji shumë e njohur që është bërë simbol i jetës së Perëndimit Amerikan. Këto kapele janë prodhuar për herë të parë nga John B. Stetson në mesin e shekullit të 19-të. Kapelat Stetson u bënë shumë të popullarizuara midis kaubojsëve, fermerëve dhe madje edhe disa grupeve vendase, përfshirë disa fise si Crow, të cilët filluan të adaptonin elemente të kulturës kaubojske pas kontaktit me evropianët dhe pas vendosjes në rezervate. (Shënim i përkthyesit)

15 Gërhanë - fjalë e burimit indoeuropian të shqipes, vjen prej *krahën* (krehër).(Shënim i redaktorit)

Kur ka lesh të mjaftueshëm, ajo e fillon mënjeherë endjen në vekun e shtëpisë. Veku për gratë shqiptare të Gegnisë është një pajisje e zakonshme evropiane me dy trarë, e ngjashme me ato që përdoren në Hebride dhe në malet e Kentakit, në Amerikë. Ai ka një kornizë prej druri, dy trarë ose rrotulla midis të cilave janë tendosur fijet e bazës, një shpatull druri dhe një pajisje që vihet në lëvizje me këmbë e cila quhet *ndërkambcë* dhe shërben për ngritjen dhe uljen e fijeve. Zanci,[16] është një lloj bobine që lëvizet me dorë brenda fijeve që zhvendosen me këmbëca nëpërmjet të së cilës përshkohet fija e perit të pëlhurës.

Janë burrat ata që i blejnë në qytet pjesët e nevojshme të kësaj vegle. Pjesët tjera ata i bëjnë vetë në shtëpi me duart e tyre. Veku mbahet i montuar vetëm kur endet një masë e caktuar pëlhure, qylymi apo sexhadje. Kur nuk është më në përdorim, veku çmontohet, paloset dhe vendoset tek një qoshe bashkë me pajisje të tjera shtëpiake. Pasi pëlhura, zhguni në këtë rast, është endur, nëse është e caktuar për t'u veshur nga njerëzit, duhet të lahet. Kjo përfshin mbajtjen e saj të lagur, punimin e saj dhe rrahjen e saj për disa orë. Malësorët përdorin një pajisje artizanale për përpunimin e zhgunit, e cila quhet shkaltore ose shkalc,[17] dhe vihet në punë nëpërmjet të ujit të rrjedhshëm. Disa studiues e kanë vëzhguar këtë lloj paisje, madje edhe Nopça e ka vizatuar një prej tyre. [18]

Unë i pashë vetë disa të tilla. Ky farë mulliri, shkaltorja pra, e cila quhet edhe vojavica, që përdoret për të "shkelur"[19] zhgunin, përbëhet nga një strukturë prej druri në ajër të hapur, e vendosur rreth një rrote ku lëshohet me forcë uji nga lart. Një rrjedhë më e vogël uji kalon nëpër një kanal për të lagur pëlhurën. Aksi kryesor i rrotës është i lidhur me katër boshta ose dhëmbëza prej druri, të cilat ngrenë dhe ulin një çekiç të rëndë prej druri dhe e lëshojnë katër herë për çdo rrotullim. Dy vegla të dhëmbëzuara dhe dy çekiçë e rrahin pëlhurën vazhdimisht sa kohë që ajo lihet aty.

Askush nuk duket se e din se kush e ka shpikur këtë vegël të përpunimit të zhgunit, pra shkaltoren, ose kush i prodhon ato edhe sot. Kur i sheh këto vegla, tek gjenden diku përgjatë një përroi, zakonisht janë të pa shoqëruara nga ndokush.

16 Zanc - fjalë shqipe, prej foljes me zanë. (Shënim i redaktorit)

17 Shkaltore, shkalc, lidhen me *shkel,* fjalë e burimit indoeuropian të shqipes. Me të njëjtin kuptim përdoren edhe *dërstil, vojavicë, valanicë;* këto të tria janë huazime sllave, të panevojshme. (Shënim i redaktorit)

18 Nopesa, 1925, p. 134, fig. 99. (Shënim i autorit)

19 Me shkelë zhgunin (zhgunat) do të thotë me e la e me e rrahë në shkaltore. Zhguni i shkelur bëhet më i dendur e më i fortë, dukshëm më i ngrohtë, dhe depërtohet vështirë nga shiu. (Shënim i redaktorit)

Duket se gruaja pasi ka endur pëlhurën ia dorëzon atë burrit të saj, i cili e çon në shkaltore për ta përpunuar. Aty nuk ka ndonjë përpunues profesionist dhe çdo shkaltore duket se i përket grupit të të afërmve ose fqinjëve që e përdorin atë.

Në të shumtën e rasteve, gratë i bëjnë veshjet e tyre me pëlhura të papërpunuara. Ato gjithashtu i thurin çorapet dhe i qepin opingat të cilat i veshin të dyja gjinitë. Burrat e çojnë pëlhurën e përpunuar plotësisht për tregti në qytetin më të afërt, tek ndonjë rrobaqepës, i cili më pas e pret atë, e skicon siç e don tradita e vendit të origjinës së klientit të tij, ia qep pjesët në një të tërë, e qëndis rrobën dhe e dorëzon të përfunduar.

Një numër zanatçinjësh të tjerë janë të përfshirë në prodhimin e veshjeve dhe pajisjeve për burrat. Një mjeshtër tjetër ofron sasinë e tegelave me të cilët vishen pjesërisht xhubletet dhe tirqit. Qeleshepunuesit përdorin kallupë prej druri për të përshtatur çdo trajtë fisnore të plisit, duke iu dhënë formë atyre, diku konike ose të rrafshët, diku të bardhë ose të zezë, sipas krahinës nga janë dhe sipas dëshirës së malësorëve që i mbajnë ato.

Lëkurëpunuesit që tradicionalisht janë turq, bëjnë rripa të zbukuruar për burrat, si dhe shala kuajsh dhe hejbe me rripa. Këpucëtarët bëjnë këpucë për ata që mund ta përballojnë çmimin, megjithëse shumica mbajnë opingat që gratë e tyre ua prodhojnë me lëkurat e bagëtive ose gomat e makinave. Shumica e rrobaqepësve janë nga Kruja, pasi ky njihet si zanati i krutanëve. Në Kukës, në disa dyqane pamë lëkura zebre të ekspozuara jashtë disa dyqaneve. Këto ishin sjellë nga Afrika e Jugut për të prodhuar opinga.

Siç u tha më parë, enët prej druri bëhen nga mjeshtrat zanatçi në qytete dhe blihen nga malësorët, të cilët i përdorin për qumështin, bulmetin dhe për ruajtjen e ushqimeve. Shportat janë prodhime vendore dhe fshatarët shpesh i sjellin ato në qytet për shitje. Disa fshatra afër Shkodrës, janë të specializuara në prodhimin e shportave dhe gratë që i thurin ato, i sjellin në treg së bashku me punëdoret e tyre të qëndisura. Këto përfshijnë jo vetëm shporta për penjët e tjerrur, shporta të vogla për t'i mbajtur në dorë, por edhe kosha të mëdhenj që përdoren për transport mallrash. Një të tillë mund ta mbajë në shpinë një burrë ndërsa kuajt i mbajnë dy të tillë në të dy anët e samarit. Unë besoj se ata kosha me thupra bëhen prej burrave.

Enë të tjera përfshijnë punime bakri dhe qeramike. Në çdo qytet gjënden kallajxhinjtë që përpunojnë fletë metali, i kthejnë dhe i bëjnë të rrumbullakët. Pastaj ato përdoren për pjekje, gatime ushqimesh, ëmbëlsira, etj. Po ashtu ata

prodhojnë xhezve që përdoren për çaj dhe për kafe, bëjnë kazanë, ibrika uji, kusia dhe legena për larje. Të gjitha këto gjëra blihen nga malësorët, të cilët herë pas here marrin enë të modeleve evropiane për t'u përdorur për ushqim si komplete gotash prej qelqi etj.

Janë tre lloje qeramike të cilat gjejnë përdorim në familjen e malësorit. Në fiset katolike, nëse jo gjetkë, gratë ende bëjnë një enë të Epokës së Hekurit, me profil të thjeshtë, me doreza, pa shtresë dhe të zbukuruar. Çerepi modelohet me dorë dhe piqet në një mënyrë të tillë që i jep asaj një pamje të errët. Ai përdoret për të pjekur bukën. Në qytete, poçarë profesionistë meshkuj bëjnë enë poroze në formë rrumbullake. Kjo përdoret për të mbajtur dhe ruajtur ujin. Qeramika e rregullt moderne e glazuruar importohet nga Italia dhe më pas shitet në pazare nëpër qytetet e mëdha.

Teknikat e ruajtjes dhe konservimit të ushqimit ndryshojnë midis katolikëve dhe myslimanëve, për shkak të dallimeve të tyre në dietë. Katolikët ruajnë shumë mish derri duke e kripur dhe tymosur. Burrat e çdo shtëpie therin aq derra të majmë sa ka nevojë familja ose sa mundësi kanë që ta ruajnë duke filluar qysh në vjeshtë. Ata e presin dhjamin e derrit në copa të gjata dhe e varin mbi oxhak, poshtë tavanit. Përveç këtyre pjesëve të tëra të derrit, ata bëjnë edhe sunxhuk dhe e ruajë edhe atë, po në të njëjtën mënyrë. Peshku për ta është një delikatesë e rrallë. Myslimanët zakonisht hanë vetëm mish të freskët dhe jetojnë me mish qengji, ndërsa katolikët e hanë edhe mishin e qingjit dhe mishin e derrit.

Të dy palët i ruajnë drithërat dhe bishtajoret e tyre nëper voza druri ose nëpër thasë të vendosur nëpër shtëpi. Ata e mbajnë misrin në hambarë të veçantë, jashtë shtëpisë, të bërë me qëllim për t'u mbrojtur nga minjtë. Tek hambari shumë shpesh do të shihet dhe dëgjohet duke lehur një qen i madh, i lidhur me zinxhir. Të dy palët prodhojnë gjalpë nga qumështi i lopëve të tyre si dhe djathë nga qumështi i deleve dhe dhive, megjithëse përdorimi i këtij të fundit është shumë më i zakonshëm midis myslimanëve. Katolikët, prodhojnë një verë të kuqe të fortë, në ato vende që janë të përshtatshme për rritjen e rrushit, të cilën e trajtojnë me rrëshirë si në kohërat homerike.

Myslimanët, e kanë të ndaluar nga Kurani që të pinë verë, por kënaqen me pije të tjera të distiluara. Në çdo lagje, gjendet, tek një ose më shumë familje myslimane, një paisje distilimi e bërë prej bakri, i njohur si kazani i rakisë. Ai është një kazan me një kupolë të kuqe bakri në krye, prej nga del një tub kondesues

e avullit, i cila kalon nëpërmjet një lugu të mbushur me ujë të ftohtë rrjedhës dhe që e sjell avullin të kthyer në lëng. Këtë paisje ata e blejnë në Shkodër ose në ndonjë qytet tjetër. Fqinjët i huazojnë këto paisje distilimi herë pas here, ashtu si familjet amerikane bëjne duke huazuar makinat e akullores. Pra rakia, e prodhuar nga rrushi ose fruta të tjera, distilohet në shtëpi. Një sasi e caktuar e këtij lëngu tregtohet në qytetet.

Të dy palët, si katolikët edhe myslimanët e pijnë duhanin. Ndërsa disa myslimanë e pijnë atë me nargjile, shumica e duhanxhive e pijnë me cigare të dredhur ose me llullë. Duhani përbën edhe vlerë ekonomike. Çdo familje ka parcelën e vet të kultivimit të duhanit ndërkohë që tepricat i shesin në treg në qytet. Duhanpirësve iu duhet të blejnë letër cigarje, e cila importohet nga Franca. Ata duhet të kenë një lloj pajisje ndezëse, një shkrepse, e cila zakonisht i shton shpenzimet, siç është shpjeguar më parë. Duhanpirja ka edhe aspektin social, atë të ndërveprimit dhe mirësjelljen midis burrave që nganjëherë shkon deri tek pirja me radhë e të njejtës cigare.

Ushqimi kryesor i të gjithë malësorëve, pavarësisht nga feja që ushtrojnë, është buka, zakonisht një bukë misri e fortë, pa maja. Ajo ruhet për javë të tëra dhe bëhet gjithnjë e më e fortë. Prandaj në vend që ta lenë që të myket nga kohëzgjatja në ruajtje, del si nevojë e tyre kryesore bluarja e grurit. Shumica e shtëpive mbajnë mokër dhe thuk[20] ndërsa shumë prej tyre përdorin edhe mullinj dore, me një formë romake, të cilat i përdorin gratë. Është e mundshme që të gjithë gurët e mullinjve të blihen në treg, pasi guri i përshtatshëm gjendet në pak zona. Megjithatë, një pjesë e madhe e bluarjes së drithërave bëhet në mullinj të vegjël që punojnë me uji, të cilët gjinden gjithëandej. Këta mullinj, të bërë në kushte artizanale shtëpiake, për të vënë në lëvizje gurin e rëndë që bluan drithin iu duhen gurët, njëri poshtë i palevizshëm dhe tjetri sipër që rrotullohet, lopatat e ujit që e vënë boshtin në lëvizje ose thënë më mirë një lloj turbine primitive, pararendëse e atyre që përdoren sot për prodhim energjie.

Me këtë ata e kursejnë përdorimin e energjisë muskulore njerëzore dhe shumë nga koha e vyer për punë të tjera. Në një vend në Malësinë e Gjakovës, pashë një lloj tjetër mulliri me ujë, me një pajisje goditëse që përbëhej nga një trung në formë lugu i vendosur në një bosht dhe i pajisur me një çekiç të rëndë në njërin skaj.

20 Enë prej guri, druri ose metali, që përdoret për të shtypur në të kafe, kripë, grurë etj. Fjalë e brumit të shqipes. (Shënim i redaktorit)

Uji rridhte në këtë lug derisa kishte hyrë mjaftueshëm në fundin e poshtëm për ta anuar të gjithën dhe për të ngritur çekiçin. Pastaj kur uji derdhej, çekiçi binte dhe cikli fillonte përsëri. Këta mullinj janë parë dhe studiuar edhe nga autorë të tjerë

Megjithëse ata përdorin fuqinë e ujit aq me zgjuarsi dhe kursejnë aq shumë përpjekje dhe mundime njerëzore, këto dy lloje mullinjsh nuk përfshijnë ndonjë ndarje specifike të punës. Ka burra që mund të jenë më të aftë për t'i vënë në punë mullinjtë sesa të tjerët. Megjithatë nuk ka ndonjë ndërtues profesionist mullinjsh madje as mullixhi.

Ashtu sikundër mullinjtë me kohë të plotë pune, edhe të tjerët iu përkasin familjeve që i përdorin dhe kur nuk janë në përdorim nuk shquhen për ndonjë përkujdesje. Megjithatë, nëpër qytete mund të gjenden mullixhinj profesionistë. Prizreni, për shembull, i cili ka një furnizim të bollshëm me ujë që rrjedh me shpejtësi nëpër rrugë. Ai është një qytet mullinjsh ku udhëtari që ecën në rrugën e mullixhinjve mund të dëgjojë që nga larg zhurmën e mprehtë të fërkimit gur mbi gur. Po ashtu dëgjohet edhe çakalla e mullirit që kërcen mbi gurin e sipërm dhe e zhvendos grurin duke e lëshuar nga hinka ku është depozituar poshtë në vrimën e gurit të sipërm. Këta mullinj plotësojnë nevojat e bukëpjekësve të Gjonajt dhe Zymit dhe i ushqejnë edhe vetë qytetarët e Prizrenit. Buka nga ky rajon gatuhet me cilësi të shkëlqyer dhe malësorët që vijnë në treg shpesh blejnë edhe disa bukë për t'i marrë me vete në shtëpi.

Gegët hanë një vakt kryesor në ditë, pasdite vonë. Në mëngjes, një mysliman mund të pijë një gotë të vogël rakie sa për të hapur sytë e ta shoqërojë me pak bukë dhe djathë. Të njejtën gjë bën edhe një katolik Gegë, sa për të mos ndejtë esëll. Të dy do të hanë një gjë të lehtë, të ftohtë rrugës ose në fushë, për drekë. Por koha kur mblidhet e gjithë familja, kur argëtohen të ftuarit e nderuar, vjen kur mbarojnë punët e ditës. Për këtë gratë e gatuajnë ushqimin dhe burrat ulen rreth sofrës së përbashkët. Në familjet myslimane, sofra është e vetmja mobilje e dallueshme, përveç sëndukëve të kudondodhur. Në mesin e shtëpisë së katolikëve, zakonisht gjëndet shkami[21] më i madh i shtëpisë, i bërë prej druri ahu, e ndërtuar vetë me dorë, tek i cili ulet i zoti i shtëpisë, ose mysafiri i nderit. Rreth sofrës vendosen një numër shkamijsh më të ulët prej druri ku ulen familjarët.

21 Shkam - stol prej druri. Fjalë me prejardhje latine. *Stol* është huazim prej serbishtes dhe *fron* prej greqishtes. Huazimet latine janë të hershme dhe kanë përparësi përballë huazimeve nga gjuhët sllave ose nga greqishtja, të hyra më vonë e të mbivendosura. (Shënim i redaktorit)

Pirunjët dhe takëmet e tjera moderne zakonisht mungojnë. Sjelljet mesjetare të sofrës malësore respektohen me përpikëri. Tek myslimanët të paktën, zakoni i kalimit të një ene me ujë për të larë duart, bashkë me një peshqir për t'i fshirë ato, edhe para dhe pas vaktit të ngrënjes, është një rit i zakonshëm. Po ashtu sicili duhet të fillojë ngrënjen pasi të thotë fjalën islame, "bismilah". Në një vakt që ndoqa në shtëpinë e major Cen Elezit në Sllatinë të Dibrës, sofra kishte një diametër shumë të madh. Numri i atyre që uleshin për të ngrënë rreth saj ishte të paktën 15 vetë, dhe po aq të tjerë prisnin me durim të uleshin rreth sofrës së dytë. Aty kishte ushqime që përfshinin mish delje të pjekur, ushqime të cilat i zoti i shtëpisë i shpërndau me duar te secili pjestar i familjes.

Në këtë vend kuzhinierët profesionistë gjenden vetëm nëpër qytete dhe në qendrat e reja qeveritare. Në Prizren dhe në Shkodër, për shembull, shumë nga këta kuzhinierë janë turq dhe pjatat e tyre përbëhen kryesisht nga mishi i qengjit të shoqëruar me lloje të ndryshme perimesh. Personalisht e gjeta këtë kuzhinë shumë të shijshme. Ata gjithashtu zenë kos shumë të mirë. Gatuesit e ëmbëlsirave formojnë një grup tjetër të veçantë dhe përqendrohen në prodhimin e bakllavasë dhe kadaifit, dy ëmbëlsirat me mjaltë të njohura për njerëzit në të gjitha restorantet greke. Ndërsa kur produktet e tyre të transportohen në malësi, vetë gatuesit e ëmbëlsirave qëndrojnë në shtëpi.

Malësorët e sigurojnë pothuajse të gjithë ushqimin e tyre përmes bujqësisë dhe blegtorisë. Gjuetia siguron pak ose aspak për shumicën e familjeve dhe e njëjta gjë vlen edhe për peshkimin. Përgjatë Drinit të Zi, pak mbi Kukës, ndonjëherë mund të kapen edhe peshq. Në Prizren, peshqit e freskët të lumit shiten në treg. Megjithatë, peshku është një ushqim i parëndësishëm në dietën e malësorëve të Gegnisë. E njëjta gjë vlen edhe për bimët e egra si mjedrrat, manaferrat dhe fruta të ngjashme, të cilat i mbledhin gratë. Për më tepër, çdo familje prodhon pothuajse të gjithë ushqimin e vet, përveç kafesë, çajit, sheqerit dhe kripës. Shumica e familjeve janë aq të varfëra sa nuk i përballojnë dot këto sende luksi të importuara nga jashtë. Rëndësia e vetë-mjaftueshmërisë absolute të Gegëve në ushqim lidhet me formacionin gjeologjik lokal, i cili ndikon në dallimet fizike të shkaktuara nga dieta.

Bujqësia është një punë e përbashkët familjare. I zoti i shtëpisë i blen në qytet veglat e hekurit që i nevojiten, ndersa pjesën tjetër e bën vetë prej druri. Ai e lëron tokën me qé dhe e prashit me shatë. Kur e mbjell arën, burri e ndjek pendën e

qeve që tërheqin plugun, ndërsa gruaja e tij e ndjek nga pas, duke mbajtur një shportë ku ka futur farën e bereqetit dhe e hedh atë në brazdë me dorë, në mënyrë uniforme. Më pas, kur bima rritet edhe gratë edhe burrat, së bashku, e prashitin. Kur piqen të lashtat, e tërë familja merr pjesë në korrje, fshirje dhe grumbullim. Nëse bima është grurë, ata i presin kallinjtë me drapër, i fshijnë kokrrat dhe i fusin nëpër thasë. Kur është misër, ata e mbledhin atë, kalli për kalli, dhe i vendosin nëpër vende të posaçme për tharje. Më pas ata i shkoklojnë kokrrat dhe i bëjnë gati për bluarje. E njejta gjë bëhet edhe me fasulet. Kur gjethet e duhanit arrijnë pjekurinë, janë burrat ata që i presin me kujdes dhe i varin në verandat e shtëpisë ose nën anët e çative të shtëpive, për t'i tharë. Malësorët Gegnisë rritin gjithashtu shumë pemë në oborret e tyre, krejt pranë shtëpive. Llojet kryesore të atyre pëmeve janë ftonjtë, dardhat dhe mollat

Gratë janë ato që i mjelin lopët, e nxjerrin gjalpin dhe e zënë gjizën dhe djathin. Djemtë e vegjël zakonisht punësohen si barinj dhe i çojnë tufat e tyre deri lart në male. Në verë, shumë familje Gegë i çojnë bagëtitë e tyre në bjeshkë, deri në livadhet alpine, në kullotat malore dhe i mbajnë atje javë të tëra, për verim. Gjatë kohës së verimit, ata mbledhin atje lesh, gjalp dhe djathë. Në ato zona të larta, ata banojnë në stane të vogla të përkohshme. (fig. 8, c). Kelmendasit, të cilët përgjithësisht jetojnë në zona me lartësi të mëdha, në dimër, i zbresin çdo vit tufat e tyre në Fushën e Shkodrës, për kullota dimërore.

Blegtoria iu siguron Gegëve jo vetëm ushqime, por edhe mjete pune, pasi ata i përdorin qetë për lërim dhe kuajt për udhëtime dhe transport mallrash. Në dimër ata i mbajnë lopët dhe kuajt e tyre brenda, ndërsa derrat, në rajonet katolike, kanë strehime të veçanta. Fundi i dimrit dhe fillimi i pranverës është stina kur ushqimi pakësohet. Hangari i misrit dalëngadalë zbrazet dhe aty mund të mbetet vetëm misri i farës i varur tufa - tufa, të cilin nuk e prekin në asnjë mënyrë. Mishi i thatë i lopës, pra pastërmaja nuk gjëndet më i varur në tavan e po ashtu, tek katolikët mbarohet mishi i terun, i dhjamosur i derrave.

Kjo është koha kur malësorët, të gjendur në kushtet e mbijetesës njerëzore, dikur e gjenin plaçkitjen si zgjidhje të vetme. Ndërsa disa ua vidhnin kafshët njëri-tjetrit, të tjerët zbritnin nga malet për të vjedhur bagëti nga fshatarët në fusha. Mirdita plaçkiste Zadrimën ndërsa Mati plaçkiste zonat e ulëta rreth Elbasanit. Kjo nevojë vjetore për ushqim ishte rezultat i një mungese prodhimi të tokës, i kombinuar me një tepricë të lindjeve mbi vdekjet. Plaçkitja sillte më shumë

ushqim, por gjakmarrja për këtë arësye shkaktonte më shumë vdekje. Ballancën midis këtyre të dyjave e rregullon emigracioni.

Në vitin 1929, transporti në Gegni ishte po aq i prapambetur sa kudo në Evropë. Aty kishte një numër të caktuar rrugësh mbi të cilat njerëzit mund të ecnin, në disa vende të kalëronin kuajt dhe në të shumtën e rasteve ata i transportonin mallrat mbi shpinën e kafshëve. Në disa vende shtigjet ishin shumë të pjerrëta për kafshët dhe burrat duhej të transportonin mallra me kosha të ngarkuar në shpinë. Rruga kryesore, e cila do të përshkruhet më vonë, shkon nga Shkodra dhe Lezha nëpërmjet të Vaut të Dejës deri në Pukë, e pastaj në Kukës dhe përtej kufirit, në Prizren. Kjo ishte një rrugë e vjetër romake dhe ndoshta nuk ka ndryshuar shumë gjatë një mijë vjetëve. Në Kukës, një rrugë tjetër takohet me të, duke kaluar në jug përgjatë Drinit të Zi deri në Peshkopi dhe jashtë "territorit" të Gegëve për në Liqenin e Ohrit dhe në Korçë. Në vitin 1929, disa pjesë të kësaj rruge ishin zgjeruar për t'u përdorur edhe me automjete, por pjesa më e madhe e tyre nuk ishte e lidhur me rrugë të tjera. Thuhet se të dyja këto rrugë qenë hapur për mjetet motorike që nga koha e pushtimit italian, (1917-1920).

Një tjetër trase rruge shkon nga Tirana në Zall Herr, pastaj te Guri i Bardhë në Mat, përmes Klosit. Ajo rrugë, pasi ndahet për në Bulqizë dhe në Dibër vijon për në Peshkopi. Kjo është rruga kryesore që lidh kryeqytetin e ri dhe rajonin e rëndësishëm në verilindje. Një tjetër rrugë kalon nga Lezha për në Burrel dhe i ndjek brigjet e Lumit Mat. Burreli, tani një qendër prefekture, është bërë i rëndësishëm vetëm nën Mbretërinë e Zogut. Nga Burreli mund të vazhdohet në zonën katolike të veriut të Lurës dhe Kthellës dhe pastaj në Dibër, por ajo rrugë është pak e shkelur. Në veri të Drinit, një shteg kalon nga Shkodra në Shosh përmbi fshatin Guri i Kuq, por në dimër kjo rrugë është e pakalueshme.


Në anën tjetër ekziston një rrugë që kalon nga Kukësi. Kjo rrugë e prek buzë Drinin dhe përshkon bajrakët e Bytyçit, Gashit dhe Krasniqes, në Malësinë e Gjakovës, e më pas ngjitet kah Mërturi e del në Shosh. Në dimër kjo rrugë mund të kalohet nga njerëzit, por jo nga kafshët. Prandaj në dimër, asnjë karvan me kafshë nuk mund të hyjë në Shosh ose në Shalë. Përpara se të vendosej kufiri midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, rruga nga Tropoja në Gash (Malësia e Gjakovës) për në Gjakovë ishte shumë e frekuentuar, por tani kjo është e ndaluar dhe njerëzve të këtyre anëve iu duhet të shkojnë për tregti në Kukës.

Për sa i përket ndonjë transporti mallrash, ato me kalë dhe me shpinën e

njerëzve janë të vetmet metoda me të cilat ato bëhen në Gegni. Megjithatë, në disa nga rajonet më të shpeshta përdoren mjete të tjera më të përshtatshme lokale për distanca të shkurtëra. Në zonat përreth Shkodrës, në ultësirën poshtë maleve, bujqit përdorin karroca, veçanërisht në Zadrimë. Edhe në Lumë, në tokën e rrafshët ku bashkohen Drinat dhe në Has në anën tjetër, përdoren gjithashtu karroca, si dhe qerre verore të tërhequra nga qétë.



Dr. Carleton S. Coon, ulur, në të djathtë me grupin e tij, duke pushuar në peizazhin e mbuluar me borë.



Ura e Drinit të Bardhë pranë Kukësit" (Foto: Carleton S. Coon 1929

Kalimi i përrenjve dhe lumenjëve nga njëri breg në tjetrin nuk është një gjë e thjeshtë në Gegni. Shumica e vendkalimeve janë va[22] me ujëra shumë të ftohta. Kam parë burra që endeshin buzë lumenjëve të akullt në kërkim të një vau ku t'i kalonin kafshët. Gjatë natës, ata ngjiteshin në vise të mbuluara me borë që kapte lartësinë deri te mjekra ime. Kjo borë ishte po aq e trashë në të dy brigjet e lumit. Ndodh jo rrallë që kur përrenjtë fryhen kafshët dhe njerëzit të mbyten. Ka patur një urë të vjetër të ndërtuar në kohën e turkut, e cila ende ekziston, përtej Drinit të Bardhë që lidh Kukësin me bregun verior (fig. 9, b). Drini i Zi në Dibër mund të kalohet nëpër disa ura druri. Në rrugën nga Krasniqja në Shosh kalova mbi një urë që mbahej në dy trarë. Njëri tra ishte për të ecur mbi të, ndërsa tjetri ishte si një parmak ku duhej të mbahesha me kujdes gjatë kalimit. Në disa và ku

22 Va, vau - vend i cekët në lumë, ku mund të kalohet në këmbë. Fjalë e burimit indoeuropian të shqipes. (Shënim i redaktorit)

ka vende që janë të disponueshme për lundrat, ata funksionojnë sipas parimit të ndryshimit të pozicionit të ankorimit të kabllos pas çdo kalimi, në mënyrë që fuqia e rrymës së ujit ta shtyjë lundrën diagonalisht në bregun tjetër. Një i tillë ishte në Kukës matanë Drinit të Zi ndërsa një tjetër e pashë në Burrel mbi lumin Mat. Vëzhguesit e tjerë kanë parë Gegë që i kalojnë këto përrenj mbi rrshiqe[23] pra lëkura të fryra, por unë nuk arrita t'i shihja ndonjëherë.



Një mjet i bërë vetë që shërben si lundër për të kaluar lumin Drin në mes të Lumës dhe të Malziut.

Lundrimi nëpër lumenjtë e Malësisë së Gegnisë është shumë i kufizuar. Edhe pse Baroni Nopça ka bërë një foto të një burri në një lundër në Mertur, unë e kam parë atë vetëm në rrjedhën e poshtme të Drinit, midis Vaut të Dejës dhe Shkodrës. Aty ku lundërtarë shumë të zotët i dërgojnë udhëtarët në qytet brenda pak orëve.

23 Rrshiq/rrëshiq - një lloj "thesi" i qepur me lëkurë dhie, që mbushet me ajër; luan rolin e kamerdares, duke u mundësuar njerëzve të qëndrojnë mbi ujë. (Shënim i përkthyesit)

Këto lundra janë *kanoe* të gjata, zakonisht dyshe. Lundërtari i shtyn ato, siç ndodh me gondolierët e Venecias. Burrat që i drejtojnë ato lundra dhe vetë lundërtarët në Drinin e Poshtëm janë pa dyshim burra shumë të zotët. Ata lundrojnë pothuajse me orar të plotë aq sa e kërkon nevoja. Ndoshta jo më shumë se një duzinë burrash merren me këtë lloj pune. Shumë më të shumtë janë qiraxhinjët profesionistë të kuajve, të cilët mund të shihen në të gjitha rrugët e fshatrave ku jetojnë Gegët mysliman, por edhe në disa zona më popullsi katolike. Qiraxhinjët e serialit tonë ishin dibranë, por ka edhe të tjerë që vijnë nga jashtë krahinave fisnore, si për shembull nga Elbasani dhe Tirana.

Sipas një vëzhgimi të afërt të sjelljes njerëzore nën stres, qiraxhiu është një njeri i rryem[24], i provuar me vështirësi që heret në jetë, pasi të gjitha udhëtimet në Gegni janë të vështira. Ai është një njeri pa lidhje familjare apo fisnore në krahinat ku punon, prandaj nuk përbën objektiv për t'u vrarë. Kushdo që e plaçkit atë i bën një dëm të pallogaritshëm tregtisë dhe do të ndërpresë furnizimin me mallra të importeve të nevojshme. Ai jep me qira nga një deri në gjashtë kuaj, për të shkuar kudo që e çon rruga dhe fitimi çdo ditë Për këtë duhet të negociohet gjatë. Ai këmbëngul të marrë drithë për kuajt e tij me shpenzimet e klientit dhe refuzon t'i japë me qera nëse drithi mungon. Midis qiraxhiut dhe klientit mund të ndodhin të gjitha llojet e situatave që prodhojnë mosmarrëveshje, siç janë çmimi i rritur papritmas i drithit në një vend të caktuar, tarifat e hanit dhe vetë trajtimi i kuajve.

Krahas transportit të udhëtarëve dhe mallrave të tyre, qerraxhiu bën edhe detyra të tjera. Ai çon mallra në treg pa praninë e pronarëve të mallit, i shet ato dhe e merr përqindjen e vet. Më pas ai sjell listën e mallrave të blera. Ai duhet të jetë shumë i sinqertë dhe nëse jo, do të humbasë besimin tek klientët e tij. Në të njëjtën kohë, malësorët që e punësojnë atë e marrin në mbrojtje ndaj rrezikut që mund t'ju kanoset nëse kalojnë nëpër territore që i konsiderojnë armiqësore.

QerAxhinjtë ose punojnë thjesht për veten e tyre, ose bëhen pjestarë të ndonjë sipërmarrje të përbashkët me dikend tjetër. Në të vërtetë, puna si pjestar i një sipërmarrje të tillë është më e përhapur tek myslimanët, pasi feja islame nuk lejon të fitohen norma interesi nëpërmjet të huave ose fajdeve. Kjo nuk është ndonjë punë e madhe. Nuk është biznes i madh, pasi numri maksimal i punëtorëve të përfshirë në të nuk e kalon numrin gjashtë. Aty përfshihen edhe djemtë që

24 I kalitur, i sprovuar me çdo vështirësi të jetës (shënim i përkthyesit).

qiraxhiu merr me vete për ta ndihmuar dhe kujdesur për kuajt. E megjithatë, kjo është një nga mënyrat e pakta që malësorët Gegë kanë për të përshkuar rrugët e vendit të tyre, aq shumë të izoluar. Në vitin 1929, çdo ditë duhet të kenë qenë të paktën njëqind qerrxhinj të tillë nëpër rrugë.

Në zonat myslimane, buzë rrugës, në largësi të përshtatshme prej njëra tjetrës, gjenden hanet. Ato ngjasin me kabinat turistike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Me qëllim që të gjendet një vend për të kaluar natën, është mirë që udhëtimi të fillohet heret në mëngjes dhe të arrihet tek hani përpara se të perëndojë dielli, pasi hanet shpesh mbushen ende pa rënë nata. Një han i zakonshëm ka zakonisht tre dhoma. Një është oda e madhe, e cila zë rreth tre të katërtat e të gjithë ndërtesës. Pastaj vjen një dhomë me një tavan të ulët e ndërtuar në një qoshe të ndërtesës, rreth 14 metra e gjerë dhe 30 ose 40 metra e gjatë, me një oxhak që gjendet krejt në fund të saj. Po ashtu hani ka edhe një dhomë të vogël private që e përdor hanxhiu, një si zyrë dhe një dyqan.

Që në oborr, hanxhiu të ndihmon që t'i shkarkosh kafshët nga barra e rrugës dhe të tregon vendin ku ato mund të kalojnë natën, pra në ahër. Ai ka ruajtur ushqim për to si për shembull bar, tallë[25] e ndonjëherë edhe drithëra, për ato raste kur udhëtari nuk ka marrë ushqim me vete. Pastaj secilit bujtës i cakton një pjesë të dyshemesë, e cila është e ndarë në tre rreshta: Dy anësoret janë rreth gjashtë metra të gjëra ndërsa i mesit dy metra. Musafirët flenë krah për krah njëri tjëtrit në ato tre vende të shtruara ndërsa hapsira në mes tyre përdoret për kalim në rast nevoje. Mysafirët ushqehen vetë dhe ju lejohet që të përdorin oxhakun për gatim ndërsa hanxhiu iu pjek kafe dhe iu shpërndan edhe raki kundrejt pagesës. Pasi mysafirët e tij hyjnë në dhomë për të fjetur, ai ua mbyll derën. Pas kësaj ai i le në qetësinë e tyre dhe nuk e hap derën më, deri në mëngjes, pavarësisht sa urgjente mund të jenë nevojat e mysafirëve për të dalë jashtë. Kjo masë sigurimi bëhet e nevojshme për shkak të akteve të dhunës që ndodhin jo rrallë herë.

Disa hanxhinj janë vendas. Të tjerët vijnë nga Kruja, që njihet si vendi i hanxhinjve. Të gjithë ata që jetojnë nëpër hane të vetëm, janë beqarë. Ky sistem i hanxhinjëve, ashtu si puna e qerraxhinjëve, josh ardhjen e një numri të caktuar të të huajve në ato anë. Ndoshta në Gegni gjënden 12 deri në 18 hane të tilla, pa llogaritur hotelin e vetëm në stil evropian, i cili gjëndet në Peshkopi. Katolikët

25 Tallë - kashtë misri. Fjalë me prejardhje latine. (Shënim i redaktorit)

nuk e përdorin këtë sistem. Në zonat e tyre fisnore mysafirët strehohen nga individë të rëndësishëm përmes një sistemi mikpritjeje të ndërsjellë. Meqenëse gjakmarrjet lokale zakonisht janë më të përhapura në vendbanimet katolike sesa në ato myslimane, udhëtimi përmes krahinave të katolikëve ndodhë më rrallë.

Mbetet vetëm çështja e tregtisë, e cila është trajtuar pjesërisht. Në përgjithësi, për Malsorët Gegë mund të thuhet se ata jetojnë në një ndarje pune rajonale dhe gjeografike, dhe ndoshta edhe etnike. Njeriu i zakonshëm është bujk që pret dhe mbledh drutë e zjarrit, punon për prodhimin e drithërave, bishtajoreve, zarzavateve, duhanit, leshit, produkteve të qumështit dhe ndonjëherë edhe enëve të drurit. Gruaja e tij end pëlhurë, sexhade, qylyma, thur çorape me grep, qëndis shalla shumë të bukur, tjerr lesh, bën shporta dhe disa produkte të tjera lokale. Ajo kujdeset edhe për shpendët që prodhojnë vezë. Këto produkte malore gjejnë rrugën e shitjes drejt tregut në qytet. Zakonisht burrat dhe gratë punojnë së bashku. Ndonjëherë gratë e bëjnë të vetme udhëtimin dhe ndonjëherë e gjithë familja qëndron në shtëpi, duke dërguar mallrat me ndonjë qiraxhi.

Gegët mund t'i shesin këto prodhime jashtë krahinës së tyre kur kanë tepricë produktesh bujqësore. Një ndër arësyet përse atyre iu mbeten këto teprica është se ata përdorin disa pajisje të cilat ua kursejnë punën e krahut. Aty bëjnë pjesë shkaltoret, mullinjtë e larjes dhe rrahjes së zhgunit, mullinjtë e blojës, të cilat vihen në lëvizje me forcën e rënjes së lirë të ujit. Kjo iu jep atyre më shumë kohë për aktivitete të tjera, por prapë se prapë nuk e zvogëlon dhe aq kompleksitetin e marrëdhënieve të tyre në shtëpi Në fakt mullinjtë janë të vegjël dhe u shërbejnë atyre të familjeve që janë të lidhura në baza fisnore.

Në anën tjetër të kësaj tabloje gjenden zejtarët dhe dyqanxhinjtë e qyteteve që janë shqiptarë por ka prej tyre që janë edhe turq apo serb. Këta zejtarë jetojnë me prodhimet që vijnë nga malet dhe nga rajonet e tjera bujqësore për rreth tyre. Ndërkohë ata, me punën e tyre iu plotësojnë malësorëve nevojat që kanë, duke përfshirë këtu paisjen me armë zjarri dhe municione, si dhe objektet e përmendura edhe më parë.

Deri tani pamja është e thjeshtë: Malësorët Gegë qëndrojnë në njerën anë të gardhit ndërsa qytetarët në anën tjetër. Një malësor mund të bëhet qytetar, por kurrë nuk ndodh e kundërta. Megjithatë, në disa vende, qetësia e maleve është prishur nga ustallarët e lëvizshëm që ndërtojnë kulla, nga hanxhinjtë dhe qerraxhinjtë të cilët mbushin udhët dhe kujdesen për udhëtarët. Po ashtu edhe nga

dyqanxhinjtë, të cilët janë vetë Gegë dhe që gjenden në fshatrat më të mëdhenj fisnorë, zakonisht nga një për çdo vendbanim. Mund të kujtoj vetëm një në Mirditë, asnjë në Shosh, ndërsa në fshatrat e Dibrës, Lumës dhe Pukës, përgjatë rrugëve kryesore, kishte disa. Këta burra shisnin çaj dhe sheqer, gjilpëra dhe penj, letër cigarje, kripë dhe piper, pak ëmbëlsira, qirinj, vajguri, shamia dhe shkrepëse. Ata nuk shkonin në qytet thjesht për blerje të vogla.

Me këtë balancim midis prodhimit dhe tregtisë, Gegët mezi arrijnë të jetojnë. Nëse do të ishim në gjendje të vlerësonim saktësisht të ardhurat e tyre mesatare, do të shihnim se ato janë ndër më të ulëtat në Evropë. Bujku i zakonshëm thjesht shqetësohet nëse do të ketë mjaftueshëm ushqim dhe rroba për familjen e tij. Në disa raste kam parë vëllezër që veshin të njejtin kostum, herë njëri e herë tjetri. Kur njëri e vishte kostumin dhe dilte jashtë, tjetri duhej të qëndronte në shtëpi. Këtë e vura re në Mërtur. Një familje e zakonshme ka mjaftueshëm ushqim për të kaluar vitin, por duhet të bëjë kujdes për të ruajtur farën për ta mbjellur në vitin që pason, pasi të ketë shitur edhe ca drithë në qytet. Shumë shtëpi janë skena të një mjerimi ekstrem dhe nganjëherë pllakos gjendja e urisë, sidmos në pranverë. Duke qenë se nuk kanë njohuri për kontraceptivet, ata lindin shumë fëmijë. Por, edhe shumë njerëz vdesin, pasi mungojnë njohuritë sanitare. Popullsia shënon gjithmonë një rritje të ngadaltë. Grindjet, vdekjet e papritura dhe emigracioni janë "valvula" e sigurisë së nevojshme. Tani ka një mundësi të re punësimi, që është edhe regjistrimi në xhandarmëri.

“FAMILJA GEGË”, ASHTU SI AJO E IZRAELITËVE TË HERSHËM, APO E KINEZËVE TË ÇDO PERIUDHE, ËSHTË NJË INSTITUCION EKONOMIK. FAMILJA, E CILA PËRBËHET NGA BURRI, GRUAJA (OSE GRATË) E TIJ, DJEMTË, VAJZAT E PAMARTUARA DHE FËMIJËT E DJEMVE, JETOJNË NË NJË SHTËPI OSE GRUP SHTËPISH KU ZAKONISHT TË GJITHË PUNOJNË SË BASHKU.

SISTEMI FAMILJAR: KUSH MARTOHET ME KË DHE PËRSE[1]

Për antropologun, sistemet e martesës selektive, (ose të detyruara) siç janë ato midis krushqive të kryqëzuara dhe janë fenomene të zakonshme.[2] Por antropologu është mësuar të merret kryesisht me popuj jo - evropianë, që jetojnë larg nga qendrat e qytetërimit. Ndërsa për sociologun që është mësuar të studiojë çështjet evropiane dhe amerikane, është një ngjarje po të zbulojë se pikërisht në shekullin e 20-të, ende funksionon një sistem "primitiv" vetëm 250 milje larg Romës. Siç e bën të qartë studimi ynë mbi kulturën materiale, *"Familja Gegë"*, ashtu si ajo e izraelitëve të hershëm, apo e kinezëve të çdo periudhe, është një institucion ekonomik. Familja, e cila përbëhet nga burri, gruaja (ose gratë) e tij, djemtë, vajzat e pamartuara dhe fëmijët e djemve, jetojnë në një shtëpi ose grup shtëpish ku zakonisht të gjithë punojnë së bashku. Disa punë më të ndërlikuara dhe më të rënda që ata përballojnë, kërkojnë ndonjëherë bashkëpunimin e një grupi më të madh. Kjo nuk ndodh shpesh. Por në raste të rralla, mund të thirren për ndihmë anëtarë të farefisit fqinj. Izolimi dhe pasiguria politike rritin frekuencën dhe forcën e marrëdhënieve të ndërsjella të anëtarëve të familjes. Në disa nga fiset, veçanërisht në Dukagjin, këto familje numërojnë deri në 30 ose 40 anëtarë. Fjala arabe *mëhalla* (që do të thotë kamp ushtarak) përdoret për t'i përcaktuar ato.

Ndarja gjinore e punës i veçon qartë punët e grave nga ato të burrave. Secili ka nevojë për tjetrin. Ekzistenca e një shtëpie të banuar vetëm me të veja dhe gra të pamartuara do të ishte e pa imagjinueshme, po aq sa do të ishte e pa imagjinueshme një shtëpi e mbushur vetëm me meshkuj. Familja duhet të jetë një

1 .Materiali kryesor i këtij kapitulli është bazuar në vëzhgimet e mia personale. Megjithatë, më është dashur të përdorja publikimin e Miss. Edith Durham - it të vitit 1928, si dhe të përfshija materialin të cilin ajo me shumë dashamirësi m'i dërgoi në një letër miqësore. (Shënim i autorit)

2 Sistemet e martesave selektive i referohen normave sociale ose traditave që përcaktojnë se me kë një person mund të martohet bazuar në kritere si lidhjet familjare apo gjenealogjia. Për një antropolog, këto lloj sistemesh martesore janë fenomene të zakonshme, që do të thotë se janë të thjeshta dhe jo të habitshme pasi janë vërejtur gjerësisht në kultura të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

njësi e harmonizuar. Nëse një njeri vdes, vendi i tij duhet të plotësohet, kur kjo është e mundur. Kur gruaja nuk arrin të lindë fëmijë duhet të zevendësohet me një tjetër. Familja duhet të vazhdojë ekzistencën dhe meqenëse janë kaq shumë burra që vriten para se të arrijnë pjekurinë, ajo duhet të shtohet me meshkuj. Lindja e vajzave është më pak e rëndësishme pasi ato nuk vriten por edhe për shkak se ato largohen nga familja për t'u martuar.

Për një numër arësyesh, del e qartë se Gegët preferojnë që nuset e djemve t'i marrin diku larg. Në radhë të parë, nëse një djalë do të martohej me një vajzë vendase, ai mund të hynte në telashe me djemtë e tjerë të fshatit. Të rinjtë krijojnë lidhje me vajzat që shohin çdo ditë, dhe çdo ndjenjë rivaliteti midis të rinjëve, që do të pasohej me një martesë të tillë, mund të shkaktonte tensione që zgjatin deri në moshën e tyre të rritur. Të rinjtë që jetojnë në të njëjtin vend duhet të shkojnë mirë me njëri tjetrin për një kohë sa më të gjatë të jetë e mundur. Për shkak të gjendjes jo të mirë ekonomike, tensionet janë të larta dhe shpesh përfundojnë në dhunë. Dhuna me fqinjët më të afërm do të ishte vetëvrasje. Prandaj është më mirë që baballarët t'i rregullojnë këto çështje mirë paraprakisht, dhe t'i fejojnë djemtë me vajzat e familjeve të cilat nuk kanë lidhje me krahinën ku martohen.

Pastaj, le të mendojmë për një çast se martesa nuk shkon mirë: Nusja qëllon e turpshme, nuk i pëlqen burri, ose është e ngathët dhe e ngadalshme në procesin e përshtatjes me jetesën e re, ose e kundërshton ndërhyrjen e vjehrrës së saj në punët e përditëshme... Nëse prindërit e saj do të jetonin afër, ajo mund të shkonte në shtëpi dhe të ankohej tek e ëma. Shpejt babai dhe vëllezërit e saj do të krijonin probleme për burrin e saj dhe familjen e tij. Çdo person i mençur mund të shohë që është shumë më mirë ta marrësh nusen diku larg. Kështu, nëse lindin probleme midis dy farefiseve, ata do të jenë shumë larg njëri-tjetrit për t'u marrë përditë me të njejtat probleme.

Pasi një familje ka krijuar zakonin që t'i marrë gratë nga një fis tjetër në një zonë të largët, ajo traditë ka të ngjarë të vazhdojë. Në vijim të kësaj tradite, një burrë do të shkojë te vëllai i gruas së tij dhe t'i thotë:

"A mos keni ndonjë vajzë të mirë për një djalë të fisit tim?"

Kjo e bën më të lehtë punën duke ditur se martesa e mëparshme ka qenë e kënaqëshme. Kjo kërkon më pak përpjekje sesa të thyesh akullin me një familje apo fis krejtësisht të ri. Në të njëjtën kohë kjo gjë e ruan largësinë e nevojshme. Natyrisht, nëse familja e prindërve të gruas nuk ka vajza të disponueshme për djalin që don të martohet në fisin e burrit të saj, ai mund të provojë diku në farefisin fqinj

të tyre, ose ndonjë familje tjetër me të cilën disa nga kushërinjtë e tij kanë bërë një krushqi të ngjashme, të kënaqshme. Në këtë mënyrë zgjidhen dy probleme: Vajza nuk shkon nuse në një familje të panjohur dhe të pasigurtë, ndërsa familja ku ajo martohet nuk merr një nuse të re nga një familje e panjohur dhe e pasigurtë.

TABLE 1: NUMBERS OF WIVES MARRIED BY FATHERS OF SUBJECTS, AND NUMBERS OF OFFSPRING.

	MeM	Duk	MeJ	Has	Lum	Puk	Mir	Zad	Mat	Dib	Int	Total
One Wife, Moslems	40		54	72	76	50		9	69	74	3	450
Catholics	47	89	10	10		24	82	83	9		2	356
Total	87	89	64	82	76	74	82	92	78	74	5	803
Two Wives, Moslems	12		27	19	23	13		3	20	32	1	150
Catholics	5	16	5	3		12	16	7	1		3	68
Orthodox											1	1
Total	17	16	32	22	23	25	16	10	21	33	4	219
Three Wives, Moslems			4	7	8	1		1	4			25
Catholics			2				1	1				4
Total			6	7	8	1	1	2	4			29
Four Wives, Moslems			1		2	1						4
Catholics		1					2					3
Total		1	1		2	1	2					7
Six Wives, Moslems			1						1			2
Total Fathers	104	106	104	111	109	101	101	104	104	107	9	1060
No. childless 1st wives		6	8	4	2	3	1	1	4	6		35
With daughters only	1	7	2			4	3	3	4	2	2	28
Total unsatisfactory 1st wives in plural marriages	1	13	10	4	2	7	4	4	8	8	2	63
No. boys born	400	317	332	366	394	325	300	298	271	365	31	3399
No. girls born	283	237	201	239	227	188	165	159	167	184	17	2067
Total children	683	554	533	605	621	513	465	457	438	549	48	5466
No. children per family	6.6	5.2	5.1	5.8	5.7	5.1	4.5	4.4	4.2	5.1	5.3	5.2
Sex ratio of children	141	134	165	154	174	173	182	187	162	198	182	163

Tabela 1 - Është një evidencë e shënimeve të marra nga Prof. Coon rreth mënyrës sesi martoheshin Malësorët Gegë, në formën e tyre tradicionale të çiftëzimit dhe ruajtjes së identitetit kombëtar, si dhe pastërtisë gjenetike si pasardhës të Ilirëve – dinarikë. Edhe këtu evidencat janë marrë në zonat Malësi e Madhe, Dukagjin, Malësia e Gjakovës, Hasi, Luma, Puka, Mirdita, Zadrima, Mati dhe Dibra

Ky sistem përmbush parimin universal që zbatohet në të gjithë çiftëzimin e njerëzve, që është: Lidhja normale ose ideale e bashkëshortëve duhet të jetë ajo që krijon shqetësimin më të vogël në sistemet e marrëdhënieve të të dyja palëve të përfshira.[3]

3 Coon, 1948, pp. 602-03 (Shënim i autorit)

Nëse kjo formë e çiftëzimit midis të njohurve ka mbijetuar në vendin e Gegëvë të Malësisë është tërësisht rrjedhojë e natyrshme e mbijetesës së barabartë në kushtet e një jete tradicionale në një mjedis aq të ashpër natyror sa ç'është ai ku jetojnë ata. Siç mund të pritet, sistemi i çiftëzimit iu përshtatet rrethanave.

Megjithatë, babai Gegë nëse pyetet, nuk do të jepte përgjigjet e specifikuara më lart si arësye për zgjedhjen që ai do të bentë për nusen e djalit të tij. Ai do të paraqiste një numër arësyetimesh të tjera. Ai do të thoshte se djali trashëgon trupin dhe shpirtin vetëm nga babai dhe se nëna është thjesht një mjet riprodhimi. *Babai Gegë thotë se është çnderuese dhe e paimagjinueshme që djali i tij të martohej me çfarëdo lloj të afërmi*.[4] Meqenëse familja e nënës nuk është e lidhur në linjë gjaku me fisin ku është martuar ajo, djemtë e fisit mund të vazhdojnë të marrin nuset brez pas brezi në fisin e saj. Kodi i Lekë Dukagjinit, të cilin babai Gegë e ka për zemër që ta citojë në një rast të tillë, e ka zgjidhur këtë çështje një herë e përgjithmonë.

Zgjedhja e një nusje për djalin e tij është një problem po aq politik për një kryefamiljar Gegë, sa ç'ishte për një mbret evropian të shekullit të 19-të, në kulmin e mbretërimit të tij. Nuk duhet bërë asnjë gabim pasi preferencat e nuses apo dhëndrit nuk konsiderohen të rëndësishme. Prandaj marrëveshjet i bëjnë vetëm baballarët. Një baba zakonisht e paguan *msitin*[5] prej 15 deri 20 napoleona (60 - 80 dollarë) për nusen e djalit. Kjo është sa gjysma e çmimit që kërkohet për të ndërtuar një kullë të re. Nëse babai ka shumë djem, djalit më të vogël mund të mos i afrohet një grua e re, por ta kënaqin me një grua të ve, e mbetur e tillë brenda shtëpisë. Kështu, të gjetja e nuses për çdo djalë mund të marrë disa kohë. Prandaj shumë të rinj presin gjatë deri sa t'u vijë rradha që të martohen.

Arësye kryesore për këtë vonesë, përveç çmimit, janë edhe shifrat e veçanta të lindjeve dhe vdekshmërisë për Gegninë. Aty lindin shumë më shumë djem sesa vajza. Në disa rajone, djemtë janë në një raport pothuajse dy me një më shumë se vajzat (shih tabelën e madhe 1). Megjithatë, sapo një djalë vjen në moshën kur e vendos armën në sup, ai mund të fillojë të përfshihet në ngatërresa dhe kështu i hap rrugën edhe vrasjes. Më pas, nëse ndodh kjo, çështja e martesës së tij merr rrugë tjetër dhe nusja e zgjedhur për të mund t'i kalojë vëllait ose kushëririt të tij. Në këtë rast dhe për këtë arësye, vajza e re që pret të bëhet nuse, mund dhe

4 (Korsivi i përkthyesit)

5 Msiti është pagesa që babai i djalit i paguan babait të nuses në momentin kur merren vesh për t'I martuar të rinjtë. (Shënim i përkthyesit)

duhet të martohet me dikë tjetër, krejtësisht të ndryshëm nga ai që kishin zgjedhur për të që në fillim.

Babai i zgjuar dhe i kujdesshëm, gjithmonë në kërkim të nuseve për djemtë e tij, mund të japë si peng një pjesë të konsiderueshme të çmimit të nuses tek prindërit e një vajze që kur ajo është foshnjë, apo sapo ajo të lindë. Ose ai madje edhe mund të rrezikojë në gjininë e një fëmije të palindur. Vajza e vogël, që në moshën katërmbëdhjetë vjeçare mund të gjejë veten të martuar me një burrë dyzet vjeçar. Pasi t'i jetë dorëzuar burrit të saj të ri dhe të jenë kryer ritet sipas traditës, ajo është ende në provë dhe mund të kthehet në shtëpinë e saj nëse nuk arrin të lindë pasardhës brenda një kohe të arësyeshme. Tek katolikët, martesa në kishë shpesh vonohet deri pas lindjes së fëmijës së parë. Në këtë mënyrë, nusja mund të kthehet në gjini, nëse nuk plotëson kërkesat, pa shkelur teknikisht rregullin e monogamisë së krishterë.[6]

Ndërsa sistemi "Gegë" i përzgjedhjes së bashkëshortëve të ardhshëm mund të jetë i përshtatur mirë me kërkesat e mjedisit, ekonomisë dhe jetës politike të malësorëve, ai prapëseprapë ofron pak mundësi për përshtatje personale mes burrit dhe gruas. Princi Gjon Markagjoni e përmblodhi këtë mungesë besimi në një frazë të trishtueshme kur më tha, në praninë e gruas së tij: "Ekziston vetëm një grua që një burrë mund t'i besojë: Ajo është nëna e tij." Rastet kur martesat bëhen me vajza nga familje apo kushërinj të fisit të prindërve të një nusje të përshtatur tashmë në shtëpinë burrit, funksionojnë në mënyrë ideale, pasi djali dhe vajza mund të jenë takuar para fejesës, ose të paktën para martesës. Nëna e djalit, në vizitat tek të afërmit e saj, mund ta këtë marrë atë me vete që në vogëli dhe ai do të ketë pasur mundësinë që të luajë me fëmijët e fqinjëve të dajallarëve të vet. Pastaj kur nusja shkon te shtëpia e burrit, ajo do të vihet drejt për së drejti nën mbikëqyrjen e hallës, që është pikërisht ajo gruaja të cilën nusja e sapoardhur tashmë e njeh dhe që përfaqëson një zgjerim të familjes së saj në një shtëpi të huaj. Një lidhje e tillë martesore, ende nuk parashikon zgjedhjen e bashkëshortëve në bazë të njohjes me njëri tjetrin. Ajo thjesht e bën pak më të lehtë përshtatjen e nuses nga njëra familje në tjetrën, sesa në rastet kur vajza është krejt e huaj. Ndodh që i fejuari i një vajze vritet. Në këto raste ajo duhet të martohet me njërin nga vëllezërit e të ndjerit, nëse ka, me një kushëri të afërt ose me dikë të një familjeje

6 Coon, 1948, f. 602 – 03.

krejtësisht tjetër. Por në atë rast aty nuk do ta ketë hallën që ta ndihmojë për t'i zgjidhur problemet që i dalin në shtëpinë e re. Ajo do të ketë vetëm vjehrrën, lidhjet me të cilën kalojnë vetëm nëpërmjet të burrit të saj.



Princi i Mirditës, Gjon Markagjoni (1888-1966), me gruan, nënën dhe fëmijët e tij.

Nuk është ndonjë habi që nuset ndonjëherë ikin. Nëse kthehen në shtëpinë e prindërve, baballarët e tyre zakonisht i kthejnë mbrapsht tek burri. Ky veprim nuk është aq i rrallë dhe nëse janë me fat, kur nuk kthehen tek babai, ato vendosen në ndonjë qytet apo zonë të largët ku dora e Kanunit të Lekë Dukagjinit nuk i arrin dot. Këngët Epike të Gegëve, të cilat udhëtari i dëgjon të këndohen natë për nate në shtëpitë e malësorëve, nëpër hane apo posta xhandarmërie, e kanë si temë arratisjen e femrave të tilla. Në ato këngë të gjata këndohet për çifte të dashuruar marrëzisht, të cilët thyejnë të gjitha rregullat, kanunet, arratisen por

hasin në fat tragjik por të pashmangshëm. Në atë epikë, ata rrallë ndodh që t'ja dalin që të shpëtojnë. Ndërsa në jetën reale besoj se ndonjëherë ata ia kanë dalë me arratisjet e tyre të suksesshme. Kështu edhe ata i kontribojnë uljes së numrit të popullsisë së malësisë.

Nëse një e re përballet me një martesë të cilën nuk e pranon dhe që ajo vetë ka një karakter aq të fortë sa të guxojë të betohet dhe të shpallet "Virgjinë e Betuar ose Burrneshë" mund të shmangë martesën e imponuar. Betimin për dlirësi të përjetshme ajo e bën në prani të dymbëdhjetë pleqëve. Në këtë mënyrë, ajo jo vetëm që i shpëton fejesës, por gjithashtu parandalon një gjakmarrje mes familjes së saj dhe asaj të të fejuarit të paracaktuar të për shkak të këtij mospajtimi me vendimin e marrë për jetën e saj. Pas kësaj, ajo praktikisht sillet si burrë. Zakonisht ajo vishet me rroba burrash, mban armë në brez, qëndron dhe lufton nëse e kërkon nevoja bashkë me burrat, plugon arat, korr të lashtat, dhe kryen çdo punë që bëjnë edhe burrat. Nëse "Burrnesha" e thyen betimin e saj, pleqtë do ta djegin të gjallë. Ne nuk arritëm të mësonim nëse ndonjë rast i tillë ka ndodhur kur ky dënim është zbatuar ndonjëherë, të paktën jo në breznitë e fundit.

Siç mund ta shohë lexuesi lehtësisht, ky zakon ka aspektet e veta ekonomike. Kështu, numri i duarve që bëjnë punët e burrave shtohet me dy, ndërsa për punët e grave zvogëlohet po me të njëjtin numër. Ka edhe një arësye tjetër, por më pak dramatike, që një femër të betohet për virgjëri: Kur i zoti i shtëpisë nuk ka djem për ta ndihmuar në punët e tij, ose nëse djemtë e tij janë vrarë, atëherë e bija "Burrneshë" mund të zërë vendin e një djali dhe situata tejkalohet përkohësisht. Megjithatë, meqë pseudo-djali nuk do të ketë pasardhës, linja do të shterojë me vdekjen e saj ndërsa prona do të kalojë te më të afërmit nga ana e babait.

Ky zakon është në kundërshtim me atë të zakonshmin në shoqëri të krahasueshme, në të cilat i shoqi i vajzës së burrit të shtëpisë, pra dhëndrri, shkon të jetojë me prindërit e saj dhe adoptohet si trashëgimtar. Besimi në vazhdimësinë e linjës mashkullore është aq i fortë sa që kjo nuk mund të ndodhë në Gegni.

Gjatë udhëtimeve të mia hasa vetëm në dy "Burrnesha". Njëra ishte e veshur me rroba burrash dhe dukej sikur ishte ose me të meta mendore ose të paktën "kishte sjellje të habitshme". Ky ishte të paktën etiketimi që i bënin asaj. E dyta ishte e veshur me rroba grash. Ajo ishte në të njëzetat dhe mjaft tërheqëse. Meqë kaloi natën me një anëtar të ri të grupit tim të kalorësve, krijova një mendim të keq për praktikën zakonore të djegies së gjallë. Është mjaft e qartë që praktika e

betimit për virgjëri shpesh ka motivime ekonomike, por gjithashtu është pjesë e të gjithë procesit të kontrollit të popullsisë lokale, së bashku me gjithë konfigurimin e krenarisë, fyerjes dhe gjakmarrjes.

Janë edhe dy mënyra të tjera që ndihmojnë në ruajtjen e numërit të anëtarëve të familjes në një nivel të pranueshëm me krahë pune dhe në parandalimin e izolimit të individëve të veçantë ose grupeve të vogla, jo-ekonomike. Njëri është *levirati*.[7] Në kuptimin klasik të fjalës, kjo do të thotë se kur një burrë vdes, e veja e tij do të martohet me një (njërin) vëlla që i vdekuri lë pas, ose me njërin nga më të afërmit e tij nëse një vëlla i tillë mungon. Në një vend ku shkalla e vdekjeve nga dhuna, në disa zona arrin nivelin e dyzet për qindëshit e të gjitha vdekjeve të meshkujve dhe ku vajzat martohen në moshën 14 ose 15 vjeç, shumë prej këtyre të fundit mbeten të veja. Një e ve e tillë duhet të gëzojë kujdesin e burrave të familjes së burrit të saj, meqë ata kanë paguar për të dhe ajo i është bashkuar fisit të tyre.

Nëse i vdekuri ka një vëlla të gjallë i cili është i pamartuar, padyshim që gjëja e duhur që duhet të bëjnë është ta martojnë me vejushën. Por ajo mund t'i jepet edhe një kushëriri të parë. Megjithatë, ndonjëherë ndodh që forma klasike e *levirat-it* të bëhet e nevojshme për t'u zbatuar dhe kështu njëri nga vëllezërit, mundësisht vëllai më i madh i të ndjerit, që është tashmë i martuar, ta marrë si ortake fatkeqen e mbetur e në shtëpinë e tij. Në bashkësitë myslimane ky veprim nuk paraqet ndonjë pengesë fetare. Por në familjet katolike kjo mund të shkaktojë një konflikt me kishën. Në një rast të tillë, Kanuni i Lekës del mbi Ligjin e Rromës.[8] Nevojat shoqërore janë më të forta se kufizimet fetare. Ky "bashkëshort" i ri i kësaj vejushe mund të mos lejohet të martohet me të në kishë dhe nuk është e mundur që ai ta marrë bekimin për këtë lidhje të re. Megjithatë, gruaja hyn në shtëpinë e tij dhe ai kujdeset për të dhe për fëmijët e saj, nëse ka.

Mekanizmi i dytë është poligamia, që zbatohet në ato raste kur gruaja e parë nuk lind djem por vetëm vajza. Kjo lloj martese e re, sërish është plotësisht e pranueshme midis myslimanëve por diametralisht në kundërshtim me rregullat e

7 Levirati është një zakon i vjetër, sipas të cilit një burrë martohet me gruan e vëllait të tij të ndjerë. Ky zakon praktikohej për të siguruar vazhdimësinë e familjes dhe për të mbrojtur të venë nga vështirësitë. Në disa kultura, martesa me të venë ishte një mënyrë për të siguruar që pasuria dhe fëmijët e mundshëm të qëndronin brenda familjes.

8 Ligji Romak: Ky term i referohet sistemit ligjor të Romës së lashtë, i cili u zhvillua nga koha e themelimit të Romës në vitin 753 p.e.s. deri në rënien e Perandorisë Romake Perëndimore në vitin 476 e.s. Kodifikimi më i rëndësishëm i Ligjit Romak ishte "Corpus Juris Civilis" ose "Trupi i Ligjit Civil," i përpiluar nën drejtimin e Perandorit Justiniani I – rë, në shekullin VI e.s. Kjo përmbledhje ligjesh pati një ndikim të thellë në zhvillimin e sistemeve të drejtësisë civile në Evropë. (Shënim i përkthimit)

krishtera. Kështu, prifti kurrë nuk do t'i lejojë një burri që të ndahet nga gruaja e tij, thjesht sepse ajo nuk i lind djalë. Nëse gruaja lind vajza, aty ka gjithmonë shpresë se një ditë do të lindë edhe djalë dhe shtëpia do të këtë mashkull trashëgimtar. Por nëse pas një kohe të caktuar nuk vjen në jetë asnjë pasardhës, atëherë lind nevoja për t'u martuar me një gruaje tjetër. Ai, si rregull nuk mund të ndahet nga gruaja që ka në shtëpi dhe nuk mund të martohet ligjërisht as me një tjetër. Përgjithësisht këtu përsëri, fiton zakoni. Personalisht kam hasur dhe vizituar vetëm një familje katolike Gegë, ku mësova se i zoti i shtëpisë kishte dy gra, dhe kjo ndodhte thjesht për këtë arësye. Nuk është ndonjë habi që, meqë krishtërimi nuk përshtatet me nevojat ekonomike të familjes shqiptare, shumë prej katolikëve të jenë shndërruar në besimin Islam, i cili në këtë aspekt ishte shumë më i pranueshëm.

Kur i përgatitëm formularët e matjeve, para ekspeditës, Dr. Hooton dhe unë vendosëm hapësira për shënimin e statistikave jetësore të mëposhtme: Numri i grave të martuara nga babai i subjektit dhe numri i fëmijëve të secilës gjini të lindur nga secila grua. Ne zgjodhëm babain e subjektit dhe jo vetë burrin pasi në këtë mënyrë ne do të kishim të bënim me familje të plota ose pothuajse të plota. Kështu, në çdo rast morëm përgjigje specifike. Ishin shumë pak ata të pyetur, etërit e të cilëve kishin pasur tre ose katër gra, të cilët nuk mund të kujtonin sesa fëmijë kishte pasur secila grua e babait të tyre, përpara se ata të kishin lindur.

Këto statistika nuk paraqesin ndonjë provë të numrit të shtatëzënësive. Fëmijët që kishin vdekur që foshnjë, ndoshta nuk janë përfshirë. Infanticidi[9] femëror nuk raportohet nëpër Gegni. Supozohet se të gjithë ose shumica e fëmijëve të kishin arritur në një moshë të tillë që, ose ishin ende gjallë në vitet 1929 - 30, ose ishin mjaftueshëm të rritur në kohën e vdekjes së vëllezërve të tyre, sa për t'i kujtuar dhe lënë përshtypje tek vëllëzërit ose gjysëm vëllëzërit që ishin objekti i studimeve tona. Shifrat tona tregojnë sesa gra kishte secili baba, por jo sa në të njëjtën kohë. Në fakt ishte e vështirë të merreshin ato informacione nga një pyetje rastësore e bërë në publik, në kohën e matjeve.

9 Infanticidi i referohet vrasjes së qëllimshme të një foshnje, shpesh nga nëna ose një anëtar tjetër i familjes. Ky term mund të përdoret gjithashtu në një kontekst ligjor për të përshkruar një krim ku një foshnjë e sapolindur mbytet me qëllim. (Shënim i përkthimit)

Në vitin 1929, poli-gjinia[10, 11] ishte e ndaluar ligjërisht në Shqipëri si për katolikët ashtu edhe për myslimanët. Ndërkohë, katolikët kishin mbi vete edhe kundërshtimin e kishës e cila ndikonte që të mos e zbulonin poli-gjininë e prindërve të tyre në prani të njerëzve të tjerë. Një defekt tjetër i dukshëm i të dhënave tona është se ne nuk kemi të dhëna për ato martesa prej të cilave nuk ka lindur djalë dhe as në ato ku është marrë një grua e dytë. Ky fenomen edhe pse i rrallë, duhet të ketë ndodhur. Lexuesi mund të mendojë, duke pasur parasysh raportin e pazakontë gjinor, 163 meshkuj për 100 femra, se myslimanët nuk kanë treguar numrin e vërtetë të vajzave të lindura, por unë nuk besoj se kjo është e vërtetë. Të krishterët kishin të njëjtin raport gjinor si dhe myslimanët. Për më tepër, nëse do të kishin lindur shumë më tepër fëmijë sesa ishin regjistruar, sistemet riprodhuese të nënave Gegë do të ishin stërmunduar përtej kapacitetit të tyre.

Siç tregon tabela nr 1, 1.060 Gegë meshkuj u martuan me 1.375 gra. Tre të katërtat e burrave kishin vetëm një grua secili, pjesa tjetër kishte nga dy deri në gjashtë gra. Një e treta e të gjithë myslimanëve u martuan më shumë se një herë, krahasuar me një të gjashtën e katolikëve. Shumësia më i madhe nga ana e myslimanëve reflekton pjellorinë më të madhe të tokës në fiset lindore, të cilat janë pothuajse tërësisht të banuara nga myslimanët dhe ku një burrë mund të përballojë të mbajë më shumë gra dhe të ushqejë më shumë fëmijë. Banorët e fiseve tërësisht katolike, si Mirdita dhe Dukagjini, janë më të varfërat në Gegni. Aty ku katolikët dhe myslimanët jetojnë së bashku në numër të barabartë, katolikët martohen po me aq gra sa edhe myslimanët. Në fakt, në Pukë, katolikët ishin martuar me më shumë gra. Feja pra ka pak lidhje me numrin e përgjithshëm të grave me të cilat martohet një burrë. E prapë se prapë kjo mund të ketë diçka të bëjë me numrin e grave me të cilat ai është martuar në të njëjtën kohë.

Statistikat tona na ndihmojnë pak për të zbuluar se përse 256 Gegë u martuan me më shumë se një grua. Në 82 raste, ose 32 për qind, gruaja e parë nuk arriti t'i sigurojë burrit të saj një trashëgimtar, megjithëse në 28 prej këtyre rasteve, ose 11 për qind syresh, lindën një ose më shumë vajza. Meqenëse nuk e dimë datën e lindjes së çdo fëmije, nuk mund të jemi të sigurt nëse disa nga gratë e para që

10 Poli-gjinia është një lloj poligamie ku një burrë është i martuar me më shumë se një grua në të njëjtën kohë. Kjo praktikë ka qenë pjesë e kulturave dhe feve të ndryshme nëpër botë, dhe vazhdon të ekzistojë në disa shoqëri.

11 Poligamia është praktika e pasjes së më shumë se një bashkëshorti ose bashkëshorteje në të njëjtën kohë. Ajo mund t'i referohet ose poligjinisë (një burrë me disa gra) ose poliandrisë (një grua me disa burra). Poligjinia është një formë specifike e poligamisë ku një burrë ka disa gra. (Shënim i përkthyesit)

lindën djem nuk e bënë këtë pasi të ishte marrë një grua e dytë, dhe raporti i martesave në shumësi të lidhura për këtë arësye mund të jenë më të larta sesa tregojnë shifrat tona. Disa nga të dhënat tona zbulojnë fenomenin e martesave, pas martesës së parë, pa pengesa derisa më në fund, gruaja e katërt apo edhe e gjashtë të lindë djalin. Pas kësaj, njerëzia e dëgjon krismën e pushkës për ardhjen në jetë të trashëgimtarit dhe gëzimin që sjell ai me vetë.

Në ndërthurjet ndërfisnore që i studiuam ne, në 5 raste nga 9, ishin burra, baballarët e të cilëve kishin marrë më shumë se një grua secili. Nga katër burrat që i studiuam në Has, nënat e të cilëve kishin ardhur nga Podrimja, tre ishin rritur në familje poligjene[12]. Këto shifra tregojnë një motivim tërësisht politik. Zakoni i marrjes së grave në shumë raste nga fiset e huaja për të forcuar aleancat është një zakon i përhapur dhe shkon prapa që në ditët e Solomonit. Shifrat tona nuk janë të përshtatshme për të zbuluar shembullin e saktë të kësaj lloj ekzogamie.[13]

Këto dy arësye ndoshta shpjegojnë pothuajse gjysmën e të gjitha martesave pluraliste. Gjysma tjetër mund të jetë shkaktuar lehtësisht nga rrethanat e vdekjeve të parakohëshme. Pas vdekjes së një burri, *levirati* mund t'i jepte një prej të afërmve të tij një grua të dytë, pra gruan e mbetur vejë. Pas vdekjes së një gruaje, burri i saj do të martohej përsëri, nëse do të ishte i aftë. Me lindjet e vështira, *ethet puerperale*[14] dhe lodhjen e përgjithshme nga lindja e shumë fëmijëve fill njëri pas tjetrit, vdekja duhet të ketë marrë shumë nga gratë e listuara në serinë tonë si vdekje në një moshë të re.[15]

Shifrat për fëmijët tregojnë se 1.060 etër, lindën me 1.375 gratë e tyre (të para dhe të dyta sipas rastit) 5.466 pasardhës të cilët jetuan aq gjatë sa për t'u studiuar nga ekipet tona. Kjo jep një mesatare prej 5.2 fëmijësh për familje, nga të cilët 3.399, ose 62 për qind, ishin djem. Kështu, mesatarja e familjes Gegë kishte 3.2 djem për ta ndihmuar që të punonin tokën ndërkohë që kishte vetëm

12 Familjet poligjene janë familje që rezultojnë nga poligamia, një lloj martese në të cilën një burrë ka më shumë se një grua në të njëjtën kohë. Kjo është një praktikë e zakonshme në disa kultura dhe shoqëri në botë. Në familje të tilla, burri zakonisht ka disa gra, dhe të gjitha janë pjesë e një njësie familjare të vetme, shpesh duke jetuar së bashku ose në afërsi të njëra-tjetrës.
Karakteristikat kryesore të familjeve poligjene: (Shënim i përkthyesit)
Disa gra: Burri është i martuar me më shumë se një grua në të njëjtën kohë.
Shtëpi e përbashkët: Në shumë raste, gratë dhe fëmijët e tyre jetojnë së bashku ose në një komunitet të përbashkët.
Fëmijët: Fëmijët e të gjitha grave konsiderohen pjesë e së njëjtës familje të zgjeruar. (Shënim i përkthyesit)
13 Ekzogamia referohet si "eksogami". Ky term gjithashtu tregon praktikën e martesës jashtë grupit ose komunitetit shoqëror. (Shënim i përkthyesit)
14 Ethet puerperale, të njohura gjithashtu si ethet e lehonisë, janë një infeksion që ndodh tek gratë pas lindjes ose abortit.
15 Nopcsa, 1925, Të dhënat të mbledhura nga klerikët katolikë. (Shënim i autorit)

2.0 vajza për t'i *shitur* për martesë. Kjo normë lindjeje është aq e lartë sa krijon një disproporcion të konsiderueshëm popullsie. Ajo varion nga 4.2 në Mat deri në 6.6 në Malësinë e Madhe, me familjet më të mëdha në të dy anët e maleve dhe më të voglat në mes. Por edhe familjet e vogla, janë shumë të mëdhaja kur e krahasojmë vendin dhe prodhimtarinë që iu duhet atyre që të ushqehen. Kjo do të zgjase deri kur të ndryshojnë metodat e shfrytëzimit të tokës, ndryshim i cili ende nuk ka ndodhur.[16]

Qyteti i Shkodrës ua merr fshatrave për rreth tij disa nga tepricat e prodhimit. Në tokat në lindje të Drinit të Zi, zhvendosja drejt fushës ishte e mundur dhe zakonisht ndodhte. Cvijič[17] ka treguar se si, përgjatë të gjithë zinxhirit Dinarik, për shekuj me radhë popullsia ka zbritur vazhdimisht nga malet drejt fushës. Megjithatë, që atje nga malet e largëta, një zhvendosje e tillë nuk ishte e lehtë. Veçanërisht në ato kohëra kur katolikët nuk ishin të mirëpritur në territorin mysliman, njerëzit që jetonin nëpër ato male duhej të qëndronin në vendbanimet e tyre.

Ka vetëm një metodë universale dhe të lashtë për të zvogëluar numrin e popullsisë në këto rrethana. Kjo është metoda e gjetur në Rif.[18] në Kaukaz, në vendin Kafir të Afganistanit dhe në shumë vende të tjera - Gjakmarrja. Kur prej saj vriten shumë meshkuj, popullsia mbetet konstante.

Në ato anë vriten vetëm meshkujt. Ekzistojnë disa statistika për vdekjet nga dhuna.[19] Gjatë periudhës së viteve 1901 - 1905, raportet për një numër bashkësishë veriore ishin: Toplana, 39 për qind, Dushmani, 23 për qind, Spaçi, 32 për qind, Shala, 26 për qind, Oroshi, 21 për qind, Nikaj, Shoshi dhe Kaçinari, nga 25 për qind. Këto shifra dyfishohen, kur sheh se midis tyre deri në 42 për qind dhe 64 për qind të meshkujve vdesin për shkak të konflikteve të brendshme. Duket sikur ndonjë mekanizëm natyror përpiqet qëllimisht për të kompensuar këtë humbje të njëanshme pasi ne gjejmë një raport gjinor prej 163 lindjesh meshkuj për çdo 100 lindje femra.[20]

Raporte të dallueshme të kësaj natyre të seksit mashkull – femra në lindje

16 Gates, 1946, vol. 2, pp. 872 – 73; Little, 1919, pp. 127 – 30. (Shënim i autorit)

17 Antropologu Jovan Cvijič ishte gjeograf, antropolog dhe etnolog i njohur serb, i njohur më së shumti për punën e tij mbi gjeografinë dhe etnografinë e Ballkanit. I lindur më 11 tetor 1865 dhe i ndarë nga jeta më 16 janar 1927, Cvijič ka dhënë kontribute të rëndësishme në kuptimin e peizazheve fizike dhe kulturore të rajonit. Hulumtimet dhe botimet e tij të shumta kanë pasur një ndikim të madh dhe të qëndrueshëm në fushat e gjeografisë dhe antropologjisë. (Shënim i përkthyesit)

18 Termi "Rif" zakonisht i referohet rajonit Rif në veriun e Marokut. (Shënim i përkthyesit)

19 Nopça, 1925. Të dhëna të mbledhura nga kleri katolik. (Shënim i autorit)

20 Këtë shifër të diferencuar lindjesh nuk duket se e çertefikon ndonjë shkencë apo studim tjetër. Megjithatë, në tekst ka ardhur siç e ka thënë autori. (Shënim i përkthyesit)

janë gjetur më parë edhe në vende të tjera ku praktikohet zakoni i gjakmarrjes. Në fakt është vënë re se raporti i lindjeve mashkullore rritet edhe në vendin tonë, në kohë lufte. Shpjegimi biologjik është se njerëzit që jetojnë në kushte lufte martohen dhe prodhojnë fëmijë në një moshë më të hershme sesa do të bënin në kohë paqeje. Një mekanizëm për të cilin jo të gjithë biologët bien dakord, seleksionon qelizat spermatike, ose vezët e fekonduara, në organet riprodhuese të nënës. Kjo është arsyeja pse fëmijët që presin të lindin kanë tendencë të jenë kryesisht djem. Në këtë rast, është mosha e nënës ajo që ka rëndësi. Në Shqipërinë e veriut vajzat martohen sapo arrijnë pjekurinë seksuale dhe fillojnë të lindin fëmijë sapo janë biologjikisht të afta. Nuk ka kohë për të humbur.

Këto statistika, megjithëse jo të plota ndihmojnë në plotësimin e pamjes së paraqitur në kapitujt e mëparshëm. Të gjithë këta faktorë përputhen dhe bazohen tek: Mjedisi, teknikat dhe mënyra e jetesës në llojin e vet specifik, ndarja e punëve midis gjinive, bashkësia ekonomike e familjes patriarkale, pavarësia e saj nga familjet tjera të ngjashme, ndarja e punës midis asaj të malësisë dhe asaj të qytetit, mungesa që pason ndonjë nevojë për një ndarje të teknikave të punës në mes të malësorëve, vështirësia dhe kufizimi i udhëtimeve dhe të transportit, lufta për ekzistencë brenda një popullsie gjithnjë në rritje, mekanizmat pasuese të kontrollit të popullsisë, që praktikohet në disa nga fiset kufitare nga një masë e caktuar emigracioni. Praktikisht janë të gjitha së bashku. Më pas vjen ndërlikimi dhe vështirësimi i jetës për shkak të gjakmarrjes dhe vrasjet e njëri tjetrit, i gjithë sistemi i martesës dhe kompensimet e saj. Ato tregojnë pa dyshim të vërtetën e pikës kryesore të këtij punimi deri tani, duke arritur në konkluzionin se Malet e Gjigantëve formojnë një zonë gjenetike të mbyllur në mënyrë të veçantë ndaj ndikimeve të jashtme.

Ne thamë në studimin tonë për martesën se një djalë nuk mund të martohej me një vajzë me të cilën mund të kishte çfarëdo lloj lidhje gjaku apo prejardhje të përbashkët në linjë atërore, (patrilineare). Ai konstatim ka nevojë për t'u sqaruar. Në të vërtetë, Gegët janë të ndarë në një numër gjenesh ekskluzivisht të ndërsjella, të papërziera, përjashtuese ndaj njëra tjetrës, të mbartura në Fise, të bazuara në tradita të prejardhjes së përbashkët, të plotësuar me mitet e origjinës. Shkalla në të cilën mitet janë historikisht të sakta ndoshta varet sesa larg shkon gjenetikisht një fis i veçantë. Çdo fis thuhet se ka rrjedhur nga një trung i vetëm, zakonisht nga dikush që erdhi në atë vend në një kohë apo në një tjetër edhe pse besohet se disa kanë rrjedhur nga popullsia autoktone.

Fisi më i madh dhe më i njohur në Gegëri është ai i Dukagjinit. Ky fis përfshin në të edhe tre bajrakët e Mirditës, atë të Oroshit, Spaçit dhe Kushnenit, që përbëjnë tre të pestat e Mirditës, si dhe Shoshin dhe Shalën në fisin që mban emrin Dukagjin. Ka dy mite rreth origjinës së tyre, njëri që tregohet në Dukagjin ndërsa tjetri në Mirditë.

Sipas legjendës së parë, tre vëllezër erdhën nga një vend i quajtur Marina afër Gjakovës. Njëri kishte me vete një shoshë dhe u bë i pari i Shoshit. I dyti kishte me vete një Shalë Kali dhe u bë i pari i Shalës. I treti nuk kishte asgjë, me vete por shqiptoj fjalën "Mirëdita" dhe u largua. Pasardhësit e këtij të fundit janë banorët e Mirditës. Mirditorët tregojnë një histori më të detajuar. Ata i përmendin pesë vëllezër, Shoshin dhe Shalën si më parë, të emëruar sipas objekteve që mbanin, dhe tre të tjerë që u vendosën në Mirditë, Orosh, Spaç dhe Kushnen. Kuptimi i këtyre fjalëve është i paqartë.[21]

Në Mirditë, ku u vendosën këta tre vëllezër, gjetën njerëz të tjerë të vendosur aty para tyre, paraardhës të banorëve të dy bajrakëve të mbetur të Dibrës dhe të Fanit. Dibra dhe Fani secili kishin linjat e tyre fisnore. Kështu që secili përbëhet nga një numër fisesh. Bajrakët e Oroshit, Spaçit dhe Kushnenit formojnë një njësi të vetme ekzogamike sot. Ata i marrin gratë e tyre nga Dibra dhe Fani si edhe nga bajrakët katolikë të Selitës dhe Kthellës në Mat. Të njejtën gjë bënin edhe me Lurën në kohën kur nuk kishin rënë ende në gjak me ta. Ata gjithashtu martohen me gra katolike nga Shtatë Bajrakët e Pukës. Asnjë burrë nga Oroshi, Spaçi ose Kushneni nuk lejohet të martohet me bia të këtyre bajrakëve dhe as nga Shala apo Shoshi.

Shala dhe Shoshi formojnë një njësi gjeografike të izoluar. Shala është në pjesën e sipërme ndërsa Shoshi në pjesën e poshtme të një lugine të mbyllur malore. Nuk është e lehtë të hysh ose të dalësh në atë zonë. Prandaj kufizimet e martesave midis të dyve palëve, nëse ndonjëherë kanë ekzistuar, janë zhdukur dhe djemtë e Shoshit martohen rregullisht me bijat e Shalës dhe anasjelltas. Vendasit e arësyetojnë këtë me faktin se kanë kaluar mbi njëqind breza që nga koha kur dy vëllezërit para-ardhës, u vendosën aty dhe kjo kohë ka mjaftuar për të shlyer çdo

21 Mirditorët pretendojnë se Spaç do të thoshte "drapër", Kushnen, "sfurk". Unë nuk e mësova se çfarë do të thoshte Orosh dhe as miqtë e mi shqiptarë në Boston nuk mund ta identifikojnë atë. Megjithatë, Oroshi mund të jetë i njëjtë me Urosh, një emër sllav, i mbajtur nga i biri i Car Dushanit, i cili e plaçkiti vendin e Drinit të poshtëm në fund të shekullit të 14-të. Është e qartë se këto përkthime bashkëkohore të emrave stërgjyshorë janë apokrife. "Me apokrife" mund të nënkuptojë gjithashtu një vepër ose tekst që është me origjinë të dyshimtë ose jo e besueshme. (Shënim i autorit)

gjurmë të gjakut të përbashkët. Po ashtu, ata teorikisht mund të martohen me pjestarë të fisit të tyre nga Mirdita, përveç nëse mirditorët vetë nuk do ta pranonin këtë. Sido që të jetë, këto dy fise janë aq larg nga njëri tjetri dhe aq të izoluar, sa që në rrethana të tjera, kjo nuk do të ndodhte aq lehtë. Shala dhe Shoshi, si vëllezër që janë, e gjejnë autoktoninë në luginën e tyre. Me pasardhësit e këtyre banorëve të hershëm, ata gjithashtu mund të krijojnë krushqi të përshtatshme edhe kur janë jo aq larg.

Mërturi dhe Nikaj, janë dy bajrakët katolikë të Malësisë së Gjakovës. (Katolikët e tjerë, ata të Krasniqes u zhvendosën masivisht rreth 30 ose më shumë vite më parë në Gjakovë). Edhe ata martohen rregullisht me njëri-tjetrin. Po ashtu të njëtën gjë bëjnë edhe Shala e Shoshi. Në përgjithësi, njësitë më të mëdha ekzogamike[22] gjenden midis katolikëve, ndërsa ato më të vogla midis myslimanëve. Shumica e myslimanëve e ndiejnë se shtatë breza larg mjaftojnë për të mos u bërë pengesë për martesa brenda fisit. Kjo do të thotë se nuset merren zakonisht jo aq larg nga shtëpia e dhëndërrit. Në veri të Drinit, dhe në Mirditë, edhe kur ka disa fise që i lejojnë martesat brenda fshatit, nevoitet të ushtrohet ekzogamia. Në fiset myslimane në jug dhe lindje thuhet se kjo është e panevojshme. Në Gurin e Bardhë të Matit, na thanë se endogamia e fshatit është e zakonshme. Nuk ka asnjë dyshim se sistemi katolik, siç praktikohet në Mirditë, Dukagjin dhe Nikaj e Mërtur, është historikisht më i vjetër dhe lidhet më shumë me izolimin dhe gjakmarrjen.

Në kapitullin e ardhshëm do të merremi me detaje të cilat kanë të bëjnë me numrin dhe vend-ndodhjen e fiseve të ndryshme. Këtu mjafton të përmendim parimin, i cili është dëshmuar në mjaft raste, se atje ku ka pasur pak udhëtime dhe një minimum zhvendosje të njerëzve, njeriu gjen shumë grupe të vogla farefisnore në zona relativisht të ngushta si në rastet e përmendura më lart. Kështu në Pukë, ku kalon rruga kryesore, ka dyzina fisesh që jetojnë në disa shtëpi secila, dhe e njëjta gjë ndodh edhe në pjesët më të lëvizshme të Lumës dhe Dibrës, si dhe në rethinat e Shkodrës.

Fisi, siç e kemi parë, është njësi bazë e ekzogamisë. Si të gjitha institucionet dhe bashkësitë njerëzore, ai është një formacion i lëvizshëm pra asnjëherë nuk

22 Ekzogamia është një zakon ose rregull shoqëror që ndalon martesën brenda një grupi të caktuar, zakonisht brenda të njëjtës familje ose fis, duke kërkuar që individët të martohen jashtë këtij grupi. Kjo praktikë synon të shmangë martesat brenda gjakut të afërt dhe të promovojë lidhje të reja midis grupeve të ndryshme shoqërore ose fisnore. Ekzogamia është përdorur në shumë kultura dhe shoqëri për të siguruar diversitetin gjenetik dhe për të forcuar aleancat midis komuniteteve të ndryshme. Ajo është e kundërta e endogamisë, e cila nënkupton martesën brenda të njëjtit grup. (Shënim i përkthyesit)

është krejtësisht statik. Koncepti mbi të ndryshon sipas nevojave të vendit. Për shembull, kemi parë se si në Dukagjin nevojat gjeografike vendore e ndanin një fis, dhe se si në zonat myslimane relativisht më pak luftarake, pas një rënie të dukshme të nevojës për ekzogami të zgjatur, u arrit tek një ujdi që të vendosej si kufi - largësia prej shtatë brezash ku lejoheshin martesat brenda fisit. Kështu ekzogamia e fshatit u zhduk fare. Deri tani kemi të bëjmë me reduktimet në ekzogami. Megjithatë, ka raste kur ndodh e kundërta, dhe grupi i "incestit" zgjerohet. Për këtë, atyre iu vinë në ndihmë dy rite shumë të rëndësishme: Njëri është *vëllamëria,*[23] nëpërmjet të pirjes së gjakut në gisht midis dy pjestarëve të fiseve të ndryshme si dhe *kumbaria*.

Kur dy vetë bëhen *vëllamë* dhe kanë nevojë për ndihmën e njëri tjetrit, veçanërisht nëse ballafaqohen me ndonjë grindje ose problem shumë serioz për jetën, atëherë marrëdhënia e tyre bëhet e ngjashme me atë të dy vëllezërve. Prandaj konsiderohet e nevojshme që ata të bëjnë këtë marrëdhënie të ligjshme, e cila kryhet përmes një ceremonie të thjeshtë. Dy burrat i shpojnë gishtat e tyre me gjilpërë, ose e thithin gjakun e njëri-tjetrit me gojë, ose e shtrydhin gjakun dhe e hedhin në një gotë me raki dhe e pijnë që të dy. Pas këtij veprimi, ata konsiderohen njerëz të një gjaku. Për rrjedhojë fëmijët e tyre nuk mund të martohen me njëri-tjetrin.

Një tjetër ritual është kumbaria. Ajo motivohet nga rrethana të ngjashme, por bëhet në përputheje me një praktikë të ndryshme: Kjo shënohet me prerjen për herë të parë të flokëve të një djali të vogël, i biri i njërit prej pjesëmarrësve në këtë ritual. Babai, fëmija, dhe kumbara i ardhshëm takohen diku, në prani të të afërmve të tjerë. Kumbara e mban djalin në prehër dhe ia pret katër fije flokësh, nëse është katolik, dhe tre fije flokësh nëse është mysliman. Dallimi qëndron në refuzimin e myslimanit për të bërë shenjën e kryqit. Kumbara pastaj i djeg fijet e flokëve. Pas kësaj vjen një festë, gjatë së cilës kumbara i jep babait të fëmijës një dhuratë në para ndërsa babai ia kthen dhuratën me rroba të bukura.

23 Për vëllam, vëllamëri jo rrallë përdoren probatin/ probatim, probatini. Këto janë huazime sllave, të panevojshme në gjuhën shqipe. (Shënim i redaktorit)

Të dyja këto rituale i vendosin pasardhësit e dy pjesëmarrësve në një marrëdhënie incestuale,[24] pra në atë marrëdhënie që konsiderohet marrëdhënie e palejueshme brenda gjakut.[25] Ato megjithatë nuk aplikohen për të afërmit tjerë, sepse, nëse personi A bëhet vëlla me personin B, pra vëllezër të gjakut, ose kumbarë, i biri i vëllait të personit A mund të martohet ende me të bijën e personit B, ndërsa i biri i personit A nuk mundet. Kjo e komplikon situatën përtej sistemit të thjeshtë fisnor dhe ofron një numër marrëdhëniesh të veçanta për të përmbushur kërkesat individuale. Na duhet të themi se kleri katolik vendas i kundërshton të dyja këto praktika.

24 Marrëdhënje incestuale nënkupton marrëdhënie seksuale ose martesore midis individëve që janë të lidhur ngushtë nga gjaku ose farefisnia, të cilët sipas ligjit dhe normave shoqërore janë të ndaluara të kenë marrëdhënie të tilla. Këto marrëdhënie shpesh përfshijnë prindër dhe fëmijë, vëllezër dhe motra, ose të afërm të tjerë të ngushtë. Incesti është i ndaluar në shumicën e kulturave dhe juridiksioneve për arsye etike, morale dhe gjenetike. (Shënim i përkthyesit)

25 Ndërsa mardhënja jo-incestuale ose eksogame, nënkupton një marrëdhënie midis individëve që nuk janë të afërm të ngushtë, pra që nuk kanë lidhje gjaku. (Shënim i përkthyesit)

SHTËPIA ËSHTË SI NJË NJËSI LUFTARAKE. NJËSIA TJETËR ËSHTË KATUNDI. NJËSIA TJETËR ËSHTË KATUNDI. MË I GJËRË SE VETË KATUNDI OSE FSHATI SI NJËSI BASHKËJETESE ËSHTË BAJRAKU.QEVERISJA E LASHTË FISNORE E GEGNISË, PËRBËHEJ NGA NJË HIERARKI E PËRCAKTUAR NË TRE NIVELE: PLEQTË, KRYEPLEQTË E TYRE DHE BAJRAKTARËT.

POLITIKA DHE GJAKMARRJA

Institucioni më i vogël politik në shoqërinë fisnore të Gegëve është shtëpia me familje të zgjeruar, ku jetojnë së bashku tërë antarët e saj. Ajo është gjithashtu një institucion ekonomik. Si kryefamiljar pranohet burri më i moshuar i brezit të prindërve ose brezit të gjyshërve. Respekti për renditjen sipas moshës në Shqipëri është aq i fortë sa që burrat do t'i binden baballarëve të tyre besnikërisht edhe kur janë në moshën 40 dhe 50 vjeç, po aq sa në fëmijëri. Edhe pse jo të gjithë djemtë duhet që domosdoshmërisht të jetojnë me baballarët e tyre në një shtëpi, pra disa mund të banojnë edhe në shtëpi të veçanta, institucioni i shtëpisë mbetet i tillë. Ai mund të zgjerohet në hapsirë por marrëdhënet mbahen gjithmonë të njëllojta.

Shtëpia është si një njësi luftarake. Kur një burrë kryen vrasje brenda fisit të tij, e tërë shtëpia e vuan veprën që ai kryen. Për t'u hakmarrë, një burrë mund të shlyej njollën e rënë mbi nderin e familjes së tij duke vrarë vëllain e doresit. Nëse një anëtar i familjes vret një tjetër pjestar të po asaj familje, gjë që ndodh por shumë rrallë, nuk shoqërohet me asnjë masë si ato të gjakmarrjes. Kjo konsiderohet humbje e familjes.[1]

Njësia tjetër është katundi[2] i cili mund të jetë një grup kompakt shtëpish, i rrethuar nga tokat bujqësore dhe kullotat e tij. Por ai mund të përbëhet edhe nga prona familjare të izoluara, secila familje në tokën e vet. Kjo e fundit është forma më e zakonshme. Në çdo rast, në secilën qendër të asaj zone gjëndet një objekt i dallueshëm, një xhami ose një kishë. Ka raste kur gjendet një vend i thjeshtë, një shesh, zakonisht nën hijen e një lisi, ku takohen pleqtë. Çdo fshat supozohet të ketë dymbëdhjetë pleq, "pushteti" i të cilëve është pjesërisht i trashëguar dhe pjesërisht i krijuar me zgjedhje. Familje të ndryshme zakonisht dërgojnë secila

1 Në veprën e saj të vitit 1928, Edith Durham përshkruan një ngjarje specifike nga rajoni i Dukagjinit në faqet 69-70. (Shënim i autorit)

2 Studiuesit, M. Shuflai e të tjerë, mendojnë se katundi nënkupton një njësi të përbërë vetëm me familje vendase, me lidhje gjaku. (Shënim i redaktorit)

një burrë për të plotësuar numrin e kërkuar. Çdo anëtar i atij kuvendi njihet me emrin "plak" pavarësisht nga mosha. Këtë fjalë Miss. Durham e gjurmon mbrapa në lashtësi deri në kohën e Strabonit.[3] Njëri nga këta "pleq" zgjidhet Kryeplak. Në një fshat të Hasit, kur po i matnim burrat, njëri prej tyre qëlloi të ishte Kryeplaku. Ai i tregoi rregjistruesit tonë se ishte "Kryeplaku" i fshatit. Kryeplaku ka tagrin t'i thërrasë pleqtë kur ndodhin ngjarje të rëndësishme që kërkojnë vëmendjen e tyre. Problemet që dalin mund të kenë të bëjnë me përdorimin e tokave të fisit, marrjen e vendimeve nëse duhen djegur pyjet për t'i kthyer tokat në kullota, etj. Në fakt çështje të tilla, zakonisht kërkojnë pjesmarrjen e disa katundeve në vendimet që merren. Pleqtë mblidhen edhe si dëshmitarë, në rast se kërkohet të bëhet ndonjë betim për arësye të ndryshme, nga ndonjë banor i pleqësisë së tyre.

Më i gjërë se vetë katundi ose fshati si njësi bashkëjetese është bajraku (Nga turqishtja - flamuri), i cili është një zonë gjeografike me një lloj ngjashmërie natyrore. Aty zakonisht njerëzit që jetojnë brenda atij territori e shohin më shpesh njëri-tjetrin sesa ata që gjenden jashtë. Të gjitha kështillat e fshatrave kur mblidhen bashkë përbëjnë atë që njihet si Këshilli i Bajrakut, nën udhëheqjen e Bajraktarit, (mbajtësit të flamurit). (Figura 10) Pozita e tij është e trashëgueshme. I ati i Mbretit Zog ishte Bajraktari i Matit, që ishte bajraku kryesor i asaj krahine. Në Dibër, Majori Cen Elezi, mikëpritësi i ekspeditës tonë, ishte bajraktar, ndërsa Murat Kaloshi, rivali i tij, ishte një tjetër i tillë. Këta burra ishin udhëheqës të mëdhenj feudalë, që mbanin familje të mëdha të armatosura dhe ofronin mikpritje bujare për të gjithë miqtë dhe kalimtarët. Cen Elezi i kishte dërguar dy djemtë e tij në Shkollën Teknike Amerikane në Tiranë. Ata i mësuan metodat moderne të kultivimit në bujqësi si dhe gjuhën angleze në mënyrë të përsosur. Këta djem, ishin gati dy metra të gjatë dhe shumë të dobishëm për ne, kur e vizituam Sllatinën.

Bajraktari mund të bëhet një sovran i pavarur nëse ka një personalitet mjaft të fortë atëherë kur autoriteti fisnor është i dobët dhe aq më shumë kur edhe autoriteti i qeverisë qendrore është i tillë. Në raste të tjera, ai është nën autoritetin e kryetarit të fisit, një person i zgjedhur nga një familje sunduese dhe që mban tituj të ndryshëm në fise të ndryshme dhe zona të ndryshme. Në Mirditë për shëmbull

3 Durham, 1928, p. 14. (Shënim i autorit)

ai quhet "Kapedan", në Pukë, "Shpija e Kryeziut", në Malësinë e Madhe, "Shpija e Madhe", e barabartë kjo me atë të njohur në Egjyptin e lashtë si "äa"[4] ose Faraon.



Pamje që tregon peisazhin e zbrazët, karakteristik për shumicën e malësive ku kaloi ekspedita e prof. Coon-it. (Foto: Carleton S. Coon 1929).

Pesëdhjetë burra, që përbënin 5 për qind të serisë sonë metrike, ishin mbajtës të posteve në sistemin fisnor Gegë. Njëmbëdhjetë[5] prej tyre ishin "Pleq", njëzet e gjashtë "Kryepleq"[6], tetë Bajraktarë[7] dhe pesë mbajtës të Krye - Princit të fisit, Gjon Markagjonit të Mirditës (fig. 10, a). Me përjashtim të kryeplakut të Karashegeçit[8]

4 Në gjuhën egjiptiane të lashtë, fjala "𓄿𓎛" (transliteruar si *äa*) nënkupton "i madh" ose "i rëndësishëm". Ky term përdorej për të përshkruar madhësinë, rëndësinë, ose autoritetin e një personi, objekti, apo koncepti. Për shembull, emri i faraonit "Per-äa" (prej nga rrjedh fjala "Faraon") do të thotë "Shtëpia e Madhe", që nënkupton pallatin mbretëror ose vetë faraonin si figurë e lartë autoriteti. (Shënim i përkthyesit)

5 Kater nga Dukagjini, 2 Puka, 4 Mirdita, 1 Zadrima.(Shënim i autorit)

6 Nëntë nga Malësia e Madhe, 1 Has, 4 Mirdita, 4 Zadrima, 3 Mati, and 1 Dibra. .(Shënim i autorit)

7 Tre nga Malësia e Madhe, 1 Malësia e Gjakovës, 1 Puka, 1 Mirdita, 2 Dibra.Të gjithë këta përveç mirditasit mbanin tituj rezervë. .(Shënim i autorit)

8 Fshati Karashegeçit ndodhet në rrethin e Hasit, i cili është një pjesë e Qarkut të Kukësit në Shqipëri. Hasi është një zonë në veri-lindje të vendit, afër kufirit me Kosovën. Karashegeçit është një nga fshatrat e vogla në këtë rajon malor. (Shënim i përkthyesit)

të Hasit, i cili ishte bukëpjekës, të gjithë Pleqtë, Kryepleqtë dhe Bajraktarët ishin bujq. Bukëpjekësi ishte "Kryeplak" i një fshati bukëpjekësish, jashtë zonës malore. Të gjithë këta burra ishin vendas, të lindur nga baballarë dhe nëna vendase të zgjedhur nga brenda fisit të babait. Pra, preferencat tregohen tek këta elementë:

(a) Bujqësia ndaj zejtarisë ose tregtisë, dhe,

(b) Të qenët vendas kundrejt atij me prejardhje nga jashtë, pra *jabanxhi*.

Gjon Markagjoni, i vetmi kryefistar që takuam dhe që na priti e na gostiti shumë mirë në kryeqendrën e tij në Orosh, nuk na lejoi ta matnim atë vetë. Por ai i njoftoi të gjithë malësorët e tij nga fshatrat përreth. Pesë shërbyesit që matëm në shtëpinë e tij përbënin grupin e tij princëror. Tre prej tyre ishin bujq me kohë të pjesshme dhe dy të tjerë që merreshin me politikë, punonin me kohë të plotë. Detyrat dhe titujt e tyre ofiqarë të saktë nuk i morëm vesh asnjëherë. Qeverisja e lashtë fisnore e Gegnisë, nëse mund të gjykojmë nga shembulli i Mirditës, një fis në të cilin ajo mbijetoj pak a shumë e paprekur deri në vitin 1929, përbëhej nga një hierarki e përcaktuar në tre nivele: Pleqtë dhe Kryepleqtë e tyre, Bajraktarët dhe në krye ishte Princi Fisnor. Rreth Princit ishin njerëzit e tij të besuar, ku bënin pjesë lajmëtarët e veçantë, shërbëtorët dhe rojet.

Pushteti fisnor ishte në duart e Princit dhe këshillit të tij, i cili përbëhej nga të gjithë pleqtë e fisit, kryepleqtë e tyre dhe bajraktarët. Kryefamiljarët e familjeve të mëdha dhe të fuqishme, edhe sikur të mos kishin asnjë pozitë zyrtare, do të përfshiheshin në atë këshill. Këshilli mblidhej në rastet e vrasjeve brenda fisit, në konfliketet ndërfisnore, pushtimit të vëndit apo krizave të tjera që mund të shoqëroheshin me dhunë. Ky këshill mblidhej gjithashtu për të vendosur për përbërjen e tij, si dhe për të dëgjuar kërkesat e bajrakëve fqinjë nëse dëshironin t'u bashkoheshin atyre.[9]

Pushteti i Princit në krahasim me atë të këshillit varej nga personaliteti i të parit. Për shëmbull, gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, Mirdita është qeverisur nga Princat e mëposhtëm: Bib Doda, një burrë i madh dhe i fuqishëm që vdiq rreth vitit 1913. Pastaj vjen Preng Bib Doda, djali i tij, i cili u vra për gjakmarrje. Pasonjësi i tij ishte një prej kushërinjëve, i quajtur Mark Gjoni i cili nuk ishte ndonjë burrë aq i fortë. Ishte djali i tij, Gjon Marka Gjoni, i cili gjëndej në atë detyrë në vitin 1929. Ai ishte një burrë mjaft i fuqishëm që e mbajti sistemin fisnor

9 9 nga Malësia e Madhe, 1 nga Hasi, 4 nga Mirdita, 4 Zadrima, 3 Mati dhe 1 Dibra. (Shënim i autorit)

si një sfidë ndaj qeverisë qëndrore. Ai kërkonte përjashtimin e burrave të fisit të tij nga shërbimi ushtarak dhe nga taksat. Për këtë ai kërkonte t'i merrte qeverisë së Mbretit Zog një pagesë të majme vjetore në këmbim të ruajtjes së qetësisë.

Çdo fis në Gegni ka në përbërje disa bajrakë. Në vitin 1929 ne gjetëm se kishte 13 bajrakë në Malësinë e Madhe, 6 në Dukagjin, 7 në Malësinë e Gjakovës, 2 në Has, 5 në Lumë, 7 në Pukë, 5 në Mirditë, 1 në Zadrimë, 4 në Mat, 4 në Dibër. Të gjithë së bashku përbënin 54 bajraqe. Sipas rregjistrimeve në blloqet tona të matjeve ato janë:

MALËSIA E MADHE: Kelmendi, Hoti e Gruda, Kastrati, Kopliku, Grisha, Shkreli, Riolli, Reçi, Lloj, Postriba, Triepshi dhe Kraja.

DUKAGJINI: Shoshi, Shala, Kiri, Dushmani, Pulti, Toplana.

MALËSIA E GJAKOVËS: Krasniqja, Gashi, Bytyçi, Marina, Vlushaj, Merturi, Nikaj.

HASI: Vlahna, Helshani.

LUMA: Biçani, Kalisi, Ujmishti, Dolovishti, Çaja (Bajraku i Gorës, serbisht-folës, i cili numërohet ndonjëherë edhe me Lumën).

PUKA: Kabashi, Puka, Qerreti, Mal i Zi – Malziu[10], Berisha, Bugjoni dhe Iballja.

MIRDITA: Dibri, Fani, Oroshi, Spaçi, dhe Kushneni.

MATI: Mati, Lura, Kthella, Selita.

DIBRA: Reçi, Stashani, Shehri i Poshtëm, Shehri i Sipërm.

Në rastet e Pukës dhe të Mirditës kjo listë nuk mund të jetë e gabuar, pasi anëtarët e këtyre fiseve i përdorin emrat: "Shtatë Bajraqet" dhe "Pesë Bajraqet" për të përcaktuar saktë fiset e tyre. Në Lumë, në Malësi të Gjakovës dhe në Malësi të Madhe, situata komplikohet nga prania e kufirit Shqiptaro – Jugosllav, i cili jo vetëm që kalon përmes bajraqeve, por ka shkaktuar zhvendosje dhe arratisje të shumta brenda bashkësive të subjekteve që neve i matëm. Disa fise me disa shtëpi secila, kanë ndryshuar vend-ndodhjen, prandaj është e vështirë të thuhet se cilit bajrak i përkiste njëra bashkësi dhe cilit tjetra, në kohën kur po i bënim matjet seriale?!

Miss. Durham, e cila i vëzhgoi këto anë midis viteve 1908 -1913, pra rreth 20 vjet përpara meje, i rregjistroi listat e fiseve të ndryshme në disa zona nga ato që

10 Mali i Zi -Malziu, autori e ka emëruar gabimisht me këtë emër fshatin Malzi të Pukës. (Shënim i përkthyesit)

i vizitova edhe unë më vonë. Ajo e quan Malësinë e Madhe jo fis, por Bashkësi Fisesh. Nga këta Kelmendi, përbëhet nga katër bajrakë dhe pikërisht: Selca, Vukli, Boga, dhe Nikçi, ndërsa nëntë të tjerët, Gruda, Hoti, Shkreli, Kelmendi (Kilmeni), Loha (Loya), Reçi (Reçi), Rjolli (Riola). Kopliku dhe Grizha (Greisha), thuhet se përbëheshin vetëm nga një bajrak i vetëm. Triepshi dhe Kraja nuk ishin të listuara, pa dyshim për arësye se ato shtriheshin në vijën kufitare që e ndan Shqipërinë me Malin e Zi. Kjo kishte ndodhur edhe përpara vendosjes së kufirit të vitit 1913. Kjo bëri që Postriba të mos përfshihej në atë bashkësi, duke e lënë atë në një grup të veçantë fisnor.[11]

Këto ishin Mazreku, Drishti, Shllaku, Dushmani dhe Suma. Vetëm një nga këto, Dushmani, ka dy bajrakë, ndërsa të tjerët kanë secili nga një bajrak. Dushmani është i vetmi nga këto emra që gjendet në listën time, ku i jepet statusi i një bajraku të Dukagjinit. Unë bëra vetë matje në fshatin Postribë dhe mbeta i befasuar që asnjë subjekt nga këto "fise" të veçanta nuk u shfaq. Atë që më thanë se e quanin Dukagjin, ajo e liston si "Grupi Pulti", duke e ndarë atë në Pultin e Sipërm dhe Pultin e Poshtëm. Ajo i jep Pultit të Poshtëm 4 fise të vogla, me një bajrak secila: Plani, Gojani, Mgula dhe Kiri. Pulti i Sipërm e ka Shalën, me 4 bajrakë: Thethi, Pecaj, Lotaj dhe Lekaj; Në Shosh, numri i bajrakëve nuk thuhet; Toplana dhe Nikaj po ashtu. Mërturin, që martohej me Nikajt dhe që tani njihet si pjesë e Malësisë së Gjakovës, ajo e liston me Pukën si pjesë të Berishës. Arësyeja për këtë ishte se "Mërturi u nda nga Berisha njëmbëdhjetë breza më parë."[12]

Malziun, i shënuar në listën time si bajrak i Pukës, ajo ia cakton Lumës. Ajo e bën fis më vete Gashin si bajrak të Malësisë së Gjakovës dhe gjithashtu i jep pavarësi fisnore bajrakut të Lurës, të cilin e vendos në krye të një bashkësie që përfshin Matin, Dibrën, dhe Kthellën, të cilën e ndan në 3 bajraqe, Kthellën, Selitën dhe Përlatin.

Përshtypja ime është se disa nga këto dallime janë për shkak të një ngatërrese të bërë nga ana e Miss. Durham-it midis fisit dhe bajrakut, bajrakut dhe fisit. Në faqen 68 ajo e përkthen fjalën "bajraktar" si "kryetari i fisit". Nëse ajo nuk do të kishte gabuar diku, kjo do të ishte gjë jo e zakonshme.

11 3 nga Malësia e Madhe, 1 Malësia e Gjakovës, 1 Puka, 1 Mirdita, 2 Dibra. Të gjithë këta me përjashtim të Mirditës mbanin emra rezervë. (Shënim i autorit)

12 Miss. Durham, 1928, p. 27. (Shënim i autorit)

Udhëtimi në Gegni në vitet 1908 -1913 nuk do të ketë qenë i lehtë, madje as për një burrë me përvojë. Që një zonjushe t'i ketë bërë tërë këto udhëtime është një mrekulli. Disa të tjera mund të jenë rezultat i procesit të bashkimit, pasi shumë nga "fiset" që ajo përmend ishin fragmente të popullatave të mëparshme të shkatërruara e në mjerim të plotë nga lufta dhe, në disa raste, të masakruara nga serbët. Deri në vitin 1929 një riorganizim i konsiderueshëm duhet të ketë ndodhur në të gjithë zonën në veri të Drinit dhe veçanërisht në rajonet që ajo i përcakton si Postriba dhe Pulti. Në çdo rast, 10 grupet e njerëzve që unë i kam përcaktuar si fise u konsideruan të tilla nga njerëzit me të cilët punova në vitin 1929 dhe formojnë njësi më shumë ose më pak të pavarura, që martohen ndërmjet tyre, fakte këto të mjaftueshme për qëllimin tonë të tanishëm studimor.

Nën sistemin fisnor, lufta ishte pothuajse e vazhdueshme. Shkaku kryesor ishte, natyrisht, presioni i popullsisë. Shkaqet e dukshme ishin tundimi, rrëmbimi i grave, arratisja, vjedhja e bagëtive dhe grabitjet në përgjithësi. Nuk duhej shumë punë për të shkaktuar një vepër kriminale, veçanërisht në periudhën e dimrit të vonë, kur ushqimi pakësohej më së shumti. Edhe një burrë që kishte pothuajse mjaft për të ngrënë për vete, ai vetë do të ishte nën trystni të madhe, për shkak të stresit nervor të përgjithshëm për gjendjen e farefisit të tij dhe njerëzve që vareshin prej tij dhe pasojave që sillte kjo gjendje e keqe brenda familjes.

Konflikte në dukje të vogla, si një goditje e rastësishme, një fjalë e ashpër, e pa matur mirë, madje qoftë edhe një lojë fjalësh, që është shumë e lehtë të thuhet në Gjuhën Shqipe, ose edhe më keq, një shaka e pa matur mirë, shpesh përfundonin në konflikt ku përdoreshin edhe armët dhe kjo mund të çonte në grindje me pasoja fatale. Unë pata raste të ndjeja mprehtësinë e tyre të epokës së hekurit, shumë të ngjashme me ato të Sagave Norvegjeze. Një herë mikëpritësi im në Zadrimë më tha, në prani të shumë njerëzve, se i kisha këmbët më të hollat që ai kishte parë ndonjëherë, dhe pyeste veten se si mund të ecja?! Grupi i njerëzve të mbledhur u shkri gazit.

Në një rast tjetër, në një han në Pukë, ngrita kokën papritmas dhe u ndesha me një goditje të fortë në një gozhdë të dalë. Kjo ishte gjëja më qesharake në botë. Edhe një herë, kur miku im Farnsworth dhe unë u futëm në thasët tanë të gjumit për të kaluar natën, e gjithë familja qeshi dhe u gajas. Kur i pyetëm se çfarë kishte që po qeshnin, ata na thanë: "Mendoni sikur larg qoftë, shtëpia do të merrte flakë, ju nuk do të arrinit të dilnit të gjallë nga ata thasë, Ha! Ha! Ha!"

Ajo që ndodh kur një burrë vret një tjetër të të njëjtit fis mund të mësohet më së miri nga citimi i mëposhtëm i marrë nga Durham:[13]

> Vrasja mund të vijë si pasojë e një grindjeje ose mund të jetë kryer edhe për gjakmarrje, shkaku i së cilës është pak a shumë i largët. Në të dyja rastet, njeriu që ka marrë gjak largohet menjëherë për të gjetur një vend të sigurt jashtë territorit të fisit. (Miss. Durham përdor "fisin" në kuptimin e kufizuar, si më parë.) Në këtë rast, çdo shtëpi është e detyruar t'i japë strehë ðoresit. Në rastin e një mosmarrëveshjeje, ai konsiderohet si njeriu më fatkeq që nuk ka bërë asgjë përveç detyrës së tij. Ai menjëherë e shpall veprën që ka kryer. Më pas, krerët e fisit të tij takohen dhe urdhërojnë t'i djegin shtëpinë. Tek dukagjinasit, Këshilli ka edhe të drejtën që të shkatërrojë të korrat, t'i presë pemët e tij frutore, t'i therë kafshët dhe të ndalojë punimin e tokës për disa vjet. Me këtë veprim shpërdorohet një sasi fort e vlefshme ushqimesh. Në këtë grup, jo vetëm njeriu që ka marrë gjak, por të gjithë meshkujt e "shtëpisë" së tij, janë përgjegjës për veprimin e tij, kështu që edhe ata duhet të ikin. "Shtëpia" mund të jetë streha e një familje të tërë ku jetojnë deri në dyzet njerëz. Kjo nuk e pengon Kanunin që të zbatohet deri në pikën e fundit. Unë arrita të shihja vende të tilla të shkretuara. Kur e kundërshtoja këtë lloj sjellje më thonin: "Po, por është Kanuni që thotë kështu dhe ai duhet zbatuar". Gratë dhe fëmijët mund të shpërndahen nëse mundin të gjejnë strehim në shtëpi të tjera. Ato zakonisht e bëjnë këtë. Një njeri mund të shpëtojë shtëpinë e tij nëse mund të kthehet në të dhe ta mbrojë me sukses për tre ditë radhazi, duke mos i lënë burrat e dërguar nga këshilli t'i vënë zjarrin shtëpisë. Unë pashë një burrë shumë trim në Berishë që kishte shpëtuar shtëpinë e tij tri herë në këtë mënyrë. Një mundësi tjetër është që, një njeri të shpëtojë shtëpinë e tij, të ftojë kryetarin e një mëhalle tjetër të futet në shtëpinë e caktuar dhe të sillet si zot shtëpie dhe ta mbrojë atë me forcat e tij. Nga ana tjetër kjo zgjidhje mund të shkaktojë luftë të ashpër. Atëherë këshilli, për ta parandaluar këtë, zakonisht bie dakord të djegë vetëm shtëpinë dhe të kursejë pronën. Sasia e pronës që do të shkatërrohej gjithmonë vendoset nga këshilli. Përveç djegies së shtëpisë, në të gjitha fiset kërkohet të paguhet një gjobë e cila konsiston në dorëzimin e deleve ose bagëtive për

13 Miss. Durham, 1928, pp. 66-68. (Shënim i autorit)

qeverinë turke. Në rastin e Malësisë së Madhe kjo gjobë paguhej rregullisht në Shkodër. Qeveria turke kishte njëfarë kontrolli mbi të gjitha fiset e afërta sepse ajo mund të mbante peng çdo anëtar të një fisi që kishte gjak borxh dhe vinte në treg në Shkodër. Fiset e largëta të Dukagjinit ose nuk i njoftonin ose nuk paguanin për vrasjet e tyre. Duke qenë se gjakmarrja e dobëson shumë fisin, kryetarët e fisit ose miqtë e familjes përpiqeshin që ta ndalojnë atë. Gjakmarrjet midis fiseve të Dukagjinit dhe Pultit zgjidhen në male ndërsa ato të Malësisë së Madhe zgjidhen në Shkodër, përpara përfaqësuesve të atyre fiseve (pranë qeverisë turke) që vepronin atje. Paqëtimit ose pajtimit i paraprin "gjaksi" (ai që i ka borxh gjakun) i cili dërgon disa miq te "i zoti i gjakut të humbur" (zoti i gjakut) për t'i kërkuar "Besë". Besa mund të jepet dhe të zgjatet më tej. Gjatë atij armëpushimi, gjaksi dhe të afërmit e tij janë të sigurtë. Për t'i dhënë fund grindjes nevojiten njëzet e katër këshilltarë që të bëjnë betimin e paqtimit me gjaksin. Paditësi (familjari i të vrarit) ka të drejtë t'i zgjedhë ata këshilltarë. Ata mund të emërohen edhe nga "Bajraktari".[14] Ata i shqyrtojnë faktet dhe vendosin nëse mund të bëhet paqja dhe me çfarë kushtesh. Nëse të njëzetekatërt pranojnë të bëjnë betimin për paqtim - pajtim, atëherë ai konsiderohet i pafajshëm dhe ai dhe familja e tij nuk kanë borxh gjaku të mëtejshëm, por i paguajnë për gjakun e derdhur të zotit të gjakut. Kjo pagesë varionte nga rreth 25 deri në 50 paund. Pasi arrihet marrëveshja, i gjithë grupi futet në kishë, ose në xhami sipas rastit, përpara së cilës është mbledhur këshilli dhe në praninë e priftit doresi i dyshuar betohet për pafajësinë e tij. Pas këtij gjesti ai nuk i detyrohet më palës së dëmtuar. Pasi të tjerët kanë bërë betimin, doresi dhe i zoti i gjakut shpesh ratifikojnë paqen duke bërë betimin e vëllazërisë së gjakut. Pasi bëhet betimi dhe shpaguhet gjaku, njeriu është i lirë të kthehet në shtëpinë e tij të djegur dhe ta rregullojë atë. Duke qenë se si rregull shtëpitë janë bërë prej guri të fortë, ajo që ka mbetur për t'u ribërë janë çatia dhe punimet, dikur të bëra me dru, që kanë nevojë për t'u riparuar. Nëse ai është një njeri i njohur për mirë, anëtarët e tjerë të fisit e ndihmojnë atë të paguajë gjobën dhe të fillojë përsëri jetën.[15]

14 Miss Durham e përktheu fjalën bajraktar si "kryetar i fisit". Kjo përbën një ngatërresë midis fiseve dhe bajraqeve të vëna re më parë. (Shënim i përkthyesit)

15 Në të gjithë këtë pjesë kam përdorur drejtshkrimin e Miss. Durham për emrat vendor, tani të vjetruar. Gjithashtu, kam lënë nyjën shquese para "i zoti i gjakut", ku gramatikisht është e tepërt. (Shënim i përkthyesit)

Brenda bajrakut, pra, mekanizmat politikë (pajtues të gjaqeve) prireshin të reduktonin frekuencën e vrasjeve duke e bërë atë sa më të shtrenjtë, kur vjen puna për të shpaguar dhe sa më të rrallë. Vrasja midis pjestarëve të bajraqeve do të dekurajohej gjithashtu nëse autoriteti qendror i fisit do të ishte i fortë. Përndryshe, grindjet ndër-bajraktare mund të zgjasin për dekada përpara se të bëhet paqe. Po kështu fise të tëra mund të ishin në gjak me njëri-tjetrin, ose me një bajrak të vetëm, ashtu si Mirdita ishte në gjak me Lurën gjatë periudhës për të cilën ne po flasim.

Një autoritet pajtues qëndror tentonte të forconte lidhjet midis anëtarëve të fiseve dhe me mbledhjet e shumta të këshillit që u thirrën, anëtarët e familjeve më të shquara shkonin shpesh brenda kufijve të tyre fisnor. Kjo do t'u jepte atyre mundësinë për të rregulluar martesat në një largësi nga shtëpia e tyre. Gjakmarrja, nga ana tjetër, i shpërndau edhe më gjerësisht dhe ndërsa shumica e të ikurve u kthyen në shtëpitë e tyre, disa u vendosën përtej maleve. Aty rreth vitit 1912, Miss. Durham zbuloi për rreth Gjakovës, fshatra të vegjël të populluar nga banorë nga Fani dhe zona të tjera nga bajraqet e Mirditës, Shalës, Berishës dhe krahinave të tjera të Gegnisë. Shumica e këtyre të ikurve ndoshta ishin larguar nga shtëpitë e tyre në mënyrë të pavullnetshme.

Bashkëjetesa e shoqërisë fisnore Gegë, veçanërisht aspektet e saj luftarake, priren të nxisin largimin në kësi rastesh.

FSHATRA TËRËSISHT OSE PJESËRISHT TË ZBRAZURA U RIPOPULLUAN NGA TË ARDHURIT NGA BOSNJA. KËTA ISHIN FISNIKË KATOLIKË, QË FLISNIN NJË VARIANT TË ILIRISHTES, NË NJË FORMË GJYSMË TË ROMANIZUAR, E CILA NDRYSHONTE PAK NGA GJUHA E VETË GEGËVE. NË FAKT, KËTA NJERËZ PO VININ NGA ATDHEU I MËPARSHËM I GEGËVE, TË SHPËRNGULUR NGA PRESIONI I PUSHTUESVE SLLAVË DHE TURQ. ATA PËRBËNIN NJË VALË TË DYTË MIGRACIONI.

CARLETON S. COON

JETA RITUALE

Dyzet e dy për qind e serisë sonë u regjistruan si katolikë, ndërsa pjesa tjetër, përveç një burri[1], si mysliman. Këto shifra pasqyrojnë përafërsisht përhapjen e dy besimeve kryesore fetare në Gegni. Shpërndarja territoriale e tyre tregohet në figurën 3. E gjithë Mirdita, po aq sa edhe Dukagjini, rreth gjysma e Malësisë së Madhe, pjesa më e madhe e Zadrimës dhe disa bajrakë të Matit, Pukës dhe Malësisë së Gjakovës janë katolikë. Këta përfshijnë në përgjithësi zonat me më pak rrjet rrugor dhe ato me orientim drejt Romës. Myslimanët zënë ato zona që janë më shumë të drejtuara nga Stambolli, përgjatë rrugëve kryesore dhe në afërsi të qyteteve më të mëdha.

Ndërsa Islami është vetëm katër shekullor i pranishëm në Shqipëri, Katolicizmi ka qenë atje gjatë të paktën gjashtëmbëdhjetë shekujve më shumë. Gjatë dymbëdhjetë shekujve të fundit kanë ndodhur aq shumë ndryshime në numrin dhe vend-ndodhjen e peshkopatave dhe famullive aq sa edhe në numrin e besimtarëve. Në kohën e studimit tonë, në Zadrimë gjëndej një peshkop të cilit i raportonin famullitarët e Mirditës. Një tjetër kujdesej për territorin në veri të Drinit. Disa nga priftërinjtë, si At Krasniqi që vizituam në Mirditë, ishin shqiptarë të përgatitur në Romë. Kishte edhe prej atyre që ishin me kombësi austriake, gjermane apo italiane. Të gjithë ishin njerëz me qëndrueshmëri të lartë fizike dhe guxim të pashoq, sepse shërbimi i tyre kryhej në një terren shumë të vështirë. Andaj ajo kërkonte punë rigoroze. Disa prej tyre ishin françeskanë. Në Zadrimë, pranë rezidencës së peshkopit gjëndej një manastir me rreth dhjetra banorë.

Shumë prej myslimanëve të Shqipërisë Veriore i përkasin një vëllazërie jashtëzakonisht heterodoxe[2], asaj bektashiane. Varri i themeluesit të këtij sekti shtrihet në pjesën e brendshme të një shpelle të gjatë, në të vërtetë një grumbull

1 Të dy prindërit vinin nga Dibra. Ai ishte ortodoks, si ose pse ishte i tillë nuk munda ta zbuloj. (Shënim i autorit)

2 Heterodoksia: Duke qenë një urdhër apo sekt sufist me doktrina dhe praktika që devijojnë nga Islami ortodoks (sunni), Bektashinjtë shpesh cilësohen si një urdhër heterodoks. Ata përfaqësojnë një qasje më fleksibile dhe të hapur ndaj fesë, duke përfshirë edhe elemente të traditave dhe kulturave lokale. (Shenim i perkthyesit)

gurësh të lashtë ranorë, në shkëmbinj jashtë qytetit të Kajros. Pasardhësi i tij jeton në një shtëpi në hyrje të shpellës. Kreu i urdhërit apo sektit dhe të gjithë ithtarët e tij në vend-qëndrimin e tij janë shqiptar. Arësyeja për këtë gjë kaq interesante është se familja Khediviale[3] e Egjiptit ishte fillimisht shqiptare. Ishin ata që e sollën në Kajro kreun e tyre shpirtëror bashkë me arkivolet e para-ardhësve të tij. Edhe pse për dy breza familja mbretërore nuk i ka pranuar parimet bektashiane dhe ka adhuruar sipas riteve hanefi, faltorja dhe banorët e saj mbeten aty. Të rinjtë që dëshirojnë të bëhen dervishë shkojnë, nëse munden, në Kajro për të "marrë dorë".

Kjo është arësyeja pse shumë nga dervishët në Gegni flisnin arabisht dhe kishin njohuri për vendet e tjera myslimane. Përveç dervishëve të fshatit, bektashinjtë kanë një sërë teqeshë të cilat ndodhen në Has dhe në Malësinë e Gjakovës. Ne patëm rastin të matnim njërin prej tyre, i cili ishte një burrë nga Hasi.

Megjithë praninë e vet shumë shekullore në jetën e Gegëve, katolicizmi nuk ia ka dalë të ndryshojë shumë nga zakonet e malësorëve, siç është sistemi fisnor që ndalon rreptësisht martesat midis kushërinjve, martesat që në djep, *leviratin*, vëllamërinë dhe betimin e virgjëreshave. Arsyeja përse Kisha Katolike nuk ka mundur t'i eleminojë këto zakone është se nevojat e Gegëve që i përmbushin këto zakone nuk janë shmangur dot. Besimi mysliman i lejon ato dhe prandaj është bërë më popullor tek shqiptarët. Islami konsiderohet si fe më moderne dhe më e civilizuar.

Banorët e qyteteve, sidomos të pasurit, oficerët e ushtrisë dhe njerëz të tjerë më të mësuar zakonisht janë nga pjesa myslimane e shoqërisë. Shumica e katolikëve janë të varfër. Kjo gjendje natyrisht që është e trashëguar nga periudha e dominimit turk. Shumë shqiptarë i admironin turqit. Kishte edhe nga ata që preferonin të flisnin turqisht. Më kujtohet njëherë, tek po kalonim në një rrugicë në Zadrimë, bashkë me përkthyesin tim, z. Frashëri, ai i dëgjoi dy bujq të vjetër të cilët po i korrnin të lashtat dhe flisnin turqisht me njëri-tjetrin dhe i qortoi ata. Peshkopi Fan Noli sugjeron se ata mund të kenë qenë punëtorë të paguar me mëditje, që kishin ardhur nga qytetet e Prizrenit, Pejës ose Podgoricës dhe që flisnin turqisht.

Ekziston një dallim i caktuar dietik midis katolikëve dhe myslimanëve. Të parët e hanë mishin e derrit, veçanërisht në dimër. Ndërkohë myslimanët i mbështjellin

3 Titulli "Khedive" u njoh zyrtarisht nga Sulltani Osman në vitin 1867 dhe u përdor nga pasardhësit e Muhammad Aliut për të treguar sundimin e tyre gjysmë të pavarur nën sovranitetin osman. (Shënim i përkthyesit)

hundët dhe shmagin erën e mishit të derrit dhe nuk pranojnë të hyjnë në një dhomë ku gatuhet një mish i tillë. Në vend të kësaj ata përdorin shumë yndyrë delje në kuzhinën e tyre. Katolikët pijnë verë kurdo që e kanë atë. Myslimanët i kënaqin shijet e tyre për alkolin me raki. Këto dallime ndoshta nuk kanë asnjë rëndësi biologjike, për sa i përket rritjes dhe zhvillimit të individit, por ato shërbejnë për të intensifikuar antipatinë e ndërsjellë të dy grupeve fetare dhe për të penguar shkëmbimin gjenetik midis tyre.



Fig. 3. Shpërndarja territoriale e feve.

Në Lurë, një zonë me popullsi që nuk i kalon disa qindra vetë, katolikët dhe myslimanët martohen me njëri tjetrin. Në një familje të vetme, babai mund të jetë katolik, nëna myslimane ndërsa fëmijët e zgjedhin vetë fenë e tyre. Ky është vendi i vetëm në Gegni ku ndodh kjo. Lura është në proces kalimi nga katolicizmi në islam. Ndërsa ky i fundit fiton terren, aty ende gjenden familje të përziera. Qeveria e Ahmet Zogut bëri shumë duke i inkurajuar shqiptarët e tjerë të ndjekin shembullin e lurjanëve, në interes të unitetit kombëtar.

Faza të ndryshme të këtij procesi ndryshimi gjenden në fise dhe bajrakë të ndryshëm. Në Nikaj dhe në Mertur burrat përdorin dy palë emrash, një mysliman dhe një katolik. Për të shmangur telashet ata e përdornin të parin kur udhëtonin jashtë fshatit të tyre. Kur mësohen me këta emra, në shumë raste i përdorin edhe në shtëpi. Ndodhi një herë që në Hot, bajraktari iu priu trimave të vet kundër serbëve pushtues, me ndihmën e qeverisë turke. Në mirënjohje për aktet e tij të guximshme dhe të suksesshme, turqit i dhanë privilegje të veçanta dhe ai bashkë

me familjen e tij u shndërrua në Islam. Pjesa tjetër e bajrakut është ende kryesisht katolike, por zakonisht në një rast të tillë banorët e zonës ndjekin shëmbullin e udhëheqësit. Në Lurë, ku gjenden familje të përziera, katolikët kanë hequr dorë nga mbajtja e derrave për të mos i ofenduar vëllezërit myslimanë. Ata, për t'i shmangur problemet i kremtojnë si festat myslimane ashtu edhe ato katolike. Shumë rrallë mund të ndodhë që një djalë mirditor të martohet me një vajzë myslimane nga Mati, por kur ndodh një gjë e tillë, nusja bëhet katolike.

Gegët ishin të gjithë katolikë. Ishin turqit ata që e sollën Islamin tek Gegët. Më pas tendenca ka qenë pothuajse e tëra drejt shndërrimit në islam. Prandaj mund të supozojmë se pothuajse asnjë katolik i sotëm nuk ka elementë gjenetikë të sjellë nga jashtë rajonit as nga turqit as nga pasuesit e tyre. Ndërkohë, jo e njëjta gjë mund të jetë domosdoshmërisht e vërtetë për Gegët myslimanë. Ndërkohë që shndrrimi përparonte bajrak pas bajraku dhe fis pas fisi, linja ndarëse midis dy feve në përgjithësi ka mbetur, si një pengesë për martesat midis tyre. Për më tepër, gjatë gjithë periudhës së sundimit turk, katolikët nuk kanë qenë në gjendje të udhëtojnë aq sa myslimanët dhe kjo ka pasojat e veta gjenetike.

Në Shqipëri shpesh dëgjohet të thuhet se *"Shqiptarët nuk janë shumë fetarë"*. Kjo zakonisht thuhet me krenari pasi prania e *tre feve* në një vend kaq të vogël konsiderohet si një pengesë e rrezikshme për unitetin kombëtar. Në një farë kuptimi, ky konstatim është mjaft i vërtetë pasi ka pak shqiptarë që janë fanatikë fetarë. Madje shumë pak prej atyre janë ata që shqetësohen për shpëtimin e tyre shpirtëror. Shumica e katolikëve shkojnë në kishë me njëfarë rregullsie dhe shumica e myslimanëve e argjërojnë Ramazanin. Megjithatë, mënyra e tyre e lashtë e jetesës siguron pjesën më të madhe të ritualit që u nevojitet për t'i përballuar krizat emocionale. Kështu, Kisha dhe Xhamia janë në shumë rasta si të tepërta. Besnikëria e parë e një burri është ajo ndaj "gjakut", domethënë familjes së tij të gjerë. Ai shpenzon pjesën më të madhe të kohës, përpjekjeve të tij dhe të mirave materiale për ta mbajtur familjen të bashkuar dhe për t'u hakmarrë ndaj çdo vepre që ka të bëjë me prishjen e stabilitetit të brendshëm të familjes së tij. Vetë akti i hakmarrjes është një ritual, siç është përsëritja e vazhdueshme e nevojës për këtë akt. Ritet e vëllazërisë së gjakut, vëllamërisë dhe të kumbarisë janë rituale që kryhen si nga katolikët ashtu edhe nga myslimanët.

Prandaj si katolikët, ashtu edhe myslimanët besojnë në një mori shpirtrash keqdashës (të këqinj) që u bëjnë maleve një vizitë sezonale në pranverë, dhe që

ndonjëherë mund të mbahen larg nga besimi dhe përdorimi i hajmelive.[4] Këta shpirtra të këqinj janë sigurisht simbolet e urisë së përgjithshme, sëmundjeve dhe dëshpërimit që pushtojnë malësorët në periudha kritike të ketë së tyre. Si katolikët, ashtu edhe myslimanët ia atribuojnë sëmundjet jo-traumatike magjive të bëra nga magjistarët, nëpërmjet prerjes së flokëve dhe thonjve. Sëmundjet e pashërueshme të tilla si tuberkulozi dhe kanceri, mund t'ju atribuohen vampirëve, që thithin gjakun e viktimës së tyre.

Thuhet se një vampir është një qenie njerëzore, zakonisht një grua por jo gjithmonë e tillë, e cila mund të shndërrohet në një insekt dhe të fluturojë brenda një dhome në të cilën është duke fjetur viktima e saj. Ndërkohë që fryhet me gjakun që i thith viktimës, asaj i duhet të largohet herë pas here për ta pështyrë atë. Një person që e gjen një pështymë të tillë gjaku në rrugë është me fat pasi ai mund ta mbështjellë dhe ta mbajë atë si hajmeli për t'u mbrojtur kundër vampirëve. Ai mund ta mbështjellë dhe ta mbajë si një hajmeli për ta mbrojtur nga vampirët por ndoshta, për pasojë, mund ta ekspozojë veten dhe familjen e tij ndaj tuberkulozit.

Dyshimi për magjinë e keqe bëhet edhe më i lehtë për t'u besuar prej njerëzve të uritur dhe të sëmurë. Një personi i supozuar si shtrigë ose vampir sigurisht që do të jetë dikush, veprimet e të cilit janë të çuditshme ose misterioze dhe që është bërë shkaktar i shqetësimeve që vlojnë në një bashkësi të caktuar, kështu që vdekja apo zhdukja e tij nuk do t'i dhimbsej askujt. Nëse një fëmijë vuan nga mungesa e dëshirës për të ngrënë, prindërit e tij mund të akuzojnë një plakë si shkaktare të kësaj gjendje dhe ndodh që mund ta largojnë atë plakë nga shtëpia. Ata e akuzojnë atë se ka thithur gjak nga fëmija dhe e detyrojnë atë të pështyjë në gojën e fëmijës. Si shenjë kundërshtimi, ajo mund të pështyjë thjesht për të mos u përgojuar. Nëse fëmija shërohet, atëherë prindërit janë të sigurt se ajo është një vampire por nëse fëmija vdes ajo del e pafajshme pasi pështymja e saj nuk arriti ta shërojë. Njerëzit e urrejnë akuzën për magji ose kur gjyshet e tyre të moshuara merren nëpër gojë për veprime të tilla, këto gjëra ashtu si çdo dyshim i kësaj natyre, mund të çojnë deri në gjakderdhje.

4 Hajmelia është një objekt i vogël, shpesh i mbajtur me vete ose i varur në trup, që besohet se ka fuqi mbrojtëse ndaj fatkeqësive, sëmundjeve, shpirtrave të këqij, ose rreziqeve të tjera. Hajmelitë (Amuletet) mund të jenë në formë bizhuterish, gurësh, shenjash fetare, simboleve të veçanta ose figurave të shenjta, dhe shpesh kanë një rëndësi të thellë kulturore ose fetare. (Shenim i perkthyesit)

Gegët janë njerëz që i rrinë betimit. Në kohë grindjesh për shkak gjakmarrje, kundërshtarët betohen mbi një gur, se do të ruajnë paqen. Këtë veprim ata e bëjnë në prani të pleqëve. Edhe nëse ata binden të betohen mbi kryq, përsëri nuk heqin dorë nga betimi mbi gur, i cili është simboli që i jep vlefshmëri betimit të tyre. Ata gjithashtu besojnë shumë në parashikimet dhe në rrëfimin e së ardhmes nga fallxhoret. Ka prej atyre me përvojë që kanë aftësinë të gjejnë çfarë do të ndodhë në të ardhmen duke kqyrur me vëmendje nëpërmjet eshtrave të gjoksit të shpendëve ose kockat e shpatullave të deleve të gatuara dhe servirur për t'i ngrënë. Unë u bëra dëshmitar i një skene të tillë. Kocka ka ndarjet e saj të veçanta, secila prej të cilave ka një kuptim. Në eshtrat e shpatullës së deles, zgavrat e nyjeve janë shtëpia ndërkohë që thellësia ose cektësia e saj tregon nëse shtëpisë do t'i mungojë apo jo pasuria. Kjo mund të përdoret gjithashtu për të parashikuar suksesin ose dështimin e të korrave. Kreshta në teh të ashtit tregon nëse tufat e bagëtive do të shtohen apo jo. Vrimat e vogla në teh janë djepa dhe ai që e sheh shpatullën, nga largësia që kanë zgavrat mund të gjejë sesa afër apo larg është lindja e një fëmije në atë familje. Kur ai që e shesh shpatullën, e kthen tehun ndaj dritës së zjarrit ose llambës. Aty forma dhe pozicioni i palcës do të tregojnë se ku dhe kur do të ketë luftë. Pikat e errëta nënkuptojnë vdekje, ndërsa pozicioni i tyre tregon nëse kjo do të ndodhë brenda apo jashtë familjes ku bëhet gostia.

Të gjitha këto rituale kanë të bëjnë me ruajtjen e ekuilibrit në shoqërinë e Gegëve. Betimet i japin besueshmëri marrëveshjeve dhe nuk mund të thyhen derisa të vijë një krizë që është më e fortë se ajo që do të prodhojë thyerja e betimit. Me përdorimin e zgjuar të shikimit të shpatullave parashikuese të shpendëve, një njeri i ditur mund të vlerësojë situatën në të cilën gjëndet mëhalla ose fisi i tij. Që këndej ai e merr "paralajmërimin për atë që do të ndodhë." Ai gjithashtu mund të nxisë marrjen e vendimeve dhe inkurajimin e të lëkundurve, pasi nëse parashikuesi i ndodhive të së ardhmes është një njeri me nam të mirë, fjalët e tij do të besohen. Shpesh ndodh që parashikimi del të jetë i vërtetë.

Ritualet më të rëndësishme, të cilat janë të njëllojta për besimtarët e të dy feve zyrtare, e mbajnë gjallë mardhënien midis tyre kur është fjala për raste të tilla si për lindjet, martesat dhe vdekjen. Për malësorët Gegë, të gjitha këto rituale, të cilat përbëjnë zakonet e tyre sociale, janë shumë më të rëndësishme sesa ritet e Kishës apo të Xhamisë. Këto të fundit nuk janë aq të përshtatura mirë për këtë formë të veçantë të organizimit të tyre shoqëror. Një mekanizëm tjetër i tillë

rregullues është ligji tradicional, i kodifikuar dhe i mësuar përmendësh - Kanuni i Lekë Dukagjinit. Ky dokument shpreh qëndrimin e malësorit Gegë ndaj martesës, zgjedhjes së bashkëshortes, si dhe ndaj gjakmarrjes. Ai shërben si kodi që rregullon format e sjelljes dhe veprimeve dhe i pengon ndryshimet e këtyre sjelljeve dhe veprimeve. Kjo ndodh pë shkak se banorët janë mësuar, që nga fëmijëria, që të besojnë te autoriteti i pagabueshëm i këtij kodi.

Një formë tjetër e vetë mbrojtjes është ajo e shprehur nëpërmjet të artit, kryesisht nëpërmjet të këngëve të kënduara me çifteli, ose me lahutë.[5]

Këngët e gjata të kënduara me orë të tëra, nganjëherë edhe tërë natën, me shoqërimin e këtij instrumenti me një tel, rrëfejnë dhe evokojnë veprat e paraardhësve dhe madje edhe të bashkëkohësve të tyre. Duke përdorur format tradicionale të vargjeve dhe një fjalor të stereotipizuar, ata mund të krijojnë *epikë* të re historike, ndërkohë që i këndojnë dhe i recitojnë ato të vjetrat, fjalë për fjalë. Si bardët analfabetë diku tjetër, ata sjellin historira të jashtëzakonshme. Kënga e kënduar me lahutë e frymëzon malësorin e Gegnisë që të ndërmarrë vepra trimërie njësoj siç ndodh me tingujt e pipave të gajdeve skoceze. Pra, kjo është e njëjtë me atë që bëjnë malësorët e Skocisë.

Të dyja palët, edhe Gegët edhe Skocezët frymëzohen nga këto vegla muzikore që të ndërmarrin vepra heroike për të cilat, më vonë edhe mund t'i paguajnë shumë shtrenjtë.

Kjo, është pjesë e gjithë kompleksitetit të grindjeve, po në ndonjë rast si një formë tjetër e vogël e artit. Pra, edhe ky është njëlloj me zbukurimet e qëndisura dhe të punuara me grep në veshjet e malësorit, me të cilat ai shfaqet sfidues dhe tregon përkatësinë e saktë familjare dhe politike.

Të gjithë këto mekanizma kulturore u përkasin myslimanëve dhe katolikëve, pa dallim. Ato përbëjnë pjesën më të madhe të jetës emocionale të njerëzve dhe nuk është për t'u habitur se përse shqiptarët thonë se nuk jemi aq "fetarë". Këto zakone janë mjete psikologjike për të përforcuar mënyrat e sjelljes me të cilat malësorët e Gegnisë e mbajnë dhe e ruajnë përshtatjen e tyre me atë mjedis malor ku jetojnë. Si të tilla ato janë të rëndësishme për studimin që neve kemi ndërmarrë.

5 Të huajt e quajën atë Gusle. Kjo të çon të mendosh se marrja e lahutës si pronë e trashëgimisë së serbëve i ka rrënjët e hershme tek udhëtarët të cilët e kanë quajtur Gusle në vend të fjalës Lutë ose lahutë. (Shënim i përkthyesit)

DIALEKTI GEGË I GJUHËS SHQIPE, SIÇ FLITET SOT, NË THELB ËSHTË ILIRISHTJA, E CILA ËSHTË GJITHASHTU E VETMJA GJUHË E MBIJETUAR NGA KY GRUP GJUHËSH QË DIKUR ISHTE SHUMË E PËRHAPUR.

HISTORIA E MALËSISË SË GEGNISË

Nëse antropologjia është studimi i asaj që na bëri neve njerëz, historia është gjaku jetësor i etnografisë ndërsa historianët janë fiziologët e shoqërive. Detyra e etnografit është të përshkruajë kulturën, të tregojë ku jeton një popull i caktuar, sa vetë e përbejnë atë numerikisht, çfarë mjetesh pune dhe veglash ka përdorur për t'u përshtatur me natyrën, çfarë organizimi familjar ka pasur, çfarë institucionesh të tjera ka mundur të formojë, për tregti apo për qeverisje, si i ka ndërtuar nn marrëdhëniet me popujt e tjerë dhe si i ka plotësuar nevojat e veta jetësore dhe rituale? Ndërsa puna e etnografit është selektive, ajo e historianit duhet të jetë edhe më e kujdesshme, pasi ky i fundit merret me lëvizjen e shoqërive në rrjedhën e kohërave. Historiani duhet të zgjedhë vetëm ato fakte që janë të rëndësishme për shkencën e tij.

Në këtë rast, problemi ynë është të zbulojmë gjithçka që mundemi për origjinën e popullit Gegë, vijueshmërinë gjenetike të atyre banorëve që jetojnë brenda fortesës së tyre malore, kohën kur janë vendosur aty, vendet e origjinës dhe karakteristikat fizike të çdo të huaji, që mund të ketë shkelur dhe përzier gjakun me ta, në ato troje. Duke marrë parasyshë përzgjedhjen natyrore në migrim, siç e dinë mirë biologët, do të donim të dinim kur dhe deri në çfarë mase këta të ardhur mund të jenë larguar nga vendi i tyre?

Këto synime mund të arrihen vetëm pjesërisht. Historia është veçanërisht e heshtur, pra ka shkruar pak, kur bëhet fjalë për zonat se kur kanë ardhur këta njerëz dhe janë vendosur aty. Faktorët gjeografikë që e kanë izoluar Gegninë fisnore nga rrjedhat kryesore të migrimeve njerëzore dhe evolucionit kulturor, e kanë fshehur atë edhe nga sytë e kronikanëve, duke penguar kështu edhe punën e arkeologëve. Për momentin, nuk dimë asgjë për historinë e saj para Epokës së Hekurit.

Vetëm një studiues i quajtur Freiherr von Richtofen[1] pretendohet se ka gjetur

1 Freiherr Otto von Richtofen, ishte një antropolog dhe historian i njohur për studimet e tij mbi kulturën dhe historinë e popujve të ndryshëm. Ai ka kontribuar në fushat e antropologjisë dhe historisë me studimet e tij mbi raca dhe kulturat. Ai është i njohur për analizat dhe hulumtimet e tij në lidhje me ndikimin e faktorëve gjenetikë dhe kulturorë në formimin e popujve dhe kulturave. (Shenim i perkthyesit)

një dëshmi të kohës së Pleistocenit[2] në Shqipëri. Ai zbuloi dy fragmente stralli të gdhendura, direkt nën një trase të një rruge të kohës tonë, në Malin e Dajtit, pak jashtë Tiranës. Nuk ka asnjë arësye për të mos besuar se ato ishin mjete luftarake. Në një shpellë pranë Korçës, Pittard,[3] lokalizoi një depozitë që mendohet se mund të jetë e periudhës neolitike.[4] Ai e bazoi pretendimin e tij për moshën neolitike të një ene, e cila mund të ishte aty edhe që nga Epoka e Hekurit. Në fakt ka patur edhe gjetje të Epokës së Bronzit, por jo në territorin që ne po studiojmë. Një sëpatë prej bronzi, e gjetur pranë Shkodrës, i është atribuar Periudhës së vonë të Bronzit dhe është e ngjashme me ato të fenikasve, të cilët thuhet se kanë bërë tregti me banorët barbarë të bregdetit mesdhetar. Ajo ka një vegël ngjitur poshtë dhe një vrimë në formën e gishtit, të ngjashëm me thikat e hekurit që përdoren sot në malësi.

Në Shqipëri, ka disa gjetje arkeologjike, si kafka e prova të tjera të gjetura në veri të vendit, që vërtetojnë praninë e një tipi meso-kefalik, i cili mendohet të jetë një ndërmjetësim midis ilirëve të tipit të vjetër dhe atyre të tipit dinarik.

Carleton S. Coon

Në malësi nuk janë gjetur asnjëherë elementë arkeologjikë të Epokës së Bronzit. Kjo nuk është për mungesë të kërkimeve arkeologjike, pasi në atë zonë janë bërë gërmime dhe janë zbuluar një sërë vendndodhjesh të Epokës së Hekurit.[5] Këto vend-ndodhje përbëhen nga tuma varresh, të tilla si ato të gërmuara në Hot, Dushman si dhe në Mirditë dhe në Mat. Materiali i gërmuar në to është i tipit Hallstatt të rregullt. Në fakt, Menghin thotë se objektet nga veriu i Drinit

2 Epoka e Pleistocenit është një periudhë gjeologjike që filloi rreth 2.58 milion vjet më parë dhe përfundoi rreth 11,700 vjet më parë, duke i hapur rrugën epokës së Holocenit, në të cilën jetojmë sot. Kjo periudhë është pjesë e Erës Kuaternare dhe ka qenë e rëndësishme për zhvillimin e klimës dhe ekosistemeve të Tokës. Disa nga epokat që e pasuan janë: Epoka e akullnajave , Zhvillimi i njeriut, përfshirë shfaqjen e hominidëve të hershëm, si Homo habilis, Homo erectus dhe më vonë Homo sapiens, Ndryshimet mjedisore dhe gjeografike. . (Shenim i perkthyesit)

3 Petard, 1921, f. 271 – 74. (Shenim i autorit)

4 Vulpe, 1932, f. 132 – 45 (Shenim i autorit)

5 Menghin, 1919-20, pp. 197-202; Nopcsa, 1910, pp. [31]-[32]; Ugolini, 1927, pp. 181-88. (Shënim i autorit)

janë identike me ekzemplarët e tipit nga Glasinac dhe Dolje Dolina, vende të qytetërimit Hallstatt në Bosnje.[6]

Gjuha shqipe përbën një degë të veçantë në ndarjen satem të gjuhëve indo-evropiane. ajo është pasardhësja e drejtpërdrejtë e ilirishtes së lashtë të kohërave romake, së bashku me disa ndikime trake. aktualisht, ekzistojnë dy ndarje kryesore dialektore: gegnishtja e folur në veri dhe toskërishtja e folur në jug.

Kjo dëshmi mbështet studimet shkencore tradicionale që thonë se vendi i Gegëve ishte pjesë e dominimit të Ilirëve. Dy grupe të tjera faktesh e mbështesin edhe më tej këtë përfundim: Gjuha dhe kultura e sotme. Dialekti Gegë i Gjuhës Shqipe, siç flitet sot, në thelb është Ilirishtja, e cila është gjithashtu e vetmja gjuhë e mbijetuar nga ky grup gjuhësh që dikur ishte shumë e përhapur.

G. S. Lowman[7] thotë për këtë:

"Gjuha Shqipe e dialektit[8] Gegë, siç flitet sot, është në thelb Ilirishtja, e cila është gjithashtu e vetmja gjuhë e mbijetuar nga ky grup që dikur përdorej shumë.

Gjuha shqipe përbën një degë të veçantë në ndarjen Satem[9] të gjuhëve indo-evropiane. Ajo është pasardhësja e drejtpërdrejtë e Ilirishtes së lashtë të kohërave romake, së bashku me disa ndikime trake. Aktualisht, ekzistojnë dy ndarje kryesore dialektore: Gegnishtja e folur në veri dhe Toskërishtja e folur në jug. Ato pak a shumë e kuptojnë njëri-tjetrin.

6 Dr. Robert Ehrich, i ka shqyrtuar me kujdes riprodhimet e publikuara të këtyre objekteve dhe është i njohur me artefaktet e Glasinacit. Ai thotë se koleksionet shqiptare përfshijnë objekte romake. (Shënim i autorit)

7 Lowman, 1932, p. 271. G. S. Lowman është një linguist që ka kontribuar në fushën e studimeve gjuhësore. Ai është i njohur për analizat e tij mbi gjuhët e ndryshme dhe për kërkimet e tij në lidhje me struktura dhe zhvillimin e gjuhëve. (Shënim i përkthyesit)

8 Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: Gegë dhe Toskë. Dialekti Gegë është një nga dy grupet dialektorë të gjuhës shqipe dhe përdoret kryesisht në veriun e Shqipërisë dhe në disa pjesë të Kosovës, Malit të Zi, dhe Maqedonisë së Veriut. Ajo përfshinë: Fonologjinë, gramatikën, fjalorin. Dialekti Gegë është i pranishëm kryesisht në veriun e Shqipërisë, përfshirë Rajonin e Dukagjinit dhe Malësinë e Veriut, si dhe në disa zona të Kosovës dhe Malit të Zi. (Shënim i autorit)

9 Në studimin e gjuhëve indo-evropiane, ndarja Satem është një nga dy degët kryesore të ndarjes fonologjike të gjuhëve indo-evropiane, e cila ndan këtë grup gjuhësh në dy kategori: Satem dhe Centum. Pra, një shembuj i ndarjes Satem janë: Gjuha Sanskrite (e përdorur në Indi), Gjuha Avestike (e përdorur në Iranin antik), Gjuha Shqipe (e përdorur në Shqipëri dhe Kosovë), Gjuha Balte (e përdorur në rajonin baltik) Gjuha Sllave (e përdorur në rajonin e Evropës Lindore). (Shënim i përkthyesit).

Në rrjedhë të historisë së Shqipërisë, ka pasur shumë ndikime të huaja që kanë luajtur rolin e tyre për ta sjellë gjuhën në trajtën që është sot. Edhe pse struktura thelbësore e gjuhës dhe një pjesë e mirë e fjalëve në përdorim të përditshëm janë me origjinë amtare, fjalori ka huazuar fjalë nga burime të jashtme në një masë shumë më të madhe sesa në rastin e gjuhës angleze.

Në vitin 1891, Gustav Meyer[10] shprehet në fjalorin e tij etimologjik se nga 5.140 rrënjë fjalësh, vetëm 400 prej tyre ishin me bazë origjinale. Nga këto, 540 fjalë kishin lidhje me gjuhët sllave, 1.180 me turqishten, 840 me greqishten dhe mbi 700 fjalë ishin të papërcaktuara qartë. Megjithatë, studiuesit e mëvonshëm kanë vërtetuar se një pjesë shumë më e madhe e fjalëve janë vërtet shqip.

Vëzhgues të tillë të kujdesshëm të kulturës materiale, si Nopça dhe Haberlandt, kanë arritur në përfundimin se Gegët, me sendet që përdorin, veglat bujqësore, mobiljet, kostumet dhe shumicën e mjeteve të tjera të punës, ende jetojnë si në Epokën e Hekurit të Hallstatt - it.

Prandaj, ka vetëm një përfundim, sa të ligjshëm aq edhe të qartë:

Malet e Gegnisë fillimisht u populluan me shpejtësi gjatë shekujve të mesëm të mijëvjeçarit të parë para Krishtit. Të ardhurit e parë që iu përshtatën këtij terreni të thyer ishin Ilirët, territori qendror i të cilëve shtrihej në veriperëndim. Meqenëse kishin jetuar tashmë në Bosnje dhe në Mal të Zi, ata u përshtatën me këtë mjedis.

Fatmirësisht, në materialet e zbuluara në tumat e Glasinac - it, një truall tipik i kulturës Hallstatt - Ilire, gjënden skelete dhe artifakte. Datat e këtyre tumave variojnë nga viti 1000 deri në vitin 500 para Krishtit. Koleksioni i 38 kafkave tregon qartë se Ilirët nuk ishin një popull homogjen në kuptimin racor.

Shumica e kafkave janë të gjata dhe përfaqësojnë të paktën dy lloje racash bashkëkohore të nordikëve. Kjo nuk është e habitshme, pasi shumica e njerëzve të Epokës së Hekurit në Evropë, ishin nordikë. Megjithatë, 13 kafka, ose një e treta e serisë totale, ishin brakycefalike. Këto kafka kanë pjesët e pasme të rrafshta, pjesët anësore të drejta, ballin e gjerë, dhe në një rast janë ruajtur kockat e një hundë - shkabe. Ato janë kafkat e Dinarikëve dhe ngjajnë me kafkat Dinarike të

10 Gustav Meyer (25 nëntor 1850 – 28 gusht 1900) ishte një gjuhëtar dhe studiues gjerman, i konsideruar si një nga albanologët më të rëndësishëm të kohës së tij, më e rëndësishmja duke vërtetuar se Gjuha Shqipe i përket familjes indo-evropiane. (Shënim i përkthyesit).

Epokës së Bronzit nga Qiproja dhe kafkat e Bell Beaker-it Dinarik nga vendet e hershme të Epokës së Bronzit në Gjermani.

Të gjitha dëshmitë që kemi gjetur tregojnë se më të afërmit e atyre nga Glasinaci ishin pikërisht ata që u vendosën në Gegni, në kohën kur tuma "kishte hyrë në përdorim". Ne i kemi të gjitha arësyet të supozojmë se para-ardhësit e Gegëve, në 500 vitet e fundit para erës së re, pra gjatë periudhës së tyre fillestare, ishin shumë të ngjashëm me njerëzit, eshtrat e të cilëve u gjetën në varrezat e Glasinac-it. Kjo do të thotë se te Gegët, karakteristikat dinarike kanë qenë të pranishme që në fillim, edhe pse ndoshta përbënin vetëm një pakicë të popullsisë.

Le të kthehemi për një moment te ideja se Gegët ende jetojnë si në epokën e Hekurit të Hallstat - it. Kjo do të thotë se nuk kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në proceset e tyre teknologjike. Nëse Ilirët kishin pajisje po aq të mira për të punuar tokën, përpunuar ushqimet, ndërtuar shtëpitë, endur pëlhurat, qepur rrobat, etj., sa edhe Gegët e Malësisë moderne, atëherë ata ishin në gjendje të shfrytëzonin peizazhin po aq efikas sa pasardhësit e tyre të sotëm. Luginat dhe kullotat e larta të Gegnisë mund të mbanin një popullsi po aq të madhe atëherë sa ç'mbajnë edhe sot.

Ky supozim duhet të bëhet me kujdes dhe në një masë të caktuar. Gegët e sotëm e bluajnë miellin dhe i përpunojnë pëlhurat dhe shajakun në mullinj dhe shkaltore, që funksionojnë me anë të rrjedhjes së lirë të ujit. Kjo ndihmon që të lirohet një masë e caktuar e krahut të punës, e cila mund të përdoret në veprimtari të tjera. Këto shkaltore duhet të jenë vënë në përdorim pasi këta banorë kanë ardhur për të jetuar në këto anë. Lufta, e cila është një fenomen karakteristik për kontrollin e rritjes së numrit të popullsisë në Gegninë malore, ka ndikuar gjithashtu ndjeshëm dhe ka sjellë ndryshime. Turqit i futën armët e zjarrit nëpër kulla, ose kështjellat prej guri, si armë sulmi dhe mbrojtjeje. Ky mjet e bëri vrasjen më të lehtë se më parë dhe duhet të ketë ndihmuar në zvogëlimin e popullatës. Në tërësi, mjetet për rritjen e efikasitetit në kultivimin e tokës dhe pakësimi i fuqisë punëtore ndoshta e kanë kundër-balancuar njëra tjetrën.

Duhet t'u jenë dashur disa shekuj rishtarëve që u vendosën në ato anë për të parë, kërkuar dhe më pas shfrytëzuar çdo luginë, për të zgjedhur vendet më të favorshme për jetesë dhe për t'i kultivuar ato. Shumë shekuj u deshën që tokat më pak pjellore, të cilat prodhonin pak dhe për një popullatë më të vogël, të bëheshin të kultivueshme për të mbajtur një popullsi më të madhe.

Por në fillim të erës së re, ndikimi i parë i jashtëm, ai i Romës, u ndie edhe në skajet e maleve të Gegnisë. Në atë kohë, kjo anë e maleve mund të ketë qenë e mbushur me njerëz të ngjashëm me ata që i shohim edhe sot. Kjo do të thotë se nuk kishte vend për romakët apo të tjerë që të vendoseshein aty pa e arritur këtë me një pushtim të armatosur. Edhe me një pushtim të armatosur, siç kanë zbuluar shumë studiues dhe udhëtarë, malet e Gegnisë janë të vështira për t'u zaptuar.

Biologjikisht, rëndësia e kësaj është se ndërsa banorët origjinalë të zonës që ne po studiojmë duhet të kenë qenë një grup i përzier, ata ndoshta ishin në gjendje të mbushnin vendin e tyre me pasardhës përpara se të bëheshin përpjekje të bashkërenduara nga të huajt për të pushtuar territorin e tyre. Shumica e tyre pa dyshim që ishin Ilirë nga Bosnja, ndërsa të tjerët mund të kenë qenë trakë nga fushat në verilindje.

Nga ana racore, ata ndoshta ishin një përzierje e nordikëve, mesdhetarëve nga bregdeti Adriatik, brachycephalic, nga i njëjti rajon dhe mesdhetarëve pontikë[11] nga zonat kufitare të Detit të Zi. Ata ishin në gjendje të ruanin lëngun e tyre gjenetik dhe njëkohësisht të prodhonin varietetin e vet të racës njerëzore.

E gjithë Gegnia, përveç pjesëve jugore të Matit dhe Dibrës, formonte një pjesë të provincës së Dalmacisë.

Autorët romakë kanë shumë për të thënë për popujt rreth Gegnisë, por shumë pak për vetë malësorët. E gjithë Gegnia, përveç pjesëve jugore të Matit dhe Dibrës, formonte një pjesë të provincës së Dalmacisë. Vendi i banuar tanimë nga Toskët ishte pjesë e Epirit. Ndërsa para-ardhësit e Toskëve ishin Epirotë dhe ata të Gegëve Ilirë, banorët që gjendeshin midis tyre u formuan nga një përzierje e këtyre dy elementeve.

11 Mesdhetarë Pontikë autori iu referohet atyre njerëzve Pontiko-Kaspike, të ndodheshin pranë brigjeve veriore të Detit të Zi (Pontus) dhe Detit Kaspik. Njerëzit e klasifikuar si Mesdhetarë Pontiakë besohej se kishin disa tipare fizike, si p.sh, trup të hollë ose mesatar, lëkurë me ngjyrë ulliri deri në të errët, flokë dhe sy të errët dhe kafka të gjata ose ovale (dolikocefalike) (Shënim i përkthyesit)

Straboni, në "Libri i Shtatë"[12] i përmend fiset e Shqipërisë Qendrore që u pushtuan nga Maqedonasit, disa prej të cilëve flisnin dy gjuhë. Ai thotë se disa nga fiset vazhdimisht përpiqeshin të fitonin kontrollin mbi të tjerët, por maqedonësit i dhanë fund këtij rivaliteti. Në vitin 168 para erës së re, Maqedonia u bë një provincë romake. Që fiset e Shqipërisë Qendrore ngjanin me Gegët e sotëm në disa aspekte është dëshmuar nga përdorimi i fjalës '*peligo*' (plak) për të moshuarit, emri fisnor '*Emathia*' (e madhja, nominativi shumës), dhe ndoshta emri fisnor '*Molotti*' (malësor, malësorët).

Dardanët i dhanë Romës një perandor, Justinianin. vendi i dardanëve, të cilin romakët e pushtuan, thuhet se ishte shumë i pyllëzuar deri në afërsi të Nishit, një qytet i rëndësishëm kryqëzimesh në kohët romake, ashtu siç është edhe sot.

Straboni e cilëson një popull me emrin Dardan në verilindje të vendit të Gegëve, në fushën e Kosovës, përtej rrjedhës së sipërme të lumit Drin. Ai i konsideronte Dardanët si një popull jashtëzakonisht të egër, që jetonin në vende të ashpra dhe luanin në instrumente me tela. Dardanët i dhanë Romës një Perandor, Justinianin. Vendi i Dardanëve, të cilin Romakët e pushtuan, thuhet se ishte shumë i pyllëzuar deri në afërsi të Nishit, një qytet i rëndësishëm kryqëzimesh në kohët romake, ashtu siç është edhe sot.

Ky përshkrim tregon rëndësinë historike të një zone pyjore dhe e thekson faktin sesa e vështirë ishte kalueshmëria nëpër të dhe sesa pak ndikim kishin ngjarjet historike në këtë zonë për një periudhë të gjatë kohe.

Pjetri Hermit,[13] gjatë Kryqëzatës së tij në fund të shekullit të 11-të, eci shtatë ditë përmes këtij pylli të dendur dhe arriti në qytetin e Nishit, i cili ishte i mbrojtur

12 Libri i Shtatë i "Gjeografisë" i Strabonit (i njohur gjithashtu si "Geographica") është një pjesë e rëndësishme e veprës së tij, e cila fokusohet kryesisht në rajonet e Evropës, veçanërisht në ato të pjesëve veriore dhe lindore. Straboni ishte një gjeograf, filozof dhe historian grek që jetoi gjatë kohës së Perandorisë Romake. Vepra e tij "Gjeografia" është një vepër e gjerë që përshkruan botën e njohur të asaj kohe. Rajonet Lindore dhe Veriore të Evropës: Straboni jep përshkrime të ndryshme fisesh dhe rajonesh, duke përfshirë Ballkanin, pjesë të Evropës Qendrore dhe Lindore. Kjo përfshin territore si Trakia, Iliria dhe tokat rreth Detit të Zi. (Shënim i përkthyesit)

13 Murgu Pjetër ishte një figurë kyçe gjatë Kryqëzatës së Parë (1096–1099),që udhëhoqi një luftë fetare e nisur nga të krishterët evropianë për të rimarrë Tokën e Shenjtë nga sundimi mysliman. Ai ishte një murg dhe predikues francez që luajti një rol udhëheqës në organizimin dhe frymëzimin e e Kryqëzatës së Parë. (Shënim i përkthyesit)

prej muresh të forta prej guri dhe kishte shtatë mullinj me ujë. Shekuj më vonë, në vitin 1717, udhëtarja britanike Lady Mary Wortley Montagu,[14] e gjeti po atë pyll të mbushur me grupe banditësh, duke dëshmuar se vendi mbetej i egër dhe i pa eksploruar. Edhe më vonë, në vitin 1809, gjatë kryengritjes së fshatarëve serbë kundër turqve, një pjesë e madhe e këtij pylli ishte ende i paprekur.

Ky përshkrim tregon që ky rajon ishte i populluar në tërësinë e tij, por jo në masë të tillë që të kishte migrime të mëdha. Pylli i dendur dhe vendbanimet e izoluara mbanin një popullsi të shpërndarë, duke e bërë të vështirë zhvillimin e qytetërimeve ose nxitjen e migrimeve të mëdha nga ky rajon. Ka dëshmi të qarta që ndarja gjeografike e punës kishte filluar që në kohët romake. Malësorët shkëmbenin lëndë të para me mallra të përpunuara në tregjet e qyteteve fqinjë. Meqënëse materiali arkeologjik më i hershëm i gjetur deri tani në trojet shqiptare është prodhim boshnjak, trak ose romak, ky sistem duhet të ketë qenë në fuqi që nga fillimet e vendbanimeve Ilire. Në anën e maleve që shohin nga Deti Adriatik ka patur pika të vogla tregtare romake, të vendosura nga ana arkeologjike në *Berzumno* (Vuksanlekaj, në veri të Shkodrës), në *Cinna* (Koplik) dhe I*minacum* (Iballë, në Pukë). Romakët e pushtuan edhe Shkodrën (Scutari), Lezhën (Lissus) dhe Durrrësin (Dyrachium) dhe i lidhën këto tre qytete tregtare me rrugë.

Nga Durrësi, kjo rrugë merrte drejtimin nga lindja, duke filluar nga bregu i detit dhe kalonte mes për mes vendit, duke ndjekur luginën më të ulët në zinxhirin Dinarik në veri të Gjirit të Korinthit, për në Ohër,(Lychnidus) në Liqenin e Ohrit. Kjo rrugë kalonte anash pa prekur Malet e Gegëve, duke ndjekur trajektoren e saj nëpër bregun e Drinit të Zi, në jug të kufirit të sotëm fisnor të Dibrës.

Një rrugë tjetër kalonte drejtpërsëdrejti nëpër male nga Lissus (Lezha) në jug të lumit Drin. Ajo duket se ndiqte të njëjtin kurs si rruga e sotme që shkon nga Vau i Dejës në Zadrimë e deri në Pukë, përmes Malziut dhe më pas dredhon poshtë në bregun e Drinit të Zi, në një largësi jo aq të madhe në jug ku bashkohet me Drinin e Bardhë. Kjo rrugë ndjek bregun jugor të Drinit të Bardhë për rreth 18 milje, aty ku bën një kthesë të mprehtë drejt veriut.

Në kohët romake, territori përtej bashkimit të dy Drinëve bënte pjesë në

14 Lady Mary Wortley Montagu (1689–1762) ishte një shkrimtare dhe personalitet i njohur anglez, më së shumti e njohur për letrat e saj, të cilat ofrojnë një pasqyrë të jashtëzakonshme të jetës në Evropë dhe Lindjen e Mesme në shekullin e 18-të. Ajo ishte një nga gratë më të rëndësishme të kohës së saj për kontributin në letërsi, shoqëri dhe përpjekjet mjekësore. (Shënim i përkthyesit)

provincën e Moesisë së Epërme. Rruga vazhdonte përtej kësaj province deri në një vend të quajtur Ulpiana, në Fushën e Kosovës, pranë qytetit të sotëm të Prishtinës. Nga Ulpiana, rruga kalonte në luginën e Moravës dhe arrinte në lumin e Nishit, qyteti i sotëm Nish. Kjo nuk ishte rruga e vetme romake që kalonte Alpet Dinarike nga Adriatiku në qytetin modern të Nishit. Kjo ishte vetëm njëra nga tri trasetë që lidhin bregdetin Adriatik me luginën e Danubit. Shumë më në veri, një udhë tjetër e lidhte *Senian* (Zengg) në jug të *Fiumes* me *Siscian* (Zagrebin ose aty pranë) dhe me rrugën që kalonte poshtë lumit Sava. Nga *Spalatum* (Split) gjithashtu ishte e mundur të kalohej nëpër pengesat mbi rrugët e kalldremta romake. Via Egnatia, që kalonte përmes Shqipërisë Qendrore, ofronte një rrugë më të gjatë për në Nish, pasi në *Heraklion,* Manastiti i sotëm, ajo bashkohej në një kënd të drejtë me një rrugë që shkonte në drejtimin veriperëndimor dhe juglindor, një degë e së cilës kalonte, përmes *Scupi - t* (Shkup), për në *Ulpiana* (Prishtinë).

Rruga e Drinit nuk mund të ketë qenë më e rehatshme se këto rrugë të tjera. Megjithëse romakët duhet ta kenë mbajtur mirë rrugën, sot ka pak dëshmi për ekzistencën e saj. Ajo kurrë nuk do të ketë qenë e përshtatshme për mjetet lëvizëse me rrota, pasi është e ngushtë, me kthesa, e pjerrët dhe në disa vende ka shkallë të gdhendura në shkëmb ose të ndërtuara me muraturë. Gjatë kësaj rruge, udhëtarët duhet të kenë pasur nevojë të flinin dy netë në territoret malore të Gegnisë. Kjo do të thotë se romakët duhet të kenë ndërtuar stacione të fortifikuara për këtë qëllim. Nata e parë do t'i çonte ata në *Picaria* (Qerret), e dyta në *Creveni*, pranë Va-Spasit të sotëm (fshat i vogël që ndodhet buzë Drinit) ose *Parmchi*, në bregun jugor të lumit Drin, disa milje poshtë bashkimit të tij me Drinin e Bardhë. Nata e tretë do t'i çonte ata në fushë, në rrugën për në Ulpianë. Ai vend mund të ketë qenë vendbanimi romak në *Gabuleum*, diku pranë Gjonajt ose Zym-it, në territorin e sotëm të Hasit.

Transporti i mallrave mbi këtë rrugë, me materiale të përpunuara që lëviznin drejt lindjes dhe me lëndë të para drejt perëndimit, duhet të ketë përbërë një tundim të fortë për malësorët në secilën anë. Por romakët duhet ta kenë mbajtur të ruajtur mirë këtë rrugë, sepse sulmet nga pritat e grabitësve ishin të shpeshta. Garnizonet nënkuptojnë trupa ushtarake, ndërsa ushtarët vetë nënkuptojnë një bashkëjetesë midis ushtarëve nga vende të ndryshme të përzier me ushtarë nga popullata vendase. Ndoshta shumë nga ata ushtarë janë thirrur dhe rekrutuar nga bijtë e fiseve të Gegëve që ishin afër postave të tyre të mbrojtjes. Por gjithësesi, disa prej tyre duhet

të kenë qenë të huaj dhe mund të presim që përzierja gjenetike e Gegnisë të ketë ndodhur paksa gjatë periudhës romake, përgjatë asaj rruge. Kjo do të ndikonte kryesisht në fiset e Pukës, përmes të cilave kalon një pjesë e madhe e rrugës, dhe gjithashtu në fiset e Lumës dhe të Hasit, përmes të cilave ajo kalon po ashtu.

Pas rënies së Perandorisë Romake, rruga duhet të jetë përdorur shumë më pak, pasi tani nuk kishte kush të kujdesej për të apo ta ruante atë. Për më tepër, mallrat që do të niseshin nga Moesia dhe Dacia nuk do të shkonin më në Romë, por në Bizant. Në shekujt e IV – rt dhe të V – të, të erës së re, Gotët i vunë nën zotërim disa pjesë të Gegnisë Lindore. Traditat e tyre u ruajtën në fisin e Lumës, ku disa prej këtyre veriorëve mund të kenë qenë vendosur. Në vitin 535 të erës së re, Justiniani i mundi ata dhe e përfshiu Gegninë brenda Perandorisë së Lindjes.

Ishte ndoshta pikërisht kjo periudha, rreth shekullit të IV - rt të erës së re, kur trafiku në rrugën e Pukës ishte në kulmin e vet, kur fiset në të dyja anët e saj e përqafuan për herë të parë Krishterimin.

Vetë Konstantini, perandori i parë i krishterë, mund të ketë kaluar nëpër Gegëni, pasi ai ishte dardan, i lindur në Nish.

Vetë Konstantini, Perandori i parë i Krishterë, mund të ketë kaluar nëpër Gegëni, pasi ai ishte Dardan, i lindur në Nish.

Regjistrimi ynë i parë i institucioneve të krishtera në malet e Gegnisë daton në vitin 877[15] pas Krishtit, kur tashmë kishte një peshkop në *Pulat* (Pult) dhe deri në shekullin XIV - të dëgjojmë për dy peshkopata, atë të *Pulatenses Majores* dhe atë të *Pulatenses Minores*[16], të cilat u bashkuan në vitin 1520. Një peshkopatë tjetër e kishte selinë e saj në fshatin Drisht,[17] në Postribë.[18]

15 Durham, 1928, f. 24 – 25, 28 (Shënim i autorit)

16 *Pulatenses Majores*, ose Pulti i Madh, është një krahinë historike në Veri të Shqipërisë, që përfshin pjesë të zonave malore të Shkodrës. Në dokumentet historike, *Pulatense Major* dhe *Pulatense Minor* ishin emërtime që i referoheshin dy pjesëve të kësaj treve, që janë Pulti i Madh dhe Pulti i Vogël (shënim i autorit).

17 Farlati, 1817, fq. ix-xiv, tregon historinë e këtyre Ipeshkivive Shqiptare; shih gjithashtu Sufflay, 1916, fq. 188.(Shënim i autorit)

18 Peshkopata në fshatin Drisht, në Postribë, ishte një seli peshkopale katolike në Shqipërinë e Veriut. Drishti, një fshat historik afër qytetit të Shkodrës, ishte një qendër e rëndësishme kishtare dhe kulturore gjatë Mesjetës. Në këtë zonë ekzistonte një peshkopatë që luante një rol të rëndësishëm në administrimin fetar të rajonit dhe shërbente si qendër shpirtërore për komunitetin katolik. (Shënim i përkthyesit)

Në fillimet e shekullit të VI - të, sllavët e jugut e pushtuan Ballkanin. Një shekull më vonë, disa prej tyre lëvizën nga Fusha e Kosovës drejt Perëndimit përmes hyrjeve që iu mundësonte Drini brenda territorit të Gegëve, ndoshta duke ndjekur rrugën e vjetër romake. Mbërritjen e tyre në Adriatik ende e kujton emri sllav *Zadrima* dhe një numër emrash vendesh të tjera. Për 700 vjet, mbretërit serbë ruajtën një farë sundimi (nominal) mbi këtë vend malor. Herë pas here ata e bezdisnin popullsinë katolike shqiptare, siç ndodhi në vitin 1335, kur Car Dushani i dha Manastirit Ortodoks të Deçanit tokën e fshatit Summa, në bregun e djathtë të Kirit në peshkopatën e Pultit, së bashku me disa rajone fqinje shqiptare dhe një numër shërbëtorësh, emrat e të cilëve tingëllojnë shumë si ata në listat tona të matjeve. Ndërmjet viteve 1372 dhe 1427, Helena, e veja e Stefan Dushanit, dhe djali i saj, Uroshi, i bezdisën edhe më shumë katolikët, ua grabitën mallrat dhe i lëshuan në varfëri të thellë.[19]

Gjatë asaj periudhe sllave, është e mundur që pushtuesit të kenë ndikuar në përbërjen gjenetike të popullit malor, pasi emrat sllavë, si Orosh, janë mjaft të zakonshëm në Gegni. Sllavët me siguri kishin qasje në shumë pjesë të vendit, ndërkohë që e folmja sllave pati një ndikim të konsiderueshëm në fjalorin e Gjuhës Shqipe. Megjithatë, ky pushtim nuk ishte aq i rëndësishëm nga pikëpamja biologjike sa ata që pasuan.

Gjatë periudhës së shkurtër që pasoi ndërmjet fundit të Perandorisë së Vjetër Serbe dhe fillimit të pushtimeve turke, Gegët u lanë të qetë. Turqit e filluan pushtimin e Shqipërisë në fund të shekullit XIV - të, pas Betejës së Kosovës, së vitit 1389. Ata u ndeshën në betejë me Gegën trim, Skënderbeun (Gjergj Kastrioti), më i famshmi i të gjithë Gegëve.[20] Ai dhe pasardhësit e tij i mbajtën larg turqit nga Kalaja e tij në Krujë (Croya) deri pas vitit 1479, kur shënohet rënia e Shkodrës. Turqit kurrë nuk i morën nën kontroll të plotë të gjitha ato male. Në të vërtetë, e gjithë Mirdita, Dukagjini dhe pjesë të tjera të fiseve mbetën të krishterë gjatë gjithë periudhës turke. Të ruanin fenë katolike do të thoshte që ata mund të ruanin edhe vendin e tyre të lirë nga turqit. Kjo gjithashtu nënkuptonte se ata zakonisht ishin vetë të zotët e shtëpive të tyre. Megjithatë, shumë nga katolikët i përshtatën emrat e tyre në emra myslimanë, emra të cilët i përdornin kur dilnin

19 Stefan Dushani dhe djali i tij, Uroshi, ishin sundimtarë të Mbretërisë Serbe gjatë shekullit të 14-të dhe luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e Ballkanit. (Shënim i përkthyesit)

20 Shiko Fan Noli, Historia e Skënderbeut, 1947. (Shënim i autorit)

nga territori i tyre fisnor për të vizituar qytetet fqinjë apo për të bërë tregëti. Ky zakon vazhdon të jetojë edhe tani në vitin 1929.

Jo të gjithë Gegët që u shndërruan në Islam e ndryshuan besimin e tyre nga nevoja. Shumë prej tyre kishin përfitime kur të bënin këtë ndryshim në besimin e tyre fetar. Nëse ndryshonte fenë e bëhej mysliman, malësori mund të mbante armën në krah, hapur, kudo që shkonte dhe mund të qëllonte mbi të krishterët sipas dëshirës, pasi ata ishin "jashtë ligjit". Ai mund të udhëtonte në territoret e kontrolluara nga turqit pa u shqetësuar se do të kapej dhe mund të përfitonte shumë përparësi ekonomike në raport me të afërmit e tij katolikë, të cilët përbënin një armik fetar në krahasim me të. Ai mund të bashkohej me ushtrinë turke dhe të ngjitej në rangje të larta ushtarake. Shumë shqiptarë u ngjitën në rangun e gjeneralëve turq. Shqiptarë të tjerë u bënë zyrtarë të lartë në Oborrin e Sulltanit. Njëri prej tyre themeloi Mbretërinë moderne të Egjiptit të sotëm. Turqit i vlerësuan shumë shqiptarët që ngjitën shkallët e karrierës dhe i favorizuan ata më shumë se të tjerët. Kjo është një nga arësyet se, përse Shqipëria mbeti kaq gjatë pjesë e Perandorisë Osmane dhe se përse tre të katërtat e shqiptarëve janë ende myslimanë.

Megjithëse turqit ndoshta nuk ndikuan fare në përbërjen gjenetike të Gegëve, prapëseprapë ata sollën disa ndryshime ekonomike që mund të kenë pasur ndikim në jetën e tyre. Ishin turqit që sollën bimët e Botës së Re në Ballkan, megjithëse në disa vende jo para vitit 1850. Ata shtuan misrin, fasulen e bardhë dhe duhanin në listën e bimëve që do të rriteshin në luginat dhe në shpatet malore. Misri dhe fasulet iu dhanë atyre ushqime të reja, por është e diskutueshme nëse ato ofrojnë më shumë kalori për hektar se kulturat e mëparshme, si drithërat e vogla dhe fasulet e mëdha. Duhani u dha malësorëve një zakon dhe një nevojë të re, si dhe një bimë me vlerë. Por kjo kishte edhe anën e vet negative: Me fenë e tyre ata imponuan ndalimin e përdorimit të mishit të derrit dhe i privuan katolikët e shndërruar në myslimanë nga një burim i rëndësishëm ushqimor.

Krahas këtyre ndryshimeve në bujqësi dhe në ushqim, turqit futën në përdorim hanet, ose bujtinat, përgjatë rrugëve më të shkelura në territorin mysliman. Disa nga këto hane ndoshta u ndërtuan mbi trojet e bujtinave romake. Profesionet e hanxhiut dhe qiraxhiut duket se kanë qenë risi turke. Në periudhën e turqve, shumë shqiptarë u zhvendosën në vende të tjerasi si në Rrafshin e Kosovës, me sa duket nga territori i Gegëve dhe shumë të tjerë në Greqi, ku ka ende rrethe shqipfolëse, në Atikë dhe në Peloponez. Mijëra të tjerë hynë në ushtrinë turke dhe

në shërbime të tjera qeveritare. Ndërkohë, dhjetëra mijëra shqiptarë të krishterë, që nuk e duruan dot zgjedhën turke, e kaluan detin dhe u vendosën në Itali dhe në Siçili, ku pasardhësit e tyre ende e ruajnë identitetin e tyre etnik.

Megjithatë, ndoshta prurja më e rëndësishme dhe e vetmja e turqve ishin armët e zjarrit. Armëpunuesit nëpër qytete i gjetën malësorët të etur për t'i blerë armët e reja, me të cilat ata mund të mbronin trojet e tyre nga pushtuesit dhe të shuanin inatet me banorët e tjerë vendas. Edhe argjendarët bënin shumë punë duke i shndërruar monedhat në stoli për pistoleta, kuti për duhan, rripa të zbukuruar, këllefe për armë dhe brirë të mbushur me barut. Pas ardhjes së armëve, mosmarrëveshjet u bënë shumë më të lehta për t'u zgjidhur, por edhe shumë më vdekjeprurëse. Pas armëve të zjarrit, mbërriti kulla, ose kalaja e gurtë. Edhe pse kjo lloj shtëpie e re ofronte një farë mbrojtjeje, kjo nuk i pengoi dot humbjet e mëdha të jetëve që shkaktonte përdorimi i armëve të zjarrit.

Tani që Gegët u ndanë në dy grupe fetare dhe ishin paisur edhe me armë, shkalla e vdekjeve u shtua. Vetë turqit, me veprimet e tyre, shkaktonin humbjen e një pjese të mirë të popullsisë. Ata i shkatërruan të gjitha qytetet e Shqipërisë së Veriut, nga Durrësi në Shkodër, si dhe qendrat e tjera nëpër male. Për shembull, ata i tërhoqën zvarrë dhe ua prenë kokat drejtuesve të qytetit të Drishtit në Postribë, që ishte selia e një peshkopate të hershme, në Shkodër.

Masakrat e ndërmarra nga pushtuesit dhe emigracioni e reduktuan popullsinë e disa zonave të Gegnisë deri në kufirin minimal, duke e bërë atë të barabartë me atë të Epokës së Hekurit të Hallstatt-it. Kjo situatë linte hapësira për ardhjen e imigrantëve të rinj. Këta vinin nga fise katolike të Bosnjë e Hercegovinës, të detyruar nga trysnia turke dhe veçanërisht nga luftimet midis turqve dhe sllavëve. Ata nuk ishin as turq as sllavë, por mbetje të popullsisë para - sllave, që ende flisnin një formë të latinizuar të Ilirishtes dhe me besim katolik. Nga ana gjuhësore dhe fetare, në Gegni ata e gjetën veten si në shtëpinë e tyre.

Shumica e tyre arritën gjatë shekullit të 16 - të. Në bajrakun e Grudës, Miss. Durham gjeti 500 shtëpi, nga të cilat 80 ishin të banuara nga popullsia vendase që e gjurmonin prejardhjen e tyre në Berishë të Pukës. 420 shtëpitë e tjera ishin të banuara nga njerëz që pretendonin se kishin prejardhje nga linja mashkullore e të zhvendosurve, të quajtur Djell, që kishin ardhur nga Hercegovina rreth vitit 1530 të erës së re. Disa vjet më vonë, të paktën katër vëllezër erdhën në zonën e Malësisë së Madhe nga Bosnja. Ata ishin Geg Lazi, paraardhësi i fisit të Piperit

në Mal të Zi, të cilët tani janë sllavizuar në gjuhë dhe janë konvertuar në fe ortodokse. Vaso Lazi, para-ardhësi i fisit të ngjashëm të Vasojeviçëve, Krasni Lazi, para-ardhësi i bajrakut të Krasniqit në Malësinë e Gjakovës - shumica e të cilëve tani janë myslimanë, por ka shumë që ende janë katolikë. Nika, para-ardhësi i Nikajve, mund të ketë qenë ose një vëlla i pestë ose një djalë i Krasni Lazit.

Malësorët e Shkrelit, të cilët përbëjnë një bajrak të tërë, thuhet se kanë ardhur nga Bosnja në masë të madhe rreth vitit 1600. Ata u vendosën në atë luginë, ku vendasit ishin zhdukur dhe ku Kisha e Shën Kerlit, (Shën Karlit, "Charlit", pra Shkrelit) ishte shkatërruar. Treqind nga 500 shtëpitë e Kastratit thuhet se janë pasardhës të një njeriu të quajtur Delti, i cili erdhi nga rajoni i Kuçit, në Mal të Zi, me shtatë djemtë e tij. Megjithatë, Delti dihej se ishte pasardhës i fisit të Berishës, fisi më i vjetër i njohur në Shqipëri. Katër bajrakët e Selcës, Vuklit, Bogës dhe Nikçit në Kelmend, e gjurmojnë prejardhjen e tyre nga katër bijtë e një njeriu të quajtur Klimenti (Kelmendi), i cili kishte ikur nga zona e Gucisë rreth vitit 1600 të erës sonë.

Nuk janë të gjithë banorët e Malësisë së Madhe që pretendojnë se kanë prejardhje nga këta malësorë të ardhur aty. Traditat e tyre janë aq të qëndrueshme dhe gjenealogjitë aq të qarta, sa nuk mund të dyshohet se këto pushtime ndodhën apo se popullatat e mëparshme mbijetuan. Në Grudë, 80 shtëpi i përkasin fisit Berisha, ndërsa në Hot një numër i vogël autoktonësh mbetën aty. Të ardhurit dhe vendasit u martuan me njëri tjetrin dhe pasardhësit e këtyre dy elementeve të popullsisë vazhdojnë të martohen rregullisht. Dyqind nga pesëqint shtëpitë e Kastratit ekzistojnë që para pushtimit osman. Reçi përfshin disa shtëpi autoktone. Pjesa tjetër e popullsisë, si Lloya, pretendojnë se janë pasardhës të familjeve të ardhura nga Shllaku dhe nga Pulti. Në përgjithësi, duket se Malësia e Madhe e ka mbajtur peshën kryesore të këtij pushtimi boshnjak dhe ka marrë prej tij një pjesë të madhe të përbërjes së saj gjenetike, (fig 12 c.).

Berisha është fisi më i vjetër i njohur në Gegni. ai fis është gjurmuar me siguri deri në vitin 1370, e ndoshta edhe më thellë, deri në vitin 1270... nëse është aq i hershëm, ky fis mund të ketë origjinë që nga periudha para-romake.

Në pjesë të tjera të Gegnisë, gjejmë më pak dëshmi të pushtimeve. Fisi i Berishës është gjurmuar me siguri deri në vitin 1370, e ndoshta edhe më thellë, deri në vitin 1270. Nëse është aq i hershëm, ky fis mund të ketë origjinë që nga periudha para-romake. Mërturi u nda nga Berisha rreth vitit 1700. Dy bajrakët e Dushmanit, Temali dhe Dushmani, janë të njohur që nga viti 1402, kur përmenden në dokumente të shkruara si aleatë të Venedikut. Ata janë ndoshta shumë më të vjetër. Banorët e Drishtit, para-ardhësit e të cilëve u shkatërruan nga turqit, erdhën nga vende të ndryshme. Banorët e Toplanës u dëbuan dhe erdhën në fortesën e tyre të tanishme malore nga Vasojeviçi i Malit të Zi, rreth vitit 1450, të shtyrë nga imigrantët nga Hercegovina. Para-ardhësit e Planit erdhën nga tre burime: Klementi, Mërturi dhe autoktonët vëndas. Banorët e Kirit erdhën nga Kuçi dhe Peja në Mal të Zi. Njëqind shtëpi të Nikajve thuhet se janë pasardhës të një vajze të Nikollës me një grua rome (magjupe) dhe quhen Tsura (Curra). Ky është rasti i vetëm i njohur i një prejardhjeje nga linja femërore dhe tregon statusin relativ social të bashkëshortëve të supozuar.

Vendosja e famshme e vëllezërve Dukagjini, Shosh, Shalë, Orosh, Spaç dhe Kushnen, ndoshta ndodhi para migracionit boshnjak. Miss. Durham i konsideron ata si të zbritur nga malet e Pashtrikut pranë Gjakovës, ku ishin pjesë e lidhjeve fisnore të Pejës. Udhërrëfyesit e mi e njohin bajrakun e Marinës si vendin e tyre të origjinës. Në Shalë, thuhet se ata gjetën disa njerëz të vegjël dhe të zeshkët, me të cilët u martuan. Disa nga këta *anas*[21] mbetën aty dhe thuhet se janë 8 shtëpi prej tyre në Abat, në Shalën e Poshtme, ndërsa pjesa tjetër u shpërngul në Deçan.

Kur vëllezërit mirditorë arritën në atë zonë, ata gjetën se dibranët dhe fshatarët e Fanit ishin vendosur aty përpara tyre. Një e dhënë tregon se bajrakët e Dukagjinit dhe të Mirditës nuk qëndruan gjatë në vendin e tyre të ri. Kur turqit e pushtuan Shkodrën dhe i filluan sulmet ndaj maleve rreth saj, të ardhurit u tërhoqën në vendin e tyre të lashtë, prej të cilit nuk u kthyen më deri aty rreth vitit 1650. Sa e vërtetë është kjo dhe sa njerëz ishin aty, nëse kishte, nuk mund të përcaktohet me saktësi.

Më në fund ne e dimë se qyteti i Gjakovës u banua prej njerëzve që vinin nga pjesë të ndryshme të maleve të Gegnisë. E njëjta gjë vlen edhe për Pejën.

21 *Anas* vjen nga *anë;* ka kuptimin që është i asaj ane dhe nuk është i ardhur; domethënë vendas. (Shënim i redaktorit)

Këto ishin qytete strehuese, si qytetet e mëparshme. Më i ri se cilido prej tyre është fshati Vrakë, një bashkësi që përbëhet prej një mijë banorësh dhe që shtrihet midis Koplikut dhe Shkodrës. Kjo është qendra e banimit e bujqëve ortodoksë serbisht - folës, para - ardhësit e të cilëve ikën nga gjakmarrja në pjesë të ndryshme të Malit të Zi, Hercegovinës dhe Bosnjës. Ata ende nuk janë asimiluar dhe me politikën e sotme që ndiqet ndaj tyre, ndoshta një ditë kjo do të ndodhë. Ky rast i shërben qëllimit tonë për të ilustruar një parim të lëvizjes së popullsisë së një shoqërie në gjendje konflikti të pandërprerë.

Këtu përfundon historia e studimit tonë deri në datën përfundimtare të së "*Tashmes Etnografike*", siç përcaktohet në kapitullin e I - rë, të "*Problemit Dinarik*."

Sundimi turk zgjati në Shqipëri deri në vitin 1912. Pas Luftërave Ballkanike, u krijua një mbretëri e tipit opera bouffe[22] me mbret Princin e Wied-it, me kryeqytet në Durrës. Gjatë mbretërimit të tij të pa suksesshëm, një komision ndërkombëtar kufitar përcaktoi kufijtë e shtetit të ri dhe në çdo pikë ku kishte ndonjë dyshim, Shqipëria dilte e humbur. Gruda iu dha Malit të Zi, dhe banorët e asaj ane që i mbijetuan këtij ndryshimi politik u zhvendosën në Shkodër. Hoti humbi një pjesë të tokës, veçanërisht kullotën dimërore.

Banorëve të fisit të Kelmendit iu ndanë tokat aq keq, sa që ata nuk mund të çonin më tufat e bagëtive në kullotat e tyre dimërore në rrethinat e Shkodrës, pa kaluar në territorin malazez. Kjo do të ishte e barabartë me humbjen e kafshëve dhe rrezikimin e jetës së tyre. Serbët e mbyllën kufirin për malësorët që sillnin mallrat e tyre në Gjakovë për tregti dhe dëbuan shumë shqiptarë nga ky qytet, si dhe nga Peja. Ata e bënë pothuajse të pamundur udhëtimin mes Kukësit dhe Prizrenit.

Në vitin 1929, grupi ynë u mbajt një ditë të tërë në kufi teksa na kontrolluan deri nën lëkurë. Ata na urdhëruan të lexonim me zë të gjitha gazetat tona, dhe na akuzuan se ishim renegatë kroatë, etj. Më në fund, u larguam vetëm pas një telefonate dhe shumë lutjesh dhe përgjërimesh, me pretendimin se njëri prej nesh ishte i sëmurë aq rëndë sa i rrezikohej jeta.

Në Prizren, e gjetëm burgun plot e përplot me shqiptarë. Edhe Dibra ishte shkëputur dhe nuk ishte më qyteti i tregtisë për shqiptarët e Shqipërisë. Kukësi u ngrit si një qytet i improvizuar, ashtu siç u bë edhe me Peshkopinë. Tregtarët dhe

22 "Opera Bouffe" përdoret për të përshkruar mënyrën e krijimit të një mbretërie të re që ishte e ndikuar shumë nga situata politike, dhe që në fakt ishte një përpjekje për të krijuar një qeverisje që rezultoj të ishte jo serioze dhe e pa qëndrueshme. (Shënim i përkthyesit)

artizanët, siç i kemi parë edhe ne, e kanë kaluar kufirin nga Gjakova, Prizreni dhe Dibra dhe kanë hapur dyqane në vende të tjera brenda Shqipërisë.

Çfarëdo që të kishte bërë Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve, i ngritur pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, kurrë nuk do të kishte mundur të nxiste më shumë urrejtje tek shqiptarët ndaj ndërkombëtarëve sesa ajo që kishte bërë, aq sa dukej sikur ky të kishte qenë vetë qëllimi i tyre kryesor. Lufta e Parë Botërore pasoi menjëherë pas këtyre vendimeve krejtësisht të palogjikshme dhe Mbretëria u bë pluhur e hi. Një ushtri serbe, e cila po ikte me nxitim për të shpëtuar kokën e vet, marshoi përmes Dibrës dhe Matit, duke djegur dhe plaçkitur çdo gjë që iu dilte përpara deri sa gjeti strehim në Korfuz. Në anën tjetër, trupat austriake e pushtuan Shkodrën dhe Malësinë e Madhe, si dhe rajonin e Kukësit. Ata ndërtuan disa rrugë dhe ura dhe madje gjetën kohë për të kryer edhe antropometri.[23]

Pas luftës, Shqipëria u bë Republikë Parlamentare. Në një gjendje feudale dhe fisnore, me analfabetizëm të lartë dhe mundësi të kufizuara lëvizjeje për shkak të mungesës së rrugëve, populli nuk ishte i përgatitur për një vetëqeverisje të tillë. Pas një numri episodesh të dhunshme, Ahmet Zogu, djali i bajraktarit të Matit, mori pushtetin dhe në vitin 1929 e shpalli veten Mbret. Shumica e shqiptarëve e panë sundimin e tij si një kërcënim për liritë e tyre.

Megjithatë, ai bëri disa lëvizje të zgjuara. Njëra prej tyre ishte punësimi i kolonelit Stirling si këshilltar personal, i njohur si shoqërues i Lawrence-it të Arabisë.[24] Një tjetër veprim ishte angazhimi i gjeneralit von Mirdach nga ushtria austriake i cili do të organizonte ushtrinë shqiptare. Një risi e tretë ishte dhënia e dorës së lirë Gjeneralit Britanik Percy[25] për organizimin e xhandarmërisë. Gjenerali Percy solli me vete një grup oficerësh britanikë, ku përfshiheshin

23 Antropometria është studimi i matjeve të trupit të njeriut për të analizuar dhe kuptuar ndryshimet dhe variacionet në dimensionet fizike të trupit. Kjo fushë e shkencës përfshin matjen e veçorive si përmasat e trupit, peshën, lartësinë, përqindjen e yndyrës trupore dhe përmasat e ndryshme të trupit, si p.sh. perimetri i krahëve dhe gjatësia e këmbëve. Antropometria përdoret në fusha të ndryshme, përfshirë: Antropologji, Mjekësi, Ergonomi, Sport: Në përmbledhje, antropometria është një fushë e rëndësishme që ndihmon në kuptimin e ndryshimeve trupore dhe në aplikimin e këtyre njohurive në praktika të ndryshme shkencore dhe praktike. (Shënim i përkthyesit)

24 Lawrence i Arabisë, emri i vërtetë i të cilit ishte Thomas Edward Lawrence, ishte një arkeolog britanik, oficer ushtarak, diplomat dhe shkrimtar. Ai u bë i famshëm për rolin e tij gjatë Luftës së Parë Botërore, kur udhëhoqi Kryengritjen Arabe (1916-1918) kundër Perandorisë Osmane. Jeta dhe veprimet e tij u bënë të njohura më gjerësisht përmes filmit të vitit 1962, *Lawrence of Arabia*. (Shënim i përkthyesit)

25 Gjenerali britanik Sir Jocelyn Percy, shërbeu në Shqipëri gjatë periudhës së mbretërimit të Mbretit Zog. Ai ishte një figurë e rëndësishme ushtarake dhe diplomatike britanike, i cili kishte një ndikim të caktuar në trajtimin e çështjeve ushtarake dhe të sigurisë në Shqipëri. Ai kishte marrëdhënie të ngushta me Mbretin Zog, i cili kërkonte të konsolidonte pushtetin dhe të siguronte stabilitetin e vendit përballë sfidave të brendshme dhe të jashtme. (Shënim i përkthyesit)

koloneli Martin dhe majori Clegg. Këta burra me përvojë zgjodhën një grup elitar malësorësh për të patrulluar rrugët kryesore dhe për të raportuar e shuar konfliktet e përditshme. Ishte hera e parë në historinë e këtij vendi që dikush po ndërmerrte hapa të zgjuar për të çliruar malet nga zakoni i keq i gjakmarrjes.



Njësi e xhandarëve në Shqipërinë Veriore, në një sfond mali me borë (Foto: Carleton S. Coon 1929).

Ne i matëm 62 prej këtyre xhandarëve, vendas. Prej tyre, 21 ishin nga Luma, 17 nga Mati, 10 nga Puka, 6 nga Malësia e Gjakovës, 4 nga Dibra, 3 nga Dukagjini dhe 1 nga Malësia e Madhe. Oficerët britanikë i përdorën me zgjuarsi Gegët në shërbim të vendit të tyre. Shumë prej këtyre xhandarëve shërbenin brenda fiseve dhe bajrakëve të tyre, dhe shpesh ndodhte që ata vetë ishin në gjak diku tjetër. Nëse do t'i kishin sjellë nga zona të tjera, atëherë kjo do të kishte krijuar probleme. Ky profesion i ri u dha malësorëve mundësinë të shihnin më shumë nga bota sesa më parë, pasi kërkohej që të trajnoheshin në Tiranë ose në Shkodër.

Sistemi i xhandarmërisë nuk ndikoi drejtpërdrejt në gjenetikën e malësorëve, sepse këta burra martoheshin siç martoheshin edhe para-ardhësit e tyre. Ky sistem i ri i xhandarmërisë dhe siguria që ai solli në rrugët e vendit i mundësoi tregtarëve, zejtarëve dhe zyrtarëve të rinj qeveritarë të ndryshonin jetën e tyre. Arësyeja është se xhandarët u ofruan atyre siguri në rrugë dhe luftuan kundër banditëve.

Raporti mes gjerësisë së ballit dhe gjerësisë së fytyrës (zygo-frontal) është i lartë në të gjitha seritë Dinarike, duke përfshirë edhe Gegët. Kjo reflekton gjerësinë e pazakontë të ballit. Zygomatiku[9](zygogonial) është edhe më i lartë, për të njëjtën arësye, bashkë me faktin që diametri bigonial është relativisht më i vogël se ai bizygomatic. Indeksi facial i serisë së tanishme e tejkalon kufirin mes kategorive mesoprosopike[10] dhe leptoprosopike.[11] Edhe pse fytyrat e Gegëve janë të mëdha, raportet e gjatësisë së këtij lloji janë jo aq ekstreme. Por kjo nuk

7 Në gjuhën antropologjike, fjala bigonial i referohet matjes së distancës midis dy pikave më të largëta të nofullës së poshtme (gonionet), që janë qoshet e jashtme të kockës së nofullës. Kjo distancë quhet gjerësia bigoniale dhe përdoret për të përshkruar gjerësinë e fytyrës në pjesën e nofullës së poshtme. Kjo matje është pjesë e antropometrisë dhe përdoret për të analizuar variacionet në strukturën kraniofaciale të popullatave të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

8 Indeksi nazal "leptorrhine" i referohet një tipi të formës së hundës, veçanërisht një hundë e gjatë dhe e ngushtë. Në kontekstin antropologjik dhe kraniometrik, leptorrhine përshkruan një hundë me një indeks nazal të ulët, që nënkupton një raport të ngushtë midis gjerësisë dhe gjatësisë së hundës. Indeksi nazal llogaritet duke ndarë gjerësinë maksimale të hundës me gjatësinë maksimale të saj dhe pastaj duke shumëzuar rezultatin me 100. Njerëzit me hundë leptorrhine kanë një indeks nazal më pak se 47.0, që tregon se hunda është më e gjatë se e gjerë. Ky tipar është i zakonshëm në disa popullata dhe mund të përdoret për të bërë studime krahasuese antropologjike. (Shënim i përkthyesit)

9 Zygomatiku në gjuhën antropologjike i referohet kockës zygomatike, e njohur ndryshe si kocka e faqeve ose molla e faqeve. Ajo është një nga kockat e fytyrës që formon pjesën anësore dhe përparme të kafkës, duke krijuar një hark midis pjesës së sipërme të nofullës (maxilla) dhe pjesës temporale të kafkës. (Shënim i përkthyesit)

10 Indeksi facial Mesoprosopike është një term antropologjik që përshkruan një formë të mesme të fytyrës, bazuar në indeksin fytyror. Indeksi fytyror llogaritet duke matur raportin midis gjatësisë dhe gjerësisë së fytyrës dhe kategorizon fytyrën në forma të ndryshme. Indeksi fytyror llogaritet duke matur lartësinë vertikale të fytyrës dhe duke e ndarë atë me gjerësinë bizigomatike (gjerësia e fytyrës midis kockave të faqeve). Ky raport shumëzohet me 100 për të marrë një përqindje. Një fytyrë mesoprosopike ka një indeks fytyror midis 85 dhe 89.9, që nënkupton një fytyrë as shumë të gjatë, as shumë të gjerë, pra me përmasa mesatare. Ky term përdoret për të krahasuar forma të ndryshme të fytyrës në studimet antropometrike dhe për të kuptuar variacionet fizike midis popullatave.

11 Indeksi facial leptoprosopike është një term antropologjik që përshkruan një formë të gjatë dhe të ngushtë të fytyrës, bazuar në indeksin fytyror. Kjo fjalë vjen nga greqishtja, ku "lepto-" nënkupton "i hollë" dhe "-prosopos" do të thotë "fytyrë." Një fytyrë leptoprosopike ka një indeks fytyror më të lartë se 90, që tregon se fytyra është më e gjatë në krahasim me gjerësinë e saj. Ky term përdoret shpesh në studimet antropometrike dhe antropologjike për të përshkruar variacionet në strukturën e fytyrës mes popullatave të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

qëndron për hundën. Kjo pasi hunda e tyre sipas matjeve tona rezulton se ka një nga indekset më të ulëta, duke e klasifikuar atë në kategorinë hiperleptorrhine.[12]

Kapakët e mëdhenj të syve të tyre bëjnë që ky ndryshim të bie më shumë në sy. Ne pamë se thuajse një nga pesë persona që matëm ka pak pjerrësi të syrit, fenomen që shfaqet në njërën nga racat e Mesdheut dhe të Lindjes së Afërt. Janë tridhjetë e tetë raste që e përforcojnë këtë fakt. Matja e 1.067 burrave na dha përshtypjen se ata kanë kryesisht një ballë me lartësi mesatare dhe pak më të gjerë se mesatarja, dhe me një pjerrësi pak më të madhe se mesatarja. Gropat e syve[13] janë mesatarisht të mëdha, dhe glabella[14] është zakonisht e dalur. Palosjet e syve zakonisht mungojnë, por kur ato ndodhin janë pothuajse gjithmonë të jashtme. E ashtuquajtura palosje 'nordike' është e zakonëshme për të gjithë evropianët me fytyrë të ngushtë. Mungesa pothuajse e plotë e palosjeve mesatare dhe të brendshme i dallon këta njerëz ndjeshëm nga popullsitë mongoloide dhe balltike, lindore të Evropës verilindore.

Gjerësia e hapjes së kapakëve të syve e thekson më tej këtë ndryshim. Pothuajse një në pesë individë ka pak pjerrësi të syve, gjë që ngjan me disa raca të Mesdheut dhe Lindjes së Afërt. Fytyra vetë, si karakteristikë, vjen e dobët. Mollëzat nuk mbushen aq shumë dhe shtrirja anësore është mesatare. Faqet janë mesatarisht të holla dhe zakonisht të rrudhura me vija të thella rreth gojës. Këndet goniale[15] janë normale krahasuar me standartet Evropiane Perëndimore. Pamja e dobët e fytyrës e tkurrur dhe e rrahur nga moti i bën këta njerëz të ngjashëm me skocezët, norvegjezët, norsmanët - skandinavë dhe baskët.

---

12 Kategoria hiperleptorrhine i referohet një klasifikimi në antropologji dhe mjekësi që përshkruan një formë specifike të hundës që është shumë e ngushtë dhe e gjatë në krahasim me gjatësinë e fytyrës. Ky term është pjesë e një sistemi klasifikimi për formën e hundës bazuar në raportin midis gjerësisë dhe gjatësisë së saj, i quajtur indeksi nazal. Indeksi nazal është raporti midis gjerësisë së hundës (matet në pjesën më të gjerë të saj) dhe gjatësisë (matet nga baza deri në majë). Ky raport shumëzohet me 100 për të marrë një përqindje. Njerëzit me hundë hiperleptorrhine kanë një indeks nazal më të ulët se 40, që tregon një formë shumë të ngushtë dhe të gjatë të hundës. Ky klasifikim përdoret zakonisht në studimet antropometrike për të krahasuar karakteristikat fizike të popullatave të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

13 Gropa e syve (browridges) i referohet kockave të theksuara që ndodhen mbi sytë, konkretisht mbi boshllëqet e syve (orbitat). Këto kocka janë pjesë e kockës frontale të kafkës dhe njihet edhe si kockat super orbital. (Shënim i përkthyesit)

14 Glabella është një term anatomik që i referohet zonës të kockës frontale të kafkës që ndodhet midis syve, mbi hundë dhe në mes të eyebrow-ëve (harqet e syve). Ajo është zona e sheshtë dhe ndonjëherë e theksuar që ndodhet para kockave supraorbital dhe nën pjesën e pasme të ballit. (Shënim i përkthyesit)

15 Këndet goniale në antropologji i referohen këndeve të formuara në pjesën e poshtme të nofullës së njeriut, ku degët e nofullës (ramus mandibulae) lidhen me trupin e saj kryesor (corpus mandibulae). Këndi gonial, që ndryshe quhet kënd mandibular, është pika ku nofulla e poshtme ndryshon drejtimin dhe kocka formon një kënd të dukshëm në pjesën anësore të fytyrës, poshtë veshëve. (Shënim i përkthyesit)

Pesë vëzhgimet që iu bëmë veshëve nuk na treguan asgjë të ndryshme nga ato të evropianëve. Buzët janë pak mbi mesataren në trashësinë e tyre muskulore dhe kanë membranë jashtëzakonisht të hollë, gjë që reflekton ndoshta zakonet e përtypjes dhe të të ngrënit po aq sa edhe të racës. Ato janë gjithashtu më pak të lakuara sesa ato të evropianëve të bardhë, tashmë të njohur për këtë. Buzët e Gegëve ngjajnë më shumë me ato të portreteve familjare të periudhës revolucionare sesa me ato të amerikanëve modernë.

Dalja më shumë ose më pak në pah e mjekrës vihet re në pjerrësinë e saj më shumë sesa në ndonjë ngjashmëri të përgjithshme nga një individ në tjetrin. Prania e 23 përqind të *sm*-së (variabilitetit) të mjekrave të tyre nuk është më e madhe se e popullatave të tjera evropiane që kanë nofulla të ngushta. Shumica e mjekrave të tyre janë mesatare dhe kanë forma të balancuara që i shkojnë tipareve alpine si dhe tipareve të tjera para - mesdhetare në Evropë dhe individëve me një fuqi të pazakontë. Tipari më dallues i fytyrës së Malësorit Gegë është hunda.

Hunda e tij pothuajse asnjëherë nuk zbret nga mesi i vetullave pa krijuar një hark. Kjo formë i ngjan modelit ideal grek. Edhe pse zakonisht nuk është shumë e lartë, rrënja e saj është shumë e ngushtë. Ura e hundës është shpesh edhe e lartë edhe e ngushtë. Ky kombinim krijon shpesh profile të një hunde me formë konvekse. Kjo i jep Malësorit Gegë pamjen tradicionale të një skifteri.

Maja e hundës është përgjithësisht e hollë, më shpesh e drejtë ose e ngritur sesa e shtypur, me flegra mesatare deri në të ngjitura dhe zakonisht me një septum të drejtë. Kjo hundë, ashtu si segmenti i përparmë i një fytyre të dobësuar, trekëndore i jep atij pamjen e një Dinariku Klasik me një fytyrë ekspresive dhe mbresëlënëse.

III. Koka

Deri tani kemi realizuar vetëm disa matje dhe vëzhgime për të dalluar Malësorin e zakonshëm Gegë nga barinjtë e Malësive të Skocisë, baskëve dhe norvegjezëve të zonave të brendshme me të cilët e kemi krahasuar në fillim. Por kur ia heqim plisin dhe ia vëzhgojmë me kujdes kokën, shohim që ngjashmëria nuk është më e pranishme. Koka e tij është 10 milimetra më e shkurtër se ato të individëve të ngjashëm që gjenden buzë bregut të Atlantikut, duke krijuar kështu një ngjashmëri më të madhe me popujt e Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe me banorët e Armenisë, Anadollit, disa pjesëve të Kaukazit dhe Libanit. Në të njejtën kohë, koka e tij është shumë më e gjerë dhe në fakt, është ndër kokat më të gjera në Evropë.

Është e vështirë të përcaktohet pozicioni i saktë i saj në lidhje me lartësinë, pasi lartësia e kokës ndikohet dukshëm nga harmonia e masave trupore të çdo individi. Duke gjykuar vetëm nga ato seri për të cilat jam i sigurt, unë i konsideroj kokat e Gegëve diçka më të larta se mesatarja. Megjithatë, ata nuk arrijnë ekstremet as në gjatësi dhe as në gjerësi. Në indekset e kokës, këta njerëz janë plotësisht brakicefalikë, megjithëse më pak ekstremë në këtë drejtim sesa disa nga bashkëatdhetarët e tyre Toskë dhe disa fqinjë jugosllavë malësorë, mes të cilëve janë regjistruar tregues mesatarë 87 dhe 88. Në indeksin e gjatësisë së kokës, ato renditen si hipsicefalike,[16] ndërsa në indeksin gjerësisë zënë një pozicion të ulët. Kjo thjesht pasqyron disi lartësinë e kokës në krahasim me një gjerësi ekstreme të kafkës.

Indekset që shërbejnë për të krahasuar gjerësinë parietale me diametrat e fytyrës fronto-parietale[17] dhe cefalo-faciale,[18] të dyja theksojnë disproporcionin midis fytyrës që është shumë e gjerë në raport me pjesën e pasme të kokës që është mesatare. Indekset fronto-parietale dhe cefalo-faciale, që lidhin gjerësinë e ballit dhe fytyrës me segmentin e pasmë të kokës, janë të ulëta, por jo krejt të pazakonta. Kjo sepse balli dhe harqet zigomatike janë gjithashtu pak më të gjera sesa do të ishte normale për një fytyrë të hollë. Ne kemi parë tashmë se balli ka tendencë të jetë pak më i drejtë, ose më pak i pjerrët, sesa te shumica e popujve evropianë jo-dinarikë me pamje skifteri. Ky ballë i plotë përputhet me një kohë të gjatë që është normale në ato anë dhe për rrjedhojë është zhvilluar deri në atë trajtë.

Megjithatë, në pjesën e pasme, kafka tregon një tendencë më të vogël të zgjatjes okcipitale se normalja, dhe tek 31 për qind e individëve zverku është në të vërtetë i rrafshuar. Një raport edhe më i madh, 44 për qind, shfaq sheshtësim

16 Fjala hipsicefalike (nga greqishtja "hypsi" që do të thotë "i lartë" dhe "kephale" që do të thotë "kokë") i referohet një formë të kokës që ka një indeks vertikal të lartë, domethënë një kokë relativisht të gjatë ose të lartë nga lart-poshtë. Kjo karakteristikë matet përmes indeksit vertikal kranial, që përfaqëson raportin midis lartësisë së kafkës dhe gjatësisë së saj totale. Njerëzit me një formë hipsicefalike kanë një kafkë më të ngritur në krahasim me gjatësinë e saj. (Shënim i përkthyesit)

17 Fytyra fronto-parietale i referohet zonës së kafkës që përfshin kockat frontale (ballore) dhe parietale (anësore) të kafkës. Në antropologji dhe anatominë e kokës, kjo zonë është e rëndësishme për studimin e formës dhe përmasave të kafkës, si dhe për të analizuar variacionet midis grupeve të ndryshme njerëzore. (Shënim i përkthyesit)

18 Termi cefalo-faciale në antropologji i referohet matjeve dhe studimeve që lidhen me kokën (cefalon) dhe fytyrën (faciale). Në kontekstin antropometrik, matjet cefalo-faciale përdoren për të studiuar përmasat dhe formën e kokës dhe fytyrës, të cilat janë të rëndësishme për të analizuar variacionet etnike, gjenetike dhe evolucionare midis popullatave të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

në rajonin lambdoid[19] dhe në 29 për qind të rasteve gjejmë anomalinë e njohur si batrocefalia[20], e cila është një pamundësi e kockave parietale për t'u bashkuar pa probleme me zverkun në lambda,[21] me një rrafshim ose zbritje në pikën kritike. Pjesa e pasme e kokës është padyshim pjesa më e pazakontë dhe për këtë arësye më interesante e anatomisë së Malësorëve Gegë. E njëjta gjë është e vërtetë, natyrisht, edhe për Dinarikët[22] dhe Armenoidët[23] nga vende të tjera. Një fakt tjetër shumë sugjestiv është se 36 për qind e subjekteve tona (shumica e të cilëve, siç do të shohim më vonë, kanë disa lloje rrafshesh), pra kanë koka të dukshme me forma jo simetrike. Megjithatë, në pjesën e pasme, kafka ka një tendencë për një shkallë më të ulët të zgjatjes okupitale[24] dhe në 31 për qind të individëve, zverku është në të vërtetë i rrafshuar.

Po të ishte kjo asimetri një variant normal apo gjendje e zakonëshme, atëherë do të kishim më shumë individë në kategoritë më të vogla sesa në ato më të mëdha, por kjo nuk duket të jetë kështu. Asimetria në vetvete duket të ketë një shpërndarje normale, krejtësisht të përjashtuara nga kategoria e atyre që mungojnë. Për më tepër, është 2.4 herë më e shpeshtë në anën e djathtë sesa në atë të majtë, çka sugjeron një lidhje funksionale. Asimetria e fytyrës, nga ana tjetër, është shumë e rrallë, duke përbërë vetëm 6 për qind të rasteve dhe pa dallime të rëndësishme midis anës së djathtë dhe asaj të majtë.

---

19 Indeksi Lambdoid është një matje antropometrike që përdoret në studimin e kafkave të njeriut. Ai lidhet në mënyrë specifike me përqindjen e gjerësisë së kafkës në suturën lambdoide në raport me gjerësinë maksimale të kafkës. Sutura lambdoide ndodhet në pjesën e pasme të kafkës, ku bashkohen kockat parietale me kockën oksipitale. (Shënim i përkthyesit)

20 Batrocefalia në studimet antropologjike i referohet një tipari specifik të formës së kokës, ku kafka është e sheshtë dhe e zgjeruar në pjesën e sipërme, duke i dhënë kokës një pamje të gjerë dhe të rrumbullakosur. Termi vjen nga fjalët greke "batrachos" (bretkocë) dhe "kephale" (kokë), që sugjeron një formë që ngjan me kokën e bretkosës. (Shënim i përkthyesit)

21 "Lambda" i referohet një pike të rëndësishme anatomike në kafkën e njeriut. Ajo është vendi ku bashkohen qepjet (suturat) sagittale dhe lambdoide të kafkës. Këto qepje janë lidhje midis kockave të kafkës që gradualisht ngurtësohen gjatë zhvillimit dhe rritjes së individit. (Shënim i përkthyesit)

22 Dinarikët i referohen një grupi morfologjik ose tiparit racor të identifikuar në studimet e hershme të antropologjisë fizike. Ky term u përdor për të përshkruar individët me tipare të veçanta fizike që ishin të zakonshme në rajonin e Dinarikut, një zonë malore që përfshin pjesë të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnjën, Kroacinë dhe Malin e Zi. (Shënim i përkthyesit)

23 Armenoidët janë një tip morfologjik antropologjik që i referohet një nënndarjeje të klasifikimeve racore historike, përdorur kryesisht në antropologjinë fizike të shekujve të 19-të dhe të hershëm të 20-të. Ky term është përdorur për të përshkruar njerëz me një grup të veçantë tiparesh fizike që janë të zakonshme në disa rajone të Azisë Perëndimore, përfshirë Armeninë, Kaukazin, dhe Lindjen e Mesme. (Shënim i përkthyesit)

24 Në kuptimin antropologjik fjala "okupital" i referohet asaj që është në lidhje me kockën okupitale, e cila është kocka që ndodhet në pjesën e pasme të kafkës, mbi qafën e njeriut. Kjo kockë është një pjesë e rëndësishme e strukturës së kafkës dhe luan një rol të rëndësishëm në formimin e profilit të kafkës dhe në përcaktimin e karakteristikave morfologjike të individëve. (Shënim i përkthyesit)

A ishin të majtë apo të djathtë burrat që u vunë në provë, u gjet kur iu kërkua atyre të merrnin një gur dhe ta gjuanin, herë me njërën dorë e herë me tjetrën, herë me të djathtën e herë me të majtën. E njëjta gjë u bë edhe me shtizat apo shkopinjtë. Shumica e të testuarve as që kishin ndonjë ide rreth kësaj pune, kështu që zgjedhja e tyre, se cilën dorë do të përdornin, qoftë edhe për të ngrënë, diktohej nga shprehija e përditëshme që ata kishin krijuar që në fëmijëri.

Shkalla prej 7.6 për qind e mëngjarashëve dhe e përdoruesve të dy duarve, është padyshim shumë e ulët. Ky numër i kushtëzuar ndoshta ka ndikuar edhe në kapjen, hedhjen dhe pritjen e gjërave në një masë të caktuar. Përqindja e treguar nga asimetria e kafkës është gjithmonë më e afërt me të vërtetën gjenetike.

IV. Sistemi Piloz[25]

Vetullat e Malësorëve Gegë janë afër normës evropiane, nëse mund të merret si i mirëqenë një pozicion i tillë. Ndoshta ato janë pak më të trasha dhe më të bashkuara me njëra tjetrën sesa ato të shumicës së popullsive veriore dhe perëndimore, por edhe nëse janë kështu, ndryshimi është i vogël. Trembëdhjetë vëzhgime të tjera tregojnë se raca dinarike, siç paraqitet te këta Gegë të Malësisë, është po aq normale sipas standardeve evropiane. Në çdo rast nuk ishte e lehtë të përcaktohej forma e flokëve. Disa burra mbanin plisa në kokë. Të tjerë i linin flokët e pasme të rriteshin, ndërsa disa të tjerë e rruanin kokën fare. Nëse disa e kishin rruar kokën kohët e fundit dhe iu mungonin mustaqet, vlerësimi im për ta ishte përkatësisht më pak i saktë. Rënia e flokëve është e rrallë, veçanërisht po të marrim parasyshë moshën e kampioneve (për të cilin do të flasim më vonë). Trashësia e qimeve të kokës (në rastin e meshkujve tullacë, e cila vërehet në pjesën e kokës që ende ka qime) është afërsisht mesatare, ndërsa qimet e fytyrës, duke përfshirë mustaqet, faqet dhe nofullën, janë ndoshta pak më të trasha se tek evropianët veriorë dhe lindorë, por nuk janë të njejta me zhvillimin e popullsisë alpine të Bavarisë dhe pjesë të tëra të Francës. Për fat të mirë, shumica e burrave mbanin mustaqe të gjata, ndërsa mjekrën e rruanin rrallë. Pavarësisht nga mosha, këta malësorë duket se kanë më pak qime në gjymtyrë dhe në gjoks, po të krahasohet kjo me mjekrën e tyre. Kjo na kujton një zhvillim normal nordik dhe mesdhetar më shumë

25 Piloz- (piloziteti) i referohet pranisë së qimeve ose mbulesës me qime në trupin e një individi, zakonisht në kontekstin e shkallës së qimeve në lëkurë. Ky term përdoret shpesh në fushat e mjekësisë, biologjisë ose dermatologjisë për të përshkruar tiparet e qimeve të trupit të njerëzve apo kafshëve. (Shënim i përkthyesit)

sesa alpin. Numri i burrave me flokë ose me mjekër krejtësisht të bardhë ishte i papërfillshëm. Thinjat në kokë ishin më të përhapura se ato në mustaqe dhe mjekër. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve mund të dallohej lehtë ngjyra e qimeve që ende ishin të pigmentuara.

V. Pigmentimi[26]

Ngjyra e lëkurës u vrojtua në sipërfaqet që mendohet se janë të paekspozuara, si pjesa poshtë krahëve dhe gjoksi. Shumica dërrmuese e tyre e kishin lëkurën pothuajse të njëjtë me ne - pra një lëkurë e bardhë, rozë, e përafërt me tonin Luschan #7.[27] Të tjerët kishin lëkura të bardha në të hirtë dhe në asnjë rast lëkurat e tyre nuk ishin më të errëta sesa prisnim ne të gjenim te grekët apo italianët. Pothuajse të gjithë kishin skuqjen vaskulare rozë ose të kuqe që shfaqet në lëkurën e hollë të njerëzve që jetojnë në natyrë. Duke marrë parasysh se matja bëhej në fund të dimrit, ose jashtë dyerve të shtëpive apo edhe brenda në shtëpi, por në kushte të ftohta dhe duke pasur parasysh që shumë prej burrave ishin të veshur për dimër, paraqitja e lëkurës së tyre nuk na befasonte.

Pothuajse një në nëntë burra kishte flokë që mund të quheshin bionde ose të kuqe. Në anën tjetër, pak më shumë se gjysma e tyre kishin flokë ngjyrë kafe, ndërsa të tjerët kishin flokë të zinj. Ngjyra kafe e errët përfshinte shumë prej atyre që mund të etiketoheshin më mirë si ngjyra kafe, por që nuk ishin të kualifikuar më tej. Mustaqet ishin shumë më të holla dhe ngjyra kafe më e errët dhe e kuqe përbënin rregullin e përgjithshëm. Ndërsa ngjyra kafe e hapur, flokët bionde dhe të bardha, si dhe ngjyrat e kuqe, përbëjnë gati një të tretën e të gjithë atyre që ne matëm. Vetëm një e gjashta e kampioneve kishte pigment të errët të irisit të pastër, ndërsa numri i nuancave të pastra blu dhe gri ishte vetëm tek gjysma e tyre. Një shumicë prej tre të katërtave kishte sy me ngjyra të përziera, dhe nga

26 Në kuptimin antropologjik, pigmentimi i referohet ngjyrës së lëkurës, flokëve dhe syve të njerëzve, e cila përcaktohet kryesisht nga sasia dhe lloji i melaninës, një pigment biologjik. Pigmentimi është një nga karakteristikat fizike që ka evoluar për t'iu përshtatur kushteve mjedisore, si ekspozimi ndaj rrezatimit ultravjollcë (UV) nga dielli. Në antropologji, studimi i pigmentimit është i rëndësishëm për të kuptuar diversitetin njerëzor dhe evoluimin e popullatave të ndryshme. Ngjyra e lëkurës, për shembull, ka evoluar si një adaptim ndaj niveleve të ndryshme të rrezatimit diellor në rajone të ndryshme të botës. Një lëkurë më e errët ofron mbrojtje më të madhe kundër dëmtimit nga rrezet UV, ndërsa një lëkurë më e çelur është më efikase në sintezën e vitaminës D në zona me më pak diell. Pigmentimi është gjithashtu studiuar në kontekstin e kulturave dhe perceptimeve sociale, duke pasur ndikim në identitetin dhe dinamikën sociale të individëve dhe grupeve në shoqëri të ndryshme. (Shnim i përkthyesit)

27 Toni i lëkurës Luschan #7 i referohet njërës nga nuancat e sistemit të klasifikimit të nuancave të lëkurës, të njohur si "Skala e Luschan". Ky sistem është krijuar nga antropologu austriak Felix von Luschan në fund të shekullit të 19-të dhe ka për qëllim të klasifikojë ngjyrat e lëkurës njerëzore në një gamë të caktuar. (Shënim i përkthyesit)

këto, përzjerjet e lehta ishin më të shpeshta. Shpërndarja e tipareve të syve me ngjyra të përziera pasqyrohet në raportet e irideve të rrezatuara, të zonuara dhe të kondensuara.

Në karakteristikat e tyre të pigmentit/ngjyruesit, Gegët e Maleve ndodhen diku në mes të ngjyrave të hapura bionde dhe atyre të errëta, brune, siç përcaktohet nga diapazoni evropian. Ato shkojnë më shumë drejt lëkurave të hapura, flokëve të errëta në kokë dhe mustaqeve të ndërmjetme deri në të lehta, me shumë ngjyra të kuqe dhe ngjyra të lehta e të përziera të syve. Në pigmentim, ata nuk janë shumë të ndryshëm nga Malësorët e Skocisë, Baskët dhe Malësorët e Kentakit - por janë dukshëm më të errët se norvegjezët. Ata janë më të drejtë se italianët nga pjesë të ndryshme të Italisë dhe më të drejtë se Toskët, grekët, bullgarët dhe serbët, ndërkohë që ndoshta kanë pak ndryshime nga malazezët, boshnjakët dhe tirolezët.

Pra, fenotipi, apo karakteristikat trupore të Malësorëve Gegë, ngjajnë shumë me ato të një burri mesatarisht të gjatë, me gjymtyrë të gjata, kocka të forta, muskuj të zhvilluar mirë, por me trup të dobët, me një fytyrë të hollë e kockore me përmasa mesatare, një hundë shkabë, të gjatë e të ngushtë, kokë të shkurtër, të gjerë dhe shpesh të rrafshuar nga pas, si dhe mustaqe dhe mjekër të zhvilluar mirë, të dyja me ngjyra. Lëkura e tyre është e hapur dhe sytë janë të qartë. Qimet e trupit janë të zhvilluara deri diku mirë, por jo aq shumë. Në të gjitha karakteristikat, përveç atyre që lidhen me gjerësinë dhe rrafshëzimin e anës së prapme të kokës, ai i ngjan popujve nordikë dhe atyre më të mëdhenj mesdhetarë të skajeve të Evropës, më shumë sesa popujve më të bëshëm, me hundë të sheshtë dhe me më shumë qime që gjenden në lindje dhe në qendër të Evropës. Nëse dikush mund të krahasojë një seri skeletesh të njerëzve të tillë me ato të varrezave të Epokës Ilire të Hekurit në Glasinac,[28] është e vështirë të kuptohet se çfarë ndryshimesh do të shfaqeshin midis tyre, përveç pranisë numerike më të madhe të kokave të gjëra dhe shpesh të rrafshta në zonën e qafës, të cilat gjenden edhe në popullsinë e sotme.

28 Varreza e Epokës së Hekurit Ilire në Glasinac është një vend arkeologjik i rëndësishëm që ndodhet në Bosnjë dhe Hercegovinë. Glasinac, një pllajë në afërsi të qytetit të Sokolacit, është i njohur për gjetjet arkeologjike që datojnë nga Epoka e Hekurit dhe janë të lidhura me fiset ilire të cilat banonin këtë zonë.Varreza e Epokës së Hekurit Ilire në Glasinac është një dëshmi e pasurisë kulturore dhe historike të rajonit dhe ofron një dritare të vlefshme për të kaluarën e lashtë të popujve ilirë. (Shënim i përkthyesit)

NDRYSHUESHMËRIA E SERISË NË TËRËSI DHE E FISEVE NË VEÇANTI

Çdo popullatë e gjallë pritet të paraqesë një shpërndarje normale të frekuencës për secilin kriter matës. Kjo shpërndarje shprehet me anë të devijimit standard (shih tabelën 3B). Vetë devijimet standarde ndryshojnë. Nëse devijimi standard tejkalon një vlerë të caktuar numerike, lind dyshimi se seria përfshin individë jo nga një, por nga disa popullata, të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra në kriteret përkatëse.

Për të siguruar një provë të thjeshtë për këtë, Howells[29] ka përpiluar një tabelë të mesatareve të devijimeve standarde për një numër të madh serish, dhe secila prej tyre përbëhet nga mbi 50 individë. Ai gjithashtu ka shpikur *'Raportin Sigma*,[30] për të krahasuar sigmat individuale me mesataren. Tabela 5 tregon se si kjo mund të zbatohet në matjet tona nme materialin tonë shqiptar.

Në shumicën e matjeve tona treguesit e fytyrës, tek Malësorët tanë Gegë, shfaqin në përgjithësi, një shkallë normale të ndryshueshmërisë. Në një karakteristikë të tyre ose më saktë në indeksin e hundës, ata shfaqin një homogjenitet të jashtëzakonshëm. Në lartësinë e trupit, gjatësinë e kokës, gjerësinë e kokës dhe indeksin cefalik, ata tregojnë një ndryshueshmëri më të madhe sesa do të pritej nga një popullsi normale e njëtrajtshme. Kjo është veçanërisht e dukshme në indeksin cefalik. Kështu, duke përdorur ndryshueshmërinë si kriter, zbulojmë se *Gegët Malësorë janë një popullsi homogjene për sa i përket përmasave të kokës dhe të fytyrës, por jo kur merren parasysh lartësia dhe permasat apo forma e qemerit kranial.*

Nëse ata nuk përbëjnë një popullsi të vetme, atëherë janë një bashkim popullsishë, të cilat mund të jenë, ose edhe mund të mos jenë, fise të njëjta. Në shumicën e kritereve, fiset tregojnë një gamë variacionesh në të dyja anët e pikës 100. Në indeksin e hundës, të gjithë bien shumë më poshtë se mesatarja, ndërsa në indeksin cefalik, të gjithë janë shumë më lart se mesatarja. Lartësia e hundës është gjithmonë më e ndryshueshme se mesatarja e Howell-it, dhe variacionet fisnore në indeksin cefalik arrijnë nivele të jashtëzakonshme ndryshimi.

29 William White Howells (1908–2005) ishte një antropolog amerikan i njohur për punën e tij në antropologjinë fizike, veçanërisht në studimin e ndryshimeve fizike dhe evolutive te njerëzit. Ai ishte profesor në Universitetin e Harvardit dhe kontribuoi shumë në studimet mbi morfologjinë kraniale (formën e kafkës), duke përdorur metoda statistikore për të analizuar popullatat njerëzore dhe për të identifikuar dallime midis grupeve të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

30 Raporti Sigma (σ) në antropologji është një term që lidhet me një masë statistikore të përdorur për të përshkruar variacionin e të dhënave. Në kontekstin antropologjik, kjo masë përdoret për të analizuar variacionet trupore apo kraniale midis individëve ose grupeve të ndryshme njerëzore. (Shënim i përkthyesit)

Nga kjo mund të arrijmë në përfundimin se ndryshimi në shtat vjen si pasojë e dallimeve rajonale. Në madhësinë e trupit kemi vërejtur tashmë se ndryshimi në indeksin cefalik është për shkak të një faktori që vepron brenda fiseve dhe ndërmjet fiseve. Ndërsa homogjeniteti i jashtëzakonshëm në indeksin e hundës lidhet me një ndryshueshmëri të madhe në lartësinë e hundës, e cila ndryshon në varësi të gjerësisë së hundës dhe jo në mënyrë të pavarur.

TABLE 5: σ RATIOS.

	HOWELLS' σ	TOTAL	MEM	DUK	MEJ	HAS	LUM	PUK	MIR	ZAD	MAT	DIB	TRIBES
Stature	5.81	116	107	107	95	125	102	110	100	109	107	117	108
Head lgth.....	6.23	114	112	97	117	106	105	117	108	97	110	111	108
Head br.....	5.24	115	108	97	112	135	105	105	112	106	111	98	109
Min. frontal diam.	4.88	100	96	86	95	104	98	99	93	102	111	93	98
Bizyg. diam.....	5.28	107	119	110	140	104	94	108	92	117	110	102	110
Bigon. diam.....	5.79	106	107	97	104	112	95	111	102	107	104	102	104
Total face ht.....	6.43	101	108	99	109	96	86	99	89	105	103	91	98
Upper face ht....	4.66	107	107	101	110	104	101	94	99	107	115	113	105
Nasal ht.....	3.77	111	110	102	107	117	114	99	108	109	114	103	107
Nasal br.....	2.92	95	105	102	81	112	94	98	100	104	101	93	99
Cephalic index ..	3.39	127	115	108	127	135	124	118	119	106	123	119	119
Cephalo-fac. index	3.51	99	98	96	97	93	95	102	85	91	99	108	96
Facial index	5.09	99	111	94	104	98	84	99	78	100	103	82	96
Upper fac. index	3.63	100	101	95	98	110	89	89	82	92	105	106	97
Nasal index.....	7.82	77	81	79	70	78	66	82	72	81	86	73	77

Në tabelën 5 tregohet lartësia totale e fytyrës, lartësia e sipërme e fytyrës, lartësia e hundës, gjerësia e hundës, indeksi cefalik, indeksi cefalo-facial, indeksi i fytyrës, indeksi i sipërm i fytyrës dhe indeksi i hundës për të gjitha zonat e studiuara nga Prof. Coon, Malësi e Madhe, Dukagjin, Malësia e Gjakovës, Hasi, Luma, Puka, Mirdita, Zadrima, Mati dhe Dibra.

Është e ditur që vetë fiset ndryshojnë në masën e ndryshueshmërisë. Për ta provuar këtë, le t'i drejtohemi tabelës 3c. Nëse mesatarizojmë vlerat e V - së për 32 karaktere, nga shtati në indeksin e hundës do të përftojmë tabelën që vijon (shih tabelën 6).

Në përgjithësi, fiset janë më pak të ndryshueshme sesa seria tërësore e matjeve tona. Vetëm dy fise, Hasi dhe Mati, përbëjnë përjashtime nga ky rregull. Kampionet e Hasit janë marrë nga një lokalitet i vetëm, ndërsa ajo e Matit nga një popullsi e shpërndarë dhe e larmishme fetare.

Por, edhe në këto fise, vetëm një koeficient variacioni është dukshëm më i madh se mesatarja e matjeve tona në serinë totale: Hasi është më i ndryshueshëm në lartësinë e kokës se sa seria totale e matjeve tona me 4,71 herë.

TABLE 6: VALUES OF V FOR 32 CHARACTERS, BY TRIBES.

	Mean V.
Total series	5.26
Mean of tribes	5.09
MeM	5.13
Duk	4.95
MeJ	4.95
Has	5.37
Lum	4.84
Puk	5.14
Mir	4.97
Zad	5.14
Mat	5.32
Dib	5.11

Tabela 6 tregon ndryshueshmërinë e vlerave midis krahinave të ndryshme për të gjitha zonat e studiuara nga Prof. Coon, Malësi e Madhe, Dukagjin, Malësia e Gjakovës, Hasi, Luma, Puka, Mirdita, Zadrima, Mati dhe Dibra.

Katër fise janë dukshëm më pak të ndryshueshme sesa e gjithë seria e matjeve tona. Ato janë: Luma, Dukagjini, Malësia e Gjakovës dhe Mirdita. *Dy prej këtyre fiseve janë fiset tona të vetme 100% katolike, të njohura për izolimin e tyre gjenetik*. Për këtë arësye, homogjeniteti relativ i tyre është i kuptueshëm. Por Luma dhe Malësia e Gjakovës janë kryesisht ose tërësisht myslimane dhe ndodhen në kryqëzimin e rrugëve kryesore. Si ndryshojnë ata nga të tjerët? Përgjigja, e cila është pjesë e një analize më të gjerë, është e thjeshtë: Ata janë më pak brachicefalikë nga të gjitha fiset. Pjesa më e madhe e diferencimit tek banorët e këtyre fiseve gjendet pikërisht në zonën e qemerit kranial.[31]

DALLIMET MES KARAKTERISTIKAVE TRUPORE MIDIS FISEVE. VLERËSIMI STATISTIKOR I TYRE

Le të shqyrtojmë shpërndarjen gjeografike të karaktereve antropometrike midis fiseve. Nuk duhet të harrojmë se sipërfaqja e përgjithshme e këtij rajoni është më e vogël se ajo e Konektikatit, dhe se popullsia e këtij rajoni nuk ka përjetuar asnjë pushtim të huaj, as infiltrim apo imigrim për të paktën 400 vjet, dhe se mund të

31 Janë përgatitur tabela të detajuara për të treguar raportet e rëndësisë së ndryshimeve midis mesatareve të të gjitha karakteristikave metrike të të gjitha fiseve, dhe e njëjta gjë për të gjitha kategoritë e përqindjeve në vëzhgime. Kostoja e publikimit të tabelave të tilla është ndaluese. Në faqet e mëposhtme të këtij kapitulli, pjesë të tyre do të përmbledhen. Autori do t'i mbajë ato në arkiv në rast se dikush mund të dëshirojë t'u referohet në të ardhmen. (Shënimi i autorit)

rrjedhë historikisht nga një burim i vetëm i njohur. Në kushte të zakonshme, nuk do të pritej që të shquheshin dallime të dukshme fizike. Por kushtet në Malësinë e Gegnisë nuk janë të zakonshme. Njerëzit, siç e kemi parë, jetojnë në lugina të thella, të izoluara nga të gjitha anët, martohen brenda kufinjëve gjenetikë të kufizuar, dhe ushqehen me produktet që u ofron toka e secilës pllajë ku banojnë.

Rezultati është ai që mund të pritej. Kampionet e marra nga individë të dhjetë fiseve ndryshojnë më shumë nga njëri tjetri sesa ndryshojnë amerikanët e bardhë të lindur nga prindër me prejardhje vendase, brenda 48 shteteve. Dhe këto dallime janë aq të mëdha sa çdo fis formon një popullsi statistikisht të ndarë nga të gjithë të tjerët.[32] Pra, kemi të bëjmë me dhjetë masa njerëzore të ndryshme, në mënyrë fenotipike (si karakteristikë trupore). Provat për këtë mund të paraqiten shkurt.

Çdo matje dhe indeks i listuar në tabelën 3c përmban 45 elementë të ndryshëm ndërfisnorë. Po ashtu, çdo fis dallohet nga seria e përbashkët, duke e rritur numrin e elementëve dallues në 55 për secilin kriter. Numri i dallimeve të rëndësishme (për shembull, kur ato ndodhin 3 ose më shumë herë) nga 10 deri në 45 të mundshme është paraqitur në tabelën 7.

Të dhënat tregojnë se dhjetë fiset e Gegëve të Malësisë dallojnë nga seria totale e matjeve tona në mënyrë të konsiderueshme në rreth dyzet për qint të të gjitha kritereve të matura, dhe ndryshimet ndërmjet tyre janë edhe më të mëdha. Përqindja e ndryshimeve të pranuara si rezultat i rastësisë në këtë kategori është vetëm katër për qind.

Dallimet janë më të theksuara në përmasat e përgjithëshme të madhësisë së trupit, duke përjashtuar matjet specifike të gjoksit. Proporcionet e trupit ndryshojnë më pak sesa vetë madhësia e trupit. Mbi nivelin e qafës, dallohen tre karakteristika kryesore.

Diametrat horizontale të fytyrës dhe indekset e tyre ndryshojnë më pak. Nëse vlerësimi ynë do të mbështetej vetëm në këto matje, do të ishte e vështirë të demonstrohej ndarja racore në Malësinë e Gegëve. Në anën tjetër, përmasat sagitalë[33] të fytyrës dhe indekset sagitalo-horizontale tregojnë ndryshime më të mëdha.

32 Goring, 1913. (Shënim i autorit)

33 Në shqip, diametri sagital i referohet një matjeje që merret përgjatë planeve sagitale të trupit. Plani sagital ndan trupin në pjesën e majtë dhe të djathtë. Prandaj, diametri sagital është distanca e matur nga pika më e përparme (para) në pikën më të prapme (mbrapa) përgjatë këtij plani. Në kontekstin e matjeve të fytyrës, diametri sagital është distanca që matet nga pika më e përparme e fytyrës në pikën më të prapme, zakonisht përgjatë vijës qendrore të fytyrës. Ky matës përdoret për të analizuar proporcionet dhe ndryshimet strukturore të fytyrës. (Shënim i përkthyesit)

TABLE 7: NUMBER OF SIGNIFICANT DIFFERENCES.

	TOTAL	EACH OTHER
Maximum possible	10	45
Stature	6	30
Span	8	32
Sitting ht.	6	28
Biacromial	7	29
Bi-iliac	4	25
Chest br.	3	18
Chest depth	2	22
Rel. span	5	17
Rel. shoulder ht.	2	13
Rel. shoulder br.	4	22
Rel. sitting ht.	3	17
Head lgth.	7	28
Head br.	5	25
Head ht.	3	21
Minimum frontal	5	20
Bizygomatic	4	17
Bigonial	1	11
Total face ht.	3	21
Upper face ht.	2	11
Nose ht.	3	21
Nose br.	3	15
Cephalic index	6	30
Length ht. index	4	21
Breadth ht. index	7	26
Fronto-parietal index	4	21
Cephalo-facial index	3	19
Zygo-frontal index	2	7
Fronto-gonial index	2	6
Zygo-gonial index	2	5
Facial index	4	25
Upper facial index	3	25
Nasal index	2	13
Total	125	641
	(320)	(1760)

Tabela 7 tregon numrin e veçorive domethënëse, ku përfshihen: maksimumi i mundshëm, gjatësia, hapësira, lartësia ulur, biakromiali, gjerësia e kraharorit, thellësia e kraharorit, lartësia relative ulur, lartësia e kokës, gjerësia e kokës, lartësia e ballit minimal, bizigomatike, bigoniale, lartësia e plotë e fytyrës, lartësia e sipërme e fytyrës, lartësia e hundës, gjerësia e hundës, indeksi cefalik, etj.

By Classes of Criteria: Percentage of All Possible Significant Differences

	Total	Each Other
5 Stand. body meas.....	62%	52%
4 Stand. body indices.....	35	38
2 Diam. of chest.....	25	44
3 Diam. of brain case.....	50	55
3 Indices of brain case.....	57	50
7 Face diam.....	30	37
3 Indices of facial br.....	20	13
3 Sagittal-br. indices of face...	30	47
2 Head-face indices.....	35	44
32 Criteria, total.....	39%	45%

Përqindja e të gjitha diferencave të mundshme domethënëse: 5 matje standarde të trupit, 4 indekse standarde të trupit, 2 diametra të kraharorit, 3 diametra të kafkës, 3 indekse të kafkës, 7 diametra të fytyrës, 3 indekse të gjerësisë së fytyrës, 3 indekse sagittale të fytyrës, 2 indekse të kokës dhe fytyrës, gjithsej 32 kritere.

Nga qafa e lart, tre diametrat kryesorë të kafkës dhe indekset e tyre janë më të ndryshueshëm. Bazuar në këto prova dhe nga tërësia e të dhënave ne mund të vijmë në përfundimin se fiset dallojnë në mënyrë metrike nga njëri tjetri në tre aspekte:

(1) Në diametrat e trupit, ndryshimet janë të mëdha;

(2) Në diametrat dhe indekset e kafkës, ndryshimet janë po ashtu të konsiderueshme;

(3) Në gjatësitë e përgjithëshme të fytyrës – veçanërisht nga hunda tek mjekra dhe në indekset që varen nga këto matje, ndryshimet janë më të vogla.

Në një aspekt, fiset tregojnë një shkallë homogjeniteti relativ. Kjo shfaqet në qëndrueshmërinë e diametrave horizontalë të fytyrës. Megjithatë, edhe në këtë rast, ato dallojnë më shumë sesa do të pritej nga rastësia.

E njëjta analizë është kryer për dallimet ndërfisnore në 78 vëzhgime të paraqitura në tabelën 4. Në këtë rast, dallimet midis fiseve dhe tërësisë së tyre nuk u llogaritën. Metoda e përdorur përfshinte llogaritjen e gabimeve të mundshme të përqindjeve duke përdorur tabelat e Ritalës[34] dhe vlerësimin e rëndësisë së dallimeve midis tyre.

34 Ritala, 1933. Tabelat e Ritalës në antropologji i referohen një grupi të matjeve ose standardeve të përdorura për të klasifikuar popullatat ose individët sipas përmasave të ndryshme trupore. Këto tabela përfshijnë matje të caktuara antropometrike, si p.sh. gjatësia e kokës, gjerësia e kokës, raportet midis gjatësisë dhe gjerësisë së kokës, dhe parametra të tjerë që ndihmojnë në studimin e tipareve fizike të popullatave të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

Tabela 8 tregon dallimet e qarta ndërfisnore. Ato janë më të vështira për t'u demonstruar në vëzhgimet tona, kjo për shkak të karaktereve metrikë, apo dhe për shkak të natyrës së veçantë të kritereve të përdorura. Kjo ndodh sepse në çdo rast 4% e dallimeve, mbi 3 *gabimin e e mundshëm* mund t'i atribuohen rastësisë. Prandaj duhet marrë parasyshë fakti se një ndryshim i tillë mund të ndodhë edhe për shkak të pasaktësive teknike, ndryshimeve në pamje, në temperatura kushteve të ndriçimit. Kështu pra është e vështirë të pretendojmë për dallime të vlefshme rajonale në klasat e kritereve ku më pak se 8% e kombinimeve janë mbi 3 p.e. Në formën e fytyrës, në ndërtimin e hundës, në rritjen e flokëve, si dhe në formën, shpërndarjen dhe pigmentimin e tyre, duket se dallimet rajonale janë të pakta. Këto karakteristika janë pikërisht ato që shumica e antropologëve i konsiderojnë si gjenetike. Prandaj, në këto aspekte, Malësorët tanë Gegë janë aq homogjenë sa edhe vetë historia e tyre, gjë kjo që vërtetohet edhe nga rezutatet e matjeve tona.

Sidoqoftë, në vëzhgimet e trupit dhe të kafkës, ata ndryshojnë më shumë sesa do të mund ta justifikonin rastësitë apo gabimet teknike. Në këto karakteristika, që janë lehtësisht të ndikueshme, ekzistojnë fenotipe - (karakteristika trupore) që mund t'i përkasin një rajoni të caktuar.

TABLE 8: INTERTRIBAL COMPARISONS.

	No. of Criteria	No. of Categories	No. of Combinations	No. of Combinations 3 p. e.	No. of Combinations 3 p. e.
Body	12	39	1755	203	11.5%
Head	7	24	1080	131	12.1
Face	25	86	2870	206	5.3
Nose	11	35	1575	96	6.1
Pilosity	16	57	2565	177	6.9
Pigment	7	32	1440	107	7.4
Total	78	273	11,285	920	7.5%

Tabela 8 tregon krahasimet ndërfisnore të trupit, kokës, fytyrës, hundës, flokëve, pigmentit dhe tërësisë së tyre sipas kritereve, numrin e kategorive dhe numrin e kombinacioneve.

NDRYSHUESHMËRITË RAJONALE NË MADHËSINË DHE FORMËN E TRUPIT

Dallimi kryesor në madhësinë e trupit qëndron në ndarjen veri - jug ndërmjet fiseve që jetojnë në të dy anët e Drinit. Ata që banojnë në veri janë 6 centimetra

më të gjatë se ata që jetojnë në jug. Këto dallime janë më të theksuara në perëndim sesa në lindje, kështu që mund t'i ndajmë në tri krahina: E para, zona veriperëndimore me trupa të gjatë. E dyta, zona lindore me trupa të ndërmjetëm. E treta, zona jugperëndimore, me trupa të shkurtër.

Banorët e këtyre krahinave ndryshojnë gjithashtu në përmasat e trupit. Banorët e fiseve veriperëndimore (Malësia e Madhe dhe Dukagjini) kanë supe të gjëra dhe krahë të gjatë, ndërsa fiset më në lindje, përfshirë Malësinë e Gjakovës, edhe pse janë të gjatë, janë më të hollë dhe më të ngushtë në supe, Ndërkohë, jugperëndimorët janë të shkurtër dhe të hollë. Kulmi i qëndrueshmërisë arrihet në Dukagjin, ku banorët e fiseve që banojnë në këtë krahine i tejkalojnë të tjerët në mënyrë të dukshme në këto kritere të veçanta. Edhe pse na mungojnë të dhënat për peshën, të cilat do të ishin shumë të vlefshme në këtë rast, ne kemi dëshmitë nga tërheqja e dinamometrit, që zbulon epërsinë e tyre në forcën muskulore (shih tabelën 9).

Burrat e Dukagjinit janë pak më të fortë se ata të Malësisë së Madhe, por ky ndryshim nuk është aq i dukshëm. Megjithatë, si Dukagjini ashtu edhe Malësia e Madhe janë dukshëm më të fortë se të gjitha fiset e tjera. Ndër të tjera, Hasi, Luma dhe Puka janë më të fortë se Mati dhe Mirdita. Puka është gjithashtu më e fortë se Zadrima, ndërsa Malësia e Gjakovës është më e fortë se krejt Mirdita. Tre krahinat e tjera, të cilat dallohen përsëri bazuar në këto prova, janë:

TABLE 9: DYNAMOMETER SQUEEZE.

	No.	MEAN	σ
Total	1058	112.09 ± .36	15.86
MeM	105	117.95 ± 1.05	15.90
Duk	106	121.20 ± 1.20	18.40
MeJ	104	108.30 ± 1.14	17.20
Has	114	110.05 ± 1.17	18.45
Lum	109	110.25 ± 1.11	17.15
Puk	102	112.80 ± 1.24	18.60
Mir	101	102.50 ± 1.39	20.65
Zad	105	105.75 ± 1.22	18.50
Mat	104	104.65 ± 1.32	19.90
Dib	108	108.25 ± 1.51	23.30

Tabela 9 tregon forcën shtrënguese të dinamometrit për të gjitha zonat e studiuara nga Prof. Coon, duke përfshirë: Malësinë e Madhe, Dukagjinin, Malësinë e Gjakovës, Hasin, Lumën, Pukën, Mirditën, Zadrimën, Matin dhe Dibrën.

- Veriperëndimi, me forcën më të madhe të përqendruar në Dukagjin.
- Fiset e kufirit lindor, përfshirë Malësinë e Gjakovës, Hasin, Lumën dhe Dibrën.

- Jugperëndimi, përfshirë Mirditën, Matin dhe Zadrimën, me Mirditën në pikën më të ulët.

Duhet të vihet në dukje fakti se dy zonat katolike, Dukagjini dhe Mirdita, të cilat supozohet se kanë origjinë nga një grup vëllezërish, janë më pak të ngjashëm në shtat, përmasa të trupit dhe forcë muskulore.

Në vëzhgimet e formës së trupit, dukagjinasi dallohet si më i zhdërvjellti nga të gjithë pjestarët e fiseve të tjera, por aty mbizotëron gjithashtu një ndarje veri - jug. Duke përmendur vetëm dallimet e rëndësishme, vërejmë se Dukagjinasi ka muskulaturën më të zhvilluar në përgjithësi, ndërsa banorët e fiseve të tjera më në jug janë më pak të zhvilluara. Malësorët e katër fiseve jugore (Zadrima, Mirdita, Mati dhe Dibra) kanë përqindje më të lartë të qafave të shkurtëra, ndërsa Zadrima, Mirdita, Mati dhe Hasi kanë përqindje më të lartë të qafave të holla. Tre fiset veriore i kalojnë të tjerat në pjerrësinë e shpatullave krahasuar me malësorët e fiseve më jugore në SM.[35] Në një masë të caktuar, zhvillimi i gjoksit shkon në të kundërt me shtatin. Malësorët e Mirditës dhe të Matit dallohen për gjokset më të zhvilluara, ndërsa Malësorët e Gjakovës janë disi më të hajshëm[36] në këtë aspekt. Ata shquhen si pak më të gjatë dhe me gjokse më të bëshme. Kufijtë vertebral të skapulave[37] dhe tehu i shpatullave, që supozohet të kenë rëndësi të madhe nga pikëpamja e shëndetit dhe fuqisë së përgjithshme, ndryshojnë shumë pak. Kurbatura e mesit është më e theksuar tek fiset në veri të Drinit. Asnjë nga Malësorët Gegë nuk kishte ushqim të mjaftueshëm për të pasur bark të fryrë. Në këtë kriter, variacioni është i papërfillshëm. Në përgjithësi, vithet janë më të plota në veri të Drinit, ku kurbatura e mesit është më e theksuar dhe për këtë arësye pjerrësia e legenit është më e dukshme. Këto dallime midis fiseve në kurbaturën e mesit dhe vithet e dala janë më të dukshme se çdo pjesë tjetër. Pulpët e këmbëve janë më të zhvilluara tek malësorët e Dukagjinit dhe të Mirditës, përkatësisht në fiset me njerëz më të gjatë dhe më të shkurtër. Këmbët tregojnë pak ndryshueshmëri.

Për t'i përmbledhur këto të dhëna, mund të themi se burra të gjatë gjenden në veri të Drinit, ndërsa shtati zvogëlohet ndërsa ne lëvizim dhe vëzhgojmë

35 SM qëndron si shkurtim i ndrysheshmërisë, variabilitetit (Shënim i autorit)

36 Kjo fjalë përdoret saktësisht në të folmen e Malësisë së Gjakovës në të njëjtin kontekst. Fjalorët e kanë i hajthëm. (Shënim i përkthyesit)

37 Skapula është kocka e shpatullës, dhe në antropologji, ajo studjohet për të kuptuar variacionet fizike dhe evolucionare mes njerëzve dhe hominidëve. Ajo ka rëndësi për të analizuar strukturën skeletore dhe adaptimet funksionale në kontekste të ndryshme antropologjike. (Shënim i përkthyesit)

më në jug. Në lindje, ndryshimi vihet re se është shumë më pak i theksuar se në perëndim. Në fakt, mund të përcaktohen tri krahina përsa i përket formës trupore: Veriperëndimi, lindja dhe jugperëndimi. Në përgjithësi, midis këtyre tri krahinave, burrat më të fuqishëm janë ata të veriperëndimit, ndërsa lindorët priren të jenë më të hollë. Malësorët e Dukagjinit dallohen mbi të gjithë të tjerët për forcën dhe shkathtësinë, të ndjekur nga malësorët e bajrakëve të Malësisë së Madhe. Malësorët e Mirditës janë të ndjekur nga ata të Matit dhe Zadrimës, të cilët ndodhet në skajin tjetër. Këto dallime krahinore janë po aq të mëdha sa ato midis Norvegjisë dhe Francës, ose Anglisë dhe Greqisë.

NDRYSHUESHMËRITË E KUPOLËS KRANALE SIPAS KRAHINAVE

Diametri mesatar i kokës ndryshon nga fisi në fis me rreth 7 milimetra, gjerësia mesatare me 6 milimetra dhe lartësia mesatare me 4 milimetra. Këto ndryshime janë të dukshme në 28 nga 45 raste për diametrin e kokës, në 25 nga 45 raste për gjerësinë e kokës dhe në 21 nga 45 raste për lartësinë e kokës. Kokat e malësorëve janë më të gjata në veriperëndim, mesatare në lindje ndërsa më të shkurtra në jugperëndim. Ato janë më të gjera në veriperëndim dhe relativisht të njëjta në zonat e tjera. Për sa i përket lartësisë, kokat janë më të larta në Zadrimë dhe në Malësinë e Madhe, por më të ulëta në Mat dhe në Dibër. Kjo ulje ndjek përgjithësisht aksin veriperëndim - juglindje.

Këto ndryshuemshmëri rajonale janë më të dukshme në indeksin cefalik, ku në 31 nga 45 fiset (69%) e atyre që matëm tregojnë dallime të dukshme. Në këtë aspekt, fiset më perëndimore janë 3 deri në 4 pikë më brahicefalike se ato lindore. Në indeksin gjatësi - lartësi, vetëm 21 nga 45 fiset (47%) shfaqin dallime të dukshme. Diapazoni i mesatareve të ndryshimit është 4 pikë, dhe vetëm në Zadrimë duket se ka ndryshueshmëri më të theksuara.

Në indeksin gjerësi - lartësi, trendi është pak më i theksuar: 26 nga 45 fiset (58%) shfaqin dallime të dukshme dhe diapazoni i mesatareve përsëri është 4 pikë. Në përgjithësi, gjatësia e kokës ndryshon me shtatin, dhe ndyshimi tek gjerësia e kokës vjen e shtohet nga lindja në perëndim, ashtu si indeksi cefalik. Ndërkohë, indekset e ndryshueshmërisë së lartësisë nuk ndjekin një linjë të qartë gjeografike. Vëzhgimet mbi kupolën kraniale i sqarojnë këto tendenca në detaje. Luma dhe

Puka kanë një zgjatje të theksuar të pjesës oksipitale, ndërsa Zadrima, Malësia e Madhe, Hasi, Mati dhe Dibra nuk e shfaqin këtë zgjatim.

Malësia e Madhe, Zadrima dhe Mati kanë një sheshtësi të lartë të pjesës oksipitale, ndërsa Dukagjini, Malësia e Gjakovës, Luma dhe Puka kanë një sheshtësi të ulët. Në lidhje me sheshtësinë lambdoide, Dukagjini është më i larti, i ndjekur nga fiset në zonat më lindore. Frekuencat e këtyre dy formave të sheshtësisë janë mjaft të larta gjë që shpjegojnë ndryshimet në formën e kokës, të shfaqura këto në matjet tona dhe indekset përkatëse. Sesa të rëndësishme janë këto dallime do të shpjegohet në vijim.

NDRYSHUESHMËRITË E FORMËS SË FYTYRËS SIPAS KRAHINAVE

Malësorët e Malësisë së Madhe kanë ballë dukshëm më të gjerë se të gjitha fiset e tjera. Gjerësia e ballit të banorëve të këtyre zonave fillon duke u ngushtuar paksa, teksa lëvizim drejt zonave të lindjes dhe jugut të Gegnisë. Nëntë nga 20 ndryshimet e rëndësishme të shfaqura midis këtyre fiseve, në këtë lloj matjeje, i përkasin Malësisë së Madhe.

Në bizigomatik,[38] Malësia e Madhe dhe Dukagjini, përbëjnë 12 nga 17 ndryshimet e rëndësishme. Dibranët e kanë ballin më të ngushtë, dhe janë dukshëm ndryshe nga të gjithë përveç 3 - it. Bigoniali është matja më e qëndrueshme nga të gjitha, dhe malësorët e Dukagjinit, që e kanë nofullën më të gjerë, përbëjnë 6 nga 11 ndryshimet e rëndësishme. Këtu bën dallim vetëm Dukagjini. Kjo pasi Dibra, kalon katër herë më shumë se *gabimi i mundshëm*. Këto dallime mund të përmblidhen në gjerësi të fytyrës duke thënë se në përgjithësi fytyrat më të gjera janë në veriperëndim dhe më të ngushta në juglindje dhe se dallimet më të mëdha janë në pjesën e sipërme të fytyrës dhe më të vogla në atë të poshtme. Në lartësitë e fytyrës, një fis dallohet ndjeshëm nga të tjerët: Hasjanët i kanë lartësitë e përgjithshme dhe pjesët e sipërme të fytyrës më të mëdha, madje shumë më të mëdha se të gjithë të tjerët.

38 Termi bizigomatik i referohet matjes së distancës midis dy pikave më të largëta të harkut zigomatik (kockat e faqeve) në fytyrë. Kjo është një matje e përdorur shpesh në antropologji fizike dhe në studimin e kranialitetit për të vlerësuar gjerësinë e fytyrës. Bizigomatik tregon gjerësinë horizontale të fytyrës, që është një nga përmasat kryesore që përdoret për të krahasuar forma të ndryshme të fytyrës ndërmjet popullatave ose individëve të ndryshëm. (Shënim i përkthyesit)

Në lartësinë totale të fytyrës, Hasi përfaqëson 8 nga 22 dallimet e rëndësishme. Për shembull në lartësinë e sipërme të fytyrës ata përmbajnë 9 nga 11 dallimet e rëndësishme. Nëse e lemë mënjanë Hasin, të tjerët janë shumë të ngjashëm, pasi ato i kanë fytyrat më të shkurtëra në të dy dimensionet, kjo shfaqet veçanërisht në fiset e zonave të jugperëndimit të Gegnisë. Këtu pra qëndron dikotomia.[39] Malsorët e Hasit në këtë aspekt dallojnë prej të gjithë të tjerëve.

Indeksi fronto - parietal, që tregon lidhjen midis gjerësisë së kokës dhe gjerësisë së ballit, ndryshon vetëm me 2 pikë në këtë indeks. Siç mund të pritet, fiset me kokën më të gjerë i kanë vlerat më të ulëta në këtë indeks, ndërsa ato me kokën më të ngushtë i kanë vlerat më të larta. Asnjë fis ose grup fisesh nuk ka dallime të theksuara në këtë karakteristikë. Indeksi cefalo-facial, që mat raportin midis gjerësisë së kokës dhe gjerësisë së fytyrës, paraqitet pothuajse i njëjtë, pra me shumë pak variacione ndryshimi. Indeksi zygo-frontal ndryshon shumë pak edhe nga gjashtë ndryshimet e rëndësishme. Ato ndodhin sepse Mirdita ka një pikë më të ulët në këtë indeks. Pra, në këtë indeks është më poshtë se shumica e të tjerëve, kjo për shkak të gjerësisë së fytyrës së tyre, e cila është pak më e madhe në raport me madhësinë e saj krahasuar me të tjerët. Indekset fronto-goniale[40] dhe zygo-goniale,[41] janë edhe më të qëndrueshme. Katër nga gjashtë ndryshimet kryesore ndodhin për shkak të ballit të gjerë të malësorit nga Malësia e Madhe. Ndërsa të gjitha ndryshimet e tjera, vijnë si rezultat i kombinimit të tipareve të malësorit nga Mirdita, i cili ka një fytyrë me gjerësi mesatare dhe një nofull më të ngushtë se të tjerët.

Kështu pra ne mund ta konsiderojmë fenotipin e Gegëve të Malësisë si një njësi tipike në këto përmasa horizontale të kokës dhe fytyrës, por me devijime shumë të vogla në Malësinë e Madhe dhe në Mirditë.

Vëzhgimet e këtyre karakteristikave na ndihmojnë edhe më shumë në këtë studim. Në lartësinë dhe pjerrësinë e ballit, pothuajse nuk ndodhin ndryshime me

39 Dikotomia është një koncept që i referohet ndarjes së një tërësie në dy pjesë ose kategori të kundërta ose kontrastuese. Këto dy pjesë zakonisht janë të ndara në mënyrë të qartë dhe ekskluzive, duke përjashtuar njëra-tjetrën. Për shembull, një dikotomi klasike është ajo midis ditës dhe natës, të cilat janë dy gjendje të kundërta të të njëjtit fenomen. (Shënim i përkthyesit)

40 Fronto-gonial është një term që përdoret në antropologji dhe kraniometri (matje e kafkës) për të përshkruar një kënd ose distancë që lidhet me ballin (frontal) dhe gonionin. (Shënim i përkthyesit)

41 Termi zygo-gonial në antropologji i referohet një matjeje të caktuar të kafkës, duke lidhur dy pika specifike: zygion (pikat më të largëta anësore të harkut zigomatik, ose faqet) dhe gonion (këndet e nofullës së poshtme). Kjo matje përdoret për të studiuar përmasat e fytyrës dhe të kafkës në studimet antropometrike, që ndihmojnë në përkufizimin e tipareve racore ose gjeografike të grupeve të ndryshme popullatash. (Shënim i përkthyesit)

vlefshmëri statistikore. Ndërsa përsa i përket gjerësisë së ballit, sipas matjeve tona, Luma, Puka dhe Malësia e Gjakovës shfaqen me një ballë më të ngushtë, kjo pasi në disa zona të tjera përqindjet e gjerësisë së ballit janë të dyfishta dhe të larta deri në trefish. Në madhësinë e harkut të vetullave ose në glabellë në daljen përpara të malarëve[42] ose mbushjen apo rrudhosjen e faqeve nuk shihen ndryshime të rëndësishme. Në shtytjen anësore të malarëve dhe në pamjen e këndeve goniale, nuk mund të gjendet asnjë ndryshim i rëndësishëm në vlerat apo në përqindje të asnjë kategorie. Në vëzhgimet morfologjike që lidhen me arkitekturën e përgjithëshme të fytyrës, përjashtuar sytë, hundën dhe gojën, fiset janë të njëjta.

Megjithatë, kur bëhet fjalë për mjekrën, çdo fis dallon nga të tjerët: Dukagjini ka më pak vlera SM (ndrysheshmëri të variabilitetit) [43] për shfaqjen e mjekrës krahasuar me çdo fis tjetër, dhe këto janë të rëndësishme. Gjithashtu, ka më shumë raste me mjekra të dyfishta krahasuar me fiset e tjera, dhe kjo veçori është e rëndësishme.

Mjekra e dukagjinasit qëndron si një përjashtim i dukshëm nga pozicioni uniform i Gegëve të Malësisë në strukturën e fytyrës. Kjo nuk është për t'u habitur pasi ndryshimet më të dukshme te mjekrat e tyre lidhen me madhësinë e fytyrës dhe forcën e kafshimit. Hundët e Gegëve ndryshojnë rreth 3 milimetra në lartësi dhe 1.5 milimetra në gjerësi. Hasjanët i kanë hundët më të gjata, por gjithashtu ka prej tyre që i kanë edhe më të gjera.

Nëntë nga 21 ndryshimet e rëndësishme në lartësinë e hundës dhe gjashtë prej 17 ndryshimeve në gjerësinë e hundës gjenden tek hasjanët. Indeksi nazal[44] ndryshon rreth 4 pikë. Kjo me vlerat më të ulëta në lindje të Gegnisë dhe me vlerat më të lartat në perëndim. Por të gjitha këto përkojnë afërsisht me ekstremet më të vogla që mund të gjënden tek njerzit. Nga 13 ndryshimet e rëndësishme, 6 janë për shkak të faktit se dukagjinasit janë më të gjatët. Vëzhgimet e hundës, të cilat e çojnë studimin tonë në detaje të imëta, konfirmojnë njëtrajtshmërinë e jashtëzakonshme rajonale të formës së këtij organi.

---

42 Termi "malars" i referohet kockave të faqeve, të njohura gjithashtu si kockat zygomatike. Këto kocka formojnë pjesën e poshtme të orbitës së syrit dhe janë të rëndësishme për strukturën e fytyrës. Në kontekstin anatomik, "malar" gjithashtu mund të përdoret për të përshkruar diçka që lidhet me faqet. (Shënim i përkthyesit)

43 Në antropologji, veçanërisht në studimin e kraniologjisë (studimi i kafkës), shkurtimi "s.m." zakonisht qëndron për "*shkalla e devijimit standard*" në italisht, që është "*scarto medio*". Ky term i referohet masës statistikore që përdoret për të përshkruar sasinë e variacionit ose shpërndarjes nga mesatarja e madhësisë së një karakteristike të caktuar të kafkës. Kur krahasohen madhësitë e pjesëve të ndryshme të kafkës së një burri, "s.m." përdoret për të treguar sesa shumë matjet individuale devijojnë nga matja mesatare për atë popullatë, duke ofruar njohuri mbi variabilitetin brenda grupit. (Shënim i përkthyesit)

44 Indeksi nazal është një matje antropometrike që tregon marrëdhënien midis gjerësisë së hundës dhe lartësisë së hundës. (Shënim i përkthyesit)

Në rënjen nazale, nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm madje nuk ka as në karakterin më kritik e as në formën e profilit nazal. Në lartësinë e rrënjës dhe lartësinë e urës, dibranët tregojnë një përqindje më të lartë krahasuar me të tjerët. Ata kanë gjithashtu gjerësinë e urës së hundës pak më të ngushtë, duke përbërë 8 nga 10 ndryshimet e rëndësishme në këtë karakter.

Malësia e Madhe përbën 7 nga 8 ndryshimet e tilla në trashësinë e majës së hundës, pasi hunda e tyre është pak më e trashë se të tjerat. Në fiset e Gegnisë lindore, hundët janë pak më të holla. Dymbëdhjetë nga 22 ndryshimet në pozicionin e majës së hundës pasqyrojnë përqindjen e një hunde më të vogël tek banorët e Hasit, një ndryshim ky për të cilin do të flasim më vonë.

Në formën e flegrave të hundës shihet një karakteristikë tjetër shumë e rëndësishme. Në kuptimin statistikor asnjë fis nuk i ka format e flegrave më të hapura, se fiset e tjerë. Disa ndryshime midis kategorive të flegrave të shtypura dhe atyre mesatare reflektojnë një rritje të numrit të hundëve me formë të rrudhur të flegrave në Has dhe në Dibër.

Forma e septumit është e qëndrueshme, përveç në rastin e Malësorëve të Zadrimës, e cila është dukshëm më e drejtë krahasuar me të gjitha fiset lindore. Në pjerrësinë e septumit, fiset perëndimore, Malësia e Madhe, Zadrima dhe Mirdita, tregojnë një tendencë më të madhe për t'u përkulur në krahasim me ato në lindje.

Disa karakteristika të pjesëve të buta të syve tregojnë ndryshueshmëri të qënësishme fisnore. Fiset perëndimore, veçanërisht Zadrima, Malësia e Madhe dhe Dukagjini, kanë një përqindje të madhe të individëve me pulitjen e jashtme të syve, një tipar që është i rrallë në lindje dhe në Mat. Burrat nga Dukagjini kanë tendencë t'i rrudhin vetullat dhe kjo përbën 14 nga 28 ndryshimet e rëndësishme në hapjen palpebrale.[45] E njëjta tendencë në Has përbën 9 nga 28 ndryshimet krahasuar me pjesën tjetër. Në rastin e Dukagjinit, kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të faktit që matjet i bëmë në kohë me borë dhe në dritë të fortë dielli.

Shumica e fiseve kishin 20 deri në 30 për qind të një pjerrësie të lehtë të syve, por hasjanët, me vetëm 8 për qind, ishte ndjeshëm më poshtë se të tjerët. Kjo pjerrësi nuk ishte lart, si në stilin mongol, por poshtë, siç është zakonisht tek evropianët me fytyrë të ngushtë.

45 Termi "palpebral" i referohet qepallave të syve. Në kontekstin anatomik, përdoret për të përshkruar diçka që lidhet me qepallat, si për shembull hapja palpebrale, që i referohet hapjes së qepallave. (Shënim i përkthyesit)

Buzët tregojnë disa veçori të ndryshme sipas zonave. Dukagjinasit kanë buzë me integument[46] më të trashë se të tjerët, në 18 nga 23 raste të dukshme. Hasjanët kanë trashësi të ulët membranore, ndërsa Malësorët e Malësisë së Madhe kanë trashësi më të madhe, megjithëse në një shkallë shumë të vogël në secilin rast mes tyre. Malësorët e Malësisë së Madhe dhe ata të Malësisë së Gjakovës kanë pak më shumë eversion[47] të buzëve e zonave të tjera ku ne kryem matje. Vetëm disa nga këto dallime arrijnë 3 herë *gabimin e mundshëm* dhe vetëm një prej këtyre dallimeve arrin në 4 herë *gabimin e mundshëm*. Këtu përveç buzës së trashë të sipërme të Dukagjinit, pjesën tjetër mund të mos e marrim në konsideratë. Ndërsa tek veshët, nuk gjejmë dallime të rëndësishme.

Ne kemi 6 vëzhgime, ku vetëm 20 dallime prej 3 ose më shumë herë të gabimit standard ose *gabimit të mundshëm*. Kjo është llogaritur nga një total prej 810 përsonash të matur nga ne. Nga këto, vetëm 4 janë mbi *gabimin e mundshëm* dhe një arrin 5 mbi *gabimin e mundshëm*. Pra, mund të themi me siguri që fiset Gegë janë të ngjashme në frekuencën e faktorëve përbërës në formën e veshëve.

NDRYSHUESHMËRITË KRAHINORE TË PILOZITETIT [48]

Sipas hulumtimeve tona del se tek dëndësia dhe forma e qimeve dhe e flokëve në trupin e malësorëve, raporti është praktikisht i njëjtë midis të gjitha fiseve, përveç Hasit, i cili është vënë re se ka dukshëm më shumë individë me flokë të dredhura se të gjithë banorët e fiseve të tjera, përveç Malësisë së Madhe dhe Dukagjinit. Kështu pra, përveç Hasit, të tjerët janë praktikisht të njëjtë. Kjo për shkak të përhapjes së rruarjes së kokës tek burrat e disa fiseve dhe faktit që kampioni ynë nga Hasi jetonte pranë qytetit të Prizrenit, ku prerjet moderne të flokëve janë më të modës se në vende të tjera. Kështu pra që nuk duhet të kemi aq besim në këtë dallim.

46 Në gjuhën e antropologjisë, integumenti i referohet shtresës së jashtme që mbulon trupin e një organizmi, kryesisht lëkurës dhe strukturave të lidhura me të, si flokët dhe thonjtë. Integumenti është një nga aspektet kryesore të studimeve antropologjike, veçanërisht në lidhje me karakteristikat fizike, si ngjyra e lëkurës, që shpesh lidhet me përshtatjet mjedisore dhe evolucionare të grupeve të ndryshme njerëzore. Në studimet antropologjike, integumenti shpesh analizohet për të kuptuar dallimet e trashëgimisë dhe evolucionit midis popullatave të ndryshme. (Shënim i përkthyesit)

47 Eversion do të thotë kthimi i një pjese të trupit nga brenda jashtë. Në kontekstin e anatomisë, shpesh i referohet kthimit të buzëve ose të ndonjë pjese tjetër të trupit nga brenda jashtë, duke krijuar një pamje më të hapur ose të kthyer jashtë. (Shënim i përkthyesit)

48 Në shqip, termi "pilosity" do të thotë mbushja me qime e trupit. Ky term përdoret për të përshkruar praninë, sasinë dhe shpërndarjen e qimeve në trup. Në antropologji, biologji dhe dermatologji, prania e qimeve përdoret shpesh për të përshkruar shkallën e tyre te një individ apo specie. Kjo mund të përfshijë variacione në llojin e qimeve, si për shembull qime të holla apo të trasha, si dhe dendësinë e mbulimit me qime në pjesë të ndryshme të trupit. (Shënim i përkthyesit)

Në teksturën e flokëve,[49] banorët e Zadrimës shfaqin një tendencë në favor të qimeve më të holla, ndërsa banorët e Lumës kanë qime mesatare, dhe të dyja grupet kanë të njëjtën vlefshmëri statistikore. Por, me gjithë vëzhgimet e mia të imta, unë nuk i besoj mjaftueshëm vetvetes për t'i konfirmuar këto.

Në lidhje me rënien e flokëve tek burrat, Hasi dallon nga të tjerët, gjë që mund të shpjegohet bazuar në faktorë të tjerë. Në sasinë e flokëve të kokës (përveç zonave ku ato kanë rënë), dibranët tregojnë se kanë më shumë flokë se të tjerët. Sasia e qimeve të mustaqeve, trashësia e vetullave dhe bashkimi i vetullave nuk tregojnë ndryshueshmëritë rajonale, dhe këto janë kritere kryesore racore. Zgjatja anësore e vetullave, megjithatë, ndryshon. Këtu ndarja është thelbësore, por jo tipike, në veri-perëndim dhe juglindje. Kampionet fisnore me vetulla të gjera shfaqën veçanërisht tek malësorët e Dukagjinit, Malësisë së Gjakovës, Pukës dhe Zadrimës, ndërsa ato me vetulla të ngushta janë ata të Hasit, Lumës, Mirditës, Matit dhe Dibrës. Në këtë kriter të vetëm gjenden 41 dallime të rëndësishme. Në ato 10 karakteristika që lidhen me sasinë e flokëve, ekzistojnë 124 dallime të rëndësishme, dhe një e treta e këtyre gjenden pra në karakteristikën e vetme të zgjatjes anësore të vetullave. Përveç ndryshueshmërisë në formën e kafkës dhe mjekrës së malësorëve të Dukagjinit, ky është dallimi më i madh që ka dalë deri tani nga vëzhgimet tona.

Përsa i përket rritjes së qimeve në pjesët e ndryshme të fytyrës, përveç vetullave, nuk gjenden dallime të rëndësishme. Por përsa u përket qimeve të trupit, ekziston një tendencë që dukagjinasit dhe ata të Malësisë së Madhe të kenë nivele të ulëta të mungesës së qimeve, ndërsa fiset lindore të kenë nivele të larta në kategoritë më të dendura me qime. Por, këto prirje janë të një natyre thuajse të pakonsiderueshme.

NDRYSHUESHMËRITË RAJONALE NË PIGMENTIM

Në ngjyrën e lëkurës, vetëm Hasi tregon një ndryshim të qëndrueshëm nga të tjerët. Lëkurët e këtyre burrave janë regjistruar si të bardha mesatare në vend të së bardhës së lehtë, në rreth 20 për qind të rasteve. Kjo pakicë prej një të pestës së lëkurave jo të bardha është jo vetëm statistikisht e rëndësishme, por ndoshta edhe

49 Tekstura e flokëve i referohet karakteristikave fizike të fijeve të flokëve, përfshirë diametrin, gjerësinë ose trashësinë e qimeve. (Shënim i përkthyesit)

teknikisht e saktë. Burrat e Hasit i kishin shpesh enët e gjakut më të dukshme në krahë. Në ngjyrën e flokëve të kokës, dallimet e rëndësishme qëndrojnë vetëm midis kategorive ngjyrë e zezë dhe kafe e errët. Të gjitha fiset kanë pothuajse në mënyrë të barabartë flokë të kuqe dhe bionde.

Hasi është i dalluar për mbizotërimin e flokëve të zinj, ndërsa Dukagjini për flokët kafe të errët. Kjo mund të shpjegohet ndoshta me moshën dhe mënyrën e qethjeve të flokëve. Midis tyre, këto dy zona përmbledhin çdo dallim të rëndësishëm statistikisht të këtyre karakteristikave, të cilat janë gjithsejt 20 të tilla. Në ngjyrën e mustaqeve shfaqen disa dallime. Për shembull, mustaqet e burrave të Malësisë së Madhe, Dukagjinit dhe Malësisë së Gjakovës kanë tendencë të jenë pak më të forta në ngjyrat kafe të errëta, ato të Zadrimës dhe Dibrës në ngjyrat kafe në të kuqe, ndërsa Hasi dhe Puka me nuanca bionde, krahasuar me të tjerët. Nga 14 dallime të pakta, të gjitha përveç dyve janë nën katër herë *me gabim të mundshëm*, që mund të mos merren parasyshë.

Në ngjyrën e syve shfaqen disa tendenca. Dukagjini dhe Malësia e Gjakovës, me 23 për qind sy kafe të errët, e tejkalojnë ndjeshëm gati gjysmën e të tjerëve. Dibra ka një përqendrim të syve kafe të çelur, duke i tejkaluar ndjeshëm të gjithë, përveç dyve. Mati dhe Zadrima kanë një tendencë t'ua tejkalojnë të tjerëve në format e irisit të zonuar.[50] Këto dallime pigmentimi mund të tregojnë variacione shumë të vogla gjenetike dhe janë me të vërtetë të pakonsiderueshme.

PËRMBLEDHJA E DALLIMEVE KRAHINORE MIDIS FISEVE

Pasi kemi analizuar të gjitha dallimet midis fiseve në të gjitha karakteristikat e matura dhe të vëzhguara, dhe pasi i kemi testuar të gjitha për rëndësinë statistikore, tani mund të rendisim dallimet e veçanta që shfaqën sipas zonave të ndryshme në fenotipin, karakteristikat trupore të Gegëve të Malësisë (fig. 12, a).

1. Burrat në veri të Drinit janë më të gjatë, më muskulozë dhe më të fortë se ata në jug të tij. Ata gjithashtu kanë shpatulla më të gjera, krahë më të gjatë, qafa më të gjata dhe më të trasha, shpatulla më të pjerrëta, kurba më

50 Zoned iris forms" i referohet variacioneve në strukturën dhe ngjyrën e irisit të syrit, ku irisi mund të ketë zona me ngjyra ose modele të ndryshme. Këto zona mund të përfshijnë unaza, njolla ose ndarje të tjera që krijojnë një pamje të veçantë dhe të dallueshme të irisit. (Shënim i përkthyesit)

të mëdha të mesit dhe vithe më të dala. Dy krahinat më të dallueshme në këto karakteristika janë Dukagjini dhe Mirdita. Fiset në lindje, nga Malësia e Gjakovës deri në Dibër, tregojnë pak ndryshueshmëri në këto veçori. Dallime shfaqen mes veriut dhe jugut por jo pak ka edhe në perëndim. Këto dallime janë aq të mëdha sa duket sikur janë dallime të një kontinenti dhe jo të një territori kaq të vogël.

2. Aty ku trupat janë më të mëdhenj, edhe kokat janë më të mëdha. Përveç kësaj, kokat janë më të shkurtëra, më të gjera dhe më të larta në veriperëndim, dhe e kundërta ndodh në lindje. Rrafshimi oksipital arrin maksimumin e tij në Malësinë e Madhe dhe Zadrimë, ndërsa shestësimi lambdoid dhe shoqëruesi i tij, bathrocefalia, janë më të larta në Dukagjin. Dallimet fisnore në formën e kokës janë po aq të mëdha sa ato në madhësinë dhe forcën e trupit.
3. Fytyrat janë jashtëzakonisht homogjene në Malësinë e Gegnisë. Ndryshimet në paraqitjen trupore mes fiseve janë minimale. Disa veçori lokale që shquhen janë: Balli i gjerë në Malësinë e Madhe dhe lartësia e tepruar e fytyrës pa pjerrësi e syve në Has. Dukagjini ka një tepricë statistikisht të rëndësishme të mjekrave bilaterale, shumë pak prej të cilave janë të tërhequra. Zadrima ka një tendencë drejt një septumi nazal të drejtë dhe të kthyer poshtë, ndërsa Dukagjini ka një dukuri me buzë më të trasha.
4. Burrat e Hasit kanë një prirje për rënie flokësh. Fiset e Gegnisë veriperëndimore kanë vetulla më të gjera dhe të shtrira se ato në juglindje.
5. Në Has shfaqet një tendencë më e lartë drejt ngjyrës së lëkurës mesatare dhe flokëve të zinj. Dukagjini ka tendencë për flokë kafe të errët. Fiset veriore kanë në një përqindje të lartë flokësh kafe të errët, ndërsa Dibra ka përqindje më të lartë të syve kafe të çelur.

Ndërsa ndryshimet në madhësinë e trupit dhe formën e kokës janë të mëdha. Ngjashmëria në formën e fytyrës, pilozitetin dhe pigmentimin është gjithashtu e madhe. Por Gegët në përgjithësi duken të ngjashëm. Fiset që ndryshojnë më shumë nga pamja janë ato që jetojnë në pjesët skajore të Gegnisë: Koka të mëdha dhe të gjera kanë banorët e Malësisë së Madhe. Banorët e Dukagjinit janë gjigantë muskulorë me mjekër të ndarë. Ato të Zadrimës i kanë kokat mesatare dhe të gjera dhe një pakicë e dibranëve kanë sy kafe të çelur. Ndërkohë vëllezërit e tyre fisnorë, kanë fytyra dhe hundë disi më të ngushta.

Një nga rezultatet më befasuese të këtij krahasimi ndërfisnor është zbulimi se fiset ndryshojnë më shumë mes tyre, jo në kriteret konvencionale të racës, por në ato që zakonisht konsiderohen si veçori anatomike të vogla ose të parëndësishme. Nëse kthehemi për një moment te statistikat e vlefshmërisë, gjejmë se vlerat prej 7 herë *gabimin e mundshëm*, ose më shumë, janë më të dukshme në diametrin biakromial[51], në të cilin Dukagjini i tejkalon të gjithë nga forca burrërore e shtatlartësia, aq sa edhe kur janë të ulur, ata duket qartë se janë me shtat më të lartë se të tjerët. Në biakromial, Dukagjini i tejkalon të gjitha fiset tjera përveç atyre fqinje, në Malësinë e Madhe dhe Malësinë e Gjakovës. Ky tejkalim është me 10 ose më shumë herë *gabim i mundshëm,* 37 nga 69 ndryshimet ndërfisnore në 7 vëzhgime trupore arritën 4 ose më shumë herë *gabimin e mundshëm*. Këto ndryshime kishin të bënin me vithet dhe kurbën lumbare.[52] 4 nga 5 prej tyre e tejkaluan 6 herë *gabimin e mundshëm* dhe kishin përmasa të njëjta. Përsëri, mund të themi se Dukagjini është fis i veçantë.

Në matjet dhe indeksët e kokës, janë gjetur 42 ndryshime prej 7 ose më shumë herë *gabimi i mundshëm,* duke arritur një ekstrem prej 14 herë *gabimin e mundshëm* në krahasimin midis indeksit cefalik të Malësisë së Madhe dhe Lumës. Malësia e Madhe i tejkalon të gjitha fiset e tjera në gjerësinë e kokës me 7 deri në 11 herë *gabimin e mundshëm*. Ky është rezultati më i spikatur i këtij studimi.

Në matjet e kokës, bathrocefalia kryeson në diferencimin fisnor, e ndjekur kjo nga sheshtësia lambdoide. Këto dy veçori janë të përqendruara në Dukagjin, por asnjëra nuk i kalon 6 herë *gabimin e mundshëm*. Zadrima është e shquar jo aq shumë për sheshtësinë okcipitale, gjë në të cilën shfaq një ngjashmëri me Malësinë e Madhe. Dhe kjo mund të thuhet si për mungesën e sheshtësisë lambdoide ashtu edhe për bathrocefalinë.

Në fytyrë, vetëm dy veçori janë me rëndësi për t'u analizuar: Vetullat e gjera të dukagjinasit, të krahasuara ato me ato të hasjanit, të cilat arrijnë 9 herë *gabimin e mundshëm* dhe në një masë më të vogël me ato të dibranit dhe matjanit. Mjekrat bilaterale të dukagjinasve afrohen në 9 *gabimin e mundshëm,* në krahasim

51 Diametri biakromial. Kjo distancë midis pikave më të largëta të proceseve akromiale të shpatullave, që është gjerësia e shpatullave, e matur nga një akromion në tjetrin. (Shënim i përkthyesit)

52 Kurba lumbare i referohet harkimit natyror të pjesës së poshtme të shpinës (rajoni lumbar) tek njeriu, e cila ka një formë konkave drejt brinjëve. Kjo kurbë është një nga karakteristikat anatomike të trupit të njeriut dhe ka një rol të rëndësishëm për balancën dhe mbështetjen e trupit gjatë qëndrimit në këmbë dhe ecjes. (Shënim i përkthyesit)

me pukjanin, fqinjin e saj përtej Drinit, dhe 7 herë *gabimin e mundshëm* me ata të Malësisë së Madhe, të Mirditës, Zadrimës dhe Matit.

Pra, cilat janë ndryshimet e rëndësishme ndërfisnore në Malësinë e Gegnisë? Ato nuk janë as shtati, as piloziteti, as forma e kokës (edhe pse gjerësia e saj është e rëndësishme), as forma e fytyrës, por në realitet janë gjerësia e shpatullave, ndryshimet e kockës okcipitale[53] për t'u bashkuar me parietalet në mënyrë të qetë tek lambda, zgjerimi i vetullave me tendencë të mandibulës për të formuar një gungë në secilën anë të mjekrës, si një vjuzhgë në mes.

Kur kemi të bëjmë me popullata relativisht homogjene, si ky që po analizojmë në këtë studim, i cili bëhet për një segment të vogël dhe të izoluar të një vendi evropian, ndryshimet në tiparet trupore si ato që analizuam më sipër shfaqin variacione të dukshme sipas rajoneve ku jetojnë këta banorë.

Është shfaqja e këtyre ndryshimeve dhe përhapja e tyre në këtë qark të izoluar që përcakton ndyshimet tek racat. Në këtë këndvështrim në Malësinë e Gegnisë, fisi më i veçantë është Dukagjini, i cili është gjithashtu edhe më i izoluari.

53 Kocka oksipitale zakonisht i referohet një problemi zhvillimor ose strukturor me kockën oksipitale, e cila është kocka në pjesën e pasme të kafkës. Ky dështim mund të shfaqet në forma të ndryshme, si formim i paplotë, defekte ose fraktura. Këto probleme mund të ndodhin për shkak të faktorëve gjenetikë, traumave, ose kushteve të tjera që ndikojnë në zhvillimin ose integritetin e kockës. (Shënim i përkthyesit)

DIALEKTI GEGË I GJUHËS SHQIPE, SIÇ FLITET SOT, NË THELB ËSHTË ILIRISHTJA, E CILA ËSHTË GJITHASHTU E VETMJA GJUHË E MBIJETUAR NGA KY GRUP GJUHËSH QË DIKUR ISHTE SHUMË E PËRHAPUR.

MOSHA

Dimensioni i kohës nuk mund të anashkalohet kurrësesi në studimin e vetive të trupave, përfshirë edhe ato të qenieve njerëzore. Koha është masa që mat rritjen tonë deri në pjekuri dhe pastaj tkurrjen tonë deri në pleqëri. Në këtë studim të veçantë, koha na paraqet tre sfida:

1. Cili është diapazoni i serisë në terma të grupeve të moshës dhe si ndryshojnë ato në këtë aspekt në nënseritë përbërëse fisnore?
2. Si ndikon shpërndarja e moshës në krahasueshmërinë e kësaj serie me seritë e tjera?
3. Deri në çfarë mase shpjegohen këto ndryshime me moshën dhe lidhjet ndërfisnore në formë, pigment dhe pilozitet, të analizuara këto në kapitullin e fundit?

SAKTËSIA E TË DHËNAVE TË TASHME

Ndoshta jo më shumë se një duzinë të rinjësh që pyeta dhe i mata mund ta dinin saktësisht moshën e tyre ndërkohë që asnjë nga burrat e moshuar nuk e dinte moshën që kishte. Malësorët Gegë punojnë dhe argëtohen me familjet e tyre, por jo sipas grupmoshës. Asgjë në mënyrën e tyre të jetesës nuk e bën të nevojshme njohjen e saktë të moshës. Ndonjëherë, kur i bënim matjet në grup prej 20 ose 30 burrash nga i njëjti vend, vetëm disa pjestarë të gjeneratës së vjetër mund të dinin se kush ishte më i moshuari dhe rendin e lindjes së të tjerëve, por nuk e dinin moshën e secilit prej tyre. Ndonjëherë, ata mund të përcaktonin përafërsisht datën e lindjes duke u bazuar në ndonjë ngjarje historike lokale, e cila do t'u jepte një pikë referimi të dobishme. Shpesh më duhej ta bëja vetë vlerësimin e moshës bazuar në formën, konsumimin ose rënien e dhëmbëve, thellësinë e rrudhave, zbardhjen e flokëve apo dhe elementë të tjerë. Kur i pyesja për moshën e tyre, burrat zakonisht përgjigjeshin me numra të përafërt, si rreth 50, ndoshta 40, etj., dhe shumica e individëve senilëdeklaronin se ishin 100 vjeç.

TABLE 10: AGE.

TRIBE	No.	RANGE	MEAN P.E.	σ P.E.	V P.E.
Total series.....	1063	18–65+	39.40 ± .26	12.50 ± .18	31.73 ± .66
Malsia e Madhe.....	105	20–65+	38.05 ± .71	10.80 ± .71	28.38 ± 1.32
Dukagin	106	25–65+	37.80 ± .61	9.25 ± .43	24.47 ± 1.13
Malsia e Jakovës.....	104	18–65+	35.85 ± .75	11.50 ± .54	32.08 ± 1.50
Has	113	18–65+	44.30 ± .82	12.95 ± .58	29.23 ± 1.31
Luma	108	18–65+	36.70 ± .87	13.50 ± .62	36.78 ± 1.69
Puka	101	18–65+	36.10 ± .92	13.70 ± .65	37.95 ± 1.80
Mirdita	101	21–65+	43.60 ± .85	12.60 ± .60	28.90 ± 1.37
Zadrima	105	21–65+	43.70 ± .78	11.80 ± .55	27.00 ± 1.26
Mati	103	18–65+	35.80 ± .67	10.10 ± .47	28.21 ± 1.33
Dibra	108	18–65+	42.00 ± .88	13.55 ± .50	32.26 ± 1.48

Tabela 10 jep të dhëna nga seria krahasuese rreth moshave, niveleve të ndryshme dhe përqindjes së shpërndarjes për 1063 banorë të matur në të gjitha zonat e studiuara nga Prof. Coon: Malësinë e Madhe, Dukagjinin, Malësinë e Gjakovës, Hasin, Lumën, Pukën, Mirditën, Zadrimën, Matin dhe Dibrën.

Duke qenë i sigurt në aftësinë time për të vlerësuar moshën te meshkujt e bardhë të rritur që jetojnë jashtë, besoj se niveli i saktësisë në përcaktimin e moshës, kur bëhet në këtë mënyrë, duhet të ketë variacione të ndjeshme. Kështu, që për këto arësye ne përballemi me një përqindje gabimi të mundshëm jo vetëm në mostër, por edhe në saktësinë e materialit. Kjo e fundit e bën përdorimin e konstanteve statistikore të rafinuara të duket e dyshimtë. Tabela 10 merr parasysh vetëm burimin e parë të gabimit.

MOSHA NË KAMPION SI E TËRË

Po të marrim moshën si kriter ne mund të shohim se kampioni është i plotë dhe përfshin një diapazon të gjerë, nga 18 deri në 65 vjeç, e më shumë. Në secilin grup - moshë mbi 19 vjeç të përfaqësuar nga një nën – kampion, statistikat janë të mjaftueshme. Ne synojmë që kriteret tona të reflektojnë çdo fazë të jetës, nga fëmijëria e vonë deri në pleqëri. Megjithatë, duke qenë se nuk kemi mundur të sigurojmë shifra të sakta për moshën, madje as në nivelin më të ulët të saj, kemi përjashtuar të gjithë djemtë që dukeshin qartë të papjekur, pavarësisht se çfarë moshe pretendonin se kishin. Për këtë arësye, grupi i moshës 18 deri në 20 mund të jetë më i përzgjedhuri. Nga ana tjetër, unë u përpoqa të mos përfshija burra të moshuar që ishin të kërrusur, pa dhëmbë, dhe të deformuar nga sëmundjet e

plakjes senile.[1] Për këtë arësye, grupmosha më e moshuar që kam përzgjedhur mund të jetë gjithashtu e ndryshme, pasi pleqëria nuk vjen tek gjithë burrat në të njëjtën mënyrë apo në të njëjtën moshë.

Kampioni, për aq sa është i saktë, ofron një shpërndarje të moshës që është e përshtatshme për studimin racor, pasi përfshin të gjithë diapazonin e moshave në të cilat kriteret racore shprehen në mënyrë të plotë. Ajo gjithashtu mund të përdoret në një masë të kufizuar për të studiuar ndryshimet e moshës.

PERCENTILE DISTRIBUTION

	No.	PER CENT
18–20	12	1.1
21–24	99	9.3
25–29	155	14.6
30–34	166	15.6
35–39	162	15.3
40–44	129	12.1
45–49	103	9.7
50–54	88	8.3
55–59	52	4.9
60–64	56	5.3
65+	41	3.8
	1063	100.0

Megjithatë, ky nuk mund të zëvendësojë studimin e ndryshimeve vit pas viti te të njëjtëve individë. Një studim i tillë është i vështirë për t'u realizuar, pasi vëzhguesi jeton në të njëjtën shkallë kohore si subjektet e tij. Ndryshimet e moshës të studiuara në individë të ndryshëm kanë aplikime shumë të kufizuara dhe studjohen rrallë. Nëse kampioni është gjenetikisht konstant në gjeneratat e hulumtuara (dhe mund të themi, se kjo ndodh me studimin tonë), atëherë ndryshimet midis grupeve të moshave pasqyrojnë ndryshime që kanë ndodhur mes individëve të përfshirë këtu. Në këtë mënyrë, mund të themi se mund të shpresohet në gjurmimin e ndryshimeve progresive që ndodhin për shkak të ndikimeve mjedisore që veprojnë mbi organizmin, si drejtpërdrejt ashtu edhe përmes agjencisë[2] së përzgjedhjes gjenetike.

NDRYSHUESHMËRITË FISNORE NË MOSHË

Tabela 10 gjithashtu na tregon se mosha mesatare ndryshon në varësi të krahinave. Dallimi midis moshës së kampionit më të ri, që ishte në Mat, dhe kampionit të

1 Plakja senile është procesi i plakjes që karakterizohet nga ndryshime fizike dhe mendore që ndodhin si pasojë e moshës së avancuar. Në këtë fazë, individët mund të përjetojnë një rënie të funksioneve trupore dhe mendore, përfshirë dobësimin e muskujve, reduktimin e energjisë, ndryshimet në përceptimin mendor dhe humbjen e kujtesës. Plakja senile shpesh lidhet me sëmundje si demenca apo sëmundja e Alzheimerit, por nuk është domosdoshmërisht e njëjtë me këto gjendje. Ajo përfshin të gjitha ndryshimet e natyrshme që ndodhin me moshën. (Shënim i përkthyesit)

2 Fjala "agjenci" në këtë rast ka kuptimin e një faktori ose procesi që ka një ndikim dhe ka rol në formësimin e ndryshimeve gjenetike. (Shënim i përkthyesit)

Hasit, që ishte kampione më i vjetër, është 8.5 vjet, ose 8.45 herë më shumë. Ky dallim është ndoshta mjaft i madh për të qenë i vlefshëm, edhe kur merret parasysh gjykimi im në përcaktimin e moshave për subjektet. Nga këndvështrimi i kampioneve, shumica e fiseve ndryshojnë ndjeshëm nga njëri tjetri në mesataren e moshës, megjithëse diapazoni i moshës së secilit është praktikisht i njëjtë. Gjashtë nga dhjetë fise ndryshojnë nga mesatarja totale më shumë se tre herë në përqindjen e gabimit të mundshëm.

Në pasqyrat statistikore të mëposhtme, sa herë që krahasojmë kampionet fisnore me njëra tjetrën, duhet të kujtojmë se ekziston një diapazon i mundshëm prej 8 vitesh në mesataret e moshës nga 36 deri në 44 vjeç. Pra nuk duhet ta konsiderojmë të rëndësishëm ndonjë ndryshim në rajone të caktuara në ndonjë kriter. Por duhet të shohim sesa ndryshon ky diapazon 8 - vjeçar i moshës në serinë si tërësi. Kjo çështje bëhet më e ndërlikuar nga fakti se disa kampione fisnore kanë një shpërndarje më të madhe të moshës sesa të tjerat. Kjo mund të matet me vlerat e devijimit standard. Dukagjini ka një devijim standard prej 9.25 vitesh, ndërsa Puka prej 13.7 vitesh.

Këto janë rastet e skajshme. Dallimi prej 4.45 vitesh është 5.71 herë më i madh se gabimi i mundshëm, duke e bërë atë statistikisht të rëndësishëm. Ky ndryshim në ndryshueshmëri mund të pritet të ndikojë edhe në mesataret e tyre, në disa raste. Në një karakteristikë ku vlerat më të larta gjenden në grupmoshën 35 - 39 vjeç dhe kemi dy kampione, secila me një moshë mesatare prej 38 vitesh, kampione me vlerën më të ulët të devijimit standard **σ** Sigma, mund të pritet të shfaqë mesataren më të lartë. Kjo është një arësye tjetër pse duhet të lejojmë më shumë fleksibilitet sesa zakonisht në interpretimin e rëndësisë statistikore në aspektin e ndryshimeve midis kampioneve brenda një fisi, krahasuar këto me kampionet e marra nga fise të tjera.

MOSHA DHE FORCA

Asnjë kriter i vetëm nuk mund të përshkruajë më mirë shëndetin, pjekurinë dhe fuqinë e një burri sesa forca e tij muskulore. Tabela 11 paraqet vlerat e shtrëngimit të dorës në paund për të gjitha grupmoshat nga 20 - 24 deri në 75 -89 vjeç, si dhe për grupmoshën e kombinuar 65 - 89 vjeç. Ndër 78 krahasime të mundshme, duke përjashtuar kombinimin, 44 prej tyre arrijnë tre ose më shumë

TABLE 11: AGE AND STRENGTH, IN POUNDS.

AGE	#	RANGE	MEAN P.E.	σ	V
20–24...	107	60–160	112.80 ± 1.11	17.10	15.20
25–29...	154	75–170	115.00 ± .93	17.10	14.86
30–34...	164	50–180	114.60 ± 1.00	19.00	16.61
35–39...	163	70–185	115.30 ± 1.07	20.15	17.42
40–44...	125	45–170	112.10 ± 1.16	19.25	17.16
45–49...	106	50–150	103.65 ± 1.36	20.85	20.15
50–54...	88	65–140	103.90 ± 1.17	16.25	15.64
55–59...	51	50–140	103.35 ± 1.65	17.45	16.83
60–64...	58	50–130	96.05 ± 1.46	16.55	17.20
65–69...	15	50–115	91.00 ± 2.65	15.20	16.82
70–74...	14	70–130	95.70 ± 3.02	16.70	17.46
75–89...	11	75–110	90.00 ± 2.34	11.50	12.78
65–89...	40	50–130	92.40 ± 1.62	15.05	16.30

Tabela 11 jep të dhëna rreth moshës dhe forcës në masën peshuese në pound (një pound është i barabartë me 0.4536 kg), të matur për të gjitha zonat e studiuara nga Prof. Coon: Malësinë e Madhe, Dukagjinin, Malësinë e Gjakovës, Hasin, Lumën, Pukën, Mirditën, Zadrimën, Matin dhe Dibrën.

herë gabimin e mundshëm. Kur llogarisim grupmoshën 65 e tutje si të kombinuar, rezultati është 31 nga 55. Njëmbëdhjetë nga këto ndryshime e tejkalojnë 9 herë gabimin e mundshëm. Malësorët tanë arrijnë kulmin e fuqisë së shtrëngimit të dorës në fund të të 30-ave, pastaj bien ngadalë gjatë gjysmës së dekadës dhe dobësohen më shpejt pas moshës 45 vjeç. Ky kombinim i ndryshimeve fiziologjike, i reflektuar në këtë kurbë, shfaqet qartë në karakteristikat metrike dhe morfologjike që pasojnë.

MOSHA DHE KARAKTERISTIKAT METRIKE TË ZGJEDHURA

Tabela 12 paraqet kuptimin e 7 karakteristikave metrike të zgjedhura. Për shkak të mungesës së kohës dhe hapësirës për të llogaritur dhe paraqitur mesataret e grupeve të moshës për të gjitha kriteret, kam zgjedhur disa prej tyre që kanë rëndësi të veçantë për problemet e këtij studimi dhe që janë në interes të përgjithshëm. 12 të rinjtë që ndoshta kanë lindur pas vitit 1910 nuk janë të mjaftueshëm për një analizë të plotë statistikore. Edhe pse ata devijojnë nga tendencat e treguara nga grupet e tjera të moshës, kjo nuk mund të interpretohet me siguri. Kjo është për të ardhur keq, pasi shumë nga seritë më të mëdha në literaturën evropiane përfaqësojnë vetëm këtë grupmoshë, të matur si rekrutë. Lartësia në serinë tonë ndryshon shumë pak me kalimin e viteve (fig. 4). Vetëm 6 nga 55 ndryshimet midis grupmoshave arrijnë tre herë gabimin e mundshëm, dhe vetëm një arrin katër herë atë. Kjo ka pak rëndësi. Duke gjykuar nga tendenca e mesatareve, malësorët tanë arrijnë kulmin e lartësisë në të njëjtën kohë kur janë më të fortë: Pra, në fund të të 30-ave.

Rritjet në të dy skajet e shkallës mund të përfaqësojnë përzgjedhje, gjë që e

kemi përmendur dhe më parë. Në çdo rast, nuk ka prova që popullsia malore po rritej në shtatlartësi gjatë 30 viteve të fundit të shekullit të 19 - të dhe 20 viteve të para të shekullit të 20 - të. Që nga viti 1865 deri në vitin 1929, shumica e popujve të Evropës Perëndimore dhe amerikanët përjetuan një rritje të qëndrueshme të gjatësisë trupore. Cilëtdo qofshin faktorët që e shkaktonin këtë në perëndim, në malet e Shqipërisë së Veriut kjo dukuri nuk u shfaq. Ky përfundim mund të konfirmohet nga një studim i bërë me 17 çifte vëllezërish. Në 9 raste, më i madhi ishte më i gjatë se më i vogli,[3] ndërsa në 8 raste, më i vogli ishte më i gjatë se më i madhi.

TABLE 12: AGE GRADE MEANS FOR SELECTED METRICAL CHARACTERS.

Age	Birth Year	No.	Stature	Head Length	Head Breadth	Head Height	Bizygomatic	Cephalic Index
18–19	1911 ca.	12	173.25	182.75	154.99	128.50	137.00	85.25
20–24	1908	99	169.73 ± .44	186.27 ± .50	156.24 ± .39	130.02 ± .42	140.60 ± .35	83.90 ± .32
25–29	1903	155	169.24 ± .34	185.63 ± .37	157.00 ± .35	128.57 ± .31	141.67 ± .28	84.71 ± .24
30–34	1898	166	169.79 ± .39	186.54 ± .36	157.86 ± .24	127.77 ± .24	142.33 ± .30	84.66 ± .20
35–39	1893	162	170.46 ± .35	186.22 ± .37	158.22 ± .29	128.19 ± .27	142.65 ± .27	85.02 ± .21
40–44	1888	129	170.14 ± .44	185.46 ± .47	159.03 ± .40	128.73 ± .36	142.85 ± .30	86.14 ± .28
45–49	1883	103	170.13 ± .48	186.90 ± .41	158.75 ± .40	128.74 ± .43	143.20 ± .37	84.87 ± .26
50–54	1878	88	169.01 ± .41	186.99 ± .53	157.99 ± .43	127.26 ± .27	143.09 ± .43	84.41 ± .31
55–59	1873	52	169.41 ± .55	185.54 ± .59	157.45 ± .61	126.64 ± .62	143.85 ± .52	85.04 ± .42
60–64	1868	56	167.34 ± .57	185.20 ± .51	157.38 ± .49	127.77 ± .48	142.70 ± .45	85.23.± .33
65 +	1865	41	170.18 ± .62	187.61 ± .73	157.22 ± .56	128.78 ± .66	143.10 ± .36	83.28 ± .44

Age	Birth Year	No.	Total Face Height
18–19	1911 ca.	12	122.40
20–24	1908	98	121.90 ± .49
25–29	1903	153	121.87 ± .34
30–34	1898	163	123.93 ± .25
35–39	1893	151	124.05 ± .36
40–44	1888	111	123.99 ± .44
45–49	1883	85	124.45 ± .48
50–54	1878	61	124.85 ± .49
55–59	1873	30	125.16 ± .72
60–64	1868	37	125.92 ± .68
65 +	1865	16	126.69 ± 1.35

Tabela 12 jep të dhëna rreth moshës, shkallës dhe karakteristikave metrike, duke përfshirë: shtatin, gjatësinë, gjerësinë, lartësinë, indeksin cefalik, gjatësinë e kokës, gjerësinë e kokës, datëlindjen, vitin, numrin e pjesëmarrësve në total dhe peshën. Të dhënat janë të matur për të gjitha zonat e studiuara nga Prof. Coon

3 Material Icelandic ngaHannesson, 1925 (Shënim i autorit)




FIG. 4. Age and stature.[3]

Figura 4 tregon moshën dhe shtatin, si dhe shtesën e popullsisë në Islandë. Popullsia e qëndrueshme në Malet e Gegnisë as shtohet, as pakësohet. Po ashtu, figura ilustron grupmoshat ndër dekada.

Shtati mesatar i më të moshuarve ishte 171.72 centimetra, ndërsa i më të rinjve ishte 171.47 centimetra. Mosha mesatare e më të moshuarve ishte 41 vjeç, ndërsa e më të rinjve ishte 33 vjeç. Në Amerikë dhe gjetkë ku rritja është në proces, vëllezërit më të vegjël janë më të gjatë se ata më të mëdhenjtë.[4] Ky studim mbi lartësinë nënkupton atë që ndryshimet midis grupmoshave janë aq të vogla sa që krahasimet tona ndërfisnore të lartësisë nuk kanë nevojë për korrigjim moshe. Ne mund t'i krahasojmë Gegët tanë me seritë më të reja, pasi burrat mbi 50 vjeç do të balancojnë ata në të 30 - at dhe 40 - at. Ndryshimet në madhësi të ngjashme me ato të vërejtura në disa vende të tjera nuk po ndodhin në dimensionin kryesor sagital[5] të organizmit, dhe e njëjta gjë është ndoshta e vërtetë edhe për organizmin në tërësi.

4. 'Bowles, 1932. (Shënim i autorit)

5 Dimensioni sagital i organizmit është një term që i referohet përmasës së trupit nga përpara në prapa, pra gjatësia që shkon nga faqja e përparme e trupit deri te faqja e pasme. Në kontekstin anatomik, kjo përfshin matjen ose analizën e strukturave të trupit në planin sagital, që është plani vertikal që ndan trupin në dy gjysma të barabarta, të djathtë dhe të majtë. (Shënim i përkthyesit)

Gjatësia e kokës e tregon variacion të moshës më pak sesa lartësia. Në fakt, asnjë ndryshim midis mesatareve të 11 grupmoshave nga 20 vjeç e tutje nuk është statistikisht i rëndësishëm. Për më tepër, nuk shfaqen trende të qarta ndryshimi edhe nëse ato janë të vogla përsa i përket përcjelljes së mesatareve. Por kjo ndofta fillon vetëm gjatë periudhës së mplakjes midis 55 dhe 64 vjeç. Ndryshe nga kjo, në gjerësinë e kokës, mesataret rriten në mënyrë të qëndrueshme dhe të rregullt deri në grupmoshën 40 - 44 vjeç, dhe pastaj bien me të njëjtën rregullsi. Kjo sekuencë ka kuptim, dhe këtë e përforcon fakti që 6 nga ndryshimet midis mesatareve të grupmoshave janë statistikisht të rëndësishme. Indeksi cefalik pasqyron gjerësinë e kokës, me të njëjtën sekuencë, dhe me 9 ndryshime prej 3 ose më shumë herë me *gabimin e mundshëm,* nga të cilat 3 e tejkalojnë shifrën 4 të ndryshimit dhe një e tejkalon shifrën 5. Ky kombinim është i pazakonshëm. Dikush pret që gjatësia e kokës të zmadhohet me moshën dhe pastaj të bjerë gradualisht ndërsa pjesët e buta hollohen. Këtu, barrën e ndryshimit të moshës e tregon gjerësia. Ndryshimi prej 2 pikësh në indeksin cefalik që shoqëron këtë fenomen nuk mund të jetë tregues i ndryshimeve ndërfisnore në atë karakter, pasi fiset që pritet të jenë më brahicefalike me kalimin e moshës janë më pak të tillë, dhe anasjelltas.

Ndërsa, përsa i përket lartësisë së kokës, 6 janë ndryshimet e rëndësishme nga ana statistikikore nga 55 ndryshime të tilla që ekzistojnë zakonisht. Dy prej tyre janë mbi 4 ndërsa një është mbi 5. Megjithatë, tabela nuk tregon ndonjë tendencë të lartë ndryshueshmërie. Lartësitë më të larta dhe më të ulëta alternohen në mënyrë të rastësishme. Provat e tanishme nuk janë të mjaftueshme për të zbuluar nëse ndonjë faktor tjetër përveç rastësisë është në lojë këtu.

Me kalimin e moshës fytyra pëson ndryshime të tjera nga ajo e kafkës së kokës (fig. 13). Kjo situatë është e njëjtë me atë që i ndodh njeriut kudo tjetër. Diametri bizigomatik vazhdon të rritet deri në fund të të 40 - ave, kur stabilizohet, 11 nga 55 ndryshime janë të rëndësishme, 6 janë mbi 4 dhe 2 mbi 5 herë *gabimin e mundshëm*. Lartësia e plotë e fytyrës rritet vazhdimisht gjatë gjithë jetës por mesataret nuk stabilizohen kurrë. 16 ndryshime janë të rëndësishme, me 8 mbi 4.00 dhe 1 mbi 5.00 herë *gabimin e mundshëm*. Kjo do të thotë që Gegët tanë Malësorë mund të dallohen për gjatësinë dhe gjerësinë më të madhe të fytyrës, krahasuar me seritë e tjera evropiane. Kjo dhe për shkak të moshës së tyre më të avancuar. Pa dyshim, kjo vlen edhe më shumë për diametrat e hundës dhe indeksin nazal, të cilët nuk u renditën këtu pasi nuk ndryshojnë me kampionet

ndërfisnore. Por, përmasat e fytyrës së tyre ndryshojnë në planin ndërfisnor dhe kështu që kërkojnë vlerësim të mëtejshëm.

MOSHA DHE PJESËT E CAKTUARA TË BUTA TË FYTYRËS

Një numër mospërputhjesh janë vënë re midis moshës dhe disa pjesëve të buta të fytyrës, por nuk mund t'i japim të gjitha me detaje. Në tabelën 13, janë paraqitur vetëm ato elementë në të cilët ndryshimet e moshës luajnë një rol me interes për ne, në këtë studim. Për t'i përcatuar ato, përdoren tre teknika të ndryshme krahasuese, prej të cilave njërën po e përdorim edhe ne, pasi është e re. *Integumenti*[6] i buzëve rritet në mënyrë të qëndrueshme, megjithëse jo shumë, deri në të 50-at, pas së cilës sjellja e tij është e ndryshueshme, gjë që mund të shpjegohet për shkak të rënies së dhëmbëve. Kur dhëmbët mungojnë, është më e vështirë të vëzhgohet kjo dukuri sesa kur ato janë të pranishëm.

TABLE 13: MEAN AGES, IN YEARS.

	Abs. No.	Abs. Mean	ssm No.	ssm Mean	sm No.	sm Mean	+ No.	+ Mean	++, +++ No.	++, +++ Mean
Lips, integ. thick					22	(46.18)	908	38.69	133	43.54
Lips, membr. thick	91	51.29	19	(48.84)	455	42.00	467	35.52	31	36.04
Nasal tip thick			31	38.13	371	38.50	544	39.61	117	42.05
Ear lobe, develop.					434	36.66	568	40.14	61	49.10

Nasal Wings:	No.	Mean	*Nasal Profile:*	No.	Mean
Compressed	383	38.75	Concave	69	36.67 ± .96
Medium	621	39.98	Straight	414	37.83 ± .35
Flaring	61	37.82	Convex	569	40.89 ± .36
			Concavo-convex	11	(38.82)

Nasal Tip, Elevation-Depression	No.	Mean
Elevation ++	36	36.45
" +	332	37.68
" sm	230	38.39
Depression sm	173	40.32
" +	256	40.46
" ++	36	42.97

6 Integumenti i buzëve në sensin antropologjik i referohet strukturës së lëkurës dhe indeve që mbulojnë buzët. Integumenti përfshin lëkurën, mukozën dhe shtresat nënlëkurore të buzëve, që janë përgjegjëse për formën dhe funksionet e tyre. Në studimet antropologjike, integumenti i buzëve vëzhgohet për të kuptuar ndryshimet dhe variacionet mes popullatave të ndryshme, pasi trashësia, forma dhe ngjyra e buzëve mund të tregojnë dallime etnike apo gjeografike. (Shënim i përkthyesit)

MEAN VALUES OF FOUR OBSERVATIONS*

					Nasal Profile, by Percentages							
	LIPS,	LIPS,	NASAL TIP	EAR LOBE	CONCAVE		STRAIGHT		CONVEX		CONCAVO-CONVEX	
AGE	INTEG.	MEMBR.	THICK.	DEV.	#	%	#	%	#	%	#	%
18–20.....	50.0	43.8	33.3	35.4	2	16.7	6	50.0	4	33.3		
21–24.....	50.2	42.2	44.1	37.4	9	9.1	51	51.5	38	38.4	1	9.1
25–29.....	51.4	40.7	41.1	37.9	13	8.4	59	38.1	81	52.3	2	18.2
30–34.....	52.3	40.1	40.5	37.4	9	5.4	68	41.0	86	51.8	3	27.3
35–39.....	51.8	36.0	41.8	40.1	10	6.2	66	40.7	85	52.5	1	9.1
40–44.....	54.8	33.0	44.0	42.6	6	4.6	50	38.8	72	55.8	1	9.1
45–49.....	54.4	32.1	46.2	43.2	9	8.7	36	35.0	57	55.3	1	9.1
50–54.....	55.1	31.2	44.9	43.5	5	5.7	39	44.3	44	50.0		
55–59.....	51.0	26.4	45.7	45.9	3	5.8	13	25.0	36	69.2		
60–64.....	54.5	24.3	44.5	50.0	3	5.4	15	26.8	37	66.1	1	9.1
65 + ...	50.6	18.0	42.4	49.7			11	26.8	29	70.7	1	9.1

Tabela 13 tregon Moshat Mesatare ndër vite, Dhe lerat mesatare në katër vëzhgimet në përqindje dhe në karakteristikat tjera.

Përndryshe, sipas vëzhgimeve tona, membrana e buzëve hollohet me kalimin e moshës. Marrëdhëniet midis këtij karakteri dhe karakteristikave të ndryshme dentare, siç është okluzioni, do të diskutohen në kapitullin e ardhshëm. Për momentin, mjafton të thuhet se pjesërisht pamja e buzëve të Malësorëve të Gegnisë, që është e ngjashme me atë të George Washington-it, shfaqet për shkak të moshës. Lobi i veshit gjithashtu rritet në mënyrë të qëndrueshme, ngadalë deri në fillim të të 50 - ave, dhe pastaj rritet më shpejt. Flegrat e hundës ndryshojnë pak. Maja, megjithatë, trashet gradualisht deri në fund të të 40 - ave dhe pastaj hollohet dalëngadalë.

8 Termi "Upper Palaeozoic rocks" i referohet shkëmbinjve që janë formuar gjatë pjesës së fundit të erës Paleozoike, e cila përfshin periudhat e fundit të kësaj ere, si Karboni dhe Permi (rreth 359 - 252 milionë vjet më parë). (Shënim i përkthyesit)

9 Strata të Mesozoikut-Eocenit, përgjatë të dy anëve të Drinit në Shosh, Nikaj dhe fshatrat veriore të Pukës i referohet shtresave gjeologjike (strata) që janë formuar gjatë periudhave Mesozoike dhe Eocene, dhe që ndodhen përgjatë të dyja anëve të lumit Drin në zonat e Shoshit, Nikajve, dhe në fshatrat veriore të Pukës. (Shënim i përkthyesit)

10 Mbulesa gëlqerore e periudhës terciare që ndërpret vijueshmërinë e Gabros në Shqipëri ndodhet kryesisht në rajonin e Matit dhe Mirditës, ku formacionet sedimentare kanë mbuluar Gabrot si rezultat i lëkundjve tektonike dhe sedimentare. (Shënim i përkthyesit)

11 Gëlqerorja numulitike Dalmato-Malazeze (Dalmato-Montenegrin nummulithic limestone) është një lloj gëlqerore e periudhës së Tretë (Tertiary) që përfshin formacione gëlqerore të pasura me fosile të llojit nummulites. Nummulites janë fosile të lidhura me një grup të veçantë ameboidësh që jetonin në detet e kohës së Tretë dhe janë përdorur për të datuar dhe karakterizuar formacionet gjeologjike. (Shënim i përkthyesit)

- it,[12] në Zadrimë, mundëm të kryejmë matje vetëm në 41 burra. Shembulli 13 tregon se kjo ndryshueshmëri në madhësi gjendet vetëm në krahinën e vogël gëlqerore të Matit, e cila është statistikisht e pamjaftueshme për t'u marrë në konsideratë si provë shkencore. Në tabelën 21 jepen mesataret për këto 6 kampione fisnore në 12 matje përkatëse. Në përgjithësi, ato përsërisin pamjen e treguar nga shpërndarja fisnore dhe në disa aspekte e theksojnë atë. Në tabelën 21 janë paraqitur mesataret për këto 6 kampione fisnore në 12 matje përkatëse. Në përgjithësi, këto mesatare përsërisin pamjen e shpërndarjes fisnore dhe në disa aspekte e theksojnë atë. Kur krahasojmë pesë të parat, duke bërë 15 krahasime për 12 karaktere, gjejmë 65 nga 180 ndryshime të mundshme që janë të rëndësishme, ose 36%. Nga këto, 28 (16%) janë më shumë se 6 herë për shkak të ndryshimit të ndjeshëm, 14 (8%) janë mbi 8 herë për shkak të ndryshimit të ndjeshëm, dhe 6 (3%) janë mbi 10 herë për shkak të ndryshimit të ndjeshëm. Mesatarët për zonat në vetvete nuk e tejkalojnë atë fisnore, sepse zonat janë hapësira më përfshirëse se fiset e veçanta që ndodhen brenda tyre. Ata bien në mes të fiseve dhe serive totale në ndryshueshmëri, siç është treguar në tabelën 21 nga vlerat σ Sigma.[13] Secila nga zonat gjeologjike padyshim përmban një numër enklavash të vogla lokale, ashtu si Zvicra gjatë viteve 1800. Për të gjetur vlera më të ulëta për σ, Sigma, do të duhej të studionim këto lugina dhe fshatrat brenda tyre, një nga një. Por për fat të keq, kampioni ynë nuk është mjaftueshmërisht i madh sa të ndihmojë për një fragmentim të tillë. Vlefshmëria e ndarjes së serisë totale në krahinat gjeologjike tregohet më qartë në shifrat e pjesës së tretë të tabelës 21, në të cilën janë renditur së bashku mesataret e lartësisë për të gjitha segmentet përbërëse të fiseve që banojnë në secilën krahinë gjeologjike.

Në çdo rast përveç njërit, mesataret e segmenteve të fiseve individuale ndryshojnë nga njëra tjetra në drejtimet e mesatareve të tyre zonale dhe u ngjajnë këtyre mesatareve zonale më shumë sesa i ngjajnë njëra tjetrës.

Përjashtim bën vetëm Malësia e Gjakovës, e ndarë midis gëlqerorës dhe pjesëve të tjera jo të tilla. Këto dy zona janë pothuajse të njëjta në lartësi, ndërkohë

12 Flysh është një lloj formacioni sedimentar që zakonisht rezulton nga një sekuencë e shtresave të ndryshme të rërës dhe llucës. Këto shtresa shpesh depozitohen në mjedise detarë të thellë, dhe termi "flysh" mund të referohet si në formacionin gjeologjik ashtu edhe në llojin e shkëmbit. (Shënim i përkthyesit)

13 Në antropologji, shkronja greke sigma (σ) shpesh përdoret për të përfaqësuar "devijimin standard" në kontekste statistikore. Devijimi standard është një masë e sasisë së variacionit ose shpërndarjes në një grup vlerash. Në kërkimin antropologjik, kjo mund të përdoret për të përshkruar variacionin në një grup të dhënash, siç janë matjet e karakteristikave fizike, praktikat kulturore, ose ndryshimet tjerë që studiohen. (Shënim i përkthyesit)

që dallimi midis segmenteve fisnore është i papërfillshëm. Katër burrat e tjerë nga ky fis që jetonin në territorin e vargmaleve ishin shumë më të shkurtër, me një mesatare gjatësie trupore prej 168 centimetra. Jo vetëm që burrat nga territori i vargmaleve ishin të shkurtër në përgjithësi, por midis tyre kishte shumë pak individë që janë të gjatë, pra nga 180 deri në 190 centimetra, krejtësisht ashtu siç përshkruhen Gjigantët Gegë.

Këto figura mbresëlënëse shihen kryesisht në veri të Drinit. Disa shfaqen pranë zonës gëlqerore në veri të Matit, ku një mostër e vogël sugjeron se mund të gjendet një enklavë burrash të gjatë. Nga një këndvështrim statistikor, ndarja më domethënëse brenda një fisi është ajo që ndan Dibrën në nëngrupe vargmalesh dhe pjesën lindore. Dallimi midis mesatareve është 3.07, që është 3.49 herë për shkak të ndryshimit të ndjeshëm. Për të testuar këtë në lidhje me mundësinë e një ndryshimi gjenetik, zgjodha karakterin e vetëm në të cilin Dibra është më dalluese, ngjyrën e syve kafe të çelur, dhe i rendita nëngrupet sipas këtij karakteri.

Nga 15 burra që kishin sytë me këtë ngjyrë, 7, ose 19%, ishin nga territori vargmalor perëndimor, ndërsa 8, ose 11%, nga ai lindor. As pjesa tjetër e vargmaleve dhe as pjesa tjetër e lindjes nuk i afrohen këtyre frekuencave. Në këtë karakter, që është padyshim gjenetik, Dibra mbetet ende një njësi e veçuar nga krahinat tjera që e rrethojnë. Edhe pse fragmentimi i serisë është i pafrytshëm për shkak të vogëlsisë së nëngrupeve, një shembull mund të tregojë se çfarë lloj informacioni mund të pritet kur enklavat lokale do të studiohen.

Siç u përmend më parë, në Dukagjin ekziston ekzogamia e ndërsjellë. Ndërsa në Shosh ndodh endogamia lokale, por më rrallë. Shala duket se ndodhet në zonën e gëlqerorëve, ndërsa Shoshi në zonën vargmalore. Burrat e Shalës, nënat e të cilëve vijnë nga Shoshi, janë 4.04 centimetra më të gjatë (shih tabelën 21, pjesa e fundit) se burrat e Shalës, nënat e të cilëve janë vendase, dhe kjo diferencë është 5.53 herë më e madhe sipas statistikave duke marrë parasyshë *gabimin e mundshëm*. Njëkohësisht, burrat e Shalës që kanë nëna nga Shoshi janë 3.37 centimetra më të gjatë se kushërinjtë e tyre, pra burrat e Shoshit që kanë nëna nga Shala, dhe kjo diferencë është 2.88 herë më e madhe se *gabimi i mundshëm*. Njerëzit që jetojnë në zonën e gëlqerorëve veriore janë jo vetëm më të gjatë se të tjerët, por gjithashtu kanë krahë më të fuqishëm, shpatulla më të gjëra dhe në përgjithësi janë më të fortë. Ata janë më të mëdhenj dhe më të fuqishëm. Banorët e zonës së ultësirës së Gegënisë u afrohen atyre në madhësinë e trupit, ndërsa banorët e zonës së

vargmaleve janë më të vegjël në të gjitha aspektet, veçanërisht në krahë dhe në këmbë. Në mënyrë të veçantë, banorët e zonës së fushës janë më të vegjëlit nga të gjithë. Pavarësisht nëse ka ndonjë rëndësi apo jo ky fakt ne duhet ta theksojmë se këta të fundit jetojnë në kufirin e një zone malarike. Banorët e zonës lindore janë afër mesatares së serisë totale në matjet dhe përmasat e trupit, por dallohen nga të tjerët në ato të kokës dhe fytyrës. Këta banorë, krahasuar me të tjerët, kanë koka dhe fytyra më të ngushta dhe më të gjata.

TABLE 21: ANTHROPOMETRIC MEANS AND GEOLOGICAL AREAS.

	TOTAL	FLYSCH	LIMESTONE	FOLDED	SERPENTINE	EASTERN	MAT. L.
Squeeze	112.09	102.95±1.94	116.55±.79	111.95±1.20	105.55±.73	110.70±.74	102.33
(No.)		(41)	(237)	(126)	(354)	(294)	(13)
Stature	169.71±.14	165.87± .80	173.04±.27	171.87± .34	167.22±.22	169.92±.26	167.55
Rel. span ...	103.94±.05	104.74± .30	104.58±.12	104.00± .14	103.22±.10	103.56±.11	101.88
Rel. sh. br..	22.76±.02	22.55± .12	23.08±.05	22.76± .08	22.66±.05	22.68±.05	23.42
Rel. sit. ht...	52.76±.03	53.67± .19	52.55±.06	52.59± .09	52.91±.06	52.76±.07	53.12
Head lgth...	186.18±15	181.47± .57	188.12±.29	188.76± .44	184.32±.24	186.21±.26	187.88
Head br. ...	157.78±.12	157.44± .56	159.92±.26	157.38± .33	157.88±.21	156.57±.24	155.85
Head ht. ...	128.34±.12	128.63± .67	128.67±.26	129.08± .33	128.22±.17	127.95±.24	123.69
Ceph. index	84.84±.09	86.71± .40	85.17±.18	83.34± .25	85.59±.15	84.18±.17	83.07
(No.)	(921)	(39)	(204)	(115)	(298)	(252)	(7)
Tot. face ht.	123.90±.14	122.00± .72	124.80±.31	121.85± .44	122.60±.24	126.45±.33	126.40
(No.)	(921)	(39)	(204)	(115)	(298)	(252)	(7)
Up. face ht..	73.55±.11	71.25± .57	73.75±.23	72.20± .30	73.10±.19	74.95±.21	72.00
Bizygomatic	142.35±.12	140.90± .65	144.05±.22	142.50± .32	141.70±.19	141.80±.21	139.30

VALUES OF σ FOR AREAS, TOTAL SERIES, AND TRIBES

	FIVE AREAS	TOTAL	TRIBES
Stature	6.44	6.72	6.38
Rel. span	2.67	2.56	2.48
Rel. shoulder br.....	1.26	1.20	1.16
Rel. sitting ht.....	1.60	1.50	1.46
Head lgth.....	6.59	7.08	6.65
Head br.	5.72	6.00	5.67
Head ht.....	6.04	6.03	5.87
Cephalic index.....	4.12	4.29	4.03
Total face ht.....	6.83	6.50	6.29
Upper face ht.....	4.95	5.00	4.89
Bizygomatic	5.49	5.65	5.80

STATURE MEANS FOR GEOLOGICALLY SEPARATED SEGMENTS OF TRIBES

LIMESTONE			FOLDED			SERPENTINE			EASTERN			FLYSCH		
MeM	105	172.77	Duk	20	173.20	Puk	40	168.25 ± .72	Has	113	170.82	Zad	34	165.72
Duk	78	174.36	MeJ	48	172.87	Mir	101	166.68	Lum	109	169.47			
MeJ	52	172.48	Puk	57	170.23 ± .47	Zad	70	167.72	Dib	74	169.53 ± .52			
			Puk*	13	170.85	Mat	92	166.68						
Mat	12	168.25				Dib	35	166.46 ± .71						

* Thirteen men from the village of Puka, eating bread from a bakery which uses flour from all parts of the tribe.

STATURE MEANS INSIDE DUKAGIN

FATHER	MOTHER	NO.	MEAN
Shala	Shala	48	172.83
Shala	Shoshi	30	176.87 ± .46
Shoshi	Shala	16	173.50 ± 1.08
Shoshi	Shoshi	4	171.98

Tabela 21 ofron një pamje të plotë me krahasime numerike rreth mesatareve të të dhënave antropometrike dhe zonave gjeologjike. Ajo paraqet vlerat e tyre, si dhe seritë totale dhe fisnore. Gjithashtu, në këtë tabelë tregohen mesataret për segmentet e fiseve të ndara sipas zonave gëlqerore, vargmaleve, etj.

Edhe forma e kokës (siç tregohet në figurat 14 dhe 15) ndjek të njëjtën ndryshueshmëri si kjo e fiseve. Matja e vetme që nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme është lartësia e kokës. Por në të njëjtën kohe, diametri i kokës tregon ndryshimin më të madh nga çdo karakter tjetër i regjistruar. Duke llogaritur një modul cefalik[14] mbi mesataret, gjejmë që zonat janë grupuar në dy grupe: Ato gëlqerore dhe të palosura, me 158.90 dhe 158.41 centimetra përkatësisht, dhe ato Flish[15] vargmale në lindje me 155.65, 156.71 dhe 156.9, këto me koka të mëdha dhe koka të mesme deri të vogla.

Madhësia e kokës, brenda një grupi të madh racor të njeriut, shkon në proporcion me madhësinë e trupit. Në një seri si e jona, ku përmasat e kokës janë subjekt i një variacioni të madh me origjinë të dyshimtë, madhësia e kokës është një kriter më i dobishëm për qëllimin e këtij kapitulli sesa komponentët e saj. Ajo i ndan qartë Gegët e Malësisë në dy kategori: Një me kokë të madhe dhe një me kokë të mesme deri të vogël. Kjo sepse, përveç matjeve dhe indekseve individuale, dallimet më të theksuara deri tani janë gjetur midis segmenteve rajonale të serisë totale. Pra njerëzit në zonën e karstit të gëlqerorëve janë të mëdhenj, e për rrjedhojë dhe të afërmit e tyre në vendin ku toka është e mbuluar nga një përzierje shtresash të ndryshme, janë gjithashtu të mëdhenj.

Njerëzit që jetojnë në tokat e vargmaleve dhe të Gabros janë dukshëm më të vegjël, ashtu si edhe kampioni i vogël e banorëve të zonës së *Flishit* afër Kukësit e Dibrës. Në lindje, në luginën e Drinit të Zi dhe deri në rajonin e Prizrenit, njerëzit kanë shtat të ndërmjetëm, por kokat dhe fytyrat e tyre janë relativisht të gjata dhe

14 Cephalic module = $\frac{L+B+Ht}{3}$. (Shënim i autorit)

15 Vargmalet Flish ndodhen në veri të Shqipërisë, në rajonin e Kukësit dhe të Dibrës. (Shënim i përkthyesit)

të ngushta. Përveç të dhënave të paraqitura, u kryen klasifikime për disa vëzhgime që mund të lidhen me forcën e përgjithshme të trupit. Kjo përpjekje nuk zbuloi asgjë që klasifikimet fisnore nuk e kishin treguar tashmë. Në këtë element nuk u gjet asnjë ndryshim midis zonave në përqindjen e skapulave konkave,[16] të cilat duket se lidhen më shumë me moshën sesa me ushqimin. Së fundi, dhëmbët e banorëve të të gjitha krahinave u panë se ishin njësoj të prishur dhe me të njëjtën frekuencë të rënë.

STATUSI SHOQËROR DHE USHQYERJA

Në shumë vende, ushqimi dhe përfitimet e tjera shpërndahen në mënyrë të pabarabartë, dhe në disa prej tyre pjestarët e klasave të privilegjuara kanë trup më të gjatë se bashkëqytetarët e tyre më pak të favorizuar. Në Malet e Gegëve nuk ekziston një sistem klasor i tillë që të jetë i stereotipizuar. Megjithatë, në çdo fis disa burra mbajnë rang më të lartë shoqëror se të tjerët dhe mund të vërehet një dallim i vogël në pasuri. Pasuria dhe pushteti zakonisht ecin paralelisht. Duke përdorur të dhënat e diskutuara në kapitullin 5, mbi "Politikën dhe Gjakmarrjen", kam ndarë 66 mbajtës të posteve, 23 nga territori i gëlqerorëve dhe 43 nga vargmalet.

TABLE 22: GEOLOGY AND STATURE, OFFICE-HOLDERS.

	LIMESTONE			SERPENTINE		
	No.	MEAN		No.	MEAN	
Total	237	173.04	.34	354	167.22	.22
Office-holders ..	23	174.09	.78	43	167.63	.57

Tabela 22 i referohet mesatares së lartësisë së trupit të individëve në zonat gjeografike ku jetojnë Gegët. Ky koncept përdoret në antropologji dhe gjeografi për të studiuar variacionet e lartësisë trupore në lidhje me faktorë të ndryshëm, siç janë mjedisi, gjenetika dhe praktikat kulturore. Gegët përfaqësojnë një shembull të mirë të këtij variacioni, duke ofruar informacion të vlefshëm për lidhjen midis lartësisë trupore dhe kushteve të jetesës.

Grupi i fundit përfshinte familjen dhe vartësit e Princit Gjon Marka Gjoni (fig. 10, a), kryetari fisnor i Mirditës. Këta burra kishin marrë më të mirën që ajo tokë mund të ofronte. Siç tregohet në tabelën 22, kjo nuk solli ndonjë ndryshim të dukshëm në gjatësinë e trupit. Në ato male, një kryetar fisi ulet pranë një sofre të madhe, i rrethuar nga vartësit e tij. Çdo vizitor është i lirë, edhe ai, të ulet

16 Konkave - "Concave scapulae" i referohet një gjendjeje ku sipërfaqja e brendshme e skapulës (kocka e shpatullës) është e lakuar ose konkave. (Shënim i përkthyesit)

rreth sofrës bujare të princit. Mbajtësit e detyrave pranë Princit ndoshta hanë më shumë mish sesa njerëzit e tjerë më të varfër. Megjithatë, të gjithë ushqehen me të njëjtat produkte bulmeti, bukë dhe bishtajore, të cilat vijnë nga i njëjti burim natyror i kultivuar përreth tyre.

PËRFUNDIMI

Megjithëse harta gjeologjike mbi të cilën bazohet ky studim kishte një karakter shumë të përgjithshëm, duket se ka qenë mjaft e saktë për të arritur qëllimin tonë. Mineralet e kësaj zone, të cilat i tregon edhe harta, mund të kenë ndikim në madhësinë e trupit dhe qëndrueshmërinë fizike të banorëve ashtu si edhe në popullata të tjera. Në rastin tonë ky studim i veçantë zbulon një tendence ndryshueshmërie pjesërisht të rastësishme lindje - perëndim në formën e kokës dhe fytyrës, e cila do të diskutohet më vonë. Cilat minerale, nëse ka, janë të përfshira në këto variacione të madhësisë të kokës, si asimilohen, (nëse asimilohen), dhe si ndikojnë në rritjen e kokës, (nëse ndikojnë)? Por këto janë kërkime shkencore që nuk lidhen me objektin e këtij punimi dhe për më tepër janë jashtë kompetencës së autorit të këtij studimi. Nëse ky hulumtim në fushën e ushqimit ka ndonjë vlerë, kjo vlerë realisht qëndron në faktin që kemi eleminuar hamendjet e mundëshme mbi ndikimet e faktorëve të tjerë që mund të shkaktonin dallime në shtatlartësinë e banorëve të këtyre zonave.

LITERATURA MBI TEMËN E DEFORMIMIT TË KAFKËS ËSHTË MBULUAR ME AFTËSI NGA DINGWALL, I CILI CITON DISA RASTE SHQIPTARE KU ËSHTË VËREJTUR DEFORMIMI I QËLLIMSHËM - MEKANIK, (I SHKAKTUAR NGA LIDHJA NË DJEP)

LIDHJA E FOSHNJAVE NË DJEP

PROVAT E MBLEDHURA

Në vitin 1939 kam shkruar:

> Ka pasur shumë diskutime mbi temën e sheshtësisë oksipitale,[1] si në Shqipëri ashtu si edhe në Azinë e Vogël. Në të vërtetë ekzistojnë dy teori të mirëfillta mbi këtë fenomen, njëra që beson se ky është një fenomen i natyrshëm dhe i përcaktuar nga ana racore dhe tjetra që beson se është një formë deformimi artificial i shkaktuar nga lidhja e foshnjave në djep.
>
> Pozicioni im qëndron diku midis këtyre dy teorive shumë të ndryshme nga njëra tjetra. Teoria e sheshtësisë oksipitale tek raca dinarike sipas mendimit tim është pa dyshim një fenomen i shkaktuar nga pozicioni mekanik i vendosjes së kafkës, pra nga lidhja në djep e bebeve."[2] Ndërsa në shumicën e racave të tjera unë mendoj se ky fenomen është i lidhur me pozicionin e foramen magnum[3] të pjesës së pasme të kafkës, dhe si e tillë, është padyshim e trashëguar.
>
> Në të njëjtën kohë, përdorimi i djepit në rastin shqiptar, në të cilin trupi dhe supet e foshnjës janë të lidhura, por koka nuk është lidhur, mund të ketë ndihmuar në formimin e këtij rrafshi pas kokës, pasi kokat e disa shqiptarëve janë vërtetë pak si të sheshta. Megjithatë, duke qenë se përdorimi i djepit, ku përkunden foshnjat, është i njëjtë në të gjithë Shqipërinë, përhapja e këtij fenomeni në tërë territorin merr natyrën e një cilësie plotësisht racore.[4]

---

1 Termi "Occipital flattening" (sheshtësi oksipitale) i referohet një gjendjeje ku pjesa e pasme e kafkës, veçanërisht zona e kockës oksipitale (e vendosur në pjesën e poshtme dhe të pasme të kafkës), është më e rrafshët se normalisht. Kjo mund të jetë e shkaktuar nga faktorë natyrorë (si pjesë e variacionit të formës së kafkës në grupe të ndryshme raciale) ose nga faktorë të jashtëm, si pozicionimi i fëmijëve në krevat, ku koka e tyre mund të mbështetet për një kohë të gjatë në një sipërfaqe të fortë. Pra, "occipital flattening" nënkupton një formë të rrafshët të pjesës së pasme të kafkës, që mund të jetë ose një karakteristikë e lindur ose një deformim i shkaktuar nga faktorë të jashtëm. (Shënim i përkthyesit)

2 Carleton S. Coon, vetë citim.

3 Termi "Foramen magnum" në antropologji i referohet hapjes së madhe në bazën e kafkës, nëpër të cilën kalon palca kurrizore për t'u lidhur me trurin. (Shënim i përkthyesit)

4 'Coon, 1939, p. 600. (Shënim i autorit)

Gjithashtu në një shënim që lashë, premtova:

"Do të publikohet një studim i detajuar mbi këtë çështje në veprën *"Antropologjia Fizike e Shqipërisë Veriore"*, që ishte titulli i përkohshëm i kësaj monografie." Që atëherë janë mbledhur fakte të reja të disa "rasteve" që mund të merren edhe si prova të "shumicës së rasteve." At Ewing[5] bëri një studim dhe arriti në përfundimin se fëmijët libanezë të lindur në Brooklyn e kanë shumë më pak të rrafshët kokën mbrapa krahasuar kjo me kokat e prindërve të tyre. Po ashtu, dy studentë të diplomuar në Universitetin Harvard, z. David de Harport dhe z. William Laughlin, që punuan nën drejtimin tim, gjetën të njëjtën gjë midis Toskëve të Shqipërisë që jetojnë në Greater Boston.[6]

Gjatë punimit të kësaj monografie, kanë dalë gjashtë prova të tjera. Në kapitullin 10, i cili flet për "*Fenotipin*, pra karakteristikat trupore të Gegëve të Malësisë," dhe tabelën 4, pamë që raportet e σ - Sigma - s për gjatësinë dhe gjerësinë e kokës, si dhe indeksin cefalik, janë në një masë të madhe të larta, si në tërësi ashtu edhe brenda fiseve. Kjo vlen, veçanërisht, për indeksin cefalik. Në të njëjtin kapitull, duket se dukuritë fisnore ndryshojnë më shumë nga njëra tjetra dhe nga mesataret e përgjithshme në këto tre karakteristika dhe në indeksin e gjerësi - lartësi, sesa në ndonjë kriter tjetër, përveç diametrave të përgjithshëm të trupit, të cilët i kemi trajtuar më parë në kapitullin 13, mbi "*Tokën*". Në të njëjtin kapitull, gjetëm se fiset ndryshojnë nga njëri - tjetri më dukshëm dhe më ndjeshëm në shtatë vëzhgime të kafkës, veçanërisht në bathrocafali, sheshtësi oksipitale dhe sheshtësi lambdoide. Gjithashtu pamë se frekuencat e shkallëve të sheshtësisë morën formën e një kurbe normale, krejtësisht të pavarur nga kategoria e emërtuar "mungon". Nëse sheshtësia do të ishte natyrale, do të pritej që "*sm*" të tejkalonte "+", "+" të tejkalonte "++", etj., në frekuencën e tyre.

Në kapitullin 11, i cili flet për "Moshën," u zbulua se gjatësia e kokës nuk ndjek ndryshimet normale ose të pritura të moshës, por gjerësia e kokës zgjerohet dhe ngushtohet me moshën, duke shfaqur kështu një tendencë të dyanëshme. Në kapitullin 13, i cili flet për "Tokën" u arrit në përfundimin se forma e kokës, në përgjithësi, ndjek rrugën e saj gjeografike, pa marrë parasysh ndarjet e zonave tokësore që shënojnë aq qartë kufijtë fizikë të përmasave të trupit në tërësi dhe të kokës në veçanti. Çdo një nga këto sinjale të kuqe alarmante që shfaqen nëpër

5 Ewing, 1947, ff. 235-36, Ehrich and Coon, 1848, ff 187-86. (Shënim I autorit)
6 "Coon, 1939, p.600. . (Shënim I autorit)

kapituj do të kishte qenë e mjaftueshme për të na paralajmëruar se diçka është e habitshme në lidhje me formën e kokës, në këtë seri. Në fakt, nuk ka asnjë sinjal të gjelbër. Në asnjë segment të këtij studimi kafkat nuk janë sjellë siç pritet në një popullatë normale. Fjala "normal" në këtë kuptim iu referohet serive të mëdha të studiuara në të kaluarën, dhe shumica e këtyre studiuesve që i kanë kryer ato, kanë qenë nga Evropa Perëndimore dhe Amerika moderne.

Me kalimin e kohës, ndoshta do të tregohet se shumë popuj të botës kanë koka të krahasueshme me ato të shqiptarëve. Ne tashmë e dimë që kjo është e vërtetë për armenët, libanezët dhe malazezët dhe ndoshta mund të tregohet edhe për popullata të tjera evropiane.

Literatura mbi temën e deformimit të kafkës është mbuluar me aftësi nga Dingwall,[7] i cili citon disa raste shqiptare ku është vërejtur deformimi (molding[8]) i qëllimshëm - mekanik, (i shkaktuar nga lidhja në djep). Studiuesia Margaret[9] Hasluck[10] e konfirmon këtë për Maqedoninë dhe ka një punim mbi këtë temë që ajo po shkruan për Shqipërinë. Është e vështirë të përcaktohet nëse deformimi i kafkës në Shqipëri i shkaktuar prej faktorëve mekanikë, pra (nga lidhja në djep) ka qënë i qëllimshëm dhe sa ka qënë rezultat i pavetëdijshëm i trajtimit të foshnjës duke e lidhur atë në djep.

TEKNIKAT E LIDHJES SË FËMIJËS NË DJEP[11]

Nënat shqiptare, ashtu si çdo nënë në vende të tjera, përballën me problemin e kujdesit për fëmijët. Një grua e re duhet të dalë në fushë për të punuar ose në treg

7 Dingwall, 1931. (Shënim i autorit)

8 Në antropologji, "molding" i referohet konceptit të "modelimit kulturor," i cili sugjeron se sjellja njerëzore formohet kryesisht nga proceset e enculturimit dhe ekspozimit, sesa vetëm nga faktorët biologjikë. Ky term thekson se si individët adoptuan normat, vlerat dhe sjelljet kulturore përmes proceseve të socializimit, duke ndikuar në rolet e tyre brenda shoqërisë. Ai tregon natyrën dinamike të kulturës dhe ndikimin e saj në formësimin e përvojës dhe rolit njerëzor. (Shënim i përkthyesit)

9 Margaret Hasluck (1885–1948) ishte një shkencëtare, albanologe, arkeologe, dhe gjuhëtare skoceze e njohur për punën e saj të thelluar mbi kulturën, gjuhën dhe traditat e Shqipërisë. E lindur në Elgin, Skoci, ajo studioi në Universitetin e Aberdeenit dhe në Universitetin e Oksfordit. Hasluck ishte një nga studiueset më të rëndësishme të Shqipërisë në fillim të shekullit të 20-të dhe ka lënë një trashëgimi të rëndësishme shkencore për kuptimin e Ballkanit dhe posaçërisht Shqipërisë. Ajo erdhi për herë të parë në Shqipëri në vitin 1923 dhe kaloi një periudhë të gjatë studimesh dhe hulumtimesh në vend. Ajo zhvilloi interesa të thella në fushën e antropologjisë kulturore dhe folklorit shqiptar. Hasluck jetoi në qytetin e Elbasanit për një kohë të gjatë dhe u njoh me zakonet e shqiptarëve, për të cilët shkroi me shumë detaje në shkrimet e saj. Një nga veprat e saj më të njohura është "The Unwritten Law in Albania" (Ligji i pashkruar në Shqipëri), një libër që studion kanunin shqiptar dhe sjelljet e përditshme të shqiptarëve në atë kohë. . (Shënim i përkthyesit)

10 Hasluck, 1947 ff. 130-31. .(Shënim i autorit)

11 Teknika e mbështjelljes së fëmijëve është një praktikë që ka qenë e zakonshme në shumë kultura, përfshirë edhe Shqipërinë. Në këtë teknikë, fëmijët vendosen në një djep ku supet janë të lidhura, por koka mbetet e lirë. Kjo mund të ndikojë në formën e kafkës së fëmijës, duke shkaktuar sheshtësi oksipitale ose deformime të tjera. (Shënim i përkthyesit)

për të bërë pazar, por si mund ta lërë fëmijën e saj vetëm? Përveç kësaj, nëse ajo do të mungojë për një kohë të gjatë, duhet ta ketë fëmijën me vete për ta ushqyer.

Kur nëna shqiptare është në lëvizje, ajo nuk mund t'i zërë duart vetëm duke mbajtur fëmijën në krahë. Koha e ecjes, për të është edhe koha e tjerrjes në Shqipëri. Këto janë disa nga arësyet praktike për përdorimin e djepit. Arësye të tjera janë edhe ato emocionale dhe historike. Djepi është pjesë e kulturës shqiptare, ashtu si *vatra* dhe *tezgjahu* të cilat janë simbolet materiale të aktiviteteve të burrave, grave dhe fëmijëve në familje. Gjyshërit e Gegëve janë rritur në djep. Ata ishin burra të mençur, bujarë dhe luftëtarë të guximshëm.

Pasi është larë, bekuar dhe mbështjellë, foshnja vendosej në djep, i cili ishte i shtruar me pelena të buta. Atij i vendosej poshtë kokës një jastëk i butë që ia mbronte kokën nga fortësia e drurit të djepit. Jastëku mund të kishte llojshmëri të ndryshme, si për shembull mund të ishte i hollë, i trashë apo i butë. Foshnja lidhej në djep, dhe djepi merrej në shpinë.

Kjo mënyrë e mbajtjes së foshnjës e mbronte atë nga lëkundjet ndërsa shpatullat e tij qëndronin të sheshta. Ai mund të lëvizte kokën aq sa ia lejonte ky pozicion nga që trupi ishte i lidhur. Kështu pra, koka nuk është e lidhur, dhe pozicioni më i lehtë për të pushuar është drejtpërdrejt mbi kockën oksipitale. Të shumtën e kohës, fëmija qëndron, fle, ushqehet, qan dhe qesh në djep, duke qëndruar ashtu i lidhur në të për orë të tëra. Dhe kjo zgjat nga gjashtë muaj deri në një vit, ose edhe më shumë.

Pas kësaj periudhe, foshnja vishet me rroba dhe fillon të lëvizë lirshëm. Nxjerrja nga djepi bëhet në mënyrë graduale. Nëna e nxjerr fëmijën herë pas here për të parë nëse ai mund të qëndrojë ulur. Kur fëmija arrin të qëndrojë vetë, nëna e ul mbi një qilim ndërkohë që ajo punon, deri sa të vijë koha që ta heqë plotësisht nga djepi.

Si armenët ashtu edhe shqiptarët thonë se ka dy faktorë që e përcaktojnë moshën kur fëmija nxirret nga djepi: E para është "forca" e tij, ose aftësia për të "qëndruar "ulur pa u rrëzuar dhe e dyta është dëshira e prindërve për ta lënë atë të ecë me këmbët e veta.

Një foshnjë "e fortë" do të nxirret nga djepi më shpejt sesa një foshnjë "e dobët." Ndryshimi në kohë midis gjashtë muajsh në djep mund të jetë pikërisht periudha kur ndodhin ndryshime që ndihmojnë në dallimin midis mungesës së sheshtësisë së dukshme dhe një rasti kur kjo sheshtësi bie shumë më shumë në sy.

Njeriu ka tendencën të mendojë se kockat e një foshnje "të fortë" do të ishin më rezistente ndaj deformimeve sesa ato të një foshnje "të dobët," veçanërisht nëse dobësia është reflektim i ushqyerjes jo të mirë. Dhe kjo është evidente në një vend si Shqipëria ku ushqimi është i kufizuar. Duhet thënë se ky fenomen është më i pranishëm në shumë pjesë të Maleve të Gegnisë.

Pra, kur shqyrtohet ky fenomen si dëshirë apo zgjedhje e vetë prindërve për ta mbajtur fëmijën e tyre në djep, ne gjejmë arësye të mjaftueshme për të shpjeguar variacionet në frekuencën e sheshtësisë së pjesës së prapme të kokës. Në këtë kontekst, mund të ndikojnë edhe faktorë të tjerë si ushqyerja, kushtet mjedisore dhe praktikat kulturore të ndryshme. Të gjitha këto pra lidhen me trajtimin e foshnjave dhe ndikojnë në formimin e kokës së tyre gjatë periudhës së hershme të jetës.

Falë bujarisë së z. Dmitri Peterson, i cili jeton në Somerville, në Massachusetts, patëm mundësinë të studionim nga afër një model të tillë djepi. Z. Peterson e kishte mësuar zanatin e marangozit në Shqipëri, kur ishte i ri dhe kishte prodhuar shumë djepe të tillë.

Megjithëse z. Peterson ishte nga jugu i Shqipërisë, fotografitë që kisha bërë dhe kujtimet për djepet që kisha parë në Gegni ishin shumë të ngjashme me djepin që kishte bërë z. Peterson. Djepi i bërë prej tij përbëhet kryesisht nga dy dërrasa. Një dërrasë e poshtme shtrojë mbi të cilën shtrihet foshnja dhe një dërrasë e vendosur tek koka që e mbron majën e kokës së foshnjës. Gjithashtu janë edhe disa dërrasa të tjera që vendosen anash bazamentit të djepit. Dy prej tyre vendosen anash. Në këmbët e djepit ka një dërrasë tjetër, e cila është e njëjtë me atë të kokës, por e prerë në formë gjysmëhëne për të lejuar që këmbët e foshnjës të zgjaten nëpër të, nëse ai përpiqet të bëjë një gjë të tillë duke i shtrirë këmbët përtej gjatësisë së shtratit të djepit.

Djepi i përshkruar në figurën 11, 4, nga ana tjetër, ka një brez të bërë me fije për të mbështjellë kokën dhe një dërrasë të ulët për të vënë kokën. Dërrasa e këmbëve është e ulët, por e drejtë. Ky djep është fotografuar në Zadrimë. Baroni Nopça e ilustron një djep tjetër nga "Planti (Gebiet von Pulti, ndoshta Pulti) , që unë mendoj se është në Malësinë e Madhe (fig. 11, d).

Në veprat e Haberlandt – it, janë paraqitur dy djepe të ngjashëm me atë të z. Peterson. Njëri është nga Shkodra (fig. 11, b), ndërsa tjetri i përket Vllehëve në Shqipërinë Qendrore (fig. 11, c). Të dy këta djepe janë të llojit të njëjtë si ai i z. Peterson, me një dërrasë për kokën dhe një dërrasë të lakuar për këmbët. Nëse

dikush do të kryente një studim të detajuar të llojeve të djepave në malet e Gegëve, fis për fis dhe fshat për fshat, ndoshta do të zbulonte variacione në formën dhe përdorimin e tyre. Këto variacione mund të ndihmojnë në shpjegimin e dallimeve lokale në formën e kokës gjithashtu. Për shembull, ndoshta nuk është rastësi që djepi i Zadrimës nuk ka dërrasë për kokën, ndërsa kampioni nga Zadrima ka një nivel të lartë të sheshtësisë oksipitale dhe një nivel shumë të ulët të sheshtësisë lambdoide. Kjo mund të sugjerojë se tipi i djepit ka një ndikim të rëndësishëm në formën e kokës së foshnjave në këtë zonë.

Nuk përjashtohet mundësia që një foshnjë që rritet në djep dhe i mbështet këmbët në dërrasën e fundi të djepit mund të shtyjë kokën kundër dërrasës së kokës, nëse djepi do të kishte një të tillë, dhe kjo natyrshëm mund të shkaktojë sheshtësi lambdoide. Nga ana tjetër, edhe një jastëk i pjerrët mund të ketë të njëjtin efekt.

Ndonjëherë, të dyja këto lloje të sheshtësisë mund të shfaqën në të njëjtën kokë. Ka mundësi që fëmija të ketë patur fillimisht sheshtësi oksipitale dhe më pas, kur është hequr nga djepi, të shfaqë sheshtësi lambdoide. Nëse gjatë zhvillimit të sheshtësisë, bashkimi i kockave parietale me kockën oksipitale pengohet dhe ndodh një rritje e parregullt e kockave, kjo mund të çojë në zhvillimin e anomalisë së quajtur bathrocephaly.[12]

Në disa raste, është e mundur që bathrocephaly - a të jetë efekti i vetëm i dukshëm pas përdorimit të djepit. Ky fenomen shfaqet kur kockat marrin formë gunge në vend që të rrafshohen. Për të studiuar shkencërisht këtë fenomen nevojitet një punë studimore eksperimentale shumë më e gjerë mbi këtë temë. Deri atëherë mund të themi se çdo supozim mbetet pjesërisht spekulativ, pasi këto lloje deformimesh ndodhin edhe në koka fëmijësh që nuk janë lidhur në djep, megjithëse këto shfaqën shumë më rrallë dhe në një shkallë shumë më pak të dukshme.

PËRQASJA MIDIS LLOJEVE TË DEFORMIMEVE

Në figurën 7 janë dhënë frekuencat dhe përqindjet e kategorive të ndryshme të rrafshimit oksipital, rrafshimit lambdoid dhe bathrocefalisë. Tabela 23 tregon se si këto tre fenomene janë të lidhura. Më pak se një e treta (31.40%) e burrave kishin koka të pa-sheshuara dhe 27 për qind gjithashtu nuk kishin bathroceph-

12 Bathrocephaly është një term mjekësor që përshkruan një deformim ose formë të pazakontë të kafkës, ku pjesa e pasme e kafkës (occipiti) është e ngritur ose më e lartë se normalja. (Shënim i përkthyesit)

aly. Këta 27 për qind ishin padyshim të përkundur në djep si të tjerët. Ndoshta ata ishin foshnje "të forta" dhe u "nxorën" nga djepi më herët, ose ndoshta kishin jastëkë më të butë se të tjerët. Se çfarë i shkaktoi këto ndryshime në secilin rast, ne nuk arritëm ta kuptojmë. Nga dy të tretat e burrave që mbeten, konstatojmë se ata që kanë një lloj sheshtësie, në shumë pak raste shfaqin formën tjetër të rrafshimit të kokës. Tabela katërfish në fund të Tabelës 23 jep një koeficient të asocimit prej 0.69, që është shumë negativ.[13] 68 burrat, ose 6 për qind e serisë, që i kanë të dyja llojet e sheshtësisë, nuk arrijnë të futen në kategorinë +++ në asnjërin plan.




FIG. 7. Cephalic index frequencies.

Figura 7 jep indekset e frekuencave cefalike dhe llojet e deformimeve.

Bathrocephaly - a është ngushtësisht e lidhur me sheshtësinë lambdoide me një koeficient të shoqërimit prej +0.84, por për qëllime praktike do ta lëmë mënjanë këtë lidhje për pjesën tjetër të këtij kapitulli. Ne mund ta bëjmë këtë vetëm pasi të kemi konsideruar 49 burrat që kishin bathrocephaly pa asnjë sheshtësi fare. Këta 49 burra kanë një indeks mesatar të kokës prej 82.41 ± 0.35, që është pothuajse i njëjtë me indeksin e 286 burrave që nuk kishin sheshtësi, i cili është 82.97 ± 0.15. Kështu që duket plotësisht e justifikueshme që këto t'i përfshijmë ata në kategorinë e fundit.

13 Yule's formula. $Q=\frac{ad-bc}{ad+bc}$; Arkin and Colton, 1947, p.100 (Shënim i autorit)

TABLE 23: TYPES OF FLATTENING.

		Occipital Flattening					
		Abs.	sm	+	++	+++	Total
Lambdoid Flattening	Abs.	335	22	164	66	10	597
	sm	98	8	4	—	—	110
	+	275	7	43	2	—	327
	++	27	—	2	2	—	31
	+++	2	—	—	—	—	2
	Total	737	37	213	70	10	1067

	Combinations of Flattening		Bathrocephaly and Flattening: Bathrocephaly Absent		Bathrocephaly Present		
	No.	%	No.	%	No.	%	Total
No flattening	335	31.40	286	85.37	49	14.63	100.00
Occipital only	262	24.56	254	97.21	7	2.79	100.00
Lambdoid only	402	37.66	183	45.52	218	54.48	100.00
Both	68	6.38	34	50.00	34	50.00	100.00
Total	1067	100.00	757		308		

	Occipital		Bathrocephaly		
Lambdoid	Abs.	Pres.	Lambdoid	Abs.	Pres.
Abs.	335	262	Abs.	540	56
Pres.	402	68	Pres.	217	252
	Q = −.69			Q = +.84	

Tabela 23 jep një pamje shifrore të tipave të sheshtësimit, duke përfshirë kombinimet e brachycephaly dhe sheshtësimit oksipital dhe brachycefalik.

PROVAT RRETH VËLLEZËRVE

Në serinë e matjeve tona, ne identifikuam 13 çifte vëllezërish dhe 4 grupe me nga 3 vëllezër. Pozicionet e tyre në lidhje me praninë ose mungesën e dy llojeve të sheshtësisë kraniale janë treguar në tabelën 24. Kjo tabelë është e vështirë për t'u interpretuar, kryesisht për shkak të numrit shumë të vogël të individëve. Në çiftet e vëllezërve, duket se ka një tendencë që të dy ose asnjëri të kenë kafka të sheshuara nga mbrapa kokës pavarësisht nga shkalla e rrafshimit. Në grupet me nga 3 individë, numrat janë shumë të vegjël për të nxjerrë përfundime me rëndësi, përveçse mund të sugjerojnë se e njëjta nënë mund të ketë lindur djem që ndryshonin nga njëri - tjetri përsa i përket formës së kokës.

Në këndin e sipërm, në anën e djathtë të tabelës, numrat në kllapa përfaqësojnë përmasat e pritshme në secilën nga 4 klasat. Kjo në rastin kur grupi prej 17 familjeve përbën një kampion të rastësishëm të të gjithë serisë. Kur kombinojmë "vetëm lambdoid - in" dhe "vetëm oksipital - in", shohim se *P është – i pranishëm, dhe atë që †A mungon.

	Bathrocephaly	
Lambdoid	Abs.	Pres.
Abs.	540	56
Pres.	217	252

Q = + .84

Table 24: Head Flattening Among Brothers.

	Pairs of Brothers	
	Occip.	Lambd.
Both brothers	4	2
Older only	1	3
Younger only	3	2
Neither	5	6
	13	13 pair

Combinations Within Families
Both Pairs & Sets of Three

Both types	5	(5)
Occipital only	7	(4)
Lambdoid only	3	(6)
Neither	2	(2)

Four Sets of Three Brothers

	Occipital			Lambdoid		
Birth Order	1	2	3	1	2	3
#1	P*	A†	P	A	A	A
#2	A	A	A	P	P	A
#3	P	A	P	A	P	A
#4	P	A	A	A	A	A

Tabela 24 jep një pamje shifrore të tipave të sheshtësimit midis vëllezërve, duke shqyrtuar kombinimet ndërmjet anëtarëve të familjeve, përmes analizës së katër çiftëve të vëllezërve në tiparet oksipital, lambdoid etj.

I MAJTI OSE I DJATHTI, ASIMETRIA DHE SHESHTËSIA

Në tabelën 4 pamë që më shumë se një e treta e serisë së matjeve tona kishte koka asimetrike. Kjo është një përqindje e lartë. Por, rezultoi se asimetria e fytyrës, nga ana tjetër, ishte e papërfillshme. Me një sasi shumë të lartë të asimetrive kraniale (nëse jo në të gjitha), sheshtësitë shfaqen në forma të pazakonta. Ky fenomen ia vlen të hulumtohet më tej. Kjo pasi ekziston mundësia që asimetria e fytyrës dhe ajo e kokës të jenë të lidhura. Megjithatë, duhet që së pari të shpjegohet se si e përcaktuam shkallën e asimetrisë në kampionet që ne i matëm. Një kafkë asimetrike mund të jetë më e fryrë në njërën anë ose në tjetrën. Kur një kafkë ishte më e fryrë në të majtë, ne e kategorizonim si asimetri kraniale të majtë, dhe kur ishte

TABLE 25: HANDEDNESS, ASYMMETRY, AND FLATTENING.

OCCIPITAL

ASYMMETRY	ABS.	PRES.
ABS.	549	188
PRES.	131	199

Q = + .63

LAMBDOID

ASSYMMETRY	ABS.	PRES.
ABS.	387	210
PRES.	293	177

Q = + .06

OCCIPITAL FLATTENING ABSENT

CRANIAL ASYMMETRY	HANDEDNESS L	HANDEDNESS R
L	7	47
R	5	127

Q = + .58

OCCIPITAL FLATTENING PRESENT

	HANDEDNESS L	HANDEDNESS R
L	12	45
R	2	138

Q = + .89

Tabela 25 tregon për krahun që përdorin individët e ndryshëm të Malësisë së Gegëve, duke specifikuar se cili krah përdoret më shpesh, ai i djathtë apo ai i majtë. Tabela paraqet eksperimente shumë bindëse dhe shifra për secilin krah. Tabela 25 tregon një tendencë të qartë që burrat me sheshtësi oksipitale kanë gjithashtu asimetri kraniale. Pothuajse gjysma e kokave me sheshtësi oksipitale janë gjithashtu asimetrike. Por, burrat me sheshtësi lambdoide mund të kenë ose jo asimetri kraniale. Në këtë rast, lidhja është rastësore. Dhe kjo duket mjaft logjike nëse sheshtësia ose rrafshimi shkaktohet nga përkundja në djep. Një foshnjë që shtrihet në shpinë mund të përpiqet të kthehet në njërën anë dhe nëse zakonisht zgjedh të njëjtën anë, pritet që ajo anë të ketë pjesën më të madhe të sheshtimit. Nga ana tjetër, nëse maja e kokës së një fëmije është e shtypur nga ana e kokës së krevatit, atëherë nuk ka shumë rëndësi se nga cila anë ai do të kthehej. Mënyra për të testuar këtë teori të dytë është të shqyrtohet nëse sheshtësia oksipitale është e lidhur me prirjen e mbajtes së kokës në anën e djathtë. Frekuencat për prirjet nga e djathta janë dhënë në tabelën 4.

në anën tjetër e kategorizuam si asimetri kraniale të djathtë. Kur kafka ishte edhe asimetrike edhe e sheshtë, forma e sheshtësisë flet për atë që deformimi kishte ndodhur edhe në anën e kundërt të saj.

Ne testuam prirjen për përdorimin e dorës së djathtë duke vëzhguar se cilën dorë përdorte personi për të marrë dinamometrin dhe nëse ai shfaqi hezitim, i kërkohej të gjuante një gur. Vetëm 7% e atyre ishin të majtë. Kjo duket e arsyeshme për një vend ku pothuajse askush nuk është i shkolluar dhe ku detyrimet për përdorimin e dorës përfshijnë kryesisht aktivitetet e të ngrënit dhe punët e përditshme. Tabela 25 gjithashtu tregon se përdorimi i dorës së djathtë është i lidhur me asimetrinë kraniale në çdo rast. Tek burrat që nuk kishin sheshtësi oksipitale, koeficienti i lidhjes ishte +0.58, ndërsa tek ata që kishin sheshtësi oksipitale, lidhja ishte pothuajse e plotë me një koeficient prej +0.89. Kjo na bën të arrijmë në përfundimin se foshnjat që përdornin dorën e djathtë kishin një tendencë të mbanin kokën majtas, për të liruar krahun e djathtë dhe të shikonin me syrin e djathtë, ndërsa foshnjat

që ishin të majta kishin prirjen të bënin të kundërtën. Do të ishte shumë e habitshme nëse këto lëvizje do të deformonin kafkën, ose do të ishin të lidhura me një deformim të tillë, po të mos ishte ndikimi i djepit.

PROVAT E BOSTONIT

Prova më e mirë për të vërtetuar një tezë sigurisht që është eksperimenti. Megjithëse ishte e pamundur ta realizonim këtë eksperiment me Gegët, një gjë e tillë që na nevojitej aq shumë u krye gati rastësisht, me një grup prej disa mijëra Toskësh. Pak para Luftës së Parë Botërore, banorët e një fshati të tërë nga Shqipëria i quajtur Katundi, u shpërngulën dhe u vendosën në Amerikë. Shumica e tyre u vendosën në lagjet e Bostonit, ku u bashkuan me të tjerë nga fshatrat fqinjë. Problemet antropologjike që paraqet ky migracion ende nuk janë studiuar tërësisht, prandaj hulumtimi i tyre duhet të sjellë shumë risi në vitet që vijnë. Për momentin, mund të quhet vetëm një fillim i mbarë, i cili shërben vetëm për ua po studimin tonë.

Gjatë dimrit të viteve 1946 - 47, dy studentë të diplomuar nga Departamenti i Antropologjisë në Universitetin Harvard, pavarësisht angazhimeve të tyre në klasat përkatëse, e morën iniciativën për të matur dhe vëzhguar një mostër të kolonisë shqiptare. Ky kampion merrej me të lindurit në Shqipëri dhe të lindurit në Amerikë (fig. 16), duke përfshirë ata që kishin qenë të lidhur në djep gjatë foshnjërisë dhe ata që nuk ishin lidhur në djep.

Ata arritën të masnin 37 shqiptarë të rritur të të dy gjinive, që kishin lindur në Shqipëri dhe ishin lidhur në djep, si dhe 30 të tjerë, gjithashtu të të dy gjinive, të lindur në Amerikë, nga të cilët vetëm 12 ishin 20 vjeç ose më të mëdhenj në moshë. Tabela 26 jep rezultatet për kategoritë e sheshtësisë oksipitale dhe lambdoide. Vetëm një person i lindur në Shqipëri nuk kishte asnjë lloj sheshtësie. Ky individ ishte z. Peter Peterson. Fotografia e tij mund të shihet në pllakën 14, figura 3, të librit "Racat e Evropës."

Me një indeks cefalik prej 91.5, ai është një argument i gjallë që përkundja në djep mund të rrisë në disa raste indeksin cefalik pa shkaktuar sheshtësim. Personat me një indeks të tillë cefalik që nuk janë përkundur janë jashtëzakonisht të rrallë. Gati tre të katërtat e tyre kishin sheshtësim oksipital, ndërsa dy të tretat gjithashtu kishin sheshtësim lambdoid. Nga ata që i kishin të dyja, 46% kishin

sheshtësim të theksuar në të dyja anët, të ndara nga një kënd. Tre individë ishin sheshtësuar në një kënd të tillë që e bënte të nevojshme t'i vendosnim diku midis dy kategorive.

TABLE 26: TYPE OF FLATTENING.

BIRTHPLACE	ALBANIA		AMERICA				
					AGES		
	#	%	#	%	5-14	15-19	20
No flattening.....	1	2.70	4	13.33	0	2	2
Occipital only	11	29.73	4	13.33	2	0	2
Lambdoid only.....	8	21.62	20	66.67	8	5	7
Both	17	45.95	2	6.67	1	0	1
Totals	37		30		11	7	12

DEGREE OF FLATTENING

	OCCIPITAL				LAMBDOID			
	ALBANIA		AMERICA		ALBANIA		AMERICA	
	#	%	#	%	#	%	#	%
Abs.	9	24.32	24	80.00	12	32.43	8	26.67
sm	1	2.70	3	10.00	10	27.03	12	40.00
	17	45.95	1	3.33	7	18.92	8	26.67
	10	27.03	2	6.67	8	21.62	2	6.67
	37		30		37		30	

SEX DIFFERENCES

ALBANIAN-BORN			AMERICAN-BORN		
FLATTENING	MALE	FEMALE	FLATTENING	MALE	FEMALE
ABS.	1	0	ABS.	2	2
PRES.	21	15	PRES.	14	12

SEX DIFFERENCES

	ALBANIAN-BORN					AMERICAN-BORN				
	OCCIPITAL		LAMBDOID			OCCIPITAL		LAMBDOID		
	♂	♀	♂	♀		♂	♀	♂	♀	
Abs.	4	5	6	6	Abs.	12	12	3	5	
sm	1	0	4	6	sm	3	0	6	6	
	8	9	6	1		0	1	5	3	
	9	1	6	2		1	1	2	0	
Total	22	15	22	15	Total	16	14	15	14	

Tabela 26 tregon tipat e sheshtësimit sipas vendlindjes, në Shqipëri dhe në Amerikë, duke përfshirë shkallën e sheshtësimit në të dyja vendet. Ajo gjithashtu paraqet diferencat gjinore, dallimet mes gjinive sipas vendlindjes, si dhe tiparet oksipitale dhe lambdoide, të studiuara në lidhje me këto faktorë.

Në formularin e përdorur nuk ishte parashikuar asnjë rubrikë për kategorinë +++. Po të kishte ekzistuar ndonjë përson me këto përmasa sheshtësimi, do ta kishim përdorur edhe këtë kategori. Megjithëse nuk ka dallime të dukshme gjinore në praninë apo mungesën e sheshtësisë, qofshin ato oksipitale apo lambdoide, burrat treguan një shkallë shumë më të theksuar sheshtësie të pjesës së

pasme të kokës sesa gratë. Kështu pra është e vështirë të gjendet një grup tjetër që të shfaqë një shkallë kaq të lartë të sheshtësisë. Shqiptarët e Toskërisë janë dukshëm më të sheshtësuar se Gegët e serisë sonë. Vetëm pjesëtarët e fiseve të Zadrimës dhe Malësisë së Madhe mund t'u afrohen atyre në këtë aspekt.

Megjithatë, Toskët karakterizohen nga prania e të dy llojeve të sheshtësisë, ajo lambdoide dhe ajo oksipitale njëkohësisht, ndërsa te Gegët tanë, një kombinim i tillë është i rrallë. Toskët janë gjithashtu më të fortë, më të rëndë në peshë, dhe me më shumë flokë, por gjithashtu kanë një prirje më të lartë për rënie flokësh krahasuar me Gegët. Nga ana racore, Toskët kanë më shumë tipare alpine, ndërsa Gegët kanë më shumë tipare dinarike, në kuptimin klasik të fjalës.

Fëmijët e këtyre shqiptarëve, të lindur në Amerikë dhe të trajtuar në fëmijëri si shumica e fëmijëve amerikanë, natyrisht ndryshojnë nga prindërit e tyre. Katër nga pesë prej tyre kishin disa sheshtësime lambdoide, ndërsa vetëm një në pesë kishte llojin oksipital.

Në frekuencat e shkallës së sheshtësisë oksipitale vërehet një tendencë e rregullt në pakësimin e numrit të tyre. Kjo mungesë shfaqej në një shkallë të vogël (*sm*[14] ndryshueshmëria e variabilitetit), e më pas në +, dhe në fund në ++. Por kjo është një tendencë që pritej për incidencën e saj për karakteristikën e pakicës, nëse ajo është fituar përmes të njëjtës arësye ose procesi që shkaktoi edhe mungesën e saj.

Kjo situatë është e ndryshme dhe madje e kundërt me atë që vërehet te Gegët dhe Toskët e lindur në Shqipëri. Shkallët e sheshtësisë lambdoide gjithashtu ndjekin një shpërndarje normale, me kulmin e saj në shkallën *sm* – ndrysheshmërinë e variabilitetit. Dy meshkuj të cilët nuk ishin të lidhur në djep dhe kishin sheshtësim lambdoid kishin gjithashtu bathrocefali. Edhe pse kjo është një seri e vogël individësh, ajo i ngjan shumë asaj që kemi parë më herët në studimet e mëparshme. Sheshtësia e të dy llojeve, si ajo oksipitale ashtu edhe ajo lambdoide, duket se shfaqet që në fëmijërinë e hershme dhe ndoshta që në foshnjëri tek të lindurit në Amerikë. Kjo dukuri nuk duket se përparon apo përkeqësohet me kalimin e viteve, duke sugjeruar që formatimi i kafkës ndodh në një fazë të hershme të jetës dhe mbetet konstant më pas.

Sheshtësia lambdoide duket që është po aq e shpeshtë si te ata që nuk lidhen në djep, ashtu edhe tek ata që lidhen në djep, por në rastin e fundit sheshtësia është

14 SM qëndron si shkurtim i ndrysheshmërisë, variabilitetit (Shënim i autorit)

shumë më e theksuar. Nga këto të dhëna, mund të konkludohet se, kur sheshtësia shfaqet vetëm në një zonë të vogël të kokës, ajo ka mundësi të ketë origjinë gjenetike. Megjithatë, përkundja në djep duket se ndikon në zgjerimin e kësaj zone, duke theksuar më tej deformimin. Kjo sugjeron një ndërveprim midis faktorëve gjenetikë dhe atyre mjedisorë në formimin e sheshtësisë.

Sheshtësia oksipitale është zbuluar vetëm te 6 nga 30 individët që nuk janë lidhur në djep, dhe tre të tjerë prej tyre kishin shenja të lehta. Nga tre të tjerët, një vajzë 11 - vjeçare kishte një sheshtësim të lehtë të kategorizuar si +, ndërsa dy të tjerët kishin sheshtësim më të theksuar të kategorizuar si ++. Njëri prej tyre është vëllai më i vogël i z. Peter Peterson, një djalë 24-vjeçar. Kjo tregon se edhe në rastet kur nuk ka përkundje në djep, sheshtësia oksipitale mund të shfaqet, megjithëse në një shkallë më të lehtë.

Këtu nuk ka asnjë dyshim në rastin e shfaqjes së këtij fenomeni, pasi ai nuk ishte lidhur në djep. Ndërsa rasti tjetër është një grua 33 - vjeçare e lindur në Maine, për të cilën nuk jemi aq të sigurt. Sheshtësia oksipitale, në këtë rast, mund të jetë e lidhur me faktorë të tjerë gjenetikë ose të ndikuar nga kushte të tjera mjedisore, të cilat ende nuk janë identifikuar. Kjo lë hapësirë për mundësinë që kjo lloj sheshtësie të mos jetë vetëm rezultat i përkundjes në djep, por edhe i faktorëve të tjerë të panjohur.

Kur sheshtësia shfaqet me frekuencën dhe në shkallën e manifestuar tek Toskët e lidhur në djep, mund të jemi të sigurt se lidhja në djep është arësyeja kryesore për shumicën e rasteve, por nuk është domosdoshmërisht e vetmja arësye. Popullsia Toskë e shqiptarëve të Bostonit ka nevojë urgjente për një studim të plotë, derisa të moshuarit që udhëheqin koloninë përtej oqeanit janë ende të pranishëm dhe para se të rinjtë të shpërndahen anembanë Amerikës.

ANTROPOMETRIA E SHESHTËSISË

Bazuar në serinë e matjeve tona në Gegni, mund të shqyrtojmë shkencërisht efektin e dy llojeve të sheshtësisë, atë në dimensionet kryesore të kokës dhe atë në indeksin cefalik, siç tregohet në tabelën 27 dhe figurën 7. Konstantet i kemi renditur gjithashtu bazuar në madhësinë e tyre, si minimumin frontal, bizigomatik-un, bigonial - in, lartësinë totale të fytyrës, lartësinë e sipërme të fytyrës, lartësinë e hundës, gjerësinë e hundës dhe indeksin nazal. Duke pasur parasysh se të gjitha

këto rezultuan bosh përveç bizigomatikut, mund të konkludojmë me siguri se, brenda kufijve të tanishëm, forma e kafkës nuk ka asnjë lidhje me asnjërën prej tyre përveç gjerësisë së fytyrës. Kjo, qoftë gjenetikisht apo mekanikisht. Për më tepër, fakti që kriteret e dukshme, si lartësia e fytyrës dhe lartësia e hundës, nuk ndryshojnë në përputhje me llojin e sheshtësisë, tregon qartë se këto kritere nuk ndikohen nga mosha, pasi suturat,[15] janë mbyllur plotësisht.

TABLE 27: ANTHROPOMETRY AND FLATTENING.

VAULT DIMENSIONS

	Only Occipital	Only Lambdoid	Both	Neither
No.	262	402	68	335
Head lgth.	181.70 ± .27	186.73 ± .23	186.71 ± .95	188.36 ± .25
Head br.	161.50 ± .23	156.93 ± .19	160.10 ± .44	156.10 ± .21
Head ht.	129.44 ± .33	126.88 ± .26	129.76 ± .73	128.23 ± .23
Cephalic index	87.91 ± .16	84.08 ± .12	86.82 ± .67	82.96 ± .23
Bizygomatic	142.60 ± .25	141.79 ± .19	144.78 ± .46	142.06 ± .21

DEGREE OF FLATTENING AND CEPHALIC INDEX

	Occipital*		Lambdoid*	
Abs.	737	83.56	597	85.18
sm	37	85.86	110	83.93
+	213	87.31	327	84.31
++	70	89.06	33	87.09
+++	10	92.10		
Total	1067		1067	

* Including both.

NASAL PROFILE AND FLATTENING

	Concave		Straight		Convex		Conc.-Conv.		Total
	#	%	#	%	#	%	#	%	
Abs.	54	7.30	300	40.70	374	50.75	9	1.25	737
sm	3	8.11	15	40.54	18	48.65	1	2.70	37
+	7	3.37	80	37.47	125	58.69	1	.47	213
++	5	7.14	18	25.71	47	67.14	0	0	70
+++	0	0	3	30.00	7	70.00	0	0	10
Total	69		416		571		11		1067

CONVEXITY

Occip. Flattening	Absence	Presence
Abs.	363	374
Pres.	133	197

Q = .45

Tabela 27 tregon dimensionin e kupolës, shkallën e sheshtësimit, indeksin cefalik, profilin nazal, sheshtësimin dhe konveksitetin e këtyre të dhënave.

15 Suturat janë të rëndësishme në studimin e antropologjisë, sepse ato ndihmojnë në identifikimin e moshës, kafkës, dhe ndryshimeve që ndodhin në kafkë gjatë zhvillimit dhe plakjes. Gjithashtu, ato mund të ofrojnë informacione për evoluimin dhe diversitetin e strukturës së kafkës në popullatat e ndryshme.(Shënim i përkthyesit)

Dimensionet e kafkës ndahen në dy kategori: Ato që janë pothuajse identike me njëra tjetrën dhe ato me ndryshime që kanë rëndësi statistikore. Në gjatësinë e kokës, sheshtësitë lambdoide si dhe të dy llojet e tyre janë të ngjashme, në gjerësi. Në lartësi, sheshtësia oksipitale dhe të dy llojet e tyre janë të ngjashme, ndërsa në indeksin cefalik, të gjitha llojet janë të ndryshme.

Është interesante të vërehet se sheshtësia lambdoide, pavarësisht nga pozicioni i saj, ende shkakton një shkurtim të vogël të kokës dhe se burrat me të dy llojet e sheshtësisë janë më të paktë se ata që janë vetëm me lambdoid. Megjithatë, në gjerësi, kokat me sheshtësi lambdoide janë më të pakta sesa të pa-sheshtësuarat, ndërsa burrat me të dyja llojet e sheshtësisë përbëjnë numrin më të madh të tyre, kjo për nga sheshtësia oksipitale. Siç mund të pritet, sheshtësia lambdoide i ka vlerat më të ulëta krahasuar me lartësinë e kokës, ndërsa sheshtësia oksipitale i ka më të larta. Burrat me të dyja llojet e sheshtësisë ndjekin linjën e sheshtësisë oksipitale, ndërsa ata që nuk kanë asnjërën janë në një masë mesatare. Çfarëdo që të bëjë një njeri, sheshtësia lambdoide pengon që koka e tij të shkurtohet përtej një shkalle të caktuar. Nëse ai ka gjithashtu sheshtësinë oksipitale, mund të jetë i sigurt se ka një kurorë të kokës të gjerë dhe të lartë.

Siç pritej, vlerat për indeksin cefalik ndjekin një progresion në aspektin e mungesës së shfaqjes së sheshtësisë deri tek sheshtësia oksipitale, duke treguar një diapazon prej 5 pikësh. Është e qartë se sheshtësia është një faktor jetik dhe përbërës i rëndësishëm për Dinarikët. Në mesataret për diametrin bizigomatik, vërehen dallime të rëndësishme midis sheshtësisë lambdoide dhe sheshtësisë oksipitale dhe dy llojeve të sheshtësisë së kombinuar. Ka edhe raste të mungesës së dallimeve mes këtyre dy llojeve. Sheshtësia lambdoide nuk e zgjeron fytyrën, ndërsa duket se sheshtësia oksipitale e zgjeron atë. Arësyeja pse të dy llojet e sheshtësisë e tejkalojnë vetëm sheshtësinë oksipitale është se të dyja kanë vlera më të larta për shkallën e sheshtësisë në krahasim me vetëm njërën prej tyre.

Kjo rritje në gjerësinë e fytyrës, megjithëse e rëndësishme, nuk është e madhe. Një element tjetër në këtë kompleks është profili i hundës, i cili duket se bëhet më konveks ndërsa zverku i qafës bëhet më i sheshtë. Rëndësia e kësaj, (nëse ka ndonjë), mund të shihet më shumë në progresionin e qëndrueshëm të përqindjeve të konveksitetit në kolonën e tabelës që përfaqëson shkallën e sheshtësisë oksipitale. Pra kjo mund të shfaqet këtu më qartë sesa në ndonjë test statistikor. Këtu mund të shtohet edhe fakti se shumë përmasa të tjera u testuan

për lidhjen e tyre me formën e kokës, dhe asnjë prej tyre nuk u gjet të ishte e ndërlidhur.

Sheshtësimi lambdoid nuk ka asnjë ndikim në fytyrë. Ndërsa sheshtësimi oksipital mund të sjellë një zgjerim të lehtë të fytyrës përmes zgjerimit më të madh të parietaleve.[16] Kjo sepse ajo ndan zonat e lidhjes së muskujve temporalë dhe për pasojë mund të bëjë që të zgjerohen harqet nën të cilat kalojnë këta muskuj deri tek kondilet mandibulare,[17] të cilat mbeten të pandryshueshme.

Rritja e konveksitetit të hundës do të reflektonte një shtytje përpara në raste ekstreme të strukturave kockore në vijën sagitale[18] të kafkës në pjesën ku bashkohet me hundën. Për të sqaruar këtë fenomen është e rëndësishme të përmendet se 22 meshkuj të rritur me orrigjinë nga Toskëria e Shqipërisë që banojnë në Boston kanë një indeks cefalik mesatar prej 89.91, me një masë prej 8 individësh nga 91 prej tyre. Shpërndarja nuk paraqet asnjë kurbë të veçantë.

Pesë meshkuj të rritur, të lindur në Amerikë kanë indekse cefalike prej 76, 78, 78, 87 dhe 88, me një mesatare prej 8. Tre nga pesë janë po aq të gjatë në kokë sa pjesa tjetër e popullsisë amerikane, ndërsa dy të tjerët janë më afër mesatares dhe masës së prindërve të tyre të cilët në fëmijërinë e tyre janë lidhur në djep.

FORMA E KOKËS SIPAS SHPËRNDARJES FISNORE

Tabela 28 tregon qartë se nuk është vetëm frekuenca relative e sheshtësisë oksipitale dhe lambdoide që shkakton dallime rajonale në formën e kokës (shih figurat 7, 14, 15). Kur individët pa ndonjë rrafshim të kokës në secilën seri fisnore janë renditur dhe rishkruar, vërejmë se në secilin rast arrihet një mesatare më e ulët se më parë, duke ndryshuar nga 0.74 pikë më e ultat në rastin e Dukagjinit, deri në 2.98 pikë më e ulët në Has. Rregullsia e plotë e kësaj kolone në tabelë siguron vlefshmërinë e saj. Nëse vetëm sheshtësimi do të ishte përgjegjës për dallimet (apo i vetmi dallim) në indeksin cefalik, atëherë, kur të gjithë personat me sheshtësim do t'i hiqnim,

16 Fjala "parietals" i referohet kockave parietale, të cilat janë dy kocka të mëdha që formojnë pjesën e sipërme dhe anësore të kafkës1. Këto kocka janë të rëndësishme për strukturën dhe mbrojtjen e trurit. (Shënim i përkthyesit)

17 Kondilet mandibulare janë pjesët e rrumbullakëta në fundin e sipërm të nofullës së poshtme (mandibulës) që lidhen me nyjen temporomandibulare (TMJ) në të dy anët e kafkës. Këto kondile janë të rëndësishme për lëvizjen e nofullës dhe për formimin e nyjes temporomandibulare. (Shënim i përkthyesit)

18 "Sagittal line of the cranium" është një term që përdoret në anatominë e kafkës për të përshkruar një vijë imagjinare që kalon përmes kafkës nga përpara në prapa, duke ndarë atë në dy pjesë të barabarta, të majtë dhe të djathtë. (Shënim i përkthyesit)

TABLE 28: TRIBAL CEPHALIC AND INDEX MEANS.

	TOTAL AND UNFLATTENED			
	No.	TOTAL	No.	UNFLATTENED
MeM	105	86.79 ± .25	22	84.28 ± .46
Duk	106	84.54 ± .24	30	83.80 ± .33
MeJ	104	83.04 ± .28	41	81.22 ± .40
Has	114	85.59 ± .28	26	82.61 ± .59
Lum	109	82.62 ± .27	32	81.38 ± .40
Puk	102	83.76 ± .26	55	82.69 ± .27
Mir	101	84.39 ± .27	33	83.09 ± .42
Zad	105	86.67 ± .24	35	84.86 ± .38
Mat	104	86.49 ± .27	22	84.14 ± .54
Dib	108	84.96 ± .26	32	83.34 ± .49

Tabela 28 tregon mesataret e indeksit cefalik dhe mungesën e shqetësimit total tek kampionët e marrë nga Prof. Coon.

mesataret fisnore duhet të ishin identike. Por nuk janë identik dhe kemi zbuluar një ndryshim të vërtetë, ndoshta gjenetik, në formën e kokës që varion nga një mesatare prej 84 në perëndim të Gegnisë deri në 81 në lindje. Kjo përputhet në mënyrë të përkryer me shpërndarjen rajonale të matjeve të fytyrës që kemi parë dhe studiuar tashmë.

MALËSORËT GEGË U ZGJODHËN SI SUBJEKTE PËR KËTË EKSPERIMENT SEPSE ATA DUKEN SI NJERËZIT MË TË TIPIZUAR SI DINARIKË NË BOTË DHE SEPSE ATA NDODHEN NË NJË ZONË IDEALE PËR KËTË HULUMTIM.

POZICIONI RACOR I MALËSORËVE GEGË

Ky kapitull nuk ka nevojë të jetë i gjatë. Ai do të përbëhet thjesht nga një riformulim i gjetjeve dhe i problemit, si dhe një rishikim i provave dhe për rrjedhojë dhe një përfundim.

1. Problemi është: Çfarë është një Dinarik dhe se si një njeri, dikur apo diku, u bë i tillë? Malësorët Gegë u zgjodhën si subjekte për këtë eksperiment sepse ata duken si njerëzit më të tipizuar si Dinarikë në botë dhe sepse ata ndodhen në një zonë ideale për këtë hulumtim.

2. Malet ku ata jetojnë janë një strehë vërtet e vështirë për t'u shkelur. Ajo zonë është konservatore dhe të konservuar në çdo kuptim.

3. Malësori Gegë është gjithë kohës i zënë me punë të rënda e të përditshme, aty ku banon, për të mbajtur familjen dhe shtëpinë e tij. Ai shfrytëzon të gjithë tokën e disponueshme dhe numri i njerëzve që mund të ushqehen nga kjo tokë është rritur për shkak të teknikave të reja të përdorura në trajtimin e tokës. Disa zejtarë si dhe ndërtuesit e kullave vijnë në këto zona për të punuar, por largohen sapo mbarojnë punë. Ashtu si në Malësitë e Skocisë edhe Malet e Gjigantëve, në Gegni të Shqipërisë eksportojnë burra. Askush nga jashtë nuk vjen aty për të banuar.

4. Malësori zgjedh nusen e tij sipas një sistemi të vjetër i cili, megjithëse sociologjikisht është ekzogam, biologjikisht i mban gjenet brenda linjave shumë të afërta.

5. Sistemi i tij politik siguron autonomi lokale dhe i mban njerëzit në vendlindje. Gjakmarrja i detyron burrat të rrinë brenda shtëpisë, ose të dënohen apo edhe të dëbohen plotësisht diku larg këtyre maleve.

6. Dallimet fetare ndihmojnë në bllokimin e martesave me të huajt. As katolikët dhe as myslimanët nuk dëshirojnë të martohen me ortodoksët. Përveç disa rajoneve, besimi fetar i ka ndarë gjithashtu katolikët nga myslimanët për më shumë se katër shekuj.

7. Pamja historike është mjaft e qartë. Përveç ultësirave përgjatë bregdetit, zona fisnore e Gegëve ishte ndoshta e pabanuar, ose pothuajse e pa banuar, deri në

gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të parë p.e.s. Ilirët zbritën nga veriperëndimi, duke ndjekur malet, dhe u vendosën aty. Disa trakë mund të kenë hyrë nga lindja kurse disa gotë u shpërndanë në atë vend në zonat rreth degëzimit të Drinit. Nuk pati asnjë shtesë të vërtetë në popullsinë bazë Ilire deri në shekullin e 16 - të. Por pas kësaj periudhe, turqit i masakruan tërë fshatrat nga Durrësi deri në Shkodër, duke përshfirë dhe rajonin e Malësisë së Madhe dhe pjesët e poshtme të Dukagjinit. Për të zëvendësuar popullsinë pothuajse të shfarosur, të këtyre zonave imigrantët erdhën aty po nga ato toka prej nga kishin ardhur paraardhësit e parë të Gegëve, nga Bosnja.

8. Seria që kemi studiuar mbulon të gjitha fiset, shumicën e bajrakëve dhe shumë fshatra. Përveç disa fiseve brenda të cilave shpërndarja rajonale është e pabarabartë, ajo ofron një mbulim të plotë të antropometrisë së banorëve të Gegnisë.

9. Gegët e Malësisë i përkasin tipit të një Dinariku klasik, ashtu siç dhe pritej të rezultonte, por me variacione të shumta. Këto variacione janë të përqendruara në madhësinë dhe forcën e përgjithshme të trupit, madhësinë dhe formën e kafkës, si dhe në disa veçori lokale si incidenca e mjekrave bilaterale, rënia e flokëve dhe krrusjet e forta të shpinës. Uniformiteti më i madh gjendet në gjerësinë dhe përmasat e fytyrës, dimensionet dhe morfologjinë e hundës, formën dhe shpërndarjen e flokëve, si dhe pigmentimin. Karakteret që janë më uniforme janë ato që kanë më shumë gjasa të jenë të kontrolluara gjenetikisht. Shumica e atyre që janë më të ndryshueshme janë ato të cilat mjedisi mund t'i ketë ndikuar më shumë.

10. Shumë nga këto dallime të fundit mund të eliminohen ose të mos vihen re në mënyrë të përkohshme duke përdorur disa kontrolle të caktuara si, mosha, okluzioni dentar, ushqimi dhe efektet e lidhjes së foshnjave në djep.

11. Disa të tjera nuk mund të eliminohen, si për shembull në Dukagjin, frekuenca e lartë e flokëve kafe, sheshtësia lambdoide, mjekrat e ndara dhe supet e gjera. Kjo tregon për praninë e një elementi gjenetik shumë më pak të dukshëm në fiset e tjera, përveç në një masë më të vogël në Malësinë e Madhe. Në mënyrë të ngjashme, burrat e Hasit, të cilët martohen shpesh me bashkëkombësit e tyre shqiptar në Fushën e Kosovës, kanë disa dallime të veçanta, veçanërisht një tendencë për më shumë rënie flokësh, më shumë flokë të zinj dhe një lëkurë pak më të errët. Këto karakteristika i bëjnë ata më të ngjashëm me njerëzit që jetojnë më në lindje.

12. Pavarësisht të gjitha dallimeve, një gradient[1] lindje - perëndim ruan formën e kokës dhe të fytyrës. Njerëzit në veriperëndim kanë kokë më të gjerë, fytyrë më të gjerë dhe më të shkurtër krahasuar me ata të verilindjes. Ata në jug janë në një pozicion ndërmjetës, ndoshta duke shërbyer si vijë lidhje në drejtim të Gegëve të zonës fushore. Por si shpjegohet kjo? Mund të jetë që zgjerimi në formën e kokës dhe fytyrës të ketë ardhur me imigrimet boshnjake, ose ndoshta është mbetje e popullatave para - Ilire të ardhur nga bregdeti ajo që ka ndikuar në këtë fenomen.

13. Dallmet krahinore që janë zbuluar, pavarësisht dallimeve të tjera, ndoshta janë kryesisht gjenetike, megjithatë kjo nuk mund të konfirmohet plotësisht deri sa të kemi materiale më bindëse. Grupet e gjakut do të ndihmonin jashtëzakonisht shumë.

14. Është vertetuar se tipi i veçantë Dinarik është pjesërisht produkt i kohës, mjeteve dhe terrenit. Fytyra e tij e dobët dhe hunda shkabë zakonisht zhvillohen në moshën e mesme, ndërsa koka e tij e gjerë, e sheshtë në pjesën e pasme, është kryesisht rezultat i të lidhurit të foshnjës në djep. Trupi i tij i dobët dhe i kërrusur është në masë të madhe ai i një njeriu që ka punuar shumë dhe ka ngrënë pak.

15. Nëse dikush do të zgjidhte rastësisht 1067 djem të sapolindur të Malësisë së Gegnisë nga të gjitha fiset, të gjithë të së njëjtës moshë dhe në të njëjtën kohë, t'i transferonte ata në Amerikë, t'i ushqente me gjithë të mirat që ka toka dhe t'i rritnin si bij të prindërve të pasur dhe të kujdesshëm amerikanë, dhe pastaj t'i matnin të gjithë në moshën 20 vjeç, a thua do të kishim një seri antropometrike të ngjashme? Ky kampion do të ishte i krahasueshëm me shumë të tjerë në literaturën e antropologjisë fizike. Ndërsa unë do të guxoja të parashikoja që mesataret e disa prej matjeve të tyre do të ishin: Gjashtëdhjetë e pesë për qind e këtyre të rinjve do të kishin flokë nga ngjyra kafe e errët deri në kafe të mesme, 20 për qind të zinj dhe 15 për qind biondë, duke përfshirë aty edhe ngjyrën kafe të çelur.

Lëkura do të ishte e çelur; shumica e syve do të ishin të përzier ku mbizotërojnë nuancat më të çelura. Sytë e errët dhe me pamje të kthjellët do të përbënin

1 Në kontekstin e antropologjisë dhe studimeve të tjera të shkencës, një "gradient" është një ndryshim gradual në një karakteristikë të caktuar që ndodh në një drejtim të caktuar. Ky ndryshim mund të jetë në lidhje me ndonjë variabël, siç është forma e kokës, ngjyra e lëkurës, ose ndonjë tjetër atribut fizik. Për shembull, në studimin e formës së kokës, një gradient mund të tregojë se si një karakteristikë e caktuar ndryshon në mënyrë të vazhdueshme nga një rajon në një tjetër. Në rastin tuaj, gradienti lindje-perëndim do të thotë se ka një ndryshim të gradualshëm në formën e kokës dhe fytyrës ndërmjet rajoneve në lindje dhe perëndim. (Shënim i përkthyesit)

rreth një të katërtën e të gjithëve. Gjashtëdhjetë për qind e hundëve do të kishin profile të drejta ose pak të varura si shkabë, 10 për qind do të ishin konkave dhe vetëm 30 për qind konvekse. Këta djem nuk do të dalloheshin nga amerikanët e zakonshëm, përveçse nga një ekspert i racës, i cili mund t'i konsiderojë ata si të ndryshëm, jo individualisht, por si grup, vetëm nga indeksi mesatar cefalik i tyre që do të ishte rreth 4 pikë më të lartë se mesatarja. Ose ndoshta edhe brachycephaly-ja do të zhdukej pas transplantimit, por këtë nuk mund ta themi me siguri.

16. Nëse i krahasojmë Gegët e Malësisë në një mënyrë të tillë me Evropianët Perëndimorë dhe amerikanët, zbulojmë se ata do të ishin të krahasueshëm me shumë popullata lokale në Gjermaninë Perëndimore dhe në Austri. Ata janë nga e njëjta bazë gjenetike, e përhapur gjerësisht në Epokën e Hekurit, nga e cila erdhën shumica e popujve të Evropës Veriore dhe Perëndimore.

17. Ashtu si shumica e popullatave të tjera evropiane me karakter thelbësisht nordik ose mesdhetar (ose nordik dhe mesdhetar), ata posedojnë gjurmë të dukshme të tipareve racore para-nordike dhe para-mesdhetare, të cilat i bëjnë disa prej tyre më të gjerë në trup, më të muskulizuar, me kokë dhe fytyrë më të gjerë, me hundë më të sheshtë dhe me nofulla më të mëdha se të tjerët. Në Malet e Gjigantëve, ky element është i përqendruar në veriperëndim, në Dukagjin, me një shfaqje më të vogël në Malësinë e Madhe. Nëse seria e matjeve nga ajo zonë do të ishte shumë më e madhe, në seritë rajonale ndoshta do ta bënin këtë konkluzion më të qartë duke i nxjerrë më në pah këto tipare. Ndofta edhe është e mundshme që disa elementë të këtyre tipareve kanë hyrë këtu me imigracionin boshnjak të shekullit të 16 - të. Por gjithësesi është e sigurtë se disa prej këtyre tipareve kanë qenë të pranishme këtu edhe në kohë shumë më të hershme.

18. Gjeografia, teknologjia, sociologjia, historia dhe antropologjia fizike, të gjitha luajnë rolin e tyre në zgjidhjen e këtij problemi. Unë vetëm shpresoj që përgjigjja ime të ketë qënë e vërtetë, e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme ashtu siç e kam sugjeruar!

REFERENCAT

ALMAGIA, ROBERTO,

1932. Modern Albania: a review. The Geographical Review, vol. 22, pp. 464-73.

ARBENIA

1930. Newspaper in Tirana, Albania. June 1.

ARKIN, HERBERT AND COLTON, R. R.

1947. An outline of statistical methods. New York.

BAKER, L. W.

1922. The influence of the forces of occlusion on the development of the bones of the skull. International Journal of Orthodontia, Oral Surgery, and Radiography, vol. 8, no. 5, pp. 3-24.

BERNATZIK, H. A.

1930. In den Sümpfen und Gebirgen Albaniens. Atlantis, vol. 2, pp. 597-612.

BOAS, FRANZ

1911. Changes in bodily form of descendants of immigrants. Senate Document, no. 208, 61st Congress, 2nd Session, Washington.

1912. Changes in the bodily form of descendants of immigrants. American Anthropologist, n.s vol. 14, pp. 530-62.

BOWLES, G. T.

1932. New types of old Americans at Harvard. Cambridge, Massachusetts.

CHAPPLE, E. D. AND COON, C. S..

1942. Principles of Anthropology. New York. COON, C. S.

1931. Tribes of the Rif. Harvard African Studies, vol. 9.

1939. The races of Europe. New York.

COON, C. S. (EDITOR)

1948. A reader in general anthropology. New York.

COON, C. S., GARN, S. M., AND BIRDSELL, J. B.
1950. Races... a study of the problems of race formation in man. Springfield, Illinois.

Cozzi, ERNESTO
1909. Malattie, morte, funerali nelle montagne d'Albania. Anthropos, vol. 4, pp. 903-18.
1910a. La vendetta del sangue nelle montagne dell'alta Albania. Anthropos, vol. 5, pp. 654-87.
1910b. Lo stato agricolo in Albania, con speciale riguardo alle montagne di Scutari. Revue d'Ethnographie et de Sociologie, vol. 1, pp. 33-49.
1912. La donna albanese con speciale riguardo al diritto consuetudinario delle montagne de Scutari. Anthropos, vol. 7, pp. 617-26.
1914. Credenze e superstizioni nelle montagne dell'Albania. Anthropos, vol. 9, pp. 449-76.

Cvijič, JOVAN
1918. La peninsule balkanique. Paris.

DENIKER, JOSEPH
1890. Essai d'une classification des races humaines, basée uniquement sur les caractères phy- siques. Société d'Anthropologie de Paris, Bul- letin, series 3, vol. 12, pp. 320-36.
1900. Les races et les peuples de la terre. Paris.
1914. Les peuples balkaniques, surtout les Serbes et les Bulgares, au point de vue anthropo- logique. Institut Français d'Anthropologie, Comptes Rendus des Seances, vol. 1, pp. 170-72.

DINGWALL, E. J.
1931. Artificial cranial deformation. London. DOBZHANSKY, THEODOSIUS
1944. On species and races of living and fossil man. American Journal of Physical Anthropology, n.s., vol. 2, pp. 251-65.

DURHAM, M. E.
1928. Some tribal origins, laws, and customs of the Balkans. London.

EHRICH, R. W. AND COON, C. S.
1948. Occipital flattening among the Dinarics. American Journal of Physical Anthropology, ns., vol. 6, pp. 181-86.

EWING, J. F., S.J.
1947. Occipital flattening as a racial diagnostic. American Journal of Physical Anthropology, n.s., vol. 5, pp. 235-36.

FARLATI, DANIELE
1817. Illyrici Sacri, vol. 7. Venice. FRASHERI, S. TH.
1930. Permes Mirdites ne Dimer. Korçe. GATES, R. R.
1946. Human genetics. 2 vols. New York. GEGAJ, A.
1937. L'Albanie et l'invasion turque au XV* siècle. Louvain.

GIUFFRIDA-RUGGERI, V.
1921. I dati craniologici sull'Albania e due crani Albanesi inediti. Archivio per l'Antropologia e l'Etnologia, vol. 50, pp. 3-17.

GLÜCK, LEOPOLD 1897. Zur physischen Anthropologie des Alban- esen. Wissenschaftliche Mittheilungen aus Bosnien und der Herzegowina, vol. 5, pp. 403-33.

GORING, CHARLES
1913. The English convict; a statistical study. London.

HABERLANDT, ARTHUR
1917. Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volks- kunde von Montenegro, Albanien und Ser- bien. Zeitschrift für österreichische Volks- kunde, Ergänzungsband 12 (zu Jahrgang 23).

HABERLANDT, ARTHUR AND LEBZELTER, V.
1919. Zur physischen Anthropologie der Albane- sen. Archiv für Anthropologie, ns, vol. 17, PP. 123-54.

HANNESSON, G.
1925. Körpermasse und Körperproportionen der Isländer. Reykjavik.

HASLUCK, M. M.
1932. Physiological paternity and belated birth in Albania. Man, vol. 32, pp. 53-54.
1933. Bride-price in Albania. A Homeric parallel. Man, vol. 33, pp. 191-95.
1939. Couvade in Albania. Man, vol. 39, pp. 18-20. 1947. Head-deformation in the Near East. Man, vol. 47, pp. 130-31.

HASLUCK, M. M. AND MORANT, G. M.
1929. Measurements of Macedonian men. Biomet- rika, vol. 21, pp. 322-36.

HOOTON, E. A.
1930. The Indians of Pecos Pueblo, a study of their skeletal remains. New Haven.

HOWARD, SIR ALBERT
1947. The soil and health. New York.

HOWELLS, W. W.
1936. Some uses of the standard deviation in anthropometry. Human Biology, vol. 8, pp. 592-600, and table 1.

HUGHES, B. O.
1938. The physical anthropology of native born. Armenians. Ph.D. thesis, Harvard University Library, unpublished.

JIREČEK, KONSTANTIN
1916. Albanien in der Vergangenheit. Illyrisch- Albanische Forschungen, vol. 1, pp. 63-93.

KIEPERT, HEINRICH
1894. Formae orbis antiqui. Berlin.

LITTLE, C. C.
1919. Some factors influencing the human sex-ratio. Society for Experimental Biology and Medicine, Proceedings, vol. 16, pp. 127-30.

LOWMAN, G. S.
1932. The phonetics of Albanian. Language, vol. 8, no. 4, pp. 271-93.

LUSCHAN, FELIX VON
1898. Zur Anthropologie Kleinasiens. Globus, no. 13, Sonderabdruck von Band 73, pp. 211-14.

MARTIN, RUDOLPH
1928. Lehrbuch der Anthropologie. 3 vols. Jena.

MATHENY, W. D. AND MEREDITH, H.V.
1947. Mean body size of Minnesota schoolboys of Finnish and Italian ancestry. American Journal of Physical Anthropology, n.s., vol. 5, pp. 343-55.

MENGHIN, OSWALD
1919-20. Die prähistorische Archäologie in Montenegro und Albanien. Prähistorische Zeit- schrift, vol. 11-12, pp. 197-202.

NATIONAL CATHOLIC ALMANAC
1946. Paterson, N. J.

NEWMAN, BERNARD
1936-37. The Law of Lek. The Geographical Magazine, vol. 4, pp. 143-56.

NOLL, FAN STYLIAN, BISHOP
1947. George Castrioti Scanderbeg, 1405-1468. International Universities Press. New York.

NOFCSA, FRANZ, BARON VON
1910. Über seine archäologischen Funde in Nordal- banien. Anthropologische Gesellschaft in Wien, Mittheilungen, vol. 40, pp. [31]-[32]. 1925. Albanien; Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens. Berlin and Leipzig.
1927. Ergänzungen zu meinen Buche über die Bau- ten, Trachten und Geräte Nordalbaniens. Zeitschrift für Ethnologie, vol. 59, pp. 279-81.

PISKO, J. E.
1895. Volksmedicin in Nordalbanien. Anthropolo- gische Gessellschaft in Wien, Mittheilungen, vol. 25, pp. [63]-[64].
1896. Gebräuche bei der Geburt und Behandlung der Neugeborenen bei den Albanesen. An- thropologische Gesellschaft in Wien, Mit- theilungen, vol. 26, pp. 141-46.

PITTARD, EUGÈNE
1921. Découverte de l'âge de la pierre polie en Albanie. Archives Suisses d'Anthropologie Générale, vol. 4, pp. 271-74.

RICHTOFEN, BOLKO, FREIHERR VON
1939. Die ersten Spuren Eiszeitmenschen in Albanien. Quartär, vol. 2, pp. 151-52.

RIPLEY, W. Z.
1899. The races of Europe; a sociological study. New York.

RITALA, A. M.
1933. Zur Berechnung des Statistischen Mittleren Fehlers. Duodecim, series B, vol. 19, no. 2. Helsinki.

SCHLAGINHAUFEN, OTTO
1946. Die Anthropologie der Eidgenossenschaft. Anthropologia Helvetica, vol. 1. Archiv der Julius Klaus-Stiftung, Ergänzungsband zu Band 21.

SCHULZ, REIMER
1938. Leichenbegängnis und Totenkult bei den Malisoren. Atlantis, vol. 10, pp. 257-59.

SEMPLE, ELLEN C.
1931. The geography of the Mediterranean region. New York.

SHEPHERD, W. R.
1921. Historical atlas. New York. START, L. E.
1939. The Durham collection of garments and embroideries from Albania and Yugoslavia. Bankfield Museum Notes, series 3, no. 4. Halifax.

STILES, WALTER
1946. Trace elements in plants and animals. Cambridge, England.

STRABO
1807. Strabonis geographia. Falconer edition. London.

ŠUFFLAY, MILAN VON
1916. Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Illyrisch-Albanische Forschungen, vol. 1, p. 188.

THALLÓCZY, LUDWIG VON (EDITOR)
1916. Illyrisch-Albanische Forschungen. Munich and Leipzig.

TRAEGER, PAUL
1904. Zur Forschung über alte Schiffstypen. C. Schiffsfahrzeuge in Albanien und Mazedonien. Deutsche Gesellschaft für Anthropologie, Ethnologie und Urgeschichte, Correspondenz-Blatt, vol. 35, pp. 25-38.

UGOLINI, L. M.
1927. Le antichità primitive dell'Albania. Bollettino di Paletnologia Italiana, vol. 47, pp. 181-88.

VIRCHOW, HANS
1924. Die Armenische Wiege. Zeitschrift für Ethnologie, vol. 56, pp. 208-11.

VULPE, RADU
1932. Bronzefunde aus Nord-Albanian. Prähistor- ische Zeitschrift, vol. 23, pp. 132-45. WASHBURN, S. L.
1947. The relationship of the temporal muscle to the form of the skull. Anatomical

Record, vol. 99, no. 3, pp. 239-48. (Reprint: Year- book of Physical Anthropology, vol. 3, pp. 249-58.)

WEIDENREICH, FRANZ

1945. The brachycephalization of recent mankind. Southwestern Journal of Anthropology, vol. 1, no. 1, pp. 1-54.

WEISBACH, AUGUSTIN

1897a. Altbosnische Schädel. Anthropologische Ge- sellschaft in Wien, Mittheilungen, vol. 27, pp. 80-85.

1897b. Prähistorische Schädel von Glasinac. Wissen- schaftliche Mittheilungen aus Bosnien und der Herzegowina, vol. 5, pp. 562-76. Woo, T. L. AND PEARSON, KARL

1927. Dextrality and sinistrality of hand and eye. Biometrika, vol. 19, pp. 165-99.

YULE, G. UDNY

1927. An introduction to the theory of statistics. London.

ZAMPA, RAPHAEL

1886. Anthropologie Illyrienne. Revue d'Anthropologie, series 3, vol. 1, pp. 625-47.

FIGURAT KOLLOTIP

Fotografitë e mëposhtme, autori i ka marrë nga libri "Përmes Mirditës në Dimër," shkruar nga asistenti i tij, Stavri Frashëri (1900-1965). Ato janë shkrepur nga vetë autori Prof. Carleton S. Coon gjatë udhëtimit të tij në Malet e Gegnisë, 1929 – 1930. Midis tyre gjenden foto si për shembull:



Dr. Carleton Coon, duke marrë masat trupore të një malësori në Mirditë.



Dr. Coon (djathtas) dhe Stavri Frashëri duke pozuar me një malësor në veshje tradicionale.



Dr. Coon, majtas, me Stavri Frashërin, në qendër, dhe shoferin e tyre, gjatë rrugës nga Shkodra në Tiranë, pas përfundimit të ekspeditës.



Burrë me plis, me veshje gjysmë-perëndimore dhe me një armë në brez. Në të majtë, gruaja malësore me kostum të tipik popullor.



Banesë tipike me një stallë në të majtë.



Vajzë e re që kalon me kalë nëpër terren të vështirë.



Pamje që tregon peisazhin e zbrazët, karakteristik për shumicën e malësive ku kaloi ekspedita e Prof. Coon – it.



Njësi e xhandarëve në Shqipërinë Veriore, me një sfond mali me borë



Fotografi e rastit e dy djemve, që kanë veshur pallto ndryshe nga veshja tradicionale e fiseve të Mirditës.





Toskët duke kënduar në festën e datëlindjes së Mbretit Zog.




Një litar është mjeti më i mirë për të kaluar njeriu nëpër ato shkëmbinj të thepisur.



Dr. Carleton Coon, ulur, në të djathtë, me grupin e tij, duke pushuar në peisazhin e mbuluar me borë.



Malësori Gegë duke pozuar për fotografin pranë qerres së tij që e tërheqin qetë.




Një lloj tjetër Gege.




Portret i një Gege shqiptar.



Malësori Gegë tipik shqiptar që mban shami rreth plisit dhe rreth qafës.



Grua me dy fëmijë e stolisur me gjerdan, karakteristikë e veshjes së grave në Mirditë.



Bashkëshortja e Prof. Carleton S. Coon, Mary Coon - Goodale,
e veshur me rrobe të grave Gegë në trup dhe me një plis të bardhë në kokë.



Pamje e rrugës dhe banesave në Shqipërinë e Veriut që dëshmojnë karakterin e ashpër të vendit.



Pamje fshati me pyje dhe një kullë vetmuar.




Pamje e një kullë, shtëpia fortesë që gjendet në Mirditë dhe në vende të tjera në Shqipërinë e Veriut.[1]

1 Mendoj se kjo foto nuk është marrë në Mirditë pasi kjo është vetë Kulla e Kalasë së Skënderbeut në Krujë, që mbahet e tillë edhe sot – Shënim i përkthyesit



Pamje e një maje mahnitëse mali në rajonin e Mirditës, një nga shumë maja të tilla në malësi.



Gegë tipik malësor – Malësia e Madhe.



Kullë e izoluar në Spaç të Mirditës.



Shtëpi në Shosh.



Një Virgjinë e Betuar në Mirditë me shoqen e saj.



Grua katolike Gegë nga Zadrima.




Tom Tushi i Shoshit.




Han apo bujtinë në Pukë.



Një kolibë bagëtishë në Shalë.




Ura e Drinit të Bardhë pranë Kukësit.



Një mjet i bërë vetë që shërben si lundër për të kaluar lumin Drin në mes të Lumës dhe të Malziut.



Pamje nga Mati.




Kater bajraktarë këndojnë maje krahut. Në të majtë është bajraktari i Hotit ndërsa në të djathtë ai i Kelmendit.



Malësorë Gegë duke pushuar në borë në Dukagjin.



Princi i Mirditës, Gjon Markagjoni (1888-1966) me gruan, nënën dhe fëmijët e tij.




Tiparet standarde Dinarike të Gegëve malësorë, 1

a) Fisi i Zadrimës; mosha, 35; sytë, blu-kafe; flokë, kafe të errët; mjekër, kafe e kuqërremtë; indeksi cefalik, 88; indeksi i fytyrës, 83; indeksi i hundës, 65; shtati, 151,1.

b) Fisi i Dibrës; mosha, 50; sytë, blu-kafe; flokë, thinja e zezë; mjekër, e kuqe-kafe.thinja; indeksi cefalik, 80; indeksi i fytyrës, 94; indeksi i hundës, 58; shtat, 178,8. Tipi boshnjak i veriperëndimit:

c) Fisi Malësia e Madhe; mosha, 40; sytë, blu; flokë, të artë; mjekër, e artë; indeksi cefalik, 86; indeksi i fytyrës, 86; indeksi i hundës, 67; shtat, 175.0.

d) Fisi Dukagjin; mosha, 48; sytë, jeshile-kafe; flokë, të artë; mjekër, e artë; indeksi cefalik, 90; indeksi i fytyrës 78; indeksi i hundës, 67; shtat, 190.



Tiparet standarde Dinarike të Gegëve malësorë, 2

NDRYSHIMET E FYTYRËS PËR SHKAK TË MOSHËS

Grupi 18-26 vjeç:

Fisi Malësia e Gjakovës; mosha, 22; sytë, jeshile-kafe; flokë, kafe të errët; mjekër, kafe e errët; indeksi cefalik, 84; indeksi i fytyrës, 84; indeksi i hundës, 57; shtat, 172,5.

Fisi Puka; mosha, 24; sytë, jeshile-kafe; flokë, kafe të errët; mjekër, e artë; indeksi cefalik, 80; indeksi i fytyrës, 91; indeksi i hundës, 58; shtat, 174. Grupi 30-50 vjeç:

Fisi Zadrima; mosha, 30; sytë, jeshile-kafe; flokë, kafe të errët; mjekër, kafe e lehtë; indeksi cefalik, 87; indeksi i fytyrës, 82; indeksi i hundës, 48; shtat, 165.

Fisi Mirdita; mosha, 48; sytë, jeshile-kafe; flokë, thinja e zezë; mjekër, thinja e kuqe-kafe; indeksi cefalik, 84; indeksi i fytyrës, 80; indeksi i hundës, 59; shtat, 172,3. Grupi 60-75 vjeç:

Fisi Zadrima; mosha, 60; sytë, jeshile-kafe; flokë, kafe të errët-gri; mjekër, thinja e kuqe-kafe; indeksi cefalik, 89; indeksi i fytyrës, 85; indeksi i hundës, 53; shtat, 171,6. f, fisi Luma; mosha, 65; sytë, jeshile-kafe; flokë, thinja e zezë; mjekër, thinja e kuqe-kafe; indeksi cefalik, 80; indeksi i fytyrës, 85; indeksi i hundës, 58; shtat, 170,7.



Tiparet standarde Dinarike të Gegëve malësorë, 3

NDRYSHIMET NË FORMËN E KOKËS (vazhdim). Shestëshimi i pas kokës:

Fisi Luma; mosha, 26; sytë, jeshile-kafe; flokë, të artë; mjekër, e artë; indeksi cefalik, 96; indeksi i fytyrës, 86; indeksi i hundës, 65; shtat, 177.0.

Fisi Puka; mosha, 28; sytë, jeshile-kafe; flokë, kafe të errët; mjekër, kafe e errët; indeksi cefalik, 92; indeksi i fytyrës, 81; indeksi i hundës, 65; shtat, 170,2. rrafshim si lambdoid ashtu edhe okupital:

Fisi Malësia e Gjakovës; mosha, 20; sytë, jeshile-kafe; flokë, të zeza; mjekërr. e zezë; indeksi cefalik, 90; indeksi i fytyrës, 86; indeksi i hundës, 62; shtat, 174.0. Batrocefalia:

Fisi Mirdita; mosha, 50; sytë, jeshile-kafe; flokë, thinja e zezë; mjekër, thinja e kuqe-kafe; indeksi cefalik, 80; indeksi i fytyrës, 82; indeksi i hundës, 48; shtat, 162,1.



Tiparet standarde Dinarike të Gegëve malësorë, 4.

NDRYSHIMET NË FORMËN E KOKËS (vazhdim)

Sheshtisim zverku:

a. fisi Luma; mosha, 26 vjeç; sytë, jeshil-kafe; flokët, të artë; mjekra, e artë; indeksi cefalik, 96; indeksi i fytyrës, 86; indeksi i hundës, 65; shtat, 177 cm.

b. fisi Puka; mosha, 28 vjeç; sytë, jeshil-kafe; flokët, kafe të errët; mjekra, kafe e errët; indeksi cefalik, 92; indeksi i fytyrës, 81; indeksi i hundës, 65; shtat, 170,2 cm.

Sheshtisim lambdoid:

c. fisi Malësia e Gjakovës; mosha, 20 vjeç; sytë, jeshil-kafe; flokët, të zeza; mjekra, e zezë; indeksi cefalik, 90; indeksi i fytyrës, 86; indeksi i hundës, 62; shtat, 174 cm.

Batrocefalia:

d. fisi Mirdita; mosha, 50 vjeç; sytë, jeshil-kafe; flokët, thinja e zeza; mjekra, thinja e kuqe-kafe; indeksi cefalik, 80; indeksi i fytyrës, 82; indeksi i hundës, 48; shtat, 162,1 cm.




TOSKËT E BOSTONIT

a) Me origjinë shqiptare.


b) I lindur në Amerikë.

c) Me origjinë shqiptare.

d) I lindur në Amerikë.







DJEPAT

a) Djepi i Zadrimës.

b) Djepi nga Shkodra, (Haberlandt, 1917, fig. 29).

c) Djepi e vllehëve, (Haberlandt, 1917, table 3, no. 12).

d) Djepi nga Planti (Nopça, 1925, fig. 78).

INDEKSI

A
Abat 131
Ahmet Zogu 109, 133
Alpet Dinarike 125
Alpet e Adriatikut 25
Anadolli 170
Anthony Stevens 11, 47
Appalachian 40, 166
Armenia 272
Arthur Evans 14
Arthur MacMorrough Kavanagh 14
At Krasniqi 107
Aubrey Herbert 14
Avni Ponari 14

B
Baroni Nopça 45, 47, 51, 52, 53, 57, 67, 86, 120, 249
Bejtullah Destani 14
Bektashi 107, 108
Bell Beaker 24, 121
Benjamin Disraeli 14
Berisha 6, 14, 99, 100, 130, 131, 139, 143
Beteja e Kosovës 127
Bicaj 35, 49
Boga 100,130
Bosnja e Hercegovina 53, 105, 119, 120, 122, 129, 130, 132, 135, 136, 172, 175, 266
Bugjoni 36, 99, 143
Burreli 47, 48, 64 ,67, 135
Bytyçi 64, 99

C
Car Dushani 34, 88, 127
Cen Elezi 62, 96
Charles Cockerell 13
Charles Telford Erickson 11, 14
Clement C. Moore 14
Colorado 11
Creven 125
Cro-Magnon 23
Crow 56
Cvijič 86, 270

D
Dalmacia 122
Dalmat 165, 235
Danubi 125
Dardania 24, 123, 126, 155, 163
David Abulafia, Prof. 14
David de Harport 12, 246
David Shankland, Dr. 14

David Urquhart 14
Deçani 127, 131
Delti 130
Deniker 23, 270
Dingwall 243, 247, 270,
Dmitri Peterson 12, 249
Dobzhansky 25, 270
Duncan Heaton Armstrong 14
Durrësi 110, 115, 118, 236, 110, 115, 118, 236
Dushmani 79. 89, 90, 105, 117, 126,

E
Edith Durham 14, 75, 95,
Edith Pierpont Stickney 14
Edmond Spencer 14
Edward Brown 14
Edward Frederick Knight 14
Edward Lear 14
Elinor Bajraktari 14
Elizabeth Herbert 14
Emathia 123
Edlira Birko 6
Eocenit 35, 235
Epoka e Bakrit 24
Epoka e Bronzit 24, 118, 121, 274
Epoka e Hekurit 40, 47, 56, 59, 117, 118, 120, 121, 129, 135, 137, 175, 268

F
Fan Noli 12, 55, 108, 127
Fanny Janet Blunt 14
Fisi i Berishës 36, 99, 100, 102, 104, 129, 130, 131, 139, 142, 143
Flamur Hudhri 14
Francis Drexel Smith 14
Frederick E. Farnsworth 14
Freiherr von Richtofen 117, 273

G
Gashi 64, 99, 100
Geg Lazi 129
George Finlay 14
George Philippson 14
George Washington 208
Glasinac 119, 120, 121, 175, 275
Gojani 100, 143
Gora 46
Grisha, 99, 142
Gruda 99, 100, 132
Gucia 130
Guri i Bardhë 48, 64
Gustav Meyer 120
Gjakova 47, 133,
Gjeneralit Britanik, Percy 11, 133
Gjergj Kastrioti, Skenderbeu 127, 292
Gjon Markagjoni 79, 97, 98, 240, 303

H
Haberlandt 45, 47, 50, 120, 249, 271
Hallstatt 118, 119, 120, 129, 135
Hasi 31, 38, 45, 81, 99, 108, 125, 177, 183
Helshani 99
Henry Fanshawe Tozer 14
Henry Hodgkinson 14
Henry Holland 14
Henry N. Brailsford 14

Heraklion 125
Herman Bernstein 14
Homeri 40
Hooton, Dr 83, 272
Hoti 100
Howells 176, 272

I
Ilirët 13, 14, 21, 77, 115, 118, 120, 124, 197, 217
Iminacum – Iballë 124

J
J. H. Clark Bequest 11
John Hobhouse 13
Joseph Shutack 11
Jugosllavia 11, 33, 38, 46, 53, 64
Julius C. Holmes 11

K
Kabashi 99, 143
Kaçinari 86
Kajro 108
Kalisi 99
Kanuni 53, 80, 82, 102, 113
Karashegeçit 97
Kastrati 99, 130, 142
Kelmendi 99, 100, 130, 132, 142, 302
Kiri 100, 127, 131, 142
Kodi i Lekë Dukagjinit 78, 80, 82, 113
Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve 47, 133
Konstantini 155, 272, 126
Kopliku 48 ,99, 100, 124, 132, 142
Korçë 11, 64, 118, 271
Kosova (Fusha) 22, 25, 30, 32, 34, 34, 40, 88, 105, 109, 111, 113, 114, 237,
Kosova 27, 38, 39, 45, 123, 125, 127, 128, 266
Kraja 99, 100
Krasni Lazi 130
Krasniqja 64, 66, 89, 99, 107, 130,1 43
Kruja 46, 48, 58, 69
Kthella 64, 88, 99, 100, 144
Kuçi 130, 131
Kukësi 37, 39, 48, 64, 66, 97, 132, 133, 239
Kumbaria 90
Kushneni 88, 99, 144

L
Lady Mary Wortley Montagu 13, 124
Lawrence i Arabisë 133
Lekaj 100
Lezha 39, 48, 64, 124
Libani 170, 246
Ligji i Rromës 82
Liho Çuni 51
Liqeni i Ohrit 37, 64, 124
Liqeni i Shkodrës 36, 38 ,235
Lissus 124
Loha 100
Lord Byron 13
Lotaj 100
Luma 31, 33, 38, 46, 48, 67, 77, 99, 134, 177, 178, 183, 185
Lumi Mat 185, 86
Lloya 130, 142

M
Majori Cen Elezi 62, 96
Malësia e Gjakovës 31, 33, 46, 48, 49, 55, 77, 97, 99, 100, 134, 177, 178, 188, 192, 193, 236
Malësia e Madhe 31, 33, 49, 99, 130, 134, 142, 183,1 86, 187, 189, 194
Mali i Zi 141
Malziu 100, 124, 143, 301
Maqedoni 123 ,247
Margaret Hasluck 12, 14, 247, 271
Marina 88, 99
Marka Gjoni 98, 240
Martha Dick 12
Massachusetts 12, 249, 269
Mati 31, 33, 37, 38, 46, 47, 63, 77, 89, 96, 99, 100, 107, 110, 122, 133, 135, 144, 177, 178, 183, 184, 185, 192, 234
Matheny, Meredith 233, 272
Mazreku 100
Mbretit Zog 96, 99, 133, 282
Mesopotami 24
Mesozoikut/Mezocoic 36, 234
Mërturi 36, 64, 67, 71, 89, 99, 109, 131, 142, 223
Mgula 100
Michael Gunn 14
Mirdita 31, 33, 37, 38, 46, 49, 50, 80, 84, 88, 97, 98, 99, 107, 144, 178, 184, 191, 223, 271
Moesia 126
Morava 125
Murat Kaloshi 96

N
N. Brailsford 14
National Geographic Magazine 14
Ndrek Gjini 13
New England 39, 234
Nikaj e Mërtur 36, 86, 89, 99, 100, 109, 130, 142, 223, 235
Nikçi 100, 130
Nish 125, 126, 155, 163
Norman Douglas 14

O
Oroshi 86, 88, 144
Owen Pearson 14

P
Paleozoiku 35, 37, 234
Peja 33, 131, 132
Peshkopia 38, 47, 48, 64, 69, 132, 135, 224
Peter Peterson 258
Pjetri Hermit 123
Podrimja 45, 85
Postribë 100, 126, 129, 142
Prizreni 47, 48, 61, 108, 109, 132, 133, 190, 239
Problemi Dinarik 23
Prof. David Abulafia 14
Prof. Dr. Bardhyl Musai 14
Puka 31, 33, 38, 46, 48, 77, 99, 134, 143, 177, 183, 186, 202, 224
Pulatenses Majores 126
Pulatenses Minores 126
Pulti i Poshtëm 127, 130, 142, 143, 100, 249

Q
Qerreti 99, 143

R
Richard Knolles 14
Robert Curzon 14
Robert Elsie 14
Ruth Paddington 14
Rrape 48

S
Saga Norvegjeze 101
Selca 100
Sir Noel Malcolm 14
Stavri Frashëri 11, 34, 108, 109, 271, 277
Stefan Dushani 127
Shala 86, 89, 99, 142, 143, 237
Shkodër 39, 47, 48, 49, 60, 62, 103, 129, 132, 141, 266
Shoshi 88, 89, 99, 142, 143, 223, 237

T
Toplana 86, 99, 100, 142
Toskë 12, 35, 119, 122, 165, 171, 175, 246, 255, 258
Triasi 37, 234
Triepshi 99, 100
Tropoja 64
Thethi 100

V
Vaso Lazi 130
Vasojeviçët 130
Vuklit 100, 130

W
Washington 11
William J. Crozier Dr. 12